# Edukata Islame

*Revistë shkencore, kulturore islame tremujore*
*Viti XLII    nr. 99 / 2012*

**Edukata Islame**
**Revistë shkencore, kulturore islame tremujore**
Viti XLII    nr. 99 - 2012

*Botues:*
**Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**
*Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84*
*Tel & fax: 038 / 224-024*
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

*Kryeredaktor:*
**Mr. Qemajl Morina**
qemajlmorina@hotmail.com

*Redaksia:*
Akad. Pajazit Nushi, Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi, Hajrullah Hoxha dhe Dr. Xhabir Hamiti.

*Sekretar i redaksisë:*
***Hajrullah Hoxha***

*Lektor:*
Bislim Berisha

*Korrektor:*
Skender Rashiti

*Realizimi:* **Shtëpia Botuese**

*Redaktor teknik &*
*Operator kompjuterik:*
Nuhi Simnica

Tirazhi: 600

# Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLI    nr. 99 / 2012

Prishtinë
2012

## EDITORIALI

*Qemajl Morina*

# MEHMET AKIF ERSOJI - POETI I DY POPUJVE

Në Bursa të Turqisë, më 27 dhjetor 2011 u mbajt sesioni shkencor me temën: "Mehmet Akif Ersoji nga këndvështrimi ballkanik", me rastin e 75 vjetorit të vdekjes së poetit të madh turk me origjinë shqiptare. Sesioni shkencor ishte organizuar nga Revista për Studime Ballkanike në bashkëpunim me Universitetin Uludag dhe komunën Osmangazi të Bursës.

## Revista për studime ballkanike

Revista për Studime Ballkanike botohet nga studentët shqiptarë që studiojnë në Universitetin Uludag të Bursës, në të cilën trajtohen tema që kanë të bëjnë me kulturën e popujve të Ballkanit gjatë periudhës osmane si dhe atë të më vonshme. Deri më tani kishin nxjerr disa numra. Në universitetin e Bursës studiojnë mbi dyzet studentë shqiptarë. Shumica prej tyre në studime pasdiplomike. Në tezat e tyre të magjistraturës dhe doktorantures shtjellojnë tema nga realiteti ballkanik që ka të bëjë me kulturën dhe civilizimin osman.



Revista Studime Ballkanike[1] është revistë akademike, e cila ka filluar të botohet në prill 2010 nga studentët që vijojnë studimet pasdiplomike (master dhe doktoranturë) në Turqi. Revista botohet dy herë në vit, në gjuhën turke dhe sipas punimeve deri 30% në gjuhën angleze. E veçanta e kësaj reviste qëndron në atë se është e vetmja revistë akademike me përbërje të arbitërve (vlerësuesve) që merren direkt me studime ballkanike në Turqi dhe momentalisht ka mbi 60 vlerësues (arbitër) akademikë brenda dhe jashtë Turqisë. Në këtë revistë përveç punimeve të studiuesve të rinj nga Ballkani ka punime edhe të studiuesve tjerë që merren me studime ballkanike. Andaj, revista është e hapur për të gjithë ata që kanë shpirt studiues në çështjet ballkanike.

Ndër qëllimet kryesore të kësaj reviste është angazhimi dhe stimulimi sa më i madh i studiuesve të rinj për studimin, analizën dhe zgjidhjen e shumë çështjeve dhe problemeve aktuale ballkanike, duke u përpjekur për të siguruar një të ardhme më të mirë, në harmoni dhe tolerancë të ndërsjellë në mes popujve që jetojnë në Ballkan.

Po ashtu synohet të jepet kontribut sa më i madh në fushën e studimeve ballkanike, si brenda ashtu edhe jashtë Turqisë, duke bashkëpunuar me institucione të niveleve të ndryshme shkencore dhe kulturore; duke organizuar aktivitete të ndryshme shkencore dhe akademike si konferenca, panele, sesione, simpoziume dhe kongrese. Në këtë mënyrë revista pretendon të jetë një bazë e fort referente për çështjet ballkanike.

Qëllim dhe përpjekje tjetër e revistës është që të bëhet urë lidhëse e elitës intelektuale dhe akademike në Turqi dhe asaj ballkanase.

Po ashtu në kuadër të "Revistës Studime Ballkanike" kanë filluar përkthimet e disa titujve të rëndësishëm nga gjuha turke në gjuhën shqipe, boshnjake dhe maqedonase. Si shtesë e numrit të dytë të revistës është botuar indeksi i punimeve të masterit dhe doktorantures në lidhje me Ballkanin të punuara në Turqi.

[1] Të dhënat për Revistën i ka dërguar ndihmës redaktori, Sead Paçarizi,i cili është në fazën e përgatitjes së temës së doktoraturës.

Në kuadër të aktiviteteve për një kohë të shkurtër nga themelimi i saj, revista krahas botimeve të punimeve të ndryshme shkencore, më datë 18 maj 2011 ka organizuar një panel me temë “Perceptimi i Osmanlinjve në Ballkan sot”, ku janë paraqitur me kumtesat e tyre studentët ballkanas që vazhdojnë studimet pasdiplomike në Bursa.

Po ashtu më 27.12.2011, me rastin e përvjetorit të 75 të vdekjes së poetit Islam, Mehmet Akif Ersojit, Revista Studime Ballkanike në bashkëpunim me Fakultetin Teologjik të Universitetit Uludağ në Bursa ka organizuar një panel shkencor me temën: “Mehmet Akif Ersoj nga këndvështrimi ballkanasëve” i kryesuar nga Prof. Dr. Mefail Hızlı, ku janë paraqitur me kumtesat e tyre studiuesit nga vende të ndryshme të Ballkanit si:

1. Sabri Alagöz (Bullgari): Mehmet Akif Ersoj dhe Luftrat Ballkanike.
2. Qemajl Morina (Kosovë): Poeti i Islamit në faqet e revistës “Arrrisale” të Kajros.
3. Muhamet Aruçi (Turqi): Mehmet Akif Ersoj element bashkimi i kulturave ballkanike dhe asaj turke.
4. Sulejman Baki (Maqedoni): Mehmet Akif Ersoj në poezitë e poetit shkupjan Fetah Efendiut.

Me rastin e dy vjetorit të daljes së revistës, me datë 2 Prill 2012, në ambientet e Fakultetit Teologjik në Bursa do të organizohet një seminar me temë: “Selaniku si Vilajet Osman në periudhën e Tanzimatit”

Kurse me rastin e 100 vjetorit të tërheqjes së Osmanlinjve nga Ballkani, në dhjetor 2012, në bashkëpunim me Fakultetin Teologjik, Revista do të organizojë një simpozium ndërkombëtarë me temë “Ballkani në Shekullin XX-të”, ku pritet të marrin pjesë një numër i konsiderueshëm i studiuesve të ndryshëm nga Turqia, Ballkani dhe Evropa.



## Bursa qendër e shqiptarëve në Turqi

Është me rëndësi të potencohet se Bursa është ndër qytetet ku jeton një numër shumë i madh i shqiptarëve qysh nga kohërat më të hershme të marrëdhënieve osmano-shqiptare. Për këtë nuk është për të habitur kur sot në postet kyçe të komunës gjejmë shqiptarë, siç ishte rasti me Nexhmedin Shenoxhak, i cili ishte sekretar i përgjithshëm i Komunës kryesore të Bursës. Familja e të cilit ishte shpërngulur në Turqi në vitin 1958 nga fshati Hodonovc, komuna e Kamenicës.

Sipas të dhënave shumë të sakta thuhet se numri i qytetarëve të Bursës me orgjinë shqiptare mund të jetë më shumë se njëqind mijë. Ajo që vlen të theksohet me këtë rast është se pas demokratizimit të Turqisë, pas ardhjes në pushtet të partisë Drejtësi dhe Zhvillim të Rexhep Tajib Erdoganit, shqiptarët dhe popujt tjerë të vendosur në Turqi, në periudha të ndryshme kohore, janë të lirë të shprehin identitetin e tyre kombëtar dhe gjuhësor. Aq më tepër kjo iniciativë po gjen përkrahje nga qeveria dhe institucionet e Turqisë, për të ndërtuar ura bashkëpunimi në mes popujve, të cilët me shekuj kishin jetuar nën ombrellën e Perandorisë Osmane.

Kjo iniciativë po manifestohet edhe nëpërmes figurave, të cilët lanë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën e popujve të ndryshëm, siç ishte shembulli poetit Mehmet Akif Ersojit, me rastin e 75 vjetorit të vdekjes së tij.

## Jeta dhe veprimtaria e Mehmet Akif Ersojit (1873-1936)

Lindi në Stamboll më 20 dhjetor 1873, në lagjen Fatih. Është djali i myderriz Mehmet Tahir Efendiut, myderriz i njohur në Medresenë e njohur Fatih të Stambollit. I lindur më 1826 në katundin Sushicë, në rrethin e Pejës, ndërsa ndërroi jetë në Stamboll më vitin 1888.

Mehmet Akif Ersoji, në kujtimet e tij, për myderriz Tahir Efndiun, pra, për babain e tij, ndër të tjera, shkruan: “Ai qe edhe babai, edhe hoxha (mësues) im. Çka di, kam mësuar prej tij...”

Rrugën e të atit e ndoqi dhe i biri, Mehmet Akifi. Nga shënimet e studiuesit turk, Ertugrull Dyzdag për jetën dhe veprën e Mehmet Akifit, shihet talenti i tij i rrallë i nxënies së diturive që në moshë të re, sidomos në përvetësimin e gjuhëve dhe dëshira për të lexuar e shkruar poezi. Ai përveç gjuhës turke zotëronte shkëlqyeshëm arabishten, e cila ishte gjuhë e Kur'anit dhe persishten, gjuha e letërsisë osmane. Më vonë në Paris, përvetësoi edhe frëngjishten e gjermanishten. Theksojmë se Mehmet Akifi zotëronte bukur edhe shqipen. Zotërimi i këtyre gjuhëve i mundësoi Mehmet Akifit të lexonte vepra burimore nga ato gjuhë dhe së këndejmi të njihej në kulturat e atyre popujve nga burime të dorës së parë, sidomos me veprat poetike të klasikëve persianë, arabë, turq etj.

Mësimet fillestar i kreu në shkollën "Emir Buhari", vazhdoi "Iptidaijen", "Ruzhdijen" e "Idadijen". Në vitin 1893 diplomoi në Fakultetin e Veterinarisë, ku ishte shpallur studenti më i mirë.

Krahas mësimeve, studimeve, Mehmet Akifi në Medresenë "Tabhane' të Stambollit mësonte gjuhën arabe dhe përgatitej për Hafiz. Në vitin 1894,meqë e mësoi përmendsh Kur'anin e shenjtë, e mori titullin: Hafiz i Kur'anit, pranë dijetarit, Hafiz Isa Efendiut.

Në vitin 1894 nis punën si inspektor i veterinarisë, ku iu dha rasti me shëtitë, me vizitua shumë qytete të ndryshme të shtetit, si Rumeli, Anadoll e deri në Arabi.

Në vitin 1918 u emrua kryesekretar i Këshillit të Lartë Islam (Darul Hikmet'l Islamijet).

Në qershor të vitit 1920 u zgjodh deputet i Burdurit dhe u pranua nga Kuvendi (Mexhlisi).

Më 1921 teksti i tij, Marshi i pavarësisë, u zgjodh për himnin kombëtar të Turqisë në një konkurrencë prej më shumë se 700 konkurruesve.

Në shtator të vitit 1922, Mehmet Akifi u zgjodh anëtar i Akademisë së Studimeve Islame të Turqisë.

Prej vitit 1925 deri më 1936, Mehmet Akifi ka jetuar e punuar në Universitetin e Kajros si profesor i letërsisë turke.



Ditën e diel,në mbrëmje, në ora 19.45 më 27 dhjetor 1936 ndërroi jetë në Stamboll në moshën 63 vjeçare. Ditën e hënë më 28 dhjetor 1936, pas namazit të drekës, në xhaminë Pajazit u fal namazi i xhenazes, në praninë e mijëra admiruesve, kryesisht studentë universitarë, të cilët, në shenjë nderimi e bartën në duart e tyre deri në Varrezat e Dëshmorëve në Edirne kapi.

Populli nuk e ka harruar këtë figurë të ndritur dhe me ndikim të historisë më të re të Turqisë. Shumë salla, sheshe, lagje, rrugë e shkolla bartin emrin e tij, duke e bërë kështu të pavdekshëm.

## Mehmet Akifi në Kajro

Të rralla janë ato figura, të cilat gërshetojnë marrëdhëniet tradicionalisht të mira, në mes popullit shqiptar dhe atij turk, siç e bëri këtë poeti ynë i madh Mehmet Akif Ersoj. Ai u mishërua me Kosovën, vendlindjen e babait të vet, të cilës ia kushtoi njërën prej poezive të tija më të mira, "Unë jam shqiptar[2]" (Ben Arnavudum), ku thotë:

*Kudo që gjendem më parafytyrohet si fantazma*
*Një fushë e përgjakur.*
*A je ti e vërtetë apo parafytyrim?*
*E shkreta Kosovë?*

Për të vazhduar:

*"Dëgjojeni këtë prej meje, që vërtet, jam shqiptar…*
*Gjë tjetër s'mund të them… Ja, atdheu im është rrënuar.*

---

[2] Safahat, fq.206, marrë nga artikulli: "Me sy kah vendlindja", i autorit Hajrullah Halit Aktur, (Rilindja), 28 korrik 1979, fq. 20, Prishtinë.
Shih poashtu:
- Dr. Skendr Rizaj, Shqiptari Akif Mehmeti – poeti më i madh i letërsisë turke, (Fjala), Prishtinë, 1 tetor 1984, fq.10.
- Dr. Skender Rizaj, Shqiptari Akif Mehmeti – poeti më i madh i letërsisë turke, (Bujku), Prishtinë, 17 dhjetor 1994, fq.11.
- Shyqri Nimani, Poeti i madh Akif Mehmet Pejani, "Ekskluzive" (revistë mujore për aktualitet,kulturë, shkencë, sport, Prishtinë, nr. 25, maj 2002, fq.93-96.

Poashtu, ai u mishërua me Turqinë, atdheun e tij, për të cilën shkroi tekstin e himnit kombëtar që mbanë titullin: “Marshi pavarësisë” (Istiklal Marsh)[3].

*“Nuk shuhet flamuri i kuq që valëvitet në këto troje,*
*Pa u shuar oxhaku i fundit që tymon mbi vendin tim;*
*Ai është ylli i kombit tim, do të ndriçojë,*
*Ai është i imi, ai është vetëm i kombit tim!”*

Prej kësaj shohim, se sa ishte i lidhur ngushtë Mehmet Akifi me fatin e Kosovës, por edhe me fatin e të gjitha trojeve shqiptare. Kështu më 21 shkurt të vitit 1922, ai shkruan:

*Ngrehu baba, ngrehu nga varri !*
*Dhe shih se për qefin e tri vetave kokëkrisur,*
*Si vritet një popull tre milionash!*
*Eja shpejt, sepse të gjallët nuk po vijnë*
*Të shpëtojnë atdheun tonë…*
*Shqipëria po digjet flakë..*
*Baba! Nëna jote më e dashur, që është atdheu yt,*
*Vendlindja jote po flijohet*
*Për ambiciet e tre vetave kokëtrashë!*
*Tokë e lëvruar nga gjyshërit tanë*
*Dhe arat e mbjella po i merr lumi…*
*Sa keq, që tashmë po ngulitet në tokë kryqi i të huajit…*
*Dhe të vallëzojë në të këmba e sqaut (ushtarit serb)…*
*Oh! Kudo më del përpara Kosova!*[4]

Ashtu siç përmendet në biografinë e tij, Mehmet Akif Ersoj, pjesën e fundit të jetës së tij e kaloi në Egjipt. Për herë të parë shkoi në muajin tetor 1923, bashkë me princin Abbas Halim Pashën, nga dinastia shqiptare dhe si i ftuar i tij. Aty kaloi dy dimrat e viteve 1923 dhe 1924, pastaj bashkë, me Pashanë, u kthyen në Stamboll në pranverën e viteve 1924 dhe 1925. Pas vajtjes së fundit më 1925, nuk u kthye gjer më 1936.

[3] Mehmet Akif Ersoj, Fletët (Safahat), Logos A, Shkup, 2006, fq. 568.
[4] Nexhip Alpan, marrë nga "Drita Islame" (organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë), Tiranë, nr. 1 (84) 1996.



Gjatë qëndrimit të tij në Kajro, banoi dy vjet në një vilë të vogël të caktuar për të që ndodhej përballë sarajit të Abbas Halim Pashës në kasabanë e Hilvanit, jashtë Kajros, kurse pasi e pati sjellë familjen, pati marrë me qira një shtëpi të vogël në një skaj të Hilvanit.[5]

Pas ardhjes së dytë në Kajro, Mehmet Akifi, me propozimin e kolegut dhe mikut të tij, Dr. Abdul Vehab Azzam, u inkuadrua në Universitetin e Kajros, në Fakultetin Filologjik, profesor i gjuhës dhe letërsisë turke[6]. Këtë profesion ai e kreu deri në vitin 1936, do të thotë për më shumë se dhjetë vjet me radhë. Kjo shihet edhe nga të dhënat e profesorëve, të cilat gjenden në Arkivin e Fakultetit të Filologjisë, pranë Universitetit të Kajros.[7] Po ashtu kjo shihet edhe nga poezitë e tij të botuara në përmbledhjen e tij "Safahat", duke filluar me poezinë "Me Faronin sy më sy", e cila mban datën e 23 dhjetorit 1923 e deri në vitin 1926, përveç datës, autori shënon edhe vendin Hilvan, lagje e Kajros ku banonte Mehmet Akifi.[8]

Vendosja e Mehmet Akifit në Kajro, në atë kohë si duket ishte një zgjidhje kompromisi, në rrethanat e krijuara në Turqi, si shkak i një seri reformash që ishin ndërmarrë në atë kohë nga pushteti i ri. Mehmet Akifi, si një mendimtar i kalibrit të lartë islam nuk mund të pajtohej me një veprimtari të tillë. Andaj, largimi i tij në Egjipt, ku kishte përkrahjen morale dhe materiale të dinastisë shqiptare, përkrahjen e parazervë të kolonisë shqiptare, por edhe të inteligjencës egjiptiane, të cilët e çmonin lartë veprimtarinë e tij letrare, mu për këtë edhe e angazhuan në Universitetin e Kajros. Në të njëjtën kohë, Kajroja ishte një qendër e madhe dhe me rëndësi e mendimit islam. Me një fjalë, Mehmet Akifi në një mënyrë apo tjetër kishte zgjedhur një lloj azili politik në atë kohë. Kurse në Kajro kishte gjetur një ambient të përshtatshëm për vazhdimin e krijimtarisë së tij letrare.

[5] Mehmet Akif Ersoj, Fletët (Safahat), Logos - A , Shkup, 2006, fq.58.
[6] الرسالة العدد 187 1 فبراير 1937 السنة الخامسة القاهرة ص 181
[7] Këto të dhëna i kam vërtetuar gjatë një hulumtimi që kam bërë në Arkivin e Fakultetit të Filologjisë në vitin 1978, kur isha në studime pas diplomike (1976-1979).
[8] Safahat, shih: prej faqe 517 – 584, botimi shqip i Logos-A, Shkup 2006.

Mehmet Akifin, në atë kohë e mbante shpresa se Turqia, e cila ishte i vetmi shtet islam i pavarur dhe kishte mbetur i lirë, do të përpiqej pas kësaj, për t'i zgjuar kombet tjerë myslimanë të robëruar. Mirëpo, fakti që shteti i porsaformuar, duke u kthyer krejtësisht nga Evropa, e kishte braktisur botën islame, nuk ishte diçka që mund të pranonte Mehmet Akifi. Prandaj, duke e braktisur vatanin për besnikërinë ndaj të cilit kishte bërtitur me zë të lartë te Marshi i Pavarësisë, ishte tërhequr në pasivitet.[9]

## Poeti i Islamit[10] në faqet e revistës "Err-rrisale" të Kajros

Prezenca e tij në metropolin e Egjiptit, në veçanti angazhimi i tij profesor i gjuhës dhe letërsisë turke në Universitetin e Kajros, kishin ndikuar që krijimtaria e tij letrare të jetë më shumë prezentë në shtypin egjiptian të kohës. Kështu shohim që nga vendosja e tij në Kajro botimin e pjesëve të zgjedhura të poezive të tij në shtypin e Kajros. Pjesa më e madhe e tyre në revistën "Err-rrisale[11]" (Misioni). Botohet edhe pjesa e parë e veprës së tij “Safahat” në vitin 1353 h apo 1933, një kopje të së cilës ia kishte dhurua në shenjë kujtimi Hasan ef. Nahit nga Gjakova, i cili në atë kohë gjendej në studime në Universitetin e El-az-harit” në Kajro, që tregon për lidhjet e vazhdueshme që mbante Mehmet Akifi me shqiptarët.

Me këtë rast vlen të theksohet se nën rubrikën e rregullt, të cilën e mbante Dr. Abdul Vehab Azzam, hasim shumë poezi të përkthyera në shumë numra të revistës "Err-rrisale". Prej tyre po përmendim: "Fyelltari qorr"[12]. Përkthimit i paraprin një hyrje nga Dr.Abdul Vehab Azzam. Pastaj, vijojnë poezitë "Sejfi Baba"[13], "Artisti"[14] etj.

[9] Safahat (Fletët), Logos - A, Shkup, 2006, fq.59.
[10] Autori thotë se kështu quhej në Turqi Mehmet Akifi.
[11] Revistë javore prestigjioze për letërsi dhe kulturë ku u botuan shumica e poezive të Mehmet Akifit, u botua në Kajro për afër 20 vjet me radhë. Kryeredaktor i saj ishte shkrimtari i njohur egjiptian Ahmed Hasen Ez-zajat (1885-1968).
[12] Err-rrisale, Kajro, nr.9, 16 maj 1933, fq.29.
[13] Ibid, nr. 12, 1 korrik 1933, fq.27.
[14] Ibid. nr. 18, 1 tetor 1933, fq.30-32.



Por, ajo që zgjon kërshërinë e lexuesit, janë disa shkrime që u botuan me rastin e vdekjes së poetit, të cilat kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e tij. Autor i këtyre shkrimeve është kolegu dhe miku i tij i ngushtë, gjatë qëndrimit të Mehmet Akifit në Kajro, Dr. Abdul Vehab Azzam. Andaj, në faqet në vijim do t'i bëjmë një vështrim të shkurtër të disa artikujve, që janë botuar në revistën “Err-rrisale”, të cilët janë të lidhur ngushtë me jetën, veprimtarinë, por edhe botën e brendshme të poetit, në dekadën e fundit të jetës së tij në Kajro.

## Mehmet Akifi – poet i Islamit

Nën këtë titull, Dr. Abdul Vehab Azzam nis shkrimin e tij, për të vazhduar pesë vazhdime për Mehmet Akifin.[15]

"Kisha lexuar emrin e Mehmet Akifit në mesin e shkrimtarëve më të njohur bashkëkohor të letërsisë turke, por kisha pasur rastin të njihem me një pjesë shumë të vogël të veprimtarisë së tij poetike. Kur para shtatë vjetëve, kisha shkuar në Stamboll, Mehmet Akifi ishte vendosur në Egjipt. Ky rast më mundësoi të njihem për së afërmi me biografinë dhe veprimtarinë e tij, gjë që u bë më i dashur tek unë. Posa u ktheva në Egjipt shkova ta vizitoj. Ishte fat i mirë që ai ishte vendosur pranë meje në Hilvan, mysafir i princit Abas Halim Pashës.

Shkova në shtëpinë e tij, trokita në derë dhe ja para meje del një njeri që kishte kaluar të gjashtëdhjetat, me një trup të drejtë, ku dukeshin shenjat e modestisë dhe të pjekurisë. Më dëshiroi mirëseardhje. Hyra brenda u ula. Biseduam për një kohë, duke hapur me këtë një fazë të re të miqësisë në mes nesh.

Miku im ishte i marrueshëm, fjalëpak, mendonte gjatë, heshtte shumë, anonte në izolim, i ikte tubimeve të mëdha. Kjo më kishte bërë që gjithherë ta gjej në shtëpi dhe të bisedoj gjatë me të."

"Vizitat tona ishin të shpeshta. Më vizitonte apo e vizitoja. Bisedonim gjatë për të kaluarën dhe të tashmen. Biseda kalonte në tema të ndryshme, si letërsi, histori dhe gjendjen aktuale të myslimanëve. Kur i pëlqente biseda kërkonte nga bashkëbiseduesi të vazhdojë, kurse ai

[15] Err-rrisale nr.187, 1 shkurt 1337, fq.181.

dëgjonte me vëmendje. Kurse nëse në mexhlis merrte pjesë edhe dikush tjetër, ai heshtte nga modestia dhe marrja . Kur kërkoja prej tij që ai ta merrte fjalën, lëvizte kokën duke refuzuar të bëjë një gjë të tillë. Nëse përgjigjej këtë e bënte shumë shkurt pastaj i kthehej heshtjes. Kur përfundonte mexhlisi, ai më shprehte mua përshtypjet e tij, i pajtuar apo jo, i kënaqur apo i nervozuar."

Në vazhdimin e dytë[16] ai boton një shkrim që dhëndri i tij, Omer Rida kishte botuar në shtypin turk në muajt e fundit, pas keqësimit të gjendjes së tij shëndetësore.

Në vazhdimin e tretë [17] autori shkruan një artikull të gjatë ku përfshin shkrimet e të gjitha gazetave të Turqisë që kishin shkruar me rastin e vdekjes së Mehmet Akifit, duke e përfshirë edhe një biografi të tij. Ai fillon shkrimin me këto fjalë: “Vdiq poeti i madh në ora tetë pa një çerek të mbrëmjes së ditës së enjte të 29 dhjetorit, duke i lënë popullit turk vepra të pavdekshme si “Mbrojtja e Çana kalas” dhe “Himnin e pavarësisë”.

Mehmet Akifi kishte një respekt të madh ndaj shumë poetëve, prej arabëve: ibnu al-Farid, prej turqve Fudulin, prej persianëve Sadiun, kurse prej francezëve La Martinin.

Në vazhdimin e katërt[18]. Dr. Abdul Vehab Azzam, i bënë një analizë të veçantë poezisë së Mehmet Akifit, në mënyrë të posaçme veprës së tij më të njohur “Safahat”, duke filluar prej numrit të parë të saj deri ke i shtati.

Në vazhdimin e pestë[19], autori i bën një vështrim një lloj poezie tjetër të Mehmet Akifit, të cilën ai e quan poezi shoqërore, që ishte prezente në veprimtarinë letrare të poetit tanë të njohur.

Besoj se kjo kumtesë modeste lidhur me poezinë e Mehmet Akif Ersojit në revistën “Err-rrisale” të Kajros, me rastin e 75 vjetorit të vdekjes së poetit do të ndriçojë sa do pak dekadën e fundit të jetës së tij që kaloi në kryeqendrën e Egjiptit në Kajro..

[16] “Err-rrisale”, nr.188, 8 shkurt 1937, fq.226.
[17] “Err-rrisale”, nr.189, 15 shkurt 1937, fq.267.
[18] “Err-rrisale”, nr.194, 22 mars 1937, fq.469.
[19] “Err-rrisale”, nr.220, 10 maj 1937, fq.782.



Në anën tjetër tregon se përveç përkatësisë së tij shqiptare dhe turke, ai i përkiste universit të gjerë islam, i cili e përshkoi tërë veprimtarinë e tij letrare dhe meritoi epitetin, “poet i Islamit”, siç e quajti revista e mirënjohur e Kajros “Err-rrisale”.

Ajo që vlen të theksohet me këtë rast dhe që na jep shpresë është se idetë dhe vizioni i Mehmet Akif Ersojit, për një jetë të dinjitetshme të myslimanëve po realizohet në praktikë në shumë vende të botës islame.

شاعر الاسلام

محمد عاكف

بقلم الدكتور عبد الوهاب عزام

*Faksimil nga revista “Err-Rrisale” e Kajros (shkurt, 1937)*

*Qemajl Morina*

## MEHMET AKIF ERSOY – THE POET OF TWO NATIONS

### (Summary)

On December 27, 2011, a scientific session on “Mehmet Akif Ersoy” was held in Bursa – Turkey on the 75th anniversary of the death of the great Turkish poet of Albanian origin. The session was organized by the Journal of Balkan Studies in cooperation with the Uludag University and the Osmangazi municipality in Bursa.

*كمال مورينا*

## محمد عاكف أرسوى – شاعر الشعبين

### (خلاصة البحث)

بمناسبة مرور 75 سنة من وفاة الشاعرالتركى الكبير من اصل البانى محمد عاكف أرسوى تم انعقاد جلسة علمية بتاريخ 27 ديسمبر 2011 بمدينة بورصا فى تركيا و عنوانها: "محمد عاكف أرسوى من وجهة نظرة بلقانية". و قد تم تنظيم هذه الجلسة من مجلة الدراسات البلقانية بالتعاون مع جامعة ألوداغ و بلدية أوسمانغازي و حضر هذه الجلسة باحثون من كل من مقدونيا و كوسوفا و بلغاريا و تركيا.

**STUDIME**

*Nexhat Ibrahimi*

# PEJGAMBERËT E DALLUAR
## ( أُولُو الْعَزْمِ - Ulu'l-azm)

Dërgimi i pejgamberëve (resulë apo nebijë) është urtësi dhe mëshirë e jo pamundshmëri as anakronizëm, për shkak të pamjaftueshmërisë së njeriut[1] që t'i perceptojë dhe përvetësojë të gjitha gjërat që i sheh apo jo, që janë shpirtërore apo materiale, të kësaj apo asaj bote.

Në besimin islam të gjithë pejgamberët në parim janë të barabartë. Të tillë duhet t'i besojmë pa përjashtim. Por, sikur që në botën njerëzore disa njerëz kanë nivele shoqërore dhe shpirtërore më të larta, ashtu edhe në botën pejgamberike disa prej tyre kanë nivele më të larta se disa të tjerë. Kur'ani lidhur me këtë thotë:

تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ ۘ مِّنْهُم مَّن كَلَّمَ اللَّهُ ۖ وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ دَرَجَاتٍ ...

***"Ata të dërguar ne i kemi dalluar disa nga të tjerët. Me disa prej tyre ka folur Allahu e disa i ka ngritur për disa shkallë…".*** *(El-Bekare: 253).*

[1] Imam Nuruddin Es-Sabuni, Akaidi maturidij, Prishtinë, 2011, fq. 91 e tutje.

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ مِنْهُم مَّن قَصَصْنَا عَلَيْكَ وَمِنْهُم مَّن لَّمْ نَقْصُصْ عَلَيْكَ ۗ وَمَا كَانَ لِرَسُولٍ أَن يَأْتِيَ بِآيَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ...

***"Ne kemi dërguar pejgamberë para teje, për disa prej tyre të kemi njoftuar me rrëfimet e tyre, e për disa sish nuk të kemi njoftuar, e asnjë pejgamberi nuk i takoi të sjellë ndonjë argument, vetëm se me urdhrin e Allahut...".*** *(Gafir / Mu'min, 78).*

Në mesin e pejgamberëve me nivel të dalluar, të vendosmërisë së lartë, sipas numrit më të madh të dijetarëve myslimanë (أُولُو الْعَزْمِ / ulu'l-azmi) bëjnë pjesë: Ademi, Nuhiu, Musai, Ibrahimi, Isai dhe Muhammedi a.s.[2]

Këta janë ata që e kanë zbatuar detyrën për ta komunikuar te njerëzit fenë me vendosmëri të lartë, pa shfaqur shenja tërheqjeje para sfidave dhe problemeve, para përgjegjësive të marra përsipër. Kur'ani përmend se *sabri* (durimi) dhe *takvallëku* (devotshmëria) janë veçoritë thelbësore të *'azmit* (vendosmërisë).

Kur'ani e përshkruan këtë çështje në ajetin vijues:

وَإِذْ أَخَذْنَا مِنَ النَّبِيِّينَ مِيثَاقَهُمْ وَمِنكَ وَمِن نُّوحٍ وَإِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ ۖ وَأَخَذْنَا مِنْهُم مِّيثَاقًا غَلِيظًا .

***"Ne nga pejgamberët kemi marrë zotimin. Edhe prej teje, edhe prej Nuhiut, Ibrahimit, Musait dhe prej Isait, të birit të Merjemes, kemi marrë prej tyre zotim të fortë."*** *(El-Ahzab: 7).*

فَاصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُولُو الْعَزْمِ مِنَ الرُّسُلِ...

***"Ti kesh durim siç kanë duruar pejgamberët më të vendosur ...".*** *(El-Ahkaf: 35).*[3]

[2] Disa historianë të historisë së pejgamberëve Ademin a.s. nuk e radhisin në mesin e pejgamberëve *ulu'l-azm*. Megjithëkëtë fakt, mendojmë, krahas edhe shumë autoriteteve shkencore, se do të ishte e drejtë të theksohet edhe Ademi a.s. Arsyet e përfshirjes së tij në mesin e ulu'l-azmit janë të shumta dhe racionale.

[3] Gjerësisht: Bekir Topaloglu - Yusuf Shevki – Ilyas Çelebi, Bazat e besimit islam, Prishtinë, 2002, fq. 123-161.

## 1) Ademi a.s.

Kur’ani flet për Ademin a.s. në disa sure dhe atë si për qenie njerëzore. Sipas të dhënave kur’anore, Ademi është njeriu i parë dhe i dërguari i parë i Zotit. Emri i tij jep dy kuptime kryesore:

1. *Adem*, do të thotë qenia e krijuar nga dheu, sepse edhe sipërfaqja e dheut quhet *edim*.

2. *Adem*, do të thotë qenie e krijuar nga hiçi, asgjëja, me vullnetin e Krijuesit:

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَن يَقُولَ لَهُ كُن فَيَكُونُ.

***“Kur ai dëshiron ndonjë send, urdhri i Tij është vetëm të thotë: Bëhu! Dhe ai bëhet.”*** *(Ja Sin, 82).*

Një pjesë e madhe e ajeteve kur’anore flasin për të, por rrëfimi kryesor është zhvilluar ndërmjet Krijuesit, melekëve dhe Iblisit. Ky shqyrtim është simbolik, por mjaft ilustrues për të vërtetat besimore paraekzistenciale dhe për psikologjinë dhe fatin e gjinisë njerëzore:

وَإِذْ قَالَ رَبُّكَ لِلْمَلَائِكَةِ إِنِّي جَاعِلٌ فِي الْأَرْضِ خَلِيفَةً ۖ قَالُوا أَتَجْعَلُ فِيهَا مَن
يُفْسِدُ فِيهَا وَيَسْفِكُ الدِّمَاءَ وَنَحْنُ نُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ وَنُقَدِّسُ لَكَ ۖ قَالَ إِنِّي أَعْلَمُ
مَا لَا تَعْلَمُونَ . وَعَلَّمَ آدَمَ الْأَسْمَاءَ كُلَّهَا ثُمَّ عَرَضَهُمْ عَلَى الْمَلَائِكَةِ فَقَالَ أَنبِئُونِي
بِأَسْمَاءِ هَٰؤُلَاءِ إِن كُنتُمْ صَادِقِينَ . قَالُوا سُبْحَانَكَ لَا عِلْمَ لَنَا إِلَّا مَا عَلَّمْتَنَا ۖ
إِنَّكَ أَنتَ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ . قَالَ يَا آدَمُ أَنبِئْهُم بِأَسْمَائِهِمْ ۖ فَلَمَّا أَنبَأَهُم
بِأَسْمَائِهِمْ قَالَ أَلَمْ أَقُل لَّكُمْ إِنِّي أَعْلَمُ غَيْبَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَأَعْلَمُ مَا تُبْدُونَ
وَمَا كُنتُمْ تَكْتُمُونَ . وَإِذْ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ فَسَجَدُوا إِلَّا إِبْلِيسَ أَبَىٰ
وَاسْتَكْبَرَ وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ . وَقُلْنَا يَا آدَمُ اسْكُنْ أَنتَ وَزَوْجُكَ الْجَنَّةَ وَكُلَا
مِنْهَا رَغَدًا حَيْثُ شِئْتُمَا وَلَا تَقْرَبَا هَٰذِهِ الشَّجَرَةَ فَتَكُونَا مِنَ الظَّالِمِينَ . فَأَزَلَّهُمَا
الشَّيْطَانُ عَنْهَا فَأَخْرَجَهُمَا مِمَّا كَانَا فِيهِ ۖ وَقُلْنَا اهْبِطُوا بَعْضُكُمْ لِبَعْضٍ عَدُوٌّ ۖ



وَلَكُمْ فِي الْأَرْضِ مُسْتَقَرٌّ وَمَتَاعٌ إِلَىٰ حِينٍ. فَتَلَقَّىٰ آدَمُ مِن رَّبِّهِ كَلِمَاتٍ فَتَابَ
عَلَيْهِ ۚ إِنَّهُ هُوَ التَّوَّابُ الرَّحِيمُ .قُلْنَا اهْبِطُوا مِنْهَا جَمِيعًا ۖ فَإِمَّا يَأْتِيَنَّكُم مِّنِّي
هُدًى فَمَن تَبِعَ هُدَايَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ . وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا
بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَالِدُونَ .

***“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të caktoj përfaqësuesin në tokë” - Ata thanë: “A do të jetë përfaqësuesi yt ai që në të do të bëjë çrregullime e do të derdhë gjak? Na të madhërojmë e të lavdërojmë dhe të ngremë ashtu si të takon Ty”. Ai tha: Unë di atë që ju nuk dini. Allahu ia mësoi Ademit të gjithë emrat e pastaj ata ua paraqiti engjëjve dhe u tha: “Nëse e keni thënë të vërtetën, m’i tregoni emrat e këtyre sendeve”. “Qofsh i lavdëruar!” - thanë ata - “ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Ti je mendjemprehtë dhe i gjithëdijshëm”. O Adem, tha Ai, tregoju emrat e tyre! Kur ai u tregoi emrat e tyre, Allahu tha: “A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe vetëm Unë e di atë që tregoni haptazi dhe atë që e fshihni”. Kur u thamë engjëjve: “Përuluni para Ademit” - ata u përulën, por Iblisi nuk deshi, ai e rriti mendjen dhe u bë i pafé. Ne thamë “O Adem, të jetosh ti dhe gruaja jote në xhenet dhe të hani në të sa të doni dhe kur të doni, por mos iu afroni këtij lisi sepse i bëni keq vetvetes. Shejtani për shkak të këtij lisi i shtyri të gabojnë e t’i nxjerrë nga vendi ku ishin. “Zbritni - u thamë Ne - do të jeni armik i njëri-tjetrit e në Tokë do të qëndroni dhe do të jetoni deri në afatin e caktuar”. Ademi dëgjoi disa fjalë*** *(Urdhra)* ***e i zbatoi nga Zoti i vet. Ai ia pranoi pendimin dhe i fali gabimin. Ai shumë i pranon pendimet. Ai është i mëshirshëm. Ne u kemi thënë: “Zbritni të gjithë prej*** *(xhenetit)* ***tij. Juve me të vërtetë do t’ju vijë një dirigjues prej meje dhe ata që i përmbahen dirigjimit Tim nuk do të kenë frikë dhe nuk do të hidhërohen. Ata që nuk do të besojnë dhe i mohojnë argumentet tona do të jenë banorë të zjarrit, a në të do të mbesin gjithmonë.”*** *(El-Bekare, 30-39).*

Ademi a.s. është pejgamber kyç, i vendosur (ulu’l-azm) për shkak të disa pikave kryesore:

1. Allahu xh.sh. e ka krijuar Ademin me “dorën” e Tij, pa model pararendës dhe pa nevojë për të;
2. Allahu xh.sh. te Ademi e frymëzoi shpirtin e tij (ruhi), duke e dalluar nga krijesat tjera;
3. Melekët u urdhëruan t’i bëjnë sexhde njeriut, jo për adhurim, por për falënderim ndaj Krijuesit dhe;
4. Allahu i madhërishëm ia mësoi njeriut të gjitha emërtimet e gjësendeve, për dallim prej engjëjve, të cilët kanë dije të kufizuar.

Nga tërë e theksuara mund të kuptohet:

- Zoti e krijoi njeriun me synim dhe cak të qartë dhe nuk është qenie rastësie;
- Njeriu është përfaqësues, zëvendës i Zotit në Tokë; posedon aftësinë e mësimit dhe meditimit.
- Njeriu është qenie e respektuar, në shkallë më të lartë se engjëjt para syve të Krijuesit;
- Njeriu ka aftësi të mendojë, t’i dallojë fenomenet apo shfaqjet dhe gjerat rreth vetes;
- Ademi a.s. menjëherë pas krijimit ka jetuar në xhenet, në gjendjen e mosfrikës, mosprovokimit dhe vështirësive të shumta;
- Ademi është qenie e veçantë, por që në provokimin e shejtanit për një çast rrëshqiti dhe iu afrua pemës së ndaluar, duke shfaqur në këtë mënyrë instinktet anomale në qenien e tij;
- Pema e ndaluar dhe shijimi i saj paraqet kufirin apo ligjet e Zotit, të cilat do të latohen në natyrën njerëzore dhe simbolizon tendencën për jetën në këtë botë, që karakterizohet me dëshirën për përjetësi dhe pushtet sikurse edhe instinktin seksual, që do të rezultojë me dramën që e njohim si “bota jonë”;
- Femra është e llojit të mashkullit, respektivisht e një substance ( مِّن نَّفْسٍ وَاحِدَةٍ ) dhe nuk është qenie më e dobët se mashkulli. Edhe ajo është joshur nga pema e ndaluar e xhenetit, edhe ajo është penduar dhe së bashku me Ademin janë dëbuar nga xheneti; femra është e barabartë me mashkullin në çdo gjë: edhe në detyrime edhe në përgjegjësi.



- Pendimi (tevbeja) është institucion që garanton kthimin njerëzor në xhenet dhe e kundërta, mospendimi (pasimi i shejtanit) rezulton me vendosjen e njeriut në zjarr.[4]

## 2) Nuhiu a.s. dhe mrekullia e tij

Sipas disa burimeve, ndërmjet Ademit a.s. dhe Nuhiut a.s. kanë kaluar dhjetë breza. Në këtë etapë kohore jetëgjatësia e gjinisë njerëzore ka qenë shumë më e gjatë krahasuar me kohën tonë. Kur’ani njofton për jetëgjatësinë e tyre, kurse për Nuhiun a.s. thotë se ka ftuar në besimin në Zotin Një dhe të Vetëm:

وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَلَبِثَ فِيهِمْ أَلْفَ سَنَةٍ إِلَّا خَمْسِينَ عَامًا...

***“Ne e kemi dërguar Nuhiun te populli i tij – e ai qëndroi në mesin e tyre një mijë pa pesëdhjetë vjet”*** *(El-Ankebut, 14)*, që do të thotë se ai ka jetuar 950 vjet.

Nuhiu a.s. është pejgamberi i dytë (krahas Ademit a.s.) që pranoi mesazh hyjnor në Tokë, por pejgamberi i parë që iu drejtua njerëzisë me një platformë të qartë monoteizmi dhe që u përball në mënyrë këmbëngulëse me idhujtarinë (shirkun), amoralin dhe dhunën e vrazhdë:

لَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا إِلَىٰ قَوْمِهِ فَقَالَ يَا قَوْمِ اعْبُدُوا اللَّهَ مَا لَكُم مِّنْ إِلَٰهٍ غَيْرُهُ إِنِّي أَخَافُ عَلَيْكُمْ عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ . قَالَ الْمَلَأُ مِن قَوْمِهِ إِنَّا لَنَرَاكَ فِي ضَلَالٍ مُّبِينٍ . قَالَ يَا قَوْمِ لَيْسَ بِي ضَلَالَةٌ وَلَٰكِنِّي رَسُولٌ مِّن رَّبِّ الْعَالَمِينَ . أُبَلِّغُكُمْ رِسَالَاتِ رَبِّي وَأَنصَحُ لَكُمْ وَأَعْلَمُ مِنَ اللَّهِ مَا لَا تَعْلَمُونَ .

***“Na me të vërtetë, ua kemi dërguar Nuhiun popullit të tij, i cili u tha: “O populli im! Adhurojeni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij! – Unë frikësohem për ju nga dënimi në Ditën e madhe! Paria e popullit të tij thanë: “Na me të vërtetë, të shohim ty në humbje të madhe. Ai tha: “O populli im! Unë nuk jam në kurrfarë humbje, por***

[4] Dzemaludin Latic, Islam i svjetske religije, I, Sarajevo, 2000, fq. 36-38. Ahmed Behxhet, Të Dërguarit e Allahut, Prishtinë, 2009/ 1430 h., fq. 57 e tutje.

***jam pejgamber nga ana e Zotit të gjithësisë; ju sjell urdhrat e Zotit tim dhe ju dëshiroj çdo të mirë, unë di nga Allahu atë që nuk e dini ju.”*** *(El-A’raf, 59-61).*

Mendohet se dhjetë brezat e parë kanë pasuar udhëzimet e Ademit a.s., por pastaj ka pasuar neglizhenca, harresa dhe zbehja e besimit dhe shtrembërimi nga rruga e vërtetë. Ibn Abbasi kështu e komenton ajetin mbi idhujtarinë e popullit të Nuhiut a.s.: *“Assesi mos i braktisni zotat tuaj! Assesi mos e braktisni Veddanë, as Suvanë, as Jegusin, as Jeukin dhe as Nesranë!”*[5]

Nuhiu a.s., i njohur si “robi i cili gjithnjë ka falënderuar Allahun”, i ftonte popullin e tij të besojnë në Zotin, i cili krijon dhe i cili nuk ka rival, që pos Tij të mos adhurojnë zot tjetër.

Mirëpo, ftesa e Nuhiut a.s. nuk dha rezultate. Vetëm një numër i vogël i pasardhësve të tij iu përgjigj thirrjes pejgamberike. Këtë e thotë Kur’ani:

...وَمَا آمَنَ مَعَهُ إِلَّا قَلِيلٌ.

***“... E pak ka pasur të atillë, që kanë besuar me të.”*** *(Hud, 40).*

Natyra e popullit të devijuar kishte arritur shkallë të lartë të degjenerimit. Ata përbuznin fenë, pejgamberin Nuhi dhe çdo udhëzim e mësim fetar.

Kjo gjendje e pashpresë dhe e rëndë psikike dhe fizike e Nuhiut a.s. përballë idhujtarëve dhe idhujtarisë e detyroi Nuhiun a.s. t’i drejtohet Allahut xh.sh. për ndihmë. Ndihma nga Allahu ishte si vijon. Allahu xh.sh. e mësoi Nuhiun a.s. të ndërtojë një anije në një ambient të thatë, ku nuk kishte ujë (deti, liqen apo lum të madh) dhe e urdhëroi që brenda saj të fusë nga një çift prej të gjitha gjallesave. Brenda saj urdhëroi të futen edhe besimtarët. Pas hyrjes në anije, do të pasojë një

---

[5] Ibn Abbas, Tefsir, pjesa 6, Sarajevo, 2007/1428 h., fq. 225.
Veddai, Suvai, Jegusi, Jeuki dhe Nesrai janë njerëz të mirë të popullit të Nuhiut a.s. Pas vdekjes së tyre, me nxitjen e shejtanit të mallkuar, pasardhësit e tyre ndërtuan idhuj në vendin ku ata patën jetuar dhe i quajtën me emrat e tyre. Pas një kohe, pasi u harrua dija për ta, këta idhuj filluan të adhurohen. Në këtë mënyrë filloi adhurimi si dukuri e përgjithshme. Për idhujtarinë e Hixhazit shih: Muhammed Rewwas Qal’ahxhi, Licnost Bozijeg Poslanika, Sarajevo-Zenica , 1437 h./2006, fq. 13 e tutje.



vërshim i paparë deri atëherë. Këtë të vërtetë hyjnore kundërshtarët e refuzuan dhe Nuhiut a.s. nuk i mbeti tjetër pos të kërkojë fillimin e zbatimit të kërcënimit hyjnor.

Ja si e përshkruan Kur’ani ngjarjen e Nuhiut a.s.:

قَالَ يَا قَوْمِ أَرَأَيْتُمْ إِن كُنتُ عَلَىٰ بَيِّنَةٍ مِّن رَّبِّي وَآتَانِي رَحْمَةً مِّنْ عِندِهِ فَعُمِّيَتْ
عَلَيْكُمْ أَنُلْزِمُكُمُوهَا وَأَنتُمْ لَهَا كَارِهُونَ .وَيَا قَوْمِ لَا أَسْأَلُكُمْ عَلَيْهِ مَالًا ۖ إِنْ أَجْرِيَ
إِلَّا عَلَى اللَّهِ ۚ وَمَا أَنَا بِطَارِدِ الَّذِينَ آمَنُوا ۚ إِنَّهُم مُّلَاقُو رَبِّهِمْ وَلَٰكِنِّي أَرَاكُمْ
قَوْمًا تَجْهَلُونَ . وَيَا قَوْمِ مَن يَنصُرُنِي مِنَ اللَّهِ إِن طَرَدتُّهُمْ ۚ أَفَلَا تَذَكَّرُونَ . وَلَا
أَقُولُ لَكُمْ عِندِي خَزَائِنُ اللَّهِ وَلَا أَعْلَمُ الْغَيْبَ وَلَا أَقُولُ إِنِّي مَلَكٌ وَلَا أَقُولُ
لِلَّذِينَ تَزْدَرِي أَعْيُنُكُمْ لَن يُؤْتِيَهُمُ اللَّهُ خَيْرًا ۖ اللَّهُ أَعْلَمُ بِمَا فِي أَنفُسِهِمْ ۖ
إِنِّي إِذًا لَّمِنَ الظَّالِمِينَ . قَالُوا يَا نُوحُ قَدْ جَادَلْتَنَا فَأَكْثَرْتَ جِدَالَنَا فَأْتِنَا بِمَا تَعِدُنَا
إِن كُنتَ مِنَ الصَّادِقِينَ . قَالَ إِنَّمَا يَأْتِيكُم بِهِ اللَّهُ إِن شَاءَ وَمَا أَنتُم بِمُعْجِزِينَ .
وَلَا يَنفَعُكُمْ نُصْحِي إِنْ أَرَدتُّ أَنْ أَنصَحَ لَكُمْ إِن كَانَ اللَّهُ يُرِيدُ أَن يُغْوِيَكُمْ ۚ
هُوَ رَبُّكُمْ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ . أَمْ يَقُولُونَ افْتَرَاهُ ۖ قُلْ إِنِ افْتَرَيْتُهُ فَعَلَيَّ إِجْرَامِي وَأَنَا
بَرِيءٌ مِّمَّا تُجْرِمُونَ . وَأُوحِيَ إِلَىٰ نُوحٍ أَنَّهُ لَن يُؤْمِنَ مِن قَوْمِكَ إِلَّا مَن قَدْ آمَنَ
فَلَا تَبْتَئِسْ بِمَا كَانُوا يَفْعَلُونَ . وَاصْنَعِ الْفُلْكَ بِأَعْيُنِنَا وَوَحْيِنَا وَلَا تُخَاطِبْنِي فِي
الَّذِينَ ظَلَمُوا ۚ إِنَّهُم مُّغْرَقُونَ .وَيَصْنَعُ الْفُلْكَ وَكُلَّمَا مَرَّ عَلَيْهِ مَلَأٌ مِّن قَوْمِهِ
سَخِرُوا مِنْهُ ۚ قَالَ إِن تَسْخَرُوا مِنَّا فَإِنَّا نَسْخَرُ مِنكُمْ كَمَا تَسْخَرُونَ . فَسَوْفَ
تَعْلَمُونَ مَن يَأْتِيهِ عَذَابٌ يُخْزِيهِ وَيَحِلُّ عَلَيْهِ عَذَابٌ مُّقِيمٌ . حَتَّىٰ إِذَا جَاءَ أَمْرُنَا
وَفَارَ التَّنُّورُ قُلْنَا احْمِلْ فِيهَا مِن كُلٍّ زَوْجَيْنِ اثْنَيْنِ وَأَهْلَكَ إِلَّا مَن سَبَقَ عَلَيْهِ
الْقَوْلُ وَمَنْ آمَنَ ۚ وَمَا آمَنَ مَعَهُ إِلَّا قَلِيلٌ . وَقَالَ ارْكَبُوا فِيهَا بِسْمِ اللَّهِ مَجْرَاهَا
وَمُرْسَاهَا ۚ إِنَّ رَبِّي لَغَفُورٌ رَّحِيمٌ . وَهِيَ تَجْرِي بِهِمْ فِي مَوْجٍ كَالْجِبَالِ وَنَادَىٰ
نُوحٌ ابْنَهُ وَكَانَ فِي مَعْزِلٍ يَا بُنَيَّ ارْكَب مَّعَنَا وَلَا تَكُن مَّعَ الْكَافِرِينَ . قَالَ سَآوِي

إِلَىٰ جَبَلٍ يَعْصِمُنِي مِنَ الْمَاءِ ۚ قَالَ لَا عَاصِمَ الْيَوْمَ مِنْ أَمْرِ اللَّهِ إِلَّا مَن
رَّحِمَ ۚ وَحَالَ بَيْنَهُمَا الْمَوْجُ فَكَانَ مِنَ الْمُغْرَقِينَ . وَقِيلَ يَا أَرْضُ ابْلَعِي مَاءَكِ وَيَا
سَمَاءُ أَقْلِعِي وَغِيضَ الْمَاءُ وَقُضِيَ الْأَمْرُ وَاسْتَوَتْ عَلَى الْجُودِيِّ ۖ وَقِيلَ بُعْدًا
لِّلْقَوْمِ الظَّالِمِينَ . وَنَادَىٰ نُوحٌ رَّبَّهُ فَقَالَ رَبِّ إِنَّ ابْنِي مِنْ أَهْلِي وَإِنَّ وَعْدَكَ
الْحَقُّ وَأَنتَ أَحْكَمُ الْحَاكِمِينَ .قَالَ يَا نُوحُ إِنَّهُ لَيْسَ مِنْ أَهْلِكَ ۖ إِنَّهُ عَمَلٌ غَيْرُ
صَالِحٍ ۖ فَلَا تَسْأَلْنِ مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ ۖ إِنِّي أَعِظُكَ أَن تَكُونَ مِنَ الْجَاهِلِينَ
. قَالَ رَبِّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ أَنْ أَسْأَلَكَ مَا لَيْسَ لِي بِهِ عِلْمٌ ۖ وَإِلَّا تَغْفِرْ لِي
وَتَرْحَمْنِي أَكُن مِّنَ الْخَاسِرِينَ . قِيلَ يَا نُوحُ اهْبِطْ بِسَلَامٍ مِّنَّا وَبَرَكَاتٍ عَلَيْكَ
وَعَلَىٰ أُمَمٍ مِّمَّن مَّعَكَ ۚ وَأُمَمٌ سَنُمَتِّعُهُمْ ثُمَّ يَمَسُّهُم مِّنَّا عَذَابٌ أَلِيمٌ .

“Ai (Nuhiu) tha: “O populli im, ç’mendoni ju, nëse unë i përmbahem dokumentit të qartë të Zotit tim, madje Ai më ka dhënë nga Vetja mëshirë – e ju jeni të verbër për të, a mund t’jua imponojmë juve atë, kur ju nuk e dëshironi?” O populli im! Unë për këtë nuk kërkoj nga ju kurrfarë pasurie. Mua më shpërblen vetëm Perëndia. E, unë nuk mund t’i dëboj ata që besojnë. Ata do të takohen me Zotin e tyre. Mirëpo, unë shoh se ju, me të vërtetë, jeni popull që nuk di. O populli im kush do të më mbroj mua nga Perëndia, nëse unë ata (besimtarët) i dëboj? A nuk doni të këshilloheni?” Unë juve nuk dua t’ju them: “Unë kam thesarin e Perëndisë, as që di të padukshmet, as që do të them se unë jam engjëll, as që do t’u them atyre, të cilët, sytë tuaj i poshtërojnë: se Perëndia nuk do t’u japë kurrfarë të mire. Perëndia di më mirë se ç’ka në shpirtrat e tyre. (Sikur unë të veproja ashtu), atëherë do të isha, me të vërtetë, njëri nga zullumqarët”. Ata thanë: “O Nuhi, ti bëre polemikë me ne, dhe madje u zgjerove në polemikën tonë. Sillna ti atë premtim (dënim), nëse thua të vërtetën!” Tha (Nuhiu): “Vetëm Perëndia do t’ua sjellë atë, nëse dëshiron, e ju Atij nuk mund t’i ikni. Këshilla ime, nuk do t’ju bëjë dobi, edhe sikur të doja t’ju këshillojë – nëse Perëndia do t’ju shkatërrojë. Ai është Zoti juaj dhe ju tek Ai do të ktheheni”. Ose ata thonë: “Ai (Muhammedi) e ka trilluar (Kur’anin). Thuaj: “E nëse unë e kam trilluar, mëkati im bie mbi mua, e unë jam larg nga mëkatet që bëni ju”. Dhe Nuhiut i qe shpallur: “Nga populli yt askush nuk do të besojë, përpos atyre që kanë pranuar fenë, andaj mos u pikëllo për atë që punojnë ata, dhe ndërto anijen nën mbikëqyrje dhe udhëzimin Tonë, dhe mos m’u drejto më për ata që janë zullumqarë! Ata me siguri do të fundosen”. Dhe ndërtonte anijen. Dhe sa herë që kalonin pranë tij paria e popullit të tij, e përqeshnin atë. (Nuhi) tha: “Nëse ju talleni me ne, edhe na do të tallemi me ju, ashtu si talleni ju, dhe së shpejti, me siguri, do të dini, kë do ta gjejë dënimi poshtërues dhe në kë do të bie dënimi i përhershëm”. Dhe, kur arriti urdhri Ynë, e uji nga sipërfaqja e tokës nisi të gufojë. Ne thamë: “Ngarko në anije nga çdo lloj gjallese nga një palë (një mashkull e një femër) dhe familjen tënde, përveç atyre që ka qenë fjala (e dënimit) për ta, - dhe besimtarët!” E pak ka pasur të atillë, që kanë besuar me të. (Nuhiu) tha: “Hipni në të! Me emrin e Perëndisë ajo lundron dhe ndalet! Me të vërtetë, Zoti im është falës dhe mëshirues. Dhe, ajo lundronte me ta nëpër valët e mëdha e të larta sa malet, ndërsa Nuhiu thërriste birin e vet, i cili ishte tërhequr (anash): “O biri im, hip me ne e mos u bënë me mohuesit!” (I biri) tha: “Unë do të strehohem në bjeshkën, e cila do të më ruajë nga uji”, (e Nuhiu) tha: “Sot askush nuk do të kursehet nga dënimi i Perëndisë, përveç atë që e mëshiron Ai!” E, një valë në mes tyre i ndau dhe ai (i biri) - u fundos. Dhe është thënë: “O Tokë, gëlltitë ujin tënd, dhe ti o qiell, ndaloje (shiun)!” Dhe uji u tërhoq e u plotësua urdhri (i Perëndisë), e anija u ndal në malin Xhudij, dhe është thënë: “Le të jetë larg populli zullumqarë!” E Nuhiu iu lut Zotit të tij dhe tha: “O Zoti im, me të vërtetë, biri im është nga familja ime dhe premtimi Yt, është i vërtetë, e Ti je gjykatësi më i drejtë!” (Perëndia) tha: “O Nuhi, ai nuk është nga familja jote, ai ka bërë punë të keqe (që nuk ka ardhur me ty). Mos më pyet për atë që nuk e di ti. Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga ata që nuk dinë”. (Nuhiu) tha: “O Zoti im, unë mbështetem te Ti (për t’u ruajtur) nga pyetjet që nuk i di, e nëse Ti nuk më falë dhe nuk më mëshiron, do të jem nga të humburit”. Është thënë: “O Nuhi - zbrit me përshëndetjen Tonë

***dhe dhuntitë Tona për ty dhe pasardhësit e atyre që gjenden me ty". E, disa popujve, Na do t'u japim kënaqësi** (në këtë botë), **e që pastaj, do t'i goditë nga Ne dënimi i dhembshëm!"** (Hud, 28-48).*

فَكَذَّبُوهُ فَنَجَّيْنَاهُ وَمَن مَّعَهُ فِي الْفُلْكِ وَجَعَلْنَاهُمْ خَلَائِفَ وَأَغْرَقْنَا الَّذِينَ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا ۖ فَانظُرْ كَيْفَ كَانَ عَاقِبَةُ الْمُنذَرِينَ .

***"Por, ata, e quajtën gënjeshtar, kurse Ne e shpëtuam atë dhe të gjithë ata që ishin në anije me të. Dhe i bëmë ata zëvendës** (të atyre që u zhdukën) **kurse, i fundosëm ata që përgënjeshtruan dokumentet Tona. Shikoje se si ishte përfundimi i atyre që ishin paralajmëruar."** (Junus, 73).*

Përkundër thirrjes këmbëngulëse të Nuhiut a.s. thirrjes së tij iu përgjigj vetëm një numër i vogël njerëzish. Kjo ishte e mjaftueshme që të fillojë vërshimi dhe të gjithë jobesimtarët u përmbytën. Shpëtuan vetëm besimtarët dhe gjallesat në anijen që e ndërtoi pejgamberi Nuhiu a.s. Kur'ani e rrëfen këtë ngjarje në mënyrë mbresëlënëse dhe optimiste. Mbetën gjallë besimtarët. Ndër ta edhe tre djemtë e Nuhiut a.s., Semi, Hami dhe Jafeti, nga të cilët tërë gjinia njerëzore mban prejardhjen.[6]

Këta janë të parët që hodhën gurthemelin e një shoqërie të re fetare nga e para me prirje të qartë drejt fesë së vërtetë. Për shkak të shërbimeve dhe kontributit të tij të vlefshëm për fenë islame, ai është graduar nga All-llahu ndër pejgamberët e dalluar, si një falënderim që do të mbeten gjallë për aq kohë sa njerëzimi të ekzistojë.[7]

## 3) Ibrahimi a.s. dhe mrekullia e tij

[6] Dzemaludin Latic, Islam, po aty, fq. 39-40. Ahmed Behxhet, po aty, fq. 78 e tutje.
[7] ULUL'AZM ANBIYA' (ARCH-PROPHETS) AND ALL OTHER PROPHETS, sipas: http://www.ghadeer.org/english/shia/islam_teach/09.htm.



Nga Nuhiu a.s. deri te Ibrahimi a.s. kishte kaluar një kohë e gjatë. Edhe pse shumë pejgamberë të Zotit, si Hudi, Salihu dhe të tjerë, ftuan drejt së vërtetës dhe drejtësisë, politeizmi dhe idhujtaria lulëzuan nga dita në ditë dhe më në fund mosbesimi u bë traditë universale. Nga urtia dhe mëshira e Tij e pafundme, Allahu e zgjodhi Ibrahimin për pejgamber, i cili do të ftonte në braktisjen e së keqes dhe pranimin e së mirës.

Sipas burimeve biblike Ibrahimi ishte i biri i Tarehut, i biri i Nahorit. Madje, gjenealogjia e Ibrahimit shkon deri te Semi, i biri i Nuhiut. U lind në Babil (Babiloni), më tokën e kaldejëve, të cilët adhuronin shtatë yje. Ibn Kethiri thotë se *"në atë kohë, derisa edhe banorët e Haranit* (qyteti ku u shpërngul familja e Ibrahimit – N. I.) *adhuronin yjet dhe idhujt, të gjithë njerëzit në Tokë qenë jobesimtarë pos Ibrahimi, gruaja e tij dhe kushëriri Luti. Ibrahimi ishte ai, nëpërmjet të cilit Allahu xh. sh. i mënjanoi ato të këqija dhe e hoqi atë mashtrim."*[8]

Kur'ani njofton se Allahu e ka përgatitur Ibrahimin qysh në vegjëli për një mision të madh. E pajisi me mendjemprehtësi dhe maturi të pashoq. Kjo bëri që ai të mos bjerë në grackat e kohës së tij dhe të besojë idhujt e popullit të tij.

وَإِبْرَاهِيمَ إِذْ قَالَ لِقَوْمِهِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاتَّقُوهُ ۖ ذَٰلِكُمْ خَيْرٌ لَّكُمْ إِن كُنتُمْ تَعْلَمُونَ . إِنَّمَا تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ أَوْثَانًا وَتَخْلُقُونَ إِفْكًا ۚ إِنَّ الَّذِينَ تَعْبُدُونَ مِن دُونِ اللَّهِ لَا يَمْلِكُونَ لَكُمْ رِزْقًا فَابْتَغُوا عِندَ اللَّهِ الرِّزْقَ وَاعْبُدُوهُ وَاشْكُرُوا لَهُ ۖ إِلَيْهِ تُرْجَعُونَ .

***"Dhe** (kujtoje) **Ibrahimin kur i pati thënë popullit të vet: "Adhurojeni Allahun dhe druajuni Atij. Kjo është më së miri për ju, nëse e dini. Ju, pos Allahut, me të vërtetë, po adhuroni idhuj dhe po shpifni gënjeshtra. Me të vërtetë, ata që po i adhuroni ju pos Allahut, nuk kanë pushtet t'ju furnizojnë juve, andaj, tek Allahu kërkoni furnizimin***

[8] Hafiz Ibn Kethir, Kazivanja o vjerovjesnicima, Zenica, 1420-1999, fq. 147 e tutje.

***dhe adhurojeni Atë dhe falënderohuni Atij. Tek Ai do të ktheheni.”*** *(El-Ankebut, 16-17).*

Prej çastit të konfrontimit me idhujtarët Ibrahimi ishte monoteist i pakompromis. Ai përkundër torturave, përndjekjeve dhe ofendimeve të pafund nga ana e politeistëve zgjodhi anën e dashurisë me Allahun. Ai sikur e dinte se Allahu do ta mbrojë nga dhuna e llahtarshme e bashkëkombasve të vet. Edhe pse kundërshtarët e vendosën në turrën e drunjve për ta djegur, zjarri nuk e dogji, sepse Allahu i tha zjarrit

يَا نَارُ كُونِي بَرْدًا وَسَلَامًا عَلَىٰ إِبْرَاهِيمَ.

***“O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”*** *(El-Enbija, 69).*

Mospajtimi i Ibrahimit a.s. me gjendjen besimore të popullit të tij babilonas e solli atë në konflikt të hapur me të gjithë, madje edhe me babanë-xhaxhanë e tij. Përkundër paaftësisë së tyre për ta dënuar atë dhe mposhtjes së tyre nga ai (mu’xhizet e Allahut), kundërshtarët nuk u pajtuan ta lënë të qetë, por e dëbuan nga vendlindja. Për këtë arsye, ai mori rrugën duke kërkuar vend, ku ai dhe populli që e ndiqte do të mund ta adhurojë Allahun pa pengesa. Në shtegtim e sipër Ibrahimi a.s. u vendos në luginën e Mekës. Për shkak të përkushtimit ndaj Krijuesit dhe këmbënguljes drejt së vërtetës, Allahu e quajti Ibrahimin *mik të Tij* (Halil’ull-Llah). Për më tepër, Allahu i porositi:

وَوَهَبْنَا لَهُ إِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَجَعَلْنَا فِي ذُرِّيَّتِهِ النُّبُوَّةَ وَالْكِتَابَ وَآتَيْنَاهُ أَجْرَهُ فِي الدُّنْيَا ۖ وَإِنَّهُ فِي الْآخِرَةِ لَمِنَ الصَّالِحِينَ .

***“Dhe, Ne ia kemi dhuruar Is’hakun dhe Jakubin dhe pasardhësve të tij u kemi dhënë pejgamberinë dhe Librin, e i kemi dhënë atij shpërblimin në këtë botë. Me të vërtetë, ai edhe në jetën tjetër do të jetë prej njerëzve të mirë.”*** *(El-Ankebut, 27).*

Së këndejmi, Ibrahimi a.s. u quajt “baba i pejgamberëve”, sepse të gjithë pejgamberët tjerë kanë prejardhje nga pasardhësit e tij, Ismaili dhe Is’haku.



وَإِنَّ مِن شِيعَتِهِ لَإِبْرَاهِيمَ . إِذْ جَاءَ رَبَّهُ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ .﴾ إِذْ قَالَ لِأَبِيهِ وَقَوْمِهِ مَاذَا تَعْبُدُونَ . أَئِفْكًا آلِهَةً دُونَ اللَّهِ تُرِيدُونَ . فَمَا ظَنُّكُم بِرَبِّ الْعَالَمِينَ . فَنَظَرَ نَظْرَةً فِي النُّجُومِ . فَقَالَ إِنِّي سَقِيمٌ . فَتَوَلَّوْا عَنْهُ مُدْبِرِينَ . فَرَاغَ إِلَىٰ آلِهَتِهِمْ فَقَالَ أَلَا تَأْكُلُونَ . مَا لَكُمْ لَا تَنطِقُونَ . فَرَاغَ عَلَيْهِمْ ضَرْبًا بِالْيَمِينِ . فَأَقْبَلُوا إِلَيْهِ يَزِفُّونَ. قَالَ أَتَعْبُدُونَ مَا تَنْحِتُونَ . وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ . قَالُوا ابْنُوا لَهُ بُنْيَانًا فَأَلْقُوهُ فِي الْجَحِيمِ . فَأَرَادُوا بِهِ كَيْدًا فَجَعَلْنَاهُمُ الْأَسْفَلِينَ . وَقَالَ إِنِّي ذَاهِبٌ إِلَىٰ رَبِّي سَيَهْدِينِ . رَبِّ هَبْ لِي مِنَ الصَّالِحِينَ . فَبَشَّرْنَاهُ بِغُلَامٍ حَلِيمٍ . فَلَمَّا بَلَغَ مَعَهُ السَّعْيَ قَالَ يَا بُنَيَّ إِنِّي أَرَىٰ فِي الْمَنَامِ أَنِّي أَذْبَحُكَ فَانظُرْ مَاذَا تَرَىٰ ۚ قَالَ يَا أَبَتِ افْعَلْ مَا تُؤْمَرُ ۖ سَتَجِدُنِي إِن شَاءَ اللَّهُ مِنَ الصَّابِرِينَ . فَلَمَّا أَسْلَمَا وَتَلَّهُ لِلْجَبِينِ . وَنَادَيْنَاهُ أَن يَا إِبْرَاهِيمُ . قَدْ صَدَّقْتَ الرُّؤْيَا ۚ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِي الْمُحْسِنِينَ . إِنَّ هَٰذَا لَهُوَ الْبَلَاءُ الْمُبِينُ .

***“Dhe, me të vërtetë, nga ithtarët e tij është edhe Ibrahimi, kur Zotit të vet i erdhi me zemër të pastër, kur babait të vet dhe popullit të vet i tha: “Çka adhuroni ju? Vallë, a dëshironi hyjni të rrejshme në vend të Allahut? E çka mendoni ju për Zotin e gjithësisë?” Pastaj u hodhi një shikim yjeve, dhe tha: “Unë jam i sëmurë”. Dhe, ata u larguan prej tij, duke e lënë pas. Pastaj, ai u përvodh te hyjnitë e tyre dhe u tha: “A nuk po hani? Ç’keni, përse nuk flisni?” Ju afrua tyre tinëzisht, duke i goditur me dorë të djathtë. Dhe ata*** *(njerëzit)* ***nxituan kah ai. Ibrahimi tha: “Vallë, a i adhuroni ju ato që i keni gdhendur*** *(putat)?* ***E, Perëndia u ka krijuar juve, dhe ato që i bëni ju”.*** *(Jobesimtarët)* ***thanë: “Përgatitni për te një godinë*** *(vatër)* ***dhe hidheni atë në zjarr!” Dhe ata dëshiruan t’i bëjnë dinakëri, por Ne i bëmë ata më të poshtëruarit.*** *(Ibrahimi)* ***tha: “Unë po shkoj te Zoti im. Ai do të më udhëzojë. O Zoti im, dhuroma një fëmijë të mirë*** *(e të ndershëm)!”* ***Dhe Ne e sihariquam atë me një çun të urtë. Dhe kur fëmija u rrit aq sa t’i ndihmojë në punë, Ibrahimi i tha: “O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të presë, çka mendon ti?” – O baba, - tha: “vepro***

***ashtu siç je urdhëruar; njëmend do të bindesh, - nëse do Perëndia, se unë jam i durueshëm”. Pasi e pranuan që të dy urdhrin, e rrëzoi*** *(djalin)* ***në krah, Ne e thirrëm: “O Ibrahim, ti madje e realizove ëndrrën. E, Ne, me të vërtetë, kështu i shpërblejmë bamirësit, kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë!”*** *(Es-Saffat: 83-106).*

Një çështje e re në temën Ibrahimi a.s. është ndërtimi i Qabesë dhe vendi ku do të ndërtohej. Aty erdhi Ibrahimi a.s. me Haxheren dhe të birin Ismailin.

وَإِذْ بَوَّأْنَا لِإِبْرَاهِيمَ مَكَانَ الْبَيْتِ أَن لَّا تُشْرِكْ بِي شَيْئًا وَطَهِّرْ بَيْتِيَ لِلطَّائِفِينَ وَالْقَائِمِينَ وَالرُّكَّعِ السُّجُودِ . وَأَذِّن فِي النَّاسِ بِالْحَجِّ يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَىٰ كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِن كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ .

**“***(Kujtoje, o Muhammed!)* ***kur Na i patëm përgatitur Ibrahimit vendin e faltores*** *(duke i thënë):* ***“Mos më përshkruaj Mua shok asgjë, dhe pastroje Shtëpinë Time për ata që e vizitojnë, që rrinë aty dhe që bëj-në namaz, dhe ftoi njerëzit në haxhillëk, do të vijnë ata ty – në këmbë dhe*** *(duke shaluar)* ***në çfarëdo deve; duke ardhur prej të gjitha viseve të largëta.”*** *(El-Haxhxh, 26-27).*

Sipas traditës islame, Qabeja gjendet në mesin e rruzullit tokësor. Ajo është e vendosur nën Qabenë qiellore, e ashtuquajtur Bejt’ul-Ma’mur.

Allahu xh.sh. e përmbushi duanë e Ibrahimit a.s., duke e bërë të birin e tij, Ismailin gjithashtu pejgamber të Zotit, nga gjinia e të cilit ka prejardhjen edhe vetë Muhammedi a.s.. Gjatë jetës së këtij të fund-it, Qabeja sërish është pastruar nga idhujt, dhe ka vazhduar të vizi-tohet nga haxhinjtë për çdo vit. Me ndërtimin e Qabesë lidhet edhe burimi i ujit të Zem-Zemit, në luginën e thatë të Mekës.

Po ashtu, nga i biri i Ibrahimit a.s., Is’haku rrjedhin shumë pejga-mberë të ardhur te hebraikët: Jakubi, Jusufi, Sulejmani, Musai dhe Isai a.s.[9]

[9] Dzemaludin Latic, Islam, po aty, fq. 41-43. Ahmed Behxhet, po aty, fq. 119. Krhs.: http://www.ghadeer.org/english/shia/islam_teach/09.htm.



## 4) Musai a.s. dhe mrekullia e tij

Musai a.s. i përkiste popullit izraelit. U lind në Egjipt, në kohën e sundimit të faraonit, njërit nga kundërshtarët më rigoroz të fesë së vër-tetë. Për shkak të jetës tejet dinamike, Musai a.s. trajtohet intensivisht në Kur’an, si për jetën para shpalljes së Tevratit, ashtu edhe për pjesën pas shpalljes dhe bën pjesë në mesin e pejgamberëve të vendosur.

Allahu xh. sh. në Kur’an na ofron të dhëna autentike rreth Musait dhe faraonit:

نَتْلُو عَلَيْكَ مِن نَّبَإِ مُوسَىٰ وَفِرْعَوْنَ بِالْحَقِّ لِقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ . إِنَّ فِرْعَوْنَ عَلَا فِي الْأَرْضِ وَجَعَلَ أَهْلَهَا شِيَعًا يَسْتَضْعِفُ طَائِفَةً مِّنْهُمْ يُذَبِّحُ أَبْنَاءَهُمْ وَيَسْتَحْيِي نِسَاءَهُمْ ۚ إِنَّهُ كَانَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ . وَنُرِيدُ أَن نَّمُنَّ عَلَى الَّذِينَ اسْتُضْعِفُوا فِي الْأَرْضِ وَنَجْعَلَهُمْ أَئِمَّةً وَنَجْعَلَهُمُ الْوَارِثِينَ وَنُمَكِّنَ لَهُمْ فِي الْأَرْضِ وَنُرِيَ فِرْعَوْنَ وَهَامَانَ وَجُنُودَهُمَا مِنْهُم مَّا كَانُوا يَحْذَرُونَ .

***“Ne do të tregojmë ty disa lajme mbi Musain dhe Faraonin, ashtu siç ka qenë me të vërtetë, dhe këtë - për ata që besojnë. Me të vërtetë, Faraoni është madhështuar në Tokë dhe banorët e tij i ka në grupi-me*** *(shtresa shoqërore);* ***disa prej tyre i ka shtypur – ua mbyste fëmi-jët meshkuj, e femrat e tyre ua linte në jetë. Ai, me të vërtetë, ka qenë ngatërrestar. Ne kemi dashur t’u bëjmë mirësi atyre që kanë qenë të shtypur në Tokë, e t’i bëjmë udhëheqës ata dhe t’i bëjmë trashëgim-tar*** *(të pushtetit të Faraonit).* ***Dhe t’ua mundësojmë atyre vendosjen në Tokë dhe t’ua tregojmë Faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së tyre mu atë prej së cilës frikësoheshin ata.”*** *(El-Kasas, 3-6).*

Populli i shtypur ishte ai i Musait a.s., Benu Israilët, i cili mban prejardhjen nga Is’haku, i biri i Ibrahimit a.s. Në kujtesën izraelite ru-hej tradita se një djalosh nga ky popull do ta rrënojë faraonin. Prandaj, ky faraon pati urdhëruar vrasjen e fëmijëve meshkuj izraelitë. Ky djalosh ishte Musai, i cili me urtësinë e Allahut, do të rritet në pallatin

e faraonit. Me rritjen e tij, Allahu e gradoi me shpallje në luginën e bekuar Tuva, ku pranoi nëntë shenja të qarta:

وَلَقَدْ آتَيْنَا مُوسَىٰ تِسْعَ آيَاتٍ بَيِّنَاتٍ ۖ فَاسْأَلْ بَنِي إِسْرَائِيلَ إِذْ جَاءَهُمْ فَقَالَ لَهُ فِرْعَوْنُ إِنِّي لَأَظُنُّكَ يَا مُوسَىٰ مَسْحُورًا .

***"Na i kemi dhënë Musait nëntë shenja të qarta; dhe pyeti bijtë e Izraelit, kur u erdhi të parëve të tyre dhe kur Faraoni i tha atij: "O Musa, unë të konsideroj ty për të magjepsur"*** *(El-Isra`, 101).*

Por, shenjat (ajetet) nuk duhet ngatërruar me shpalljen që Allahu ia dërgoi Musait a.s., sepse shenjat janë mu'xhize, vepra mrekulluese, të mbinatyrshme:

فَلَمَّا أَتَاهَا نُودِيَ يَا مُوسَىٰ . إِنِّي أَنَا رَبُّكَ فَاخْلَعْ نَعْلَيْكَ ۖ إِنَّكَ بِالْوَادِ الْمُقَدَّسِ طُوًى . وَأَنَا اخْتَرْتُكَ فَاسْتَمِعْ لِمَا يُوحَىٰ . إِنَّنِي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي . إِنَّ السَّاعَةَ آتِيَةٌ أَكَادُ أُخْفِيهَا لِتُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍ بِمَا تَسْعَىٰ . فَلَا يَصُدَّنَّكَ عَنْهَا مَن لَّا يُؤْمِنُ بِهَا وَاتَّبَعَ هَوَاهُ فَتَرْدَىٰ .

***"E kur arriti ai te zjarri, u thirr: "O Musa, Unë, me të vërtetë, jam Zoti yt! Andaj, zbathi këpucët tuaja, se ti, me të vërtetë, gjendesh në luginën e shenjtë - të Tuvasë. Dhe, Unë ty të kam zgjedhur; andaj dëgjo ti atë që të shpallet*** *(ty)!* ***Me të vërtetë, Unë jam Perëndia; s'ka zot tjetër përveç meje; andaj, vetëm Mua adhuromë dhe kryej namazin, për të më kujtuar Mua! Çasti i gjykimit do të arrijë me siguri - atë e kam fsheh*** *(nga çdokush)* ***– kur secili do të shpërblehet për atë*** *(përpjekje)* ***që ka bërë. Le të mos shmangë ty nga ai*** *(çast),* ***ai që nuk beson në të*** *(Kijametin)* ***dhe që jepet pas epsheve të tij, e të humbasësh."*** *(Ta Ha, 11-16).*

Më pastaj, pasi Allahu i dha shpallje Musait a.s., e urdhëroi t'i paraqitet faraonit që ai ta pranojë fenë e vërtetë:

وَإِذْ نَادَىٰ رَبُّكَ مُوسَىٰ أَنِ ائْتِ الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ.



***"Kur Perëndia i thërriti Musait: "Shko te populli zullumqar".*** *(Esh-Shu'ara, 10).*

... فَاذْهَبَا بِآيَاتِنَا ۖ إِنَّا مَعَكُم مُّسْتَمِعُونَ . فَأْتِيَا فِرْعَوْنَ فَقُولَا إِنَّا رَسُولُ رَبِّ الْعَالَمِينَ . أَنْ أَرْسِلْ مَعَنَا بَنِي إِسْرَائِيلَ .

***"… shkoni që të dy me argumentet Tona. Me të vërtetë, Ne jemi me ju dhe dëgjojmë. Shkoni te Faraoni dhe i thoni: "Ne jemi pejgamberët e Zotit të botëve, lejoni bijtë e Israelit që të vijnë me ne!"*** *(Esh-Shu'ara, 15-17).*

Musai a.s. dhe populli i tij luftuan me Faraonin në kohë të gjatë me luftë argumentesh e nervash, të maltretuar e frikësuar, të kërcënuar e dhunuar, që më në fund të fitojnë kundrejt tyre. Allahu e ndëshkoi popullin tiran me uri, mungesë prodhimesh bujqësore, vërshime e shqetësime të tjera, që në fund të përmbyten në ujin e detit:

وَجَاوَزْنَا بِبَنِي إِسْرَائِيلَ الْبَحْرَ فَأَتْبَعَهُمْ فِرْعَوْنُ وَجُنُودُهُ بَغْيًا وَعَدْوًا ۖ حَتَّىٰ إِذَا أَدْرَكَهُ الْغَرَقُ قَالَ آمَنتُ أَنَّهُ لَا إِلَٰهَ إِلَّا الَّذِي آمَنَتْ بِهِ بَنُو إِسْرَائِيلَ وَأَنَا مِنَ الْمُسْلِمِينَ . آلْآنَ وَقَدْ عَصَيْتَ قَبْلُ وَكُنتَ مِنَ الْمُفْسِدِينَ . فَالْيَوْمَ نُنَجِّيكَ بِبَدَنِكَ لِتَكُونَ لِمَنْ خَلْفَكَ آيَةً ۚ وَإِنَّ كَثِيرًا مِّنَ النَّاسِ عَنْ آيَاتِنَا لَغَافِلُونَ .

***"Ne i bartëm izraelitët përtej detit, e ata i ndoqi Faraoni dhe ushtria e tij nga e keqja dhe armiqësia. E kur e arriti atë*** *(Faraonin)* ***përmbytja*** *(në det),* ***tha: "Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë të bijtë e Izraelit dhe unë jam mysliman". "A, tani*** *(po beson)* ***e më parë ishe rebel dhe ishe prej ngatërrestarëve?! Sot do të shpëtojmë ty – trupin tënd, që të bëhesh vërejtje për ata që vijnë pas teje". Por, me të vërtetë, shumica e njerëzve janë të pakujdesshëm ndaj argumenteve Tona.*** *(Junus, 90-92).*

Me një fjalë, Musai a.s. u përball me Faraonin, njeriun mbase më të fortë të botës së atëhershme. Ai e ngadhënjeu faraonin dhe magjistarët e tij. Nga inati por edhe nga natyra e tij gjakpirëse, ai e ndoqi për vrasje Musain a.s. dhe pasuesit e tij. Mirëpo, Allahu xh.sh. i dha Musait a.s. mrekullinë, nëpërmjet së cilës u hap deti për të kaluar populli

i Musait a.s. por jo edhe faraoni me ushtrinë e vet. Faraoni dhe ushtria e tij u përmbytën në ujërat e Detit të Kuq, dhe edhe njëherë u sendërtua premtimi i Allahut se Fjala e Tij do të triumfojë gjithmonë.

Në fund mund të përmbledhim: Musai a.s. në malin Sinaj bisedoi me Zotin dhe e pranoi shpalljen e Tevratit. Musai a.s. u përball me faraonin, armikun e tij dhe të fesë së tij, në mënyrë dinjitoze, por të prerë dhe këmbëngulëse. Musai a.s. e çliroi popullin e tij nga robëria dhe shfrytëzimi shekullor faraonik. Kur'ani i jep Musait a.s. vend me rëndësi të jashtëzakonshme. Këto dhe provat tjera janë arsyet që Musai a.s. hyri në grupin e pejgamberëve të quajtur *ulu'l-azm*, pejgamberë të vendosur, pejgamberë kyç, në misionin hyjnor të quajtur pejgamberi - nubuvet.[10]

## 5) Isai a.s. dhe mrekullia e tij

Asnjë personalitet historik nuk është kontestuar sikurse Isai a.s. dhe nëna e tij Merjemja. Një pjesë e madhe e botës, e sidomos të krishterët dhe myslimanët atyre u kushtojnë vëmendje të posaçme, dashuri dhe respekt të jashtëzakonshëm, edhe pse pikëpamjet e tyre janë të ndryshme madje edhe kundërthënëse.

Merjemja dhe Isai a.s. janë "shenja të botëve" para së gjithash për shkak të lindjes së tij të jashtëzakonshme. Në kohën e lindjes së tij populli izraelit dhe ata përreth nuk besonin si duhet. Qenë preokupuar me botën materiale në masë të madhe. Pak njerëz besonin në Zotin dhe Botën Tjetër. Për t'ua tërhequr vërejtjen banorëve të vendit Zoti ua dërgoi "shenjat" e Tij: Merjemen e ndershme dhe fëmijën e saj, të lindur pa burrë, me ndërhyrjen e "Fjalës së Zotit", nga e cila Merjemja mbeti shtatzënë. Ky fëmijë menjëherë pas lindjes, në djep, do "t'u flasë njerëzve":

[10] Dzemaludin Latic, Islam, po aty, fq. 44-46. Ahmed Behxhet, po aty, fq. 285 e tutje. Krhs.: http://www.ghadeer.org/english/shia/islam_teach/09.htm.



وَإِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَاكِ وَطَهَّرَكِ وَاصْطَفَاكِ عَلَىٰ نِسَاءِ
الْعَالَمِينَ . يَا مَرْيَمُ اقْنُتِي لِرَبِّكِ وَاسْجُدِي وَارْكَعِي مَعَ الرَّاكِعِينَ . ذَٰلِكَ مِنْ أَنبَاءِ
الْغَيْبِ نُوحِيهِ إِلَيْكَ ۚ وَمَا كُنتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يُلْقُونَ أَقْلَامَهُمْ أَيُّهُمْ يَكْفُلُ مَرْيَمَ وَمَا
كُنتَ لَدَيْهِمْ إِذْ يَخْتَصِمُونَ . إِذْ قَالَتِ الْمَلَائِكَةُ يَا مَرْيَمُ إِنَّ اللَّهَ يُبَشِّرُكِ بِكَلِمَةٍ
مِّنْهُ اسْمُهُ الْمَسِيحُ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ وَجِيهًا فِي الدُّنْيَا وَالْآخِرَةِ وَمِنَ الْمُقَرَّبِينَ .
وَيُكَلِّمُ النَّاسَ فِي الْمَهْدِ وَكَهْلًا وَمِنَ الصَّالِحِينَ . قَالَتْ رَبِّ أَنَّىٰ يَكُونُ لِي وَلَدٌ
وَلَمْ يَمْسَسْنِي بَشَرٌ ۖ قَالَ كَذَٰلِكِ اللَّهُ يَخْلُقُ مَا يَشَاءُ ۚ إِذَا قَضَىٰ أَمْرًا
فَإِنَّمَا يَقُولُ لَهُ كُن فَيَكُونُ . وَيُعَلِّمُهُ الْكِتَابَ وَالْحِكْمَةَ وَالتَّوْرَاةَ وَالْإِنجِيلَ .

"*(Kujtoje)* ***kur engjëjt i thanë*** *(Merjemes):* ***"O Merjeme! Perëndia të ka zgjedhur ty, të ka pastruar ty, dhe të ka privilegjuar ty mbi të gjitha femrat e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëni sexhde dhe përulu bashkë me ata që përulen!" Këto janë lajme të panjohura*** *(sekrete).* ***Na po t'i shpallim ty*** *(o Muhammed).* ***Ti nuk ishe i pranishëm kur ata hodhën short, se kush nga ata do të marrë Merjemen në mbrojtje. Dhe ti nuk ishe i pranishëm kur ata grindeshin.*** *(Kujtoje)* ***atë kohë kur engjëjt i thanë: "O Merjeme! Perëndia të sihariqon ty me një djalë: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të bëhet i famshëm në këtë botë dhe në tjetrën dhe do të jetë njëri nga të afërmit e Perëndisë. Dhe do të bisedojë*** *(Isai)* ***me njerëzit edhe duke qenë i vogël në djep edhe duke qenë si njeri i rritur, dhe do të jetë nga më të mirët. Merjemja tha: "Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka prekur asnjë mashkull?" - Ja kështu - tha: "Perëndia krijon ç'të dojë Ai. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: 'Bëhu!' - dhe ajo bëhet".*** *(Ali Imran, 42-47).*

Isai a.s. kishte një ngjashmëri me Ademin a.s. sepse që të dytë nuk kishin baba të zakonshëm. Por, Isai a.s. kishte edhe disa aftësi të tjera që e dallonin atë ndër pejgamberët tjerë. Me vullnetin dhe fuqinë e Allahut xh.sh. Isai a.s. i ringjallte të vdekurit, i shëronte të verbrit të lindur të tillë, i shëronte sëmundjet e lëkurës, e zbriti nga qielli sofrën

përplot ushqim, e mrekulli të tjera, por mrekullia e tij më e madhe ishte ngritja e tij në qiell kur ushtria romake përpiqej ta vriste. Tradhtia e Judës nuk pati sukses, sepse e pësoi vetë.

وَبِكُفْرِهِمْ وَقَوْلِهِمْ عَلَىٰ مَرْيَمَ بُهْتَانًا عَظِيمًا . وَقَوْلِهِمْ إِنَّا قَتَلْنَا الْمَسِيحَ عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ رَسُولَ اللَّهِ وَمَا قَتَلُوهُ وَمَا صَلَبُوهُ وَلَٰكِن شُبِّهَ لَهُمْ ۚ وَإِنَّ الَّذِينَ اخْتَلَفُوا فِيهِ لَفِي شَكٍّ مِّنْهُ ۚ مَا لَهُم بِهِ مِنْ عِلْمٍ إِلَّا اتِّبَاعَ الظَّنِّ ۚ وَمَا قَتَلُوهُ يَقِينًا . بَل رَّفَعَهُ اللَّهُ إِلَيْهِ ۚ وَكَانَ اللَّهُ عَزِيزًا حَكِيمًا . وَإِن مِّنْ أَهْلِ الْكِتَابِ إِلَّا لَيُؤْمِنَنَّ بِهِ قَبْلَ مَوْتِهِ ۖ وَيَوْمَ الْقِيَامَةِ يَكُونُ عَلَيْهِمْ شَهِيدًا .

***“Edhe për shkak të mohimit të tyre edhe për shkak të fjalës së tyre - akuzave të mëdha kundër Merjemes. Dhe për fjalët e tyre: “Na kemi mbytur Mesihun - Isain të birin e Merjemes, Pejgamberin e Perëndisë”. Por, ata as nuk kanë mbytur as nuk e kanë varë, por iu ka përngjarë atyre*** *(një person).* ***Ata që bënë polemikë për çështjen e tij, ata me siguri gjenden në dyshim për të,*** *(Isain).* ***Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm u janë mbështetur supozimeve. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë mbytur, por, Perëndia e ka ngritur pranë Vetes*** *(në një vend që nuk e arrijnë njerëzit).* ***Se Perëndia, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. Të gjithë ithtarët e Librit, para se të vdesin, - do t’i besojnë Isait*** *(që është Profet, e jo zot);* ***e, në Ditën e Kijametit, ai*** *(Isai),* ***do të jetë dëshmitar kundër tyre.”*** *(En-Nisa, 156-159).*

Për dallim prej Biblës, Kur’ani i kundërvihet divinizimit të Isait a.s. dhe Kur’ani e quan qëllimisht “I biri i Merjemes” (عِيسَى ابْنَ مَرْيَمَ) dhe rigorozisht refuzon idenë krishtere të trinitetit.

إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِندَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ ۖ خَلَقَهُ مِن تُرَابٍ ثُمَّ قَالَ لَهُ كُن فَيَكُونُ .الْحَقُّ مِن رَّبِّكَ فَلَا تَكُن مِّنَ الْمُمْتَرِينَ .

***“Rasti i Isait te Perëndia, në të vërtetë, është si rasti i Ademit, që e krijoi prej baltës e pastaj tha: “Bëhu!” - dhe ai u bë. E vërteta është nga Zoti yt, andaj, mos u bën nga ata që dyshojnë!”*** *(Ali Imran, 59-60).*



Përveç tjerash, Isai a.s. pranoi shpalljen e quajtur Inxhili (Lajmi i gëzueshëm), në Kur’an i quajtur “udhëzim dhe dritë.” Në këtë shpallje ai tregoi respekt për Tevratin, por edhe paralajmëroi pejgamberinë e Muhammedit a.s.:

وَإِذْ قَالَ عِيسَى ابْنُ مَرْيَمَ يَا بَنِي إِسْرَائِيلَ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُم مُّصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيَّ مِنَ التَّوْرَاةِ وَمُبَشِّرًا بِرَسُولٍ يَأْتِي مِن بَعْدِي اسْمُهُ أَحْمَدُ ۖ فَلَمَّا جَاءَهُم بِالْبَيِّنَاتِ قَالُوا هَٰذَا سِحْرٌ مُّبِينٌ .

***“E kur Isai, i biri i Merjemës, ka thënë: “O bijtë e Israelit, unë u jam pejgamber i Allahut te ju, për t’ju vërtetuar Tevratin e shpallur para meje dhe për t’ju sjellë lajmin e gëzueshëm për pejgamberin, emrin e të cilit është Ahmed, që do të vijë pas meje; dhe kur ai u solli atyre argumente të qarta, ata thanë: “Kjo është magji e qartë!”*** *(Es-Saff, 6).*

Për vdekjen e Isait a.s. kemi polemika të shumta si ndërmjet jude-o-kristianëve ashtu edhe ndërmjet myslimanëve dhe kristianëve. Tradita myslimane bazohet në Kur’an dhe Hadith dhe dallon nga të tjerat. Tradita myslimane pohon se Isai a.s. u ngrit nga ana e Allahut, pastaj do të kthehet në Tokë para Çastit të Fundit.[11]

## 6) Muhammedi a.s. dhe mrekullitë e tij

Të gjithë të dërguarit e mëhershëm të Zotit (nebij dhe resulë), pra edhe pejgamberët e dalluar, kanë pasur fushëveprimtari të kufizuar si në hapësirë ashtu edhe në kohë. Allahu xh. sh. ata i ka dërguar për një apo më shumë fise, për një apo më shumë popuj, për një kohë të caktuar. Porositë e tyre, qofshin fletët (suhufet), qofshin librat (kitabet), me kalimin e kohës filluan të neglizhohen dhe harrohen dhe si rezultat e kësaj të shtrembërohen. Kjo gjendje e zbehjes apo e mohimit të shpalljes hyjnore imponoi intervenimin e kohëpaskoshëm të Krijuesit me pejgamberë të rinj dhe disa herë edhe me shpallje të reja. Asnjë

[11] Dzemaludin Latic, Islam, po aty, fq. 47-50. Ahmed Behxhet, po aty, fq. 471 e tutje. Krhs.: http://www.ghadeer.org/english/shia/islam_teach/09.htm.

fletë apo libër hyjnor i mëhershëm nuk ka arritur deri te ne në formën e tyre origjinale. Disa janë humbur tërësisht e disa pjesërisht, siç e kemi gjendjen me Tevratin, Zeburin dhe Inxhilin.

Çdo pejgamber i ri e ka konfirmuar pejgamberin e mëhershëm, e ka plotësuar apo e ripërtëritur Sheriatin. Marrë në tërësi, ata paraqisnin një familje, siç e konfirmon këtë edhe Kur'ani fisnik:

إِنَّ اللَّهَ اصْطَفَىٰ آدَمَ وَنُوحًا وَآلَ إِبْرَاهِيمَ وَآلَ عِمْرَانَ عَلَى الْعَالَمِينَ.

***"Allahu e zgjodhi Ademin, Nuhiun dhe familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit në mesin e popujve."*** *(Ali Imran, 33).*

Muhammedi a.s. është pasardhës i pejgamberit Ismail, të birit të Ibrahimit a.s. Muhammedi a.s. është mëshirë për tërë njerëzinë dhe botët, vulë e të gjithë pejgamberëve, i dashur i Allahut:

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا...

***"Thuaj: "O njerëz, unë jam Pejgamber i Allahut për të gjithë ju...".*** *(El-A'raf, 158).*

Misioni i tij pejgamberik është kozmopolit duke përcjellë mesazhin edhe të shpalljeve të mëhershme, si për shembull: të Tevratit, Zeburit dhe Inxhilit ashtu edhe suhufeve të Ibrahimit dhe Musait a.s.:

وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ ...

***"Na ty*** *(o Muhammed!)* ***ta kemi dërguar Librin*** *(Kur'anin),* ***me të vërtetë, vërtetues të librit që e kanë përpara dhe dëshmues i tij..."*** *(El-Maideh, 48).*

إِنَّ هَٰذَا لَفِي الصُّحُفِ الْأُولَىٰ . صُحُفِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ.

***"Kjo, me të vërtetë, ka qenë shënuar në fletët e mëhershme, fletët e Ibrahimit dhe Musait."*** *(El-A'la, 18-19).*

نَذِيرًا لِّلْبَشَرِ.

***"Është vërejtje për njerëz!"*** *(El-Mudeththir, 36).*

.. الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتْمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ دِينًا ...



***"... Sot ua përsosa juve fenë tuaj dhe ua plotësova dhuntinë Time ndaj jush. Jam i kënaqur që feja islame të jetë fé e juaja...".*** *(El-Maideh, 3).*

Një vlerë karakteristike që duhet theksuar për Muhamedin a.s. kundrejt pejgamberëve të tjerë është se fjalët dhe veprat e tij janë quajtur *sunnet*, janë shënuar me saktësi dhe janë ruajtur, kurse mirësjellja e tij dhe zbatimi i mesazhit hyjnor paraqesin shembullin më të përkryer.

Politeistët e Mekës që në hapat e parë të shpalljes iu kundërvunë Muhammedit a.s. Arroganca e tyre shtrihej në të gjitha fushat e jetës. Përveç dhunës fizike, ata Muhammedit i bënin edhe dhunë psikike, me provokime të shumta dhe me kërkesa dhe pyetje tejet absurde.[12] Me një rast, një natë të kthjellët, kur Hëna ishte e plotë, politeistët mekas kërkuan nga Muhammedi a.s. që nëse pretendon se është i dërguar nga Zoti, ta ndajë Hënën në dysh. Muhammedi a.s. i shtrënguar nga kjo kërkesë e kundërshtarëve, iu drejtua Krijuesit dhe bëri me gisht në drejtim të hënës. Pas kësaj, Hëna u nda në dy pjesë. Përkundër kërkesës së tyre dhe përgjigjes së Pejgamberit a.s.ndaj kërkesës së tyre, ata sërish nuk besuan.

Allahu fuqiplotë thotë:

اقْتَرَبَتِ السَّاعَةُ وَانشَقَّ الْقَمَرُ . وَإِن يَرَوْا آيَةً يُعْرِضُوا وَيَقُولُوا سِحْرٌ مُّسْتَمِرٌّ .
وَكَذَّبُوا وَاتَّبَعُوا أَهْوَاءَهُمْ ۚ وَكُلُّ أَمْرٍ مُّسْتَقِرٌّ .

***"Çasti afrohet e hëna po copëtohet! E ata, kur shohin mrekulli, i kthejnë shpinën dhe thonë: "Një magji në vazhdimësi!" Dhe përgënjeshtrojnë e pasojnë dëshirat e tyre, por çdo send është e caktuar."*** *(El-Kamer, 1-3).*

Përkundër faktit se Kur'ani nuk është libër biografish, as enciklopedi historike apo doracak udhëzimesh për probleme të ndryshme shoqërore, megjithatë tri çështje nga jeta e Muhammedit a.s. janë qendrore dhe meritojnë të shtrohen si tema kyçe, sepse i kanë dhënë kthesë zhvillimit dhe ecurive shoqërore e fetare në botë. Ato janë:

[12] Nexhat Ibrahimi, Bazat e besimit islam (në pritje të botimit në: Logos-A, Shkup).

1. *Israja dhe Mi'raxhi* (Udhëtimi natën në Jerusalem dhe ngjitja në qiell): Udhëtimi natën i Muhammedit a.s. nga Mekja në Mesxhidul-Aksa në Jerusalem dhe bërja imam e tij në namaz të gjithë pejgamberëve paraqet lidhjen simbolike të Islamit me të gjithë ata dhe distancimi i tij nga të gjitha shtresimet historike si pasojë e devijimeve njerëzore. Ngjitja (hipja) misterioze por madhështore e Muhammedit a.s. në sferat qiellore dhe biseda e tij me pejgamberët më të dalluar, pastaj shikimi i xhenetit dhe xhehenemit, paraqet ndër të tjera kthimin e njeriut nga vendi nga janë dëbuar Ademi dhe Havaja.
2. *Hixhreti* (Shpërngulja e Muhammedit a.s. prej Mekës në Medinë): Kjo datë që ndodhi në vitin 622 e. r. ka rëndësi kolosale sepse më vonë u mor si fillim i kalendarit mysliman dhe ndikoi në ndryshimin e rrjedhave historike në botën e atëhershme e më vonë. Po ashtu, kjo ngjarje solli plotësisht pasqyrë të re të mësimit islam. Këto ndryshime në Medinë konsistojnë para së gjithash në formimin e institucioneve islame mbi parimet islame dhe mbi të gjitha në formimin e shtetit islam, kurse nga këtu filloi shtrirja e Islamit si lëvizje botërore dhe mision kozmik. Hixhreti myslimanët i futi në histori duke e ndryshuar botën drejt parimeve të pandryshueshme, të cilat para njerëzisë i vendosi Allahu.
3. *Beteja e Bedrit*: Kjo betejë që ndodhi në vitin 624 e. r. (viti II h.) nuk është më e madhja për nga forca e armëve dhe luftëtarëve por për nga pasojat që rrodhën në fushën politike, ekonomike, kulturore etj. Për herë të parë u vendosën rregulla të luftës dhe paqes, u ndalua masakrimi i luftëtarit të vrarë, përçmimi i robit të luftës, kurse robëria arrihej me arsimimin e myslimanëve. Islami me Muhammedin a.s. dhe Kur'anin, i dha botës alternativë të arsyeshme: në vend të shpatës dhe skllavërisë ofroi "kulturën dhe qytetërimin e fjalës, pendës dhe shkrimit, kulturën dhe qytetërimin e lirisë së mirëfilltë njerëzore.[13]

[13] Dzemaludin Llatiq, Islam, po aty, fq. 52-53. Ahmed Behxhet, po aty, fq. 551 e tutje.



Nuk duhet shpërfillur as çështjen se mrekullitë e Muhammedit a.s. kanë qenë të karakterit të përkohshëm (el-hissijjeh) dhe të tilla kemi disa dhe të karakterit të përhershëm (el-aklijjeh), dhe i tillë është Kur'ani, i cili ka vlefshmëri deri në Ditën e Fundit:

**وَإِن كُنتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّن مِّثْلِهِ وَادْعُوا شُهَدَاءَكُم مِّن دُونِ اللَّهِ إِن كُنتُمْ صَادِقِينَ . فَإِن لَّمْ تَفْعَلُوا وَلَن تَفْعَلُوا فَاتَّقُوا النَّارَ الَّتِي وَقُودُهَا النَّاسُ وَالْحِجَارَةُ ۖ أُعِدَّتْ لِلْكَافِرِينَ .**

***"Dhe nëse dyshoni në atë çka i kemi shpallur robit tonë, bëjeni ju një kaptinë të ngjashme si ai*** *(Kur'ani),* ***madje thirrni edhe dëshmitarët tuaj, përveç Allahut, nëse flisni të vërtetën! Po nëse nuk e bëni, dhe nuk mund ta bëni, atëherë ruajuni zjarrit të përgatitur për mosbesimtarët, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët."*** *(El-Bekare, 23-24).*[14]

## Përmbyllje

Edhe pse të gjithë të dërguarit përbëjnë një familje, disa prej tyre dallojnë nga disa të tjerë. Këta pejgamberë të zgjedhur nga numri i tërësishëm i të dërguarve janë quajtur ulu'l-azm, respektivisht pejgamberë të dalluar, pejgamberë të vendosur. Disa nga karakteristikat kryesore të tyre janë:

- Mbajnë prejardhje nga familje të shquara;
- Zotërojnë Ligj hyjnor (fletë apo libër);
- Posedojnë vullnet të fortë dhe janë këmbëngulës në zbatimin e misionit të tyre;
- Janë të dalluar nga Allahu në disa aspekte, që më lehtë ta përmbushin misionin e tyre[15] etj.

[14] Vehbi S. Gavoçi, Degët e imanit, po aty, fq. 25-30.
[15] Salih Karacabey, Ulu'l-Azm Prophets and Their Common Characteristics, sipas: http://www.lastprophet.info/ulul-azm-prophets-and-their-common-characteristics

*Literatura:*

1. Ahmed Behxhet, Të Dërguarit e Allahut, Prishtinë, 2009/ 1430 h.
2. Bekir Topaloglu - Yusuf Shevki - Ilyas Çelebi, Bazat e besimit islam, Prishtinë, 2002.
3. Hafiz Ibn Kethir, Kazivanja o vjerovjesnicima, Zenica, 1420-1999.
4. Ibn Abbas, Tefsir, pjesa 6, Sarajevo, 2007/1428 h.
5. Imam Nuruddin Es-Sabuni, Akaidi maturidij, Prishtinë, 2011.
6. Muhammed Rewwas Qal'ahxhi, Licnost Bozijeg Poslanika, Sarajevo-Zenica, 1437 h./2006.
7. Naim Tërnava, Akaidi 3, Prishtinë, 1999.
8. Nexhat Ibrahimi, Bazat e besimit islam, (pritet të botohet në Logos-A, Shkup, dorëshkrim).
9. Salih Karacabey, Ulu'l-Azm Prophets and Their Common Characteristics, në: http://www.lastprophet.info/ulul-azm-prophets-and-their-common-characteristics.
10. Dzemaludin Latic, Islam i svjetske religije, I, Sarajevo, 2000.
11. Ulul'azm anbiya` (Arch-Prophets) and all other prophets, në: http://www.ghadeer.org/english/shia/islam_teach/09.htm.
12. Vehbi S. Gavoçi, Degët e imanit, Prishtinë, 2005.



*Nexhat Ibrahimi*

## Most distinguished prophets ( أُولُو الْعَزْمِ - Ulu'l-azm)

### (Summary)

The sending of prophets (be they rasul or nabi) is an act of compassion and mercy due to the inability of humans to comprehend all that they see, be it spiritual or material (from this world or the other).

In Islam all the prophets are equal in principle. They should be revered as such without exception. Yet, as in the human world, where certain people have higher social and spiritual status, there are also prophets who have a higher standing than others. With regard to this, the holy Qur'an says:

Those messengers - some of them We caused to exceed others. Among them were those to whom Allah spoke, and He raised some of them in degree (Al-Baqarah: 253).

نجاد ابراهيمي

# أفضل الرسل (أولوالعزم)

## (خلاصة البحث)

ارسال الرسل (سواء كان رسولا او نبيا) يعتبر حكمة و رحمة و ليس تعجيزا بسبب امكانية الانسان لكي يفهم كل الاشياء التي يراها سواء كانت روحية أو مادية لهذه الدنيا و للأخرة.

حسب مبادئ الاسلام كل الرسل سواسية و لهذا السبب يجب علينا أن نؤمن في كل واحد منهم بلا استثناء و لكن كما أن في عالم الانسان هناك مستوايات مختلفة اجتماعية و روحية كذلك في عالم الرسل هناك مستوايات أعلى حيث تفترق من بعضها البعض و حول هذا نجد أن القرآن الكريم يقول فى سورة البقرة الآية 253:

"تِلْكَ الرُّسُلُ فَضَّلْنَا بَعْضَهُمْ عَلَىٰ بَعْضٍ ۘ مِّنْهُم مَّن كَلَّمَ اللَّهُ ۖ وَرَفَعَ بَعْضَهُمْ دَرَجَاتٍ "...

## PËRVJETORE

**Me rastin e 900-vjetorit të vdekjes së:**

# EBU HAMID MUHAMMED IBN MUHAMMED EL-GAZALIU (1058-1111)

Këtë vit shënohet 900-vjetori i vdekjes së **Ebu Hamid Muhammed ibn Muhammed el-Gazali (1058-1111)**. S'ka dyshim se Gazali është njëri ndër figurat më të ndritura të mendimtarëve myslimanë. Ky ishte një teolog islam (mutekelim), jurist (fekih), filozof, kozmolog, psikolog dhe mistik (sufi)[1] islam dhe mbetet njëri nga dijetarët më të njohur në historinë e mendimit sunit islam. Konsiderohet si një pionier i metodave të dyshimit (skepticizmit)[2]. Në njërën nga veprat e tij kryesore, ai ndryshoi kursin e fillit të filozofisë islame, që ishte e ndikuar nga filozofia antike greke, duke e drejtuar në një filozofi islame, në një metafizikë islame, të bazuar mbi shkak-efekt, që ishte vendosur nga Perëndia me ndërmjetësimin e engjëjve. Përveç punës së tij të suksesshme për të ndryshuar kahen e filozofisë islame të hershme nga Neoplatonizmi[3] pra që ishte zhvilluar mbi bazën e filozofisë helene, ai gjithashtu i solli Islamit Suni të kohës së tij, një marrëdhë-

[1] The influence of Islamic Thought on Maimonides, Stanford Encyclopedia of Phylosophy, june 30 2005.
[2] Ghazali, The Columbia Encyclopedia,six edition 2006.
[3] Neoplatonism (po ashtu thirret edhe Neo-Platonism) (në termin modern njihet per shkolle e mendimit fetarë të filozofisë mistike që u formua në shekullin e 3 p.e. bazuar në mësimet e Platonit dhe nxënësve të tij.., shiko edhe Fjalori i Terminologjisë Fetare, Akademik Dr. Ekrem Murtezai, f.356.



nie të afërt me Sufizmin. Duke zhvilluar një ndjenjë të vlerësimit reciprok dhe duke hudhur praktikat e mëparshme.[4] Kështu kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin e një pikëpamje sistematike të Sufizmit, integrimin dhe pranimin e tij në Islamin e zakonshëm. Ai mundi t'i përputhë, t'i ofrojë dhe t'i rregullojë, gjë që deri në atë kohë kishte një antagonizëm të theksuar mes tyre. Këtë e arriti me kulturën e tij, me zemrën e pastër, me shpirt të qëruar dhe me pozitë të ndritur në bazë të besimit të tij të fortë. Ai kishte shprehje të mprehtë, njohuri të gjerë dhe të gjithanshme. Sistemi i tij ishte i shkëlqyer, faktet dhe provat e tij të shëndosha e bënë ta kapërcejë mendimin e tij të kohës. Po ashtu, Gazaliu gjithashtu luajti një rol shumë të madh në konfirmimin e integrimit të tarikatit me sheriatin, (edhe pse El-Gazali nuk ka ndjekur ndonjë tarikat të veçantë e as nuk ka lënë mbrapa ndonjë tarikat sufist që të pasohet nga nxënësit apo simpatizantët e tij.[5] A i ka kombinuar konceptet e Sufizmit shumë mirë me ligjet e Sheriatit. Ishte gjithashtu i pari që provoi për të paraqitur një përshkrim formal të sufizmit në veprat e tij. Në veprimtarinë e tij gjithashtu ka përforcuar statusin e Sunizmit kundër shkollave tjera Batinite (Ismailite), që ishin shfaqur nëpër krahina të ndryshme të Persisë dhe gjatë kohës së Gazalit ishin përforcuar dukshëm. Gazali rreptësisht refuzoi ideologjinë e tyre dhe shkroi disa libra në përgenjështrimin e Batinijve.[6]

Pendat më të shquara gjatë shekujve u morën me të. Sipas "veb faqes" së tij "Gazali.org.", theksohet se për të u shkruan mbi 37 monografi, u mbajtën mbi 84 disertacione shkencore, 18 tema magjistrature, e sa e sa hyrje, parathënie librash, studime e vlerësime, të shkruara në gjuhët me të rëndësishme botërore. Edhe këtë vit u organizuan shumë simpoziume dhe konferenca shkencore nëpër rrethet e qarqeve kulturore e shkencore anembanë botës. Në Amerikë, do të veçojmë konferencat shkencore në Universitetin e Ohajos (10-12, 2011) nëntor dhe

[4] Prof. Tahir Kukaj (Fikret El-Kerame inde Ibni Tejmije. Temë magjistrature në Universitetin e Az-herit.
[5] Tahir Kukaj: *Fikre el Kerame*, po aty.
[6] Batinijtë apo Ismailitë një nga sektet radikale shiite.

Universitetin e Jelles prej (9-10, 2011) dhjetor. Kjo dëshmon aktualitetin e tij shkencor dhe pas nëntë shekujve.

Vite më parë edhe dy studiues (klerikë) shqiptarë këtu (SHBA), kanë shkruar për të: Imam Vehbi Ismaili ka bërë parathënien e botimit të parë të librit të tij në gjuhën shqipe "Ballsami i lirisë", botuar në Romë, më 1959, dhe Baba Rexhepi në "Bektashizma dhe Misticizma Islame", botuar në Nju-Jork, më 1970.

Ky dijetar i madh vjen nga Tus-i i Krahines së Horosanit në verilindje të Persisë, prej nga dolën edhe shumë dijetarë të tjerë që lanë emër në histori si: Ebu Jezid Bestamiu, Hysejn Mensur Hallaxhi, Abu Said abi el-Hajr, Nizam el-Mulk, Firdevsi dhe Omer Hajjami, duke qëndruar edhe vetë në majën e piramidës intelektuale.

Pati fatin që të ndjekë mësimet te mësuesit më të mirë të kohës. Mësuesit e tij të njohurive fetare ishin (në drejtësi -fikh, teologji-kelam, dhe besim -akaid): Ahmed Ibn Muhamed el-Râdhakâni në Tus, Ebu Nasr el-Isma'ili në Xherxhan, dhe el-Imam el Haremejn Ebu-el Ma'ali-Xhuvejni në Nishapur.

Ibn Asakir gjithashtu përmend se el-Gazali mori mësime për hadithin e Sahih-el-Buhari nga Ebu Muhamed ibn Sahl al Ahmad-Hafsi. Pati edhe të tjerë shejh, që janë profesorët të nderuar po ashtu në hadith si: ibn Ali ibn Nasr 'Ahmed el-Hakimi al-Tusi,' Abd Allah ibn Muhamed ibn Ahmed el- Havari, Muhammed ibën Jahja ibn Muhamed el-Suja `i al-Zavzani, hadithit Ebu el Master -Ibn Umeri Fityan 'Ebi el-Hasan el-el Ru'asi-Dahistani, dhe Nasr Ibn Ibrahim el-Makdisi. Midis prijësve të tij në tasavuf kanë qenë el-Fadl ibn Muhammed ibn 'Ali el-Farmadi al-Tusi (njëri nga studentët e Ebu el-Kasim el Qushajri) dhe Jusuf el-Sexhaxh.[7]

[7] Sh.G.F.Haddad në (veb: Living Islam, islamic tradicional-imam Al Ghazali).



## Jetë e shkurtër, me vepra të mëdha

Gazaliu u lind në qytetin Tusi[8], në afërsi të qytetit të sotëm Mesh'-hed, në verilindje të Persisë, katër shekuj e gjysmë pas Hixhretit dhe tre vjet pas përqendrimit të Selxhukëve në Bagdad, pra më 1058. Emri i tij ishte Muhamed bin Muhamed, dhe kishte ofiçin Ebu Hamid. Rrjedh nga një familje e ndershme. Siç pohon Taxhud-din es- Subki, babai i tij "ishte dervish i devotshëm që jetonte vetëm me atë që e fitonte me duart e tij". I ati i tij ishtë i varfër në pikëpamje materiale, por shumë i pasur në shprit. Jetesën e fitonte duke bërë pëlhurë, disa studjues mendojnë se nga ky zanat e mori edhe mbiemrin El Gazali (pëlhurëbërës).[9] Pëlhurën e mëndafshtë, ai e tregtonte në një dyqan në Tus. Historia flet shumë pak mbi jetën e prindërve të Gazaliut, nuk na tregon gjëra të shumta mbi të, vetëm na informon se babai i ka vdekur shumë i ri, dhe se kishte një dashuri e respekt të veçantë për dijetarët dhe nuk ngurronte kurrë t’u shërbente për të fituar simpatinë dhe bekimet e tyre. E kishte bërë zakon, i ati i Gazaliut-sa herë që dëgjonte një predikues (vaiz) të mirë t'i lutej Zotit duke thënë: “O Zot, më dhuro një djalë që të bëhet predikues i mirë dhe dijetar i njohur”.[10]

Si duket, Ebu Hamidi e trashëgoi këtë dashuri për dituri nga i ati, me ndryshim se pati mundësi të pajisej vetë me të, gjë kjo që i mungoi të atit. Gazaliut i vidiq i ati duke qenë akoma fëmijë, bashkë me të vëllanë e tij Ahmedin[11], dhe i la nën kujdesin e një Sufiu të varfër, që ishte mik i ngushtë i veti, të cilit i dha një pasuri të vogël duke i thënë: "Dëshira ime më e madhe ka qenë që të mësoj, por unë nuk e pata këtë fat, e dua prej teje që ta plotësosh këtë dëshirë në fëmijët e mi". Kështu shënojnë gati të gjithë kronikanët e biografisë së Gazaliut, bazuar

[8] Qytet në krahinen e Horosanit ne Iran. Dikur quhej edhe Taberan. Më 649 (27 H) Myslimanët e patën çliruar më 649 (27H) Mongolët e rrënuan tërësisht këtë qytet me 1389 (792 H) .Në gërmadhat e tij eshtë ngritur qyteti i i ri i sotëm Mesh'hed

[9] Ka edhe mendime të kunderta rreth këtij mbiemri,shih: V.Montogomeri Vatt "The Ghazali The muslim Intellectual "ABC internatiomal group 2002,f.181

[10] Imam vehbi Ismaili Ballsami i lirisë.

[11] po aty.

në autobiografinë e tij[12]. Kjo na dëshmon se familja e tij ka pasur lidhje me rrethet intelektuale të kohës. Dëshira, porosia dhe brenga e babait, që dy djemtë e tij të arsimohen në nivelet më të larta, pasqyrojnë nivelin intelektual familjar, që natyrisht ndikoi në formimin e tij të mëvonshëm.

Sufiu, të cilit ia la amanet dy fëmijët e tij, e mbajti premtimin dhe e plotësoi këtë dëshirë të mikut të vet, duke u kujdesur për rritjen e Gazaliut me të vëllanë si në pikëpamje kulturore ashtu dhe morale, por nuk shkoi shumë dhe pasuria e vogël që u kishte lënë i ati u mbarua dhe nuk ishte në gjendje që t'i ushqente, prandaj një ditë u tha: "Dijeni o djemtë e mi, që pasuria juaj që kishit u mbarua, unë jam një fukara e nuk kam pasuri që t'ju ushqej, prandaj duhet të shkoni në një shkollë", gjë që ata e dëgjuan. Kështu filloi rruga shkollore e Gazaliut. Nuk ka shënime për edukimin e tij të hershëm. Por, mosha e rregullt për fillimin e shkolllimit ka qenë mosha njëmbëdhjetëveçare, dhe ai 11 vjet i kishte më 1069.

Ky që në fëmijëri tregoi një zell të madh për mësim dhe durim të pashoq për të studiuar. Njohuritë e para i mori në qytetin e lindjes nga fusha e drejtësisë (fikhut) dhe teologjisë (kelamit). Mësuesi i parë në vendlindjen e tij ishte dijetari i njohur Ahmed Bin Muhamed er-Redhkani. Por, duke qenë se dëshironte të pajisej me më tepër dituri, e nuk kishte mundësi më shumë në atë qytet, vajti në Xhërxhan dhe u bë student i një dijetari tjetër të mirënjohur, Ebi Naser Ismaili.

Synimi dhe qëllimi i mësimeve të tij në atë kohë, ashtu siç ka pohuar edhe vetë, ishte i lidhur me çështjen ekzistenciale dhe për famë dhe jo për Allah. Ai do të shkruajë në "Shpëtimtari nga Humbja":

“I shqyrtova motivet e mia dhe arrita deri te përfundimi, se puna ime nuk ishte e nxitur nga një dëshirë e çiltër vetëm për të kënaqur Zotin, por në vend të saj, isha i motivuar nga dëshira, për të pasur një pozitë të lartë dhe famë publike. E kuptova me plot bindje http://www.balkanamerican.org/ se qëndroja buzë një bregu me rërë të

[12] Gazali "El Munkidhu min e d-dalal" (Shpëtimtari nga humbja), Vatt. e quan autobiografi shpirtërore.



thërmuar, buzë një rreziku të pashmangshëm të zjarrit të ferrit, në qoftë se nuk do të ndryshoja mënyrën e jetesës sime".[13]

Ky rrëfim i sinqertë i Gazaliut, flet vetë për pastërtinë dhe karakterin e tij.

Në Xhërxhan mbante shënim gjithçka dëgjonte nga mësuesi i vet, por si duket mjaftoi me kaq, pa përfituar intelektualisht nga çka shkruante dhe dëgjonte, pa u kujdesuar të kuptonte dhe të bluante lëndën që kishte marrë në shënim. Këtë gjë na e tregon vetë Gazaliu, në librin e cituar me këto fjalë:[14]

"Kusarët na prenë udhën dhe më morën gjithë ç'kisha me vete dhe ikën. Unë i ndoqa dhe arrita të parin e tyre, i cili më tha: "Kthehu, o i mjerë, në dash të shpëtosh lëkurën!" Unë i thashë: "Të lutem, për hir t'Atij që të ka në dorë jetën, të ma kthesh çantën e vogël, në të cilën kam gjëra që nuk të hyjnë ty në punë!".

Më tha: "Çka ke në të? Iu përgjigja: "Kam në të disa defterë në të cilët kam mbajtuar shënime, emigrova për t'i dëgjuar dhe shkruar, me ta mësoj shkencat e ndryshme". U shkreh së qeshuri me të madhe kryehajduti dhe më tha: "S’i paske mësuar shkencat që përmbajnë? Si duket kur ne ta morëm çantën ti u çmende nga dituria dhe mbete pa mësim!". Mandej urdhëroi njërin prej shokëve të tij dhe ma dorëzoi çantën. Kjo ngjarje la një përshtypje të thellë në shpirtin tim dhe i thashë vetes: "Këtë ma dërgoi Zoti për të m’udhëzuar!" dhe kur arrita në Tus iu vura me shpirt studimeve për tre vjet rresht gjersa arrita t'i mësoj dhe t'i përtyp mirë të gjitha shënimet e mia dhe arrita n'atë shkallë që po të më vidheshin defterët nuk zhvishesha nga dituria".[15]

Pas këtij rasti ai do të pohojë se nuk shkrova asgjë tjetër sa u përket mësimeve fetare, para se t’i mësoja përmendësh dymbëdhjetë mijë faqe të dijetarëve më të mëdhenj të Islamit. Dëshironte të arrijë gjer te rrënjet e problemeve. Prandaj, ai kishte zotëruar pikë për pikë, e ki-

[13] Po aty.
[14] Gadi të gjithë biografët e Gazaliut e shfrytëzojnë këtë autobiografi.Unë do ta jap sipas shqipërimit (versionit) të Imam Vehbiut.
[15] Imam Vehbi Ismaili "Ballsami i lumturisë".

shte përpunuar këtë mësim brenda në vetvete.[16] Gazaliu inspirohet nga ky ballafaqim me hajdutët dhe thotë në biografinë e tij:

“Në zemrën time e kuptova se thënia e hajdutit pati një qëllim. Vendosa se ai ishte i dërguar nga Zoti të më mësojë…Pas ballafaqimit me bandën e hajdutëve vendosa që t’i bëj roje vetes time dhe njohurisë sime nga takimet e mundshme të llojit të tillë në të ardhmen. I kalova tre vjet duke i mësuar përmendësh të gjitha shënimet që i kisha akumuluar përderisa vazhdoja me studimet e mia nën këshillat e të zgjuarit dhe të çmuarit, Imam Haramejn el Xhuvejni.[17]

Pas mësimeve të tij në Xhërxhan, u kthye në vendlindje në Tus, ku qëndroi 3 vjet. Në vitin 1077-(470 H) kur i kishte njëzet vjet shkoi në Nishapur, që ishte një qendër kulturore Islame, u regjistrua në kolegjin (Medresen ) Nizamijeh. Aty u mahnit nga fama e teologëve të shquar, si Ebu-el-Meali Zijaauddin el-Xhuvejn[18], i njohur si Imam Heremejn "imami i dy vendeve të shenjta" (Meka dhe Medina). Al-Xhuvejni ishte i biri i profesorit ose ligjëruesit të shquar në Nishapur, por Xhuvejni arriti të bëhet më i shkëlqyer dhe e tejkaloi babanë e tij. Parimisht, Gazaliu ishte një teolog dhe u regjistrua (u përcaktua ) të studiojë në teologji -ilmul kelam, ndoshta më e vështira në shkencat Islamike.

Programi mësimor në "Nizamije" në atë kohë përfshinte teologjinë, drejtësinë, filozofinë, logjikën, dialektikën, shkencat natyrore, sufizmin etj. Imam Haremejni ishte i njohur për tolerancën që u bënte studentëve të tij, ata ishin të lirë në mendimet e tyre, të guximshëm për të diskutuar çështje të ndryshme. Kjo e ngazëlleu edhe studentin e ri.

Historianët pohojnë se fakulteti i parë “Nizamije” duket të kishte qenë i themeluar në Nishapur para 960, dhe nga kjo kishin rrjedhur edhe shumë të tjera gjatë shekullit. Kjo formë e themelimit të fakulteteve u inkurajua me vrull nga Nizam-al-Mulk, veziri i madh Selxhuk

[16] Nga biografia e tij "el Munkidhu mined-dalal....(Shpëtimtari nga Humbja).
[17] Po aty.
[18] Xhuvejni autoritet fetar kulturor i kohës.



(në fuqi nga 1063 deri 1092). Ka shënime se ai ishte i pari që dha "scholarship" - "bursa" për studentët, mirëpo në botën islame ndihma për nxënës është shumë e hershme. Por, është e sigurt se ai themeloi më së paku nëntë fakultete në kuadër të “Nizamije”-s, të përhapura nga Mosul deri në Herat, dhe ato ishin të financuara pa kursyerje. Nishapuri gëzonte dhe jetonte një rehati nën Selxhuket, që zgjati afro 40 vjet, kurse Bagdadi ishte i mbërthyer në trazira. Si rrjedhojë ishte bërë e vështirë puna akademike. Ndoshta, kjo situatë kishte ndikuar që niveli i ngritjes akademike në rajonin e Nishapurit, të ishte në mesin e më të lartëve në botën Islame.

Al-Gazali mbeti në Nishapur deri në vdekjen e al-Xhuvejni-t, në gusht të 1085. Ky ishte i pajisur me një kujtesë të jashtëzakonshme, zgjuarësi të rrallë, durim të pashoq për të hetuar dhe studiuar, kështu që nuk shkoi shumë dhe u shqua si studenti më i zoti i këtij profesori të famshëm, nën kujdesin e të cilit studioi prej viti 1078 e deri me vdekjen e mësuesit tij më 1085. Në vitet e fundit e ndihmonte atë në mësime (u bë asistent i tij). Prandaj, na rezulton se Gazaliu kishte një shkollim aq të mirë sa që çdokush mund ta kishte lakmi në botën Islame. Gjatë kësaj kohe fama e Gazaliut kishte marrë dhenë.

Por më 1085, Imam Haremeni vdes. Të gjithë pritnin se Gazaliu do ta zevëndësojë mësuesin e tij të dashur e të çmuar, por befas ai e lëshon Nishapurin dhe shkon në Bagdad. Atëherë i kishte vetëm 28 vjet, ishte plot ambicie, plot energji dhe kishte një autoritet të lartë si dijetar Islam. Në një debat shkencor në të cilin Gazaliu, si zakonisht tregoi urtësi dhe dominoi kuvendin, ishte i pranishëm edhe veziri Selxhuk Shah Maliku. (Ky sundoi në periudhën 1072-1092/ 465-85 H.) Veziri pasi e kishte dëgjuar një debat të tij me studentë të tjerë, ishte i mahnitur me paraqitjen e diskutimin e tij dhe i mbetën në zemër fjalët e Gazaliut. Veziri ishte i mirënjohur për dashurinë që kishte për diturinë dhe respektin që kishte për dijetarët, ndaj pa u vonuar, e thirri Gazaliun në Bagdad, Gazaliu shkruan:

“Isha ftuar të prezentohem para vezirit Nizam Al mulk, që ishte ministri kryesor i Selxhukut Sultan Malik Shah. Atje iu bashkangjita teologëve dhe ekspertëve të tij legalë.”

Veziri i kishte bërë një pritje vërtet madhështore.

*“Abu Hamid Muhamed, student i ri, mirë se erdhe. Kam dëgjuar shumë për rrugën tënde të drejtësisë, diturisë dhe filozofisë, dhe nuk e besoja plotësisht derisa e pashë me sytë e mi, ku dëgjova debatin që solle argumente të bindshme, ku më binde dhe mua. Abu Hamid Muhamed, e adhuroi mënyrën se si jeni mendjehapur, aftësinë tënde në fjalime, dhe arsyet e bindshme që ju sillni. Kam deshirë që dituria juaj të bëhet pjesë e një audience më të gjerë. Kam menduar për këtë punë, dhe sot jam i bindur që të emëroj udhëheqës të Fakultetit të Teologjisë (ilmul kelamit) “Nizamije” në Bagdad. Që t’iu mësosh studentëve dhe atyre që janë të etur për dituri.”*[19]

Kështu, ai në vitin 1091 e zgjodhi për të dhënë mësime në kolegjin “Nizamije”[20] të Bagdadit, që ishte njëra ndër qendrat më të njohura kulturore të asaj kohe. Detyrë kjo që lakmohej nga secili dijetar i famshëm i kohës, por u jepej vetëm atyre që ishin shumë të shquar në fushën kulturore. Teologjia (Ilmul Kelami) e asaj gjenerate kishte shumë kundërthënie, por Gazaliu ishte i veçantë. Tërhiqte me qindra nxënës nga vende të ndryshme që grumbulloheshin në turma të mëdha për të dëgjuar mësimet e tij. Ky përmbushi shumë mirë misionin me të cilin u ngarkua, studentët derdheshin si ujët në klasat e tij në degët e ndryshme të kulturës së njohur atëherë, sa që arriti të kishte rreth tij më tepër se 300 studentë. Shumë prej dijetarëve trokitnin portën e tij për të diskutuar probleme të ndryshme shkencore dhe për të marrë mendimet e tij.

Si profesor i akademisë u popullarizua shumë dhe arriti një famë të mdhe. Mori edhe titullin e nderit "Huxhetul Islam" Garantues, Vërtetues i Islamit dhe tituj të tjerë. Mendimet e tij respektoheshin jo vetëm nga fetarët por edhe nga politika, masa e gjerë dhe intelektualët.

Kur e arriti nivelin më të lartë shkencor të një intelektuali, të një dijetari dhe mori mirënjohje nga dijetarë e sundues, pati simpatinë dhe besueshmërinë e shkencëtarëve të metropoles së atëhershme siç ishte

[19] Teksti është marrur nga filmi i përkthyer nga forumi shqiptar (vebsiti).
[20] Nizamije ishte themeluar ne Bagdad 1065-67/ hixhrije 458-60.



Bagdadi,[21] pikërisht në këtë kohë ai vendos të tërhiqet në një vetmi të plotë dhe ta lërë Bagdadin.

Gjatë kësaj kohe, si profesor në këtë kolegj, kur fama e tij dita-ditës shtohej, Gazali gradualisht filloi të bëhej skeptik, dhe pas katër vjetëve arriti kulmin e dyshimit, jo vetëm në teologji por dhe në çdo degë tjetër të kulturës dhe të filozofisë.

Në këtë kohë ndodhi edhe një ngjarje tragjike. Në një atentat ia vrasin përkrahësin e Gazalit, vezirin Nizam Al Mulk dhe nuk ishte e qartë se kush qëndronte prapa vrasjes (supozohej në batinij), El-Gazali mund të ketë qenë i ndikuar nga kjo ndodhi që të fillojë dhe ta rivlerësojë mënyrën e jetesës që po bënte në Bagdad. "Jo në atë se çfarë besoja, por në mënyrën se si po jetoja jetën time. Një jetë që isha i rrethuar nga çdo anë me një botë materiale.” “Pavarësisht suksesit, pasurisë dhe statusit që kisha arritur, dyshimet m’u kthyen".

Lidhur me ndërrimin e pozicionit të Gazaliut, kronikët po ashtu e shënojnë edhe këtë rast: Një ditë përderisa El-Gazali ishte duke dhënë mësime, vëllai i tij Ahmedi, hyn në klasë, ku ia ndërpret mësimin duke i thënë: *“Ti ua zgjate dorën atyre kur ata nuk kishin vullnet të ecnin përpara, por vetë ke mbetur mbrapa, përderisa ata kanë përparuar. Ti ke marrë rolin e një keshillëdhënësi, por ti nuk pranon këshilla. Ti flet, por nuk dëgjon. O gur që mprehe, edhe sa kohë do të mprehësh hekurin, por nuk do e lë veten të mprehesh"*

Por, kronikët e tij pohojnë se Gazali nuk filloi duke e detyruar vetveten në këtë ecje drejt dyshimit. Dyshimi i vinte vetvetiu në mendjen e tij. Atëherë ai filloi të vërë në pikëpyetje pseudo-sigurinë. Ai e kuptoi se duhet ta zhbëjë vetveten se i duhet ta riformojë vetveten, të kalojë përmes një transformimi shpirtëror, ta ndryshojë jetën e tij dhe mënyren e të menduarit. Ai dëshiroi të sakrifikojë të gjitha për hir të bindjes, vërtetimit apo sigurisë. Gazaliu kishte aftësi dhe vullnet të sakrifikojë në mënyrë që të arrijë të marrë diturinë. Njeriu i rëndomtë nuk e arrin këtë. Njeriu arrin njohuritë e larta (mearifetin) vetëm në qoftë se e hap zemrën te Zoti, që do të thotë t’i vdesësh vetes apo

[21] Salih Collakoviq, *"Ebu Hamid El Gazali Ihja Ulumid-din"* Libri I, Sarajevë 2005 f.21.

egos, t'i vdesësh botës përreth teje. Dhe ajo ishte që arriti ta bëjë Gazaliu. Merifeti është njohja së afërmi mirë e Zotit të Madh, i cili përfshin çdo gjë në esencën e Tij. Pra, merifeti është njohja mirë e Zotit të Madh dhe cilësive të Tij.[22]

“Një luftë zhvillohej midis zemrës dhe kokës sime, dhe eventualisht u sëmura fizikisht. Ishte një kohë shumë e vështirë hutimi. Sëmundja më zgjati afro 2 muaj, gjatë së cilës kohë u bëra praktikisht një folës skeptik, edhe pse jo në principe apo në shprehjen e jashtme.” ... “Por, në fund Zoti më shëroi. E gjeta veten të rikthyer në shëndet dhe balanc, kështu që m'u bë e mundur të pranoj të vërtetën e nevojshme të intelektit. Fitova besimin në karakterin e sigurisë dhe besimit të intelektit. Ky shërim nuk erdhi pas një demonstrimi sistematik apo të ndonjë argumenti, por nga një Dritë që Zoti i madhërishëm e hodhi mbi gjoksin tim. Kjo Dritë është çelësi i njohurisë më të madhe”.[23]

## Tërheqja nga bota materiale - rruga drejt vetmisë

Ai erdhi te përfundimi se e gjithë kjo njohuri intelektuale, është në fakt vetëm një kamuflim, një maskë e injorancës, sepse ai mendoi se gjëja më injorante e sendit dhe më kryesore është vetvetja. Ai me të vërtetë e gjen veten në atë shkallë të krizës, ku e kupton se ai është mortal, se ai do të vdesë, dhe shtronte pyetjen: a jam përgatitur për këtë udhëtim?. Dhe kjo është e vetmja krizë reale sipas tij, që ka ndonjë kuptim për çdo njeri. Prandaj, ai u ndesh përballë një krize të vërtetë ekzistenciale të gjendjes së njeriut, që është mortaliteti.

“Për gjashtë muaj me radhë vazhdimisht hidhesha midis dëshirave të botës dhe lëngimit tim për jetën e përhershme. Më në fund kjo çështje nuk varej më nga unë por u bë një detyrim. Zoti ma bëri gjuhën time të thahet, kështu që nuk isha në gjendje të ligjëroja. Çdo ditë mundohesha me gjithë fuqinë time që t'i kenaq nxënësit e mi duke u dhënë ligjërata, por gjuha ime nuk mund të nxirrte asnjë fjalë, dhe as që mund të arrija asgjë!”.

[22] "Baba Rexhepi Misticima dhe Bektashizma Islame" f.58.
[23] Shpëtimtari nga humbja.



Ai ra në në krizë mentale, në një krizë intelektuale, dhe gradualisht u shndërrua në një krizë psikologjike, që filloi të ndikojë në ngrënien e ushqimit, në apetitin për gjumë dhe ra në një sëmundje të rëndë.

“E kuptova me plot bindje se qëndroja buzë një bregu me rërë të thermuar, buzë një rreziku të pashmangshëm të zjarrit të ferrit, në qoftë se nuk do të ndryshoja mënyrën e jetesës sime. E dija se rruga e Sufinjeve përmbledh besimin intelektual dhe veprimet në praktikë. Këto veprime marrin formën e pastrimit total të pengesave në shpirt, për t'i zhveshur karakteristikat themelore dhe veset e pamoralshme. Në mënyrë që zemra të arrijë lirinë nga çdo gjë që nuk është Zot”.

“Besimi intelektual ishte i lehtë, por u bë e qartë në mua se çka e dallon Sufizmin në veçanti nuk mund të kuptohet vetëm duke e studiuar, por vetëm me një përjetim të drejtpërdrejtë, me ekstazë dhe me një transformim moral. Sufinjtë nuk ishin njerëz të fjalëve por të përjetimit. Nuk më kishte mbetur më shpresë nga një plagë e ardhshme po të mos mund të arrija të jetoj një jetë me vetëdije-Zoti, dhe të tërhiqem nga dëshirat e pafryta. Arrita të bëj atë që mjekët e mi nuk mund të bënin, arrita ta shëroj veten time, dhe ky shërim ishte absolut. Ua shpërndava varfnjakëve pasurinë që kisha, duke mbajtur për vete vetëm aq sa të më mjaftojë për udhëtimin që do të merrja dhe për të mbështetur familjen që do ta lë mbrapa, pasi që nuk prisja të kthehem më në Bagdad”.

Ai la mbrapa të gjitha, kushtet e mira dhe suksesin që kishte arritur, la mbrapa të qenit afër me halifin në kryeqytetin e Islamit, la mbrapa famën që kishte arritur, i la të gjitha, në mënyrë që të zbulojë të vërtetën, në mënyrë që të bëhet real me vetveten dhe të kuptojë natyrën e realitetit hyjnor. Kur njeriu fillon një udhëtim të brendshëm në drejtim të shpirtit, është mirë që njëkohësisht njeriu të fillojë një udhëtim të jashtëm në botë. Kur njeriu udhëton me vetëdije, ai arrin te realizmi, sepse shtëpia e njeriut nuk gjendet në ndonjë rrugë të veçantë, por është në Zotin. Prandaj, një udhëtim i jashtëm konsiderohet

një mbështetje shumë e mirë e udhëtimit të brendshëm, dhe këtë dëshironte ta bënte Gazaliu.

Nuk i bëhej më të jepte mësime, dhe pa pritur, në vitin 1095 la detyrën e profesorit, la qetësinë që gëzonte nga ofiqi i tij, u nda nga familja dhe shkoi duke u endur qytet më qytet për të gjetur prehjen shpirtërore dhe qetësinë mendore, duke e kaluar kohën në lutje dhe meditacion. Biografët e tij kanë shënuar disa teza interesante për shkaqet që e shtyn Gazin të tërhiqet në botën e meditimit. Disa mendojnë se Gazaliu u largua nga Bagdadi nga frika e hakmarrjes së Batinijve. E theksuam edhe më lart se anëtarët e këtij sekti kishin bërë atentat në Nizam el Mulk, e një muaj më vonë edhe në shah Melikun. Në shënjester të tyre ishin edhe shumë intelektualë dhe personalitete në Bagdad. Pikërisht në këtë kohë, halifi i atëhershëm abasit, Ahmed b.el-Muktedi Billah, i njohur si "el Mustez-har"[24] kishte kërkuar që të bëjë një kritikë ndaj mësimeve të Batinijve, që ishin sforcuar shumë. Këtë ide Gazali e kishte pranuar dhe i publikoi në vepren tij "el Mustez-har". Kjo ishte kritika më e rreptë që i kishte bërë ndokush deri në atë kohë.

Disa të tjerë mendojnë se kishte një mosmarrëveshje mes Gazaliut dhe halifit Musteh-zar, ndaj vendosi që të tërhiqet nga Bagdadi. Të tjerët mendojnë se fama dhe popullariteti i tij i madh kishin krijuar një urrejtje dhe një neveri ndaj tij, dhe ai mendoi se nuk është më i përshtatshëm për atë rreth.[25] Sido që të jetë, Gazaliu kishte dashuri për jetën shpirtërore, dhe ai do të pëlqente të ekspozojë veten në këtë rrafsh, në të njëjtën mënyrë siç kishte vepruar në rrafshin filozofik, duke studiuar me prirje akademike, por ai kuptoi se Sufizmi ishte diçka tjetër ishte ekzistencial, dhe se ai nuk mund të arrijë një kuptim të plotë të tij pa e vetëpraktikuar atë, si një mënyrë jetese. Kështu ai ndërmori

[24] El Mustez-har Billah, ishte i 28 halif nga dinastia Abasite.

[25] Salih Collakoviq, parathënie në përkthimin e Ihjauulumidin në boshnjakisht, Sarajevë 2005, libri parë, f.21.



një vendim të guximshëm, braktisi profesionin e tij prej akademiku dhe u fut në sufizëm.[26]

Ai u tërhoq nga bota fare dhe i vetmuar merrej me lutjet e Zotit. Dhe duke mos menduar t’i rezistonte kësaj dashurie, vendosi dhe iu shtrua jetës shpirtërore. Shkoi në Jerusalem, Aleksandri, Damask dhe kreu detyrën e haxhillëkut në Mekke, sikundër vizitoi dhe Medinën. “Publikisht lajmërova që kisha vendosur të shkoj haxhillëk në Meke. Por, privatisht u përgatita të udhëtoj për në Siri. Mora këto masa paraprake nga frika që halifi dhe kolegët e mi do të kundërshtonin vendimin tim.”

El Gazali i kalon dhjetë vjetët më të mira të jetës së tij në këtë udhëtim. Nuk dimë saktësisht se cilat kanë qenë aktivitetet e tij. Ai me siguri bëri haxhillëkun në Mekë një vit mbas largimit nga Bagdadi, por kaloi kohë edhe në Jerusalem. Dihet gjithashtu se ai kaloi shumë kohë i tërhequr në një kënd në xhaminë e madhe Emevite në Damask. Ky vend është i njohur dhe vizitohet edhe në kohën e tanishme. Me siguri se ai i përcolli gjurmët e Sufinjeve të Islamit, që thjesht ishin të vendosur t’i ndërpresin përkohesisht lidhjet e tyre me botën dhe dëshironin ta gjejnë Zotin në natyrë duke udhëtuar nëpër shkretëtirë, pyje dhe rajone malore, duke besuar në Zot për t’i mbajtur ata, dhe panderprerë duke u munduar për të mbajtur në mendje dhe medituar në bukurinë e krijesave të Zotit, dhe duke u përpjekur për të kujtuar Zotin përmes recitimeve të Kur’anit, përmes lutjeve, përmes agjërimit të shumtë, përmes takimit me njerëz të mrekullueshëm, njerëzve të urtë, të menqur dhe të shenjtë që shpesh jetonin përkohësisht në shkretëtirë dhe pranonin nxënës.

“Ia kushtova vetes sime tërë kohën për ta pastruar shpirtin, për ta përmirësuar karakterin, për ta larë zemrën në përkujtime konstante të Zotit. E vura në praktikë çfarë kisha mësuar nga studimi i misticizmit …nga leximi i librave.

[26] Vat Montgomery Vatt (Universiteti i Edinburgut): Al-Ghazali The Muslim Intellectual, publikuar më 2002 nga ABC Intenational Groupf.176.

Gazaliu iu përvesh sufizmit jo vetëm duke e njohur si rrugë, e cila të shpjerë dhe të ofron te Zoti, me anën e mënyrave të njohura të saj, por i dhuroi frymës mistike gjithë jetën e tij dhe e përqafoi siç duhet.

"Qëndrova në Damask për dy vjet, duke bërë asgjë përveç kultivimit të të panjohurës në vetmi. Tërhiqesha në xhaminë Emevite, hipja lart në minare të xhamisë duke kaluar tërë ditën i mbyllur që të jem në vetmi."

Njëra prej gjërave më me rëndesi sa i përket udhëtimit në misticizëm apo një përjetimi direkt të realitetit, është se për Imam El-Gazaliun ky përjetim ishte një shkencë. Sepse në rrënjët e shkencës është aftësia për të duplikuar eksperimentin. Në qoftë se eksperimenti mund të duplikohet apo vërtetohet, atëherë si rrjedhojë kemi rezultate shkencore. Ai dëshiroi që të vërtetojë, se a janë të vërteta këto përjetime që mistikët i kanë deklaruar, t'i kenë përjetuar. Njëri mund të thotë se Gazali ishte një shkencëtar eksperimentues dhe i dha detyrë vetes, se në qoftë se marrë këtë rrugë a mund të duplikojë atë që mistikët kishin pretenduar, dhe me sakrifica të mëdha ia arriti këtij qëllimi. Pra, me një përjetim personal u bind në vërtetësinë e kësaj çështjeje.

"Gjatë kësaj kohe të vetmisë m'u shfaqën gjëra të panumërta dhe të pafundme. Vetëm kaq do të them në menyrë që të tjerët të ndihmohen. E kuptova në mënyrë të sigurt se mbi të gjithë janë Sufinjtë që mbajnë rrugën e Zotit. Jeta e tyre është jeta më e mirë, metodat e tyre janë metodat më të shëndosha, karakteri i tyre është karakteri më i pastër. Ne fakt nëse njeriu do t'i bashkonte aftësitë e intelektualëve, zgjuarsinë e të zgjuarve dhe gjithë diturinë e studentëve dhe nga ky bashkim të mundohen të gjithë së bashku për të gjetur dhe ndryshuar vetëm një gjë në sjelljen dhe etikën e sufinjeve dhe ta zëvendësojnë atë gjë me një gjë më të mirë, asnjë mënyrë apo rrugë për të bërë një gjë të tillë nuk do të mund të gjendej. Sepse të gjitha veprimet e tyre të jashtme dhe të brendshme i kanë mësuar nga drita e qoshit të ngrohtë të Profetësisë. Dhe përtej dritës së Profetësisë nuk ka asnjë dritë në tokë prej nga dituria mund të arrihet."

Në praktikë Dhikri (Përmendja) apo përkujtimi i Allahut është i domosdoshëm, por mistikët mendojnë se gjatë këtij përkujtimi, Zoti në mënyrë misterioze bëhet prezent në emrin e tij, dhe me kujtimin konstant, janë në gjendje të afrohen afër hyjnores. Kjo është edhe alkimia (lumturia) që Gazali kërkonte në mënyrë që ta pastronte zemrën dhe të transformonte vetveten. Kështu ai përvetësoi Sufizmin, me anë të të cilit gjeti qetësinë shpirtërore që kërkonte dhe prehjen mendore. Duke folur mbi zhdukjen e dyshimit në këtë periudhë të jetës së tij, Gazaliu në biografinë e tij "Shpëtimtari nga Humbja", mbasi flet mbi periudhat e ndryshme që kaloi gjatë jetës së tij të dyshimit, tregon se shpëtimi nga errësira e dyshimit dhe dalja në dritë e besimit nuk i erdhën nga provat dhe argumentat ***"...por nga Drita që Zoti shkaktoi të depërtonte në zemrën time, Dritë që shkëlqen hyrjen në të gjitha dituritë. Të mendojmë se sigurimi vjen vetëm duke u bazuar në argumente formale është të kufizojmë mëshirën e pafund të Zotit."***

"Një luftë zhvillohej midis zemrës dhe kokës sime dhe eventualisht u sëmura fizikisht. Ishte një kohë shumë e vështirë hutimi. Sëmundja më zgjati afro 2 muaj, gjatë se cilës kohë u bëra praktikisht një folës skeptik, edhe pse jo në principe apo në shprehjen e jashtme." "Por, në fund Zoti më shëroi. E gjeta veten të rikthyer në shëndet dhe balanc, kështu që m'u bë e mundur të pranoj të vërtetën e nevojshme të intelektit. Fitova besimin në karakterin e sigurisë dhe besimit të intelektit. Ky shërim nuk erdhi pas një demonstrimi sistematik apo të ndonjë argumenti, por nga ***një Dritë që Zoti i madhërishëm e hodhi mbi gjoksin tim. Kjo Dritë është çelësi i njohurisë më të madhe".***[27]

Gazali duke i referuar hadithit të Profetit a.s. flet për një natyrë të pastër duke përdorur fjalën **fitra (natyrshmëri) që nënkupton fitretul islam**. Fitra do të thotë natyra njerëzore, që është origjinaliteti rrënjesor apo fillimi i natyrës së njeriut. Njeriu ashtu siç ishte krijuar në fillim nga Zoti. Dhe në qoftë se pyet nga çka përbëhet ky origjinalitet, njeriu mund të thotë se Dashuria e Zotit, Adhurimi i Zotit, njeriu është krijuar për Zotin. Për një adhurim më të lartë ose nga një shkallë më e lartë e adhurimit të Zotit. Ndaj, njeriu si qenie njerëzore në radhë të

[27] Të gjitha citatet e Gazaliut janë nga *"Path to sufism his deliverance from error"*, Botimi i tretë Fons vitae, Louisville, Kentucky 2006.

parë, do të thotë ta njohë Zotin, kjo nënkupton intelektin që Zoti i ka dhuruar njeriut në mënyrë që ai ta njohë Atë. Kjo njohuri natyrisht është identifikimi i të **Njohurit dhe njohësit.** Njeriu mund të thotë kështu: “Njeriu është bërë për këtë bashkim”. Për këtë arsye them se nga natyra njeriu është adhurues, ashtu si u krijua nga Zoti. Por, sipas Gazaliut njerëzit nuk janë në një shkallë aftësie për t’i nxënë njohuritë. Disa janë të fortë e disa jo! Prandaj, ai që nuk ka aftësi duhet të mjaftohet vetëm me Kur’anin dhe me fjalët e urdhrat e Profetit dhe të mos shkojnë më tutje dhe të merren me filozofi. Sepse të kërkojë e të gjejë thelbin e parimeve fetare një njeri i thjeshtë, është sikur të hyjë në det dhe të mos dijë të notojë.[28]

Gazaliu ishte njëri nga të parët që identifikoi dhe ndau në pesë motive shqisat e jashtme. (dëgjimi, shikimi, nuhatja, shijimi dhe prekja).

"Iu rreka me plot seriozitet vëzhgimit të dhuntive ndijore dhe të domosdoshmërive të arsyes, për të parë se a ekziston mundësia që edhe vetë unë të dyshoj në to. Një analizë e gjatë e dyshimit më shpuri deri aty që më nuk mund të besoja në besnikërinë e dhuntive ndijore. Dyshimi në to më kaploi dhe sikur thoshte: "Prej nga ky besim në dhuntitë ndijore? Shqisa më e fuqishme është shqisa e të pamurit dhe kur të drejtohet kah hija, ajo sheh se hija qëndron në një vend dhe nuk lëviz, andaj nxjerr përfundim se aty nuk ka lëvizje. Pastaj, me anë të eksperiencës dhe soditjes, një orë më vonë, kupton se hija lëviz, por ajo nuk lëviz përnjëherësh dhe aty për aty, por suksesivisht dhe pak nga pak, kështu që kurrë nuk është në gjendje të palëvizshme. Ajo shikon yllin në qiell dhe e sheh se ai është i vogël, jo më i madh se moneta, ndërsa argumentet gjeometrike flasin se ai është më i madh se Toka. "Në këtë rast dhe në raste të ngjashme të perceptimeve shqisore, shqisa si gjykatëse sjell gjykimin e vet, mirëpo arsyeja e rrëzon atë dhe tregon sheshit pavërtetësinë e gjykimit shqisor, i cili assesi nuk mund të mbrohet. Thash:

[28] Shih Bektashizma dhe misticizma islame f.58.



"U shkatërrua besimi im edhe në dhuntitë ndijore. Ndoshta është e mundur t'u besohet dhuntive të arsyes, të cilat janë parim i parë...”

"Por, shqisat përgjigjen: "Përse je i sigurt se besimi yt në dhuntitë e arsyes nuk është i njëjtë sikurse ai në dhuntitë ndijore; sepse neve na pate besuar, por erdhi gjykatësi (arsyeja) dhe na përgënjeshtroi. Po të mos ishte gjykatësi (arsyeja) ti edhe më do të na konsideroje si të vërteta. E, ndoshta mbrapa gjykatësit-arsye ekziston ndonjë gjykatës tjetër i cili, po të paraqitej do të tregonte sheshit mosvërtetësinë e gjykimit të arsyes, siç u paraqit gjykatësi-arsyeja e tregoi sheshit mosvërtetësinë e gjykimit të shqisave. Fakti se një vërojtje e tillë nuk është duke u paraqitur, nuk do të thotë se ajo është e pamundur..."

"Kjo nuk ndodhi për shkak të parashtrimit të argumentit apo diskutimit të arsyeshëm, por duke i falënderuar dritës, të cilën Zoti i Lartmadhërishëm e futi në shpirtin tim. Kjo dritë është çelës i shumë konceptimeve. Ai i cili konsideron se zbulimi prehet në argumentet e shkruara, ai e kufizon mëshirën e pakufishme të Zotit të Lartmadhërishëm".

## Veprimtaria e tij

Mbasi doli Gazaliu nga errësira e dyshimit në dritën e besimit me ndërmjetësinë e eksperiencës sufiste, u muar edhe disa vite me mësim në qytete të ndryshme dhe filloi të hedhë në letër eksperiencën e tij, duke shkruajtur libra të ndryshme, përveç atyre që kishte shkruar përpara në teologji, moral dhe jurisprudencë.

Enciklopedia britanike shënon që Gazaliu ka shkruar 69 vepra në subjekte të ndryshme.Gati të gjithë biografët theksojnë se numri i tyre sillet aty kah 70. Vetë Gazali në njërën nga letrat e tij që ia kishte dërguar Sulltanit Sanjar el Melik Shah, në vitet e fundit të jetës së tij, kishte përmendur numrin e veprave të tij "më shumë se 70", Megjithatë, në literaturë përmendet se ekzistojnë më shumë se 400 libra që sot i atribuohen atij.

Kështu që kur bëhet fjalë për numrin e saktë të veprave të Gazaliut, kritikët, historianët dhe biografët nuk mund të pajtohen në një numër të vetëm të tyre.

Ka dy arsye për ketë. Humbja e disa veprave të moshës së rinisë së tij, posaçërisht gjatë shkollimit në "NizamIje" në Nishapur, ku fillimisht ishte nxënës e pastaj edhe asistent i alimit të njohur Xhuvejnit. Kjo do të ishte edhe fillimi i interesimeve filozofike të tij.

Perudha e dytë është jeta e tij në Bagdad dhe puna në "Nizamije". Nuk dihet se sa vepra ka shkruar në atë periudhë. Por, kuptohet logjikisht se ka shkruar vepra që trajtonin probleme filozofike, pastaj veprat kritike në të cilat Gazaliu gjykonte idetë që ishin në kundërshtim me Kur'anin dhe hadithin. Në këtë kohë u shkruan veprat "Mekasidul el-felsefe", "Tehafetul el-felsefe", "Fedaiu el-Batanije", "Fedailu el-mustaz-hirije "etj.

Periudha e tretë që është më interesantja dhe më e plleshmja për veprimtarinë e tij është koha e vetmisë-izolimit, pra tërheqja nga jeta publike, e cila zgjati afro 15 vjet. Pikërisht në atë kohë u shkruan "El munkidhu min ed-dalali (Shpëtimtari nga humbja) dhe vepra tjetër më voluminoze e tij "Ihja -u ulumiddin".

Sado që cilësimi i veprave të tij është një hap i vështirë, studiues të ndryshëm perëndimorë si Villiam Montgomeri Vatt *(Punimet atribuohet Al-Ghazali), Maurice Bouyges (Essai de Chronologie des oeuvres d'El-Gazali)* Michael E.Marmura dhe të tjerët përgatitur një listë të veprave të tij së bashku me komentet e tyre në çdo libër.

Por, ne do të sjellim mendimin e profesorit egjiptas Abdurrahman el Bedevi, që u mor ekskluzivisht me këtë çështje. Ai në veprën e tij "Muellefatu el Gazali" (Veprat e Gazalit) ka përgatitur një listë të plotë të veprave të Gazaliut, duke shënuar me numrin rendor dhe duke përmendur titujt e tyre dhe duke ndarë saktësinë e tyre që numrojnë gjithsej 457 tituj:

- 1-72: vepra e shkruar definitivisht nga Gazaliu;
- 73-95: veprat e atribuimit të dyshimtë;
- 96-127: vepra, të cilat nuk janë ato të Gazaliut me siguri më të madhe;



- 128-224: a janë emrat e kapitujt ose seksionet e librave të Gazaliut që mendohet se janë librat e tij;
- 225-273: libra të shkruara nga autorë të tjera lidhur me veprat e Gazaliut;
- 274-389: librat e dijetarëve të tjerë të panjohur-shkrimtarëve lidhur me jetën e Gazaliut dhe personalitetet;
- 389-457: Emri i dorëshkrime të veprave të Gazaliut në bibliotekat e ndryshme të botës.

Më poshtë është një listë e shkurtër e veprave të tij kryesore:

## Teologji

- *el-Munqidh min-dalal* (shpëtimtar nga gabimi)
- *Huxhat el-Haq* (Dëshmi e së Vërtetës)
- *al-fil Iqtisad-i `tiqad*
- *el-maqsad-asna fi sharah Esma el-Husna Allahu*
- *Javahir el-Kur'an duraruha*
- *Al Fayasl-tafriqa bayn el-ëa-l-Islam zandaqa*
- *Mishkat al-Anëar*
- *Tafsir al-Jakut el-ta'ëil*
- *Sirr al-`Alamin*
- *el-Risālah-Qudsiyyah*

## Sufizëm

- Mizan al-'amal
- Al Ihya 'ulum-din, "puna më e rëndësishme Gazaliut
- Al Bidayat-hidayah
- Kimiya-sa'ādat
- Nasihat el-muluk
- el-Munqidh min-dalal
- Minhaj al-'Abidin

## Filozofi

- Falasifa Maqasid al
- Al Tahafut-Falasifa
- Al Miyar fi el-Ilm-fan Mantiq
- Al Mihak-Nazar fi el-mantiq
- el-Qistas-mustaqim

## Jurisprudencë

- Fetvë el-Gazali
- El-ëasit fi el-mathab
- Kitab al tahzib-Isul
- el-Mustasfa fi 'ilm-isul
- Asas el-Qiyas

## Tituj të veprave në persisht

**Kīmyāyé Sa'ādat**
**Nasīhatul Mulūk**
**Zād-e Ākherat**
**Pand-Emri**
**Faza'ilul al-anam min rasa'ili el hujjat-Islami**

Shumë prej veprave të tij janë përkëthyer në anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, përveç përkthimeve të bëra në gjuhët e popujve myslimanë. Në gjuhën angleze, ka kohë që kanë depërtuar veprat e tij më kryesore, pavarësisht mundit dhe vështirësive në përkthim, siç thotë Michael E. Marmuara "teksti (Gjuha) i Gazaliut nganjëherë paraqet vështirësi për përkthyesin, jo pse autori i tij është shkrimtar i keq, porse autori është shkrimtar i mirë, është një mjeshtër i vërtetë i shkrimit arab. Stili i tij, gjithsesi është shumë i veçantë dhe me plot idioma; ajo mban në vete nuanca që vështirë mund të përkthehen. Si i tillë, vështirësitë në të cilat ndeshemi nuk janë pasojë e paqartësisë



autoriale, sepse në pëgjithësi, Gazaliu shquhet për prezantimin e argumenteve komplekse dhe delikate.[29]

Libri më i madh dhe i famshëm i librave të Gazaliut është: "IHJA-UL ULUMUDDIN". Dy pjesët e para të këtij libri flasin mbi formën e jashtme të ibadeteve (lutjeve) dhe dy pjesët e fundit shkruhen mbi natyrën e brendshme të fesë. Secila nga këto katër pjesë përmban nga dhjetë libra. Stili është madhështor, gjuha është e lehtë dhe mund të kuptohet prej kujdo. Ky libër është me të vërtetë kryevepër, sidomos në pikëpamje të karakterit njerëzor dhe të etikës.[30]

Për këtë libër orientalistët evropjanë kanë treguar një kujdes të madh dhe është përkëthyer në shumë gjuhë moderne. Pozita që gëzon Gazaliu me këtë vepër në mesin e myslimanëve, mund të krahasohet me pozitën që gëzon mes bashkëfetarëve të tij Kristian Thomas a Kempis (1380-1471), i cili qe një mistik i famshëm i krishterë, i cili besohet të ketë arritur një përparim të lartë shpirtëror. Kempis u bë i famshëm me librin "Imitimi i Krishtit". Natyra e lëndës së këtij libri i afrohet natyrës së lëndës së "IHJA-S", natyrisht me ndryshim që "Imitimi" është shkruar për t'iu përshtatur mësimeve dhe pikëpamjes së krishterë.[31]

Për librin "Përtëritja e shkencave fetare disa nga dijetarët myslimanë kanë thënë: "Po të zhduken të gjitha librat e shkruara mbi fenë Islame, do t'ishte një humbje e vogël, me konditë që libra e Gazaliut "Përtëritja e shkencave fetare" të ruhej".

Dy vepra të tjera që janë me famë në botën oksidentale dhe që shkaktuan një rrebesh kundërshtimesh ndër filozofët janë: "Mekasidul Felasifeh" (Qëllimet e Filozofëve) dhe "Tehafutul Felasifeh" (Gabimet e Filozofëve). Në librin e parë Gazaliu përmbledh idetë e ndryshme filozofike në logjikë, metafizikë dhe degët e tjera që njiheshin deri

---

[29] Michel E. Marmura: Parathënie e Librit të Gazalit "The Incohere of the Philozofers" Utah 2000. f.27.
[30] Ky libër është i përkthyer edhe në gjuhën angleze, në atë boshnjake etj. Ndërsa në gjuhën shqipe vetëm libri i parë, ndërsa tjerat janë në procesin e botimit të cilat i ka përkthyer Dr Ali Iljazi (nga boshnakishtja).
[31] V. Ismaili vepra e cituar, f.11.

atëherë. Ky libër qe përkthyer latinisht prej Dominicus Gandissalvus dhe qe botuar në Venedik, më 1506. I dyti përmban një kritikë të rreptë ndaj sistemeve filozofike të ndryshme, të shpjeguara në librin e parë.[32]

Gazaliu vetë thotë se librin e parë e shkroi me qëllim që t'u paraqiste lexuesve materialin të cilin do ta kritikonte me librin e dytë të vetin.

Që nga koha kur filozofia greke u përkthye në gjuhën arabe dhe pati efekt në mendimin Islam, ishte objekt i diskutimeve mes dijetarëve myslimanë. Shumë mendimtarë Islamë e kritikuan filozofinë greke se kishte efekt negativ në të menduarit Islam, për atë, se i jepte rëndësi shumë të madhe logjikës dhe e injoronte rëndësinë e Shpalljes Hyjnore. Mirëpo, kritikat e dijetarëve ndaj filozofisë nuk arritën efektin e dëshiruar ndaj filozofisë. Kjo ishte për arsye se kritikat e tyre nuk ishin shumë të argumentuara. Ndërkaq, kritikat e Gazaliut ndaj filozofëve ishin aq të forta, sa që zgjuan një interesim të jashtëzakonshem në mes të dijetarëve. Si të tilla ato mbeten aktuale deri më sot.

Fuqia e kritikës së Gazaliut ishte se ai nuk i përdori të njëjtat argumente për ta sulmuar filozofinë duke u bazuar vetëm në Tekst (Nass) por argumentimi i tij ishte i bazuar në logjikë. Montgomeri Vatt, duke e analizuar veprën e Gazaliut al-Munkidhu Minel-Dalal, thekson se Gazaliu ishte një njohës shumë i mirë i filozofisë, dhe si e tillë kritika e Gazaliut ishte e bazuar në filozofi.

Gazaliu nuk ishte kundër filozofisë, por ishte kundër një mendimi të bazuar plotësisht në logjikë dhe injorim të tërësishëm të Shpalljes. Logjika e pavarur ka mundësi të gabojë, dhe si e tille ajo krijon mendime plotësisht të kundërta me njëra-tjetrën, sepse nuk ka mendim të njëjtë mes filozofëve të cilët e përdorin të njëjtën metodë të argumentimit. Gazaliu ishte kundër një arrogance të bazuar plotësisht në metoda të cilat nuk janë të bazuara në argumente të qëndrueshme sepse argumentet logjike në vete janë të ndryshueshme dhe nuk janë të njëjta për të gjithë ata që bazohen në to.

[32] Po aty.



## Të tjerët për Gazaliun

Gazaliu, si çdo reformator tjetër, pati shokë që pranuan idetë e tij, dhe pati njerëz që e kundërshtuan. Edhe ndër evropianët nuk i pati të rrallë admiruesit e tij: një prej atyre qe filozofi francez Ernest Renan, që e çmonte së tepërmi si dhe dijetarët: Cassanova, Carra de Voux, T.J. Boer dhe Dr. Zvimer etj. Enciklopedija Islame e shkruar nga jomyslimanë, që u botua në Leyden, Holandë më 1927, në volumin e dytë, duke folur mbi të thotë: ”...(Gazaliu) është mendimtari më origjinal që ka prodhuar Islamizmi dhe teologu më i madh".

Renan, i cili e çmonte shumë Gazaliun e quan atë "mendje më origjinale në mesin e filozofëve arabë"[33]. Pavarësisht nga kjo, fama e tij si një filozof është lënë në hije në masë të madhe nga Avicena, Ibni Sina, që ishin paraardhësit e tij dhe nga Ibni Rushdi Averroes, që ishte pasues dhe kundërshtar i tij. Është edhe një fakt i rëndësishëm, thekson Renan, se “Encyclopaedia Britannica” i kushton pesë shtylla për të tjerët dhe vetëm një shtyllë e gjysmë për Gazaliun. Por, te enciklopeditë tjera nuk është kështu".

Prof. Macdonald në librin e tij[34] shkruan: "Së bashku me kohën erdhi njeriu, ky ishte El Gazaliu, më i madhi dhe sigurisht figura më simpatike në historinë islame, i vetmi mësonjës i kohërave të vona që vihet nga myslimanët në një radhë me katër Imamët e mëdhenj" dhe më tutje thotë: "Në Islamizëm nuk ka ardhur njëri pas tij që të zerë vendin e tij dhe as që është kuptuar plotësisht prej myslimanëve. Në ringjalljen Islame që po ngjet tani, do të vijë koha e tij, dhe një jetë e re do të vijë për të, nga ristudimet e veprave të tij".

Shejh Jusuf el-Karadavi mendon se, sikurse Abd ibn 'Umer-'Aziz dhe el-Shafi'u që ishin të veçantë për kohën e tyre përkatëse, ashtu

[33] Renan: Averroes et Averroisme. Notwithstanding this, his fame as a philosopher has been greatly overshadowed by Avicenna, his predecessor, and Averroes, his successor and opponent. Renan: Averroes et Averroisme. (cituar sipas Claud Field ne The Alchemi of happiness 2009.

[34] Devellopment of the muslim teollogy, f.215.

edhe el-Ghazali është konsideruar në mënyrë unanime "Ripërtëritës" i shekullit të pestë islam.

Ibn el-Subki shkruan: "Ai erdhi në një kohë kur njerëzit ishin në një dëshpërim dhe kishin nevojë të përgjigjen kundër filozofëve ashtu sikurse nata e errët që ka  nevojë për dritën e hënës dhe yjeve".

Reformatori modern Islam, profesori i math, i ndjeri Mustafa Maragiu, rektori i Universitetit Al Azharit të Kajros së Egjyptit, ka shkruar:

"Po të përmenden Ibn Sina dhe Farabiu, menjëherë na shkon mendja te dy filozofë të mëdhenj; po të kujtohet emri i Ibni Arebiut, do të mendojmë për burrin sufi, mendimet e të cilit kanë rëndësi e peshë të madhe në misticizmin Islam; po të përmenden emrat e Buhariut dhe Muslimit, menjëherë do të mendojmë për dy tradisionalistë më të mëdhenj Islamë, që shënuan me sinqeritet fjalët dhe veprat e Profetit Islam, duke ruajtur një thesar të vlefshëm; por, po të kujtohet emri Gazali këtu kemi shumë aspekte nuk na shkon mendja në një burr, por në shumë burra dhe secili me vlerë dhe rëndësi të madhe në lëmin e vet. Na kujtohet Gazaliu kanunist, Gazaliu jurist i lirë, Gazaliu theolog, prijës i Ehli Synetit (Orthodoksis Islame), mbrojtës i ideve të tyre; Gazaliu sociolog i specializuar në gjendjet e njerëzimit, fshehtësitë e ndërgjegjes dhe sekretet e shpirtit; Gazaliu filozof që luftoi filozofinë; Gazaliu edukator; Gazaliu sufi ose, po të duash, kur kujtohet Gazaliu të shkon mendja te burri që ishte enciklopedia e diturive të shekullit të tij".[35]

## Ndikimi i Gazaliut në mendimin filozofik

Gazaliu kishte një ndikim të rëndësishëm në të dy kampet e filozofëve myslimanë dhe filozofëve të krishterë mesjetarë. Do të theksojmë këtu se veprat e Gazaliut ishin përkthyer në latinisht. Hebrenjtë që nga ato vite kishin ardhur në kontakt me idetë filozofike të Gazaliut, dhe kishin pranuar kritikën që u bënte filozofëve. Orientalisti spanjol Mi-

[35] Cituar sipas Imam Vehbi Ismailit në parathënie te *”Ballsami i Lumturisë”*, f.14.



guel Asim Palacios[36], në mënyrë të veçantë u mor me ndikimin e mendimeve të Gazaliut në Perëndim. Ky mendon se ndikimi i Gazalit nuk është vetëm me veprën e tij "Tehafut", versioni i së cilës u përkthye në shekullin e 12, por edhe nga veprat tjera. Policios mendon se ndikimi i Gazalit kishte filluar me Rajmond Martinin dominikan nga Spanja, që kishte shfrytëzuar veprat e tij.[37] Po ashtu edhe Margaret Smith shkruan në librin e saj[38] “Nuk ka dyshim se veprat e Al-Gazali do të jenë në mesin e parë për të tërhequr vëmendjen e këtyre dijetarëve evropianë". Pastaj ajo thekson, "më i madh i këtyre shkrimtarëve të krishterë që u ndikua nga Al-Gazali ishte Shën Thoma Aquini (1225-1274), i cili bëri një studim të dijetarëvë arabë dhe pranoi kontributin e tyre. Ai ka studiuar në Universitetin e Napolit, ku ndikimi i letërsisë dhe kulturës arabe dominonte në atë kohë".

Gazaliu pati ndikim te Paskali[39] (filozof dhe fizicient francez), te Dekarti[40], me të cilin fillon filozofia moderne në Evropë. Dekarti nuk e zë askund në gojë këtë ndikim, por ka disa të dhëna që " sugjerojnë që Dekarti, në masë të madhe ka qenë nën ndikimin e shkrimeve të Gazaliut. Historianët shohin shumë ngjashmëri mes autobiografisë së Gazaliut dhe asaj të Dekartit: "Discours de la methode". Ështe i njohur "Dyshimi" i Dekartit në filozofi "Cogito, ergo, sum" - (mendoj, dyshoj jam). Edhe filozofi holandez me prejardhje jevreje Spinoza ishte ndikuar nga El Farabiu, dhe Gazaliu me të cilin e kishte lexuar nga Majmonidi-s[41]. Natyrisht se edhe Imanuel Kanti[42] dhe Laibnici[43] kishin ardhur në kontakt me përkthimet e veprave të Gazaliut, ku nga

[36] Asim Palacios 1871-1944.Orientalist spanjoll, është i njohur për studimet që ka bërë lidhur më ndikimin reciprok të kulturës islame dhe krishtere.

[37] Shih më gjerësisht Salih Collakoviq vepra e cituar f.58,59,60.

[38] Al-Gazali: Mystic (Londër 1944): F 220.

[39] Paskal 1623-1662 filozof dhe fizicient francez. Shih Nakamura artikulli i përmendur.

[40] Dekarti 1597-1650, filozof francez.

[41] Majmonid, filozof jevrej, nxënës i ibni Rushdit (Averosit).

[42] Imanul Kanti; filozof gjerman, ka lindur në Këningsberg të Prusisë Lindore, (1724-1804).

[43] Lajbnici filozof gjerman 1646-1716.

trajtimi i problemeve të ndryshme filozofike rezulton se kanë ngjashmëri.

## Gazaliu u kritikua edhe nga dijetarë myslimanë

Kojiro Nakamura[44] mendon se mendimi filozofik në botën sunite pas Gazaliut kishte pësuar rënie. Këtë rënie e kishte përshpejtuar kritika që i kishte bërë Gazaliu filozofisë. Gati një shekull më vonë Ibni Rushdi (Averosi) bëri përpjekje për t'i rezistuar kësaj rënie, thotë ai. Ky i bëri kritikën më të rreptë veprës së Gazaliut, duke provuar t'i rezistojë kësaj rënie. Kundërshtoi opinionin e Gazaliut mbi filozofinë dhe librin e tij "Tehafut el felasefe" (Gabimi i filozofëve) duke e shkruar librin e vet "Gabimi i gabimit të filozofëve", dhe hodhi poshtë idetë e Gazaliut mbi filozofët. Filozofia, më vonë, mendon Nakamura, gradualisht u përfshi nga Sufizmi dhe u zhvillua në formën e filozofisë mistike, sidomos në botën shiite. Në tërë këtë roli i Gazaliut ishte i rëndësishëm.

Ka edhe dijetarë tjerë që e kundërshtuan. Ne do të veçojmë Ibn Tejmije[45], i cili duke kundërshtuar idetë e Gazaliut, ai thotë:

"Nëse theksojmë se dikush ka transmetuar pikëpamjet e selefëve (brezit të parë pas vdekjes së profetit), dhe transmetimi i tyre është larg nga pikëpamja e saktë e selefëve të vërtetë, apo kanë pak njohuri për pikëpamjen e tyre, ata janë Abu el Me'aali, Ebu Hamid el-Gazali dhe Ibn al- Hatib dhe të ngjashëm. Këta nuk kanë njohuri të mjaftueshme të hadithit (traditës) për t'u kualifikuar dijetarë të rëndomtë të hadithit (traditës), e lëre më si dijetarë të shquar në atë fushë. Sepse asnjë nga këta njerëz nuk kishin ndonjë njohuri të el-Buhari dhe Muslim (Dy koleksionarët më të mëdhenj të haditheve) dhe të haditheve të tyre, pavarësisht nga ajo që ata dëgjuan. Niveli i tyre është i ngjashëm me gjendjen e myslimanëve të zakonshëm, të cilët nuk mund të dallojnë, në mes të një hadithi i cili konsiderohet si sahih (i vërtetë) dhe mutavatir sipas dijetarëve të hadithit, dhe një hadith i cili është i fabrikuar dhe i rremë. Librat e tyre dëshmojnë se, ato përmbajnë gjëra të çuditshme, dhe shumica e këtyre dijetarëve të 'ilm el-kelam (shkenca e kelamit apo apologjetika) dhe Sufive janë larguar nga rruga e Selefit[46], këte e pranojnë, ose në kohën e vdekjes ose të para vdekjes. Ka shumë raste të tilla. Ky Hamid Ebu el-Gazali, pavarësisht shkëlqimit të tij, përkushtimin e tij ndaj Allahut, njohuritë e tij të Kelamit (apologjetikës) dhe të filozofisë, asketizmit dhe praktikat e tij shpirtërore sikundër edhe Sufizmi i tij, përfundoi në një gjendje konfuzioni dhe përfundoi në rrugën e atyre që pretendojnë për të gjetur gjëra me anë të ëndrrave dhe të metodave shpirtërore.[47]

[44] Kojiro Nakamura: është profesor i studimeve islame në Universitetin Obirin dhe Profesor Emeritus në Universitetin e Tokio-s dhe kryesues i Departamentitt e Studimeve Islame në Universitetin e Tokio-s.

[45] Ibni Tejmije teolog dhe jurist islam që i përket shkollës juridike islame-hanbelite (1263-1328).



## U kthye në vendlindje për të ndërruar jetë

Gazaliu më 1095, kthehet në Tus. Më 1096 i ishte bërë ftesë për të ligjëruar përsëri në “Nizamije” në Nishapur, ai kishte filluar por nuk e kishte mbajtur gjatë. Mendohej se do të hiqte dore nga asketizmi dhe do t'i kthehet jetës arsimore, por ai u kthye përsëri në vendlindje. I tërhequr, aty formoi një medrese dhe ligjëronte teologji dhe tesavuf. Kështu kaloi vitet e fundit të jetës me lutje e shkrime dhe mësime. Ai ndërroi jetë ditën e hënë, më 19 dhjetor 1111.

Ibn El Xhevzi në veprën e tij "Eth-thabat indel memat" thotë se vëllai i tij, Ahmedi, duke folur mbi vdekjen e Ebu Hamidit, thotë:

"Të hënën mbrëma, në kohën e sabahut, vëllai im mori abdes dhe u fal. Pastaj tha: "Më sill qefinin!", të cilin e mori dhe e puthi, dhe ngriti sytë e tij lart duke thënë: "Unë dëgjoj dhe i bindem urdhrit, të

[46] Në historinë islame është e njohur se themeluesi i Vehabizmit ishte i lidhur me dijetarët hanbelitë nga Damasku dhe se ka përdorur punimet e tyre, veçan ato të Ibn Tejmijes dhe të nxënësit të tij Ibn Kajjim el-Xhevziut. Shih Nerkez Smailagiç: leksikon Islama, Sarajevë, 1990, f.260-261.

[47] Ibni Tejmije "Mexhmuua al fetva" part 4 p 71.

shkoj te Zoti." U shtri në shtrat dhe para lindjes së diellit, ia dorëzoi shpirtin Krijuesit të tij, vajti e takoi Perëndinë e Lartë".

Kështu vdiq Gazaliu në paqe, mbasi u përpoq të gjejë paqen dhe e gjeti në lutje dhe dashuri. Lutej vetëm Një Zoti dhe dashuria për Të dhe për tërë njerëzimin pa dallim feje e race. Kështu Gazaliu mbeti njëri ndër figurat më fisnike që ia ka dhënë bota islame vargut të gjenive të vërtetë të mbarë njerëzimit.



***AL-GAZALI***

# MUNGESA E KOHERENCËS SË FILOZOFËVE DISKUTIMI I SHTATËMBËDHJETË MBI SHKAKËSINË DHE MREKULLITË

(1) Sipas mendimit tonë, lidhja midis asaj që zakonisht mendohet të jetë shkaku dhe asaj që zakonisht mendohet të jetë pasoja, nuk është e domosdoshme. Kur kemi të bëjmë me këto dy gjëra, ku "ajo" nuk është "kjo" e "kjo" nuk është "ajo" dhe ku pohimi i njërës nuk sjell pohimin e tjetrës dhe as mohimi i njërës nuk çon në mohimin e tjetrës, nuk është e domosdoshme që njëra të ekzistojë në mënyrë që të ekzistojë edhe tjetra dhe as nuk është e domosdoshme që njëra të mos ekzistojë me kusht që të mos ekzistojë as tjetra-si përshembull, shuarja e etjes dhe pirja e ujit, ngopja dhe të ngrënët, djegia dhe kontakti me zjarrin, drita dhe dalja e diellit, vdekja dhe prerja e kokës, shërimi dhe pirja e ilaçeve, pastrimi i zorrëve dhe përdorimi i një pastruesi, e kështu me radhë, për të përfshirë të gjitha dukuritë midis gjërave të lidhura në mjekësi, astronomi, art dhe zejtari. Lidhja midis tyre është rezultat i dekreteve të mëparshme të Zotit, i cili i krijon ato çift, e jo ngaqë ajo është në vete e domosdoshme, e paaftë të shkëputet. Pra, është brenda fuqive hyjnore të krijojnë ngopjen pa ngrënë, të krijojnë vdekjen pa prerjen e kokës, të shkaktojnë vazhdimin e jetës pas prerjes së kokës e kështu me radhë, duke përfshirë këtu të gjitha gjërat e lidhura. Filozofët e kanë mohuar këtë mundësi, duke pretenduar se kjo gjë është e pamundshme.

(2) Për shqyrtimin e këtyre rasteve, të cilat janë të panumërta, do të duhej kohë e gjatë. Atëherë, le të marrim një shembull praktik, pikërisht djegien e pambukut kur bie në kontakt me zjarrin. Ne pra-

nojmë mundësinë e ndodhjes së këtij kontakti pa djegien e pambukut, por në të njëjtën kohë ne pranojmë edhe mundësinë e shndërrimit të pambukut në hi pa rënë në kontakt me zjarrin. Mirëpo, filozofët i mohojnë këto mundësi.

(3) Diskutimi i kësaj çështjeje përfshin tre qëndrime.

(4) Qendrimi i parë është kur kundërshtari pretendon që shkaktari i djegies është vetëm zjarri, duke e cilësuar atë si veprues nga natyra e jo nga vullneti, pra i paaftë të veprojë në kundërshtim me natyrën e tij pasi të bjerë në kontakt me një objekt të djegshëm. Kjo është një nga gjërat që ne mohojmë. Përkundrazi, ne themi:

(5) Ai që shkakton djegien, duke bërë që pambuku të nxihet, pjesët e tij të ndahen dhe të shndërrohen në shkrumb apo në hi, është Zoti, me apo pa ndërmjetësinë e engjëjve të Tij. Për sa i përket zjarrit, ai është i pajetë dhe si rrjedhim i mungon aftësia e veprimit. Atëherë, cilat janë provat se zjarri është shkaku? Filozofët nuk kanë asnjë provë, e vetmja gjë është se ata vënë re veprimin e djegies në momentin e kontaktit me zjarrin. Mirëpo, vërejtja tregon vetëm procesin e djegies në momentin e kontaktit me zjarrin, por nuk tregon se procesi i djegies shkaktohet nga vetë zjarri dhe se nuk ka asnjë shkak tjetër. Nga ana tjetër, ne nuk kemi asnjë mosmarrëveshje me filozofët lidhur me faktin se pajisja e spermës së kafshëve me shpirt dhe me aftësitë e kuptimit e të motivimit nuk shkaktohet nga karakteristikat e kufizuara në nxehtësi, ftohtësi, lagështi dhe thatësi; se babai nuk e krijon të birin duke lëshuar spermën në mitër; se ai nuk prodhon jetën, të parët, dëgjimin dhe aftësitë e tjera të të birit. Dihet se ekzistenca e tyre fillon me vendosjen e spermës në mitër, por askush nuk thotë se veprimi i vendosjes së spermës sjell ekzistencën e tyre. Përkundrazi, ato ekzistojnë si pasojë e vullnetit të të Parit (Zotit), drejtpërdrejt ose me ndërmjetësinë e engjëjve të ngarkuar me aspektet kohore. Filozofët që besojnë në ekzistencën e Krijuesit, e mbështesin këtë gjë në mënyrë përfundimtare dhe në këtë pikë, ne pajtohemi plotësisht me ta.

(6) Në këtë mënyrë është bërë e qartë se ekzistenca e një gjëje me diçka tjetër nuk vërteton se e para ekziston për shkak të së dytës ose anasjelltas. Në fakt, ne do ta provojmë këtë me anë të një shembulli. Nëse një person, i verbër që në lindje, me një perde në sy, i cili nuk ka dëgjuar kurrë për ndryshimin mes natës dhe ditës, t'i nënshtrohet një operacioni për të hequr perden nga sytë, atëherë t'i hapë sytë gjatë ditës dhe të shohë ngjyra të ndryshme, ai do të mendonte se vepruesi që shkakton regjistrimin e formave të ngjyrave në sytë e tij është aftësia e të parit. Si rrjedhim, përsa kohë që të parët e tij të mbetet i shëndoshë, t'i mbajë sytë hapur, perdja e syve të jetë e hequr dhe gjërat para tij të jenë me ngjyra, do të ishte e domosdoshme që ai të shihte, pra do të ishte e pakuptueshme që ai të mos shihte. Mirëpo, pasi të perëndojë dielli dhe atmosferën ta përfshijë errësira, atëherë ai do të mendonte se drita e diellit është shkaku i regjistrimit të ngjyrave e formave në trurin e tij.

(7) Kur do ta pranojë kundërshtari ynë mundësinë që mes parimeve të ekzistencës ka arsye e shkaqe nga të cilat rrjedhin këto zhvillime të vërejtura kur mes tyre ndodhin kontakte, duke pranuar që këto parime janë të përhershme, se ato nuk zhduken kurrë; se ato nuk janë trupa në lëvizje që perëndojnë; se sikur ato të mos ishin të përhershme apo të perëndonin, ne do ta shihnim veçimin midis ndodhjeve kohore dhe do ta kuptonim se pas atyre që vërejmë është një shkak. Ky përfundim është i pashmangshëm në përputhje me arsyetimin që mbështetet në parimin e vetë filozofëve.

(8) Kjo është pikërisht arsyeja që edhe kundërshtarët më të rreptë mes filozofëve kanë pranuar se këto aksidente dhe zhvillime që vërehen kur ndodh një kontakt mes trupave, dhe, përgjithësisht, kur marrëdhëniet midis tyre ndryshojnë, rrjedhin nga dhuruesi i formave, i cili është një nga engjëjt, kështu që ata kanë thënë: "Regjistrimi i formës së ngjyrave në sy vjen nga dhuruesi i formave, se dalja e diellit, bebja e shëndoshë e syrit dhe trupat me ngjyra janë vetëm të "gatshme" dhe përgatitorë për pranimin e këtyre formave nga ana e receptorit. Filozofët e kanë përdorur këtë argument për të gjitha ndodhjet kohore. Si rrjedhim, pretendimi i atyre që deklarojnë se është zjarri ai që shkakton djegien, se është buka ajo që

shkakton ngopjen, se është mjekësia ajo që sjell shëndetin, e kështu me radhë, del i gabuar.

(9) Qëndrimi i dytë u përket atyre që pranojnë se këto ndodhje kohore rrjedhin nga parime të ngjarjeve kohore por që përgatitja për perceptimin e formave vjen nëpërmjet shkaqeve të pranishme e të vërejtura dhe se këto parime janë gjithashtu të tilla që gjërat rrjedhin prej tyre nga domosdoshmëria dhe në mënyrë të natyrshme, e jo si rrjedhim i një proces shqyrtimi të hollësishëm apo nga dëshira, në të njëjtën mënyrë si drita që rrjedh nga dielli. Ndryshimet në pasoja janë rrjedhim i ndryshimeve në natyrën e vetë receptorëve. Një trup i ndritshëm i reflekton rrezet e diellit duke ndriçuar në këtë mënyrë objekte të tjera përreth, kurse dheu për shembull nuk i reflekton ato; ajri nuk parandalon depërtimin e dritës, kurse guri po; disa objekte zbuten nga dielli e disa forcohen; disa zbardhen, siç ndodh me veshjen e një punëtori të punishtes ku ngjyrosen materialet, kurse disa nxihen, siç ndodh me fytyrën e tij. Ata thonë se duke marrë këto parasysh, parimi është një, por pasojat ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në natyrën e receptorëve. Po në të njëjtën mënyrë, janë të panumërta ato që rrjedhin nga parimet e ekzistencës, duke mos pasur kufizime dhe as mungesa: kështu që mangësitë janë rrjedhë vetëm e receptorit. Atëherë, argumentojnë filozofët, për sa kohë që ne supozojmë se zjarri ka aftësinë që i përket, pra atë të djegies, dhe kemi dy copa të njëjta pambuku që bien në kontakt me të në të njëjtën mënyrë, si mund të jetë e kuptueshme që njëra copë të digjet e tjetra jo, pasi shkakut i mungon aftësia të zgjedhë? Duke u mbështetur në këtë nocion, ata mohojnë hedhjen e Profetit Ibrahim në zjarr pa iu shkaktuar as djegia më e vogël, sigurisht duke supozuar se zjarri i ruan cilësitë e tij, dhe pretendojnë se kjo është e mundur vetëm nëse zjarrit i hiqet nxehtësia-gjë që çon në faktin se zjarri nuk do të ishte më zjarr- ose nëse trupi i Ibrahimit shndërrohet në gur apo në diçka tjetër, ndaj të cilit zjarri nuk do të kishte kurrëfarë ndikimi. Mirëpo, këto dy veprime janë të pamundshme.

(10) Përgjigjja ndaj këtij pretendimi të filozofëve është e dyfishtë.



(11) Së pari duhet thënë: "Ne nuk pranojmë se parimet nuk veprojnë sipas vullnetit dhe se Zoti nuk vepron sipas vullnetit." Ne i kemi dhënë fund argumentimit për të hedhur poshtë pretendimin e filozofëve lidhur me këtë aspekt në diskutimin rreth krijimit të botës. Atëherë, nëse është provuar që Vepruesi (Zoti) e shkakton djegien përmes vullnetit të Tij kur copa e pambukut bie në kontakt me zjarrin, është gjithashtu plotësisht e arsyeshme të pranohet se është e mundur që Perëndia të mos krijojë procesin e djegies.

(12) Në lidhje me këtë mund të thuhet:

(13) Kjo çon në autorizimin e kundërthënieve të papranueshme. Në qoftë se dikush mohon që pasojat rrjedhin në mënyrë të pashmangshme nga shkaqet e tyre dhe i lidh ato me vullnetin e Krijuesit të tyre, duke theksuar se vullneti nuk ka ndonjë kurs të caktuar, por një kurs që mund të ndryshojë, atëherë le të pranojmë mundësinë që para tij ndodhen bisha të egra, zjarre të furishme, male të larta ose armiq të gatshëm me armët e tyre që ta vrasin atë, por në të njëjtën kohë edhe mundësinë që ai nuk i sheh ato pasi Zoti nuk krijon për të aftësinë për t'i parë. Gjithashtu, nëse dikush lë një libër në shtëpi dhe ta lejojmë atë të pranojë si të mundshme që kur të kthehet në shtëpi të zbulojë se libri është shndërruar në një skllav të ri pa mjekër-intelegjent, shumë i zënë duke kryer punët e tij, ose në një kafshë; apo nëse ai lë një djalë të ri në shtëpi dhe ta lejojmë atë të pranojë mundësinë e shndërrimit të djalit në një qen; ose përsëri nëse ai lë hi dhe ta lejojmë atë ta mendojë si të mundshëm shndërrimin e hirit në parfum myshku si edhe të pranojë mundësinë e shndërrimit të gurit në ar dhe të arit në gur. Nëse pyetet rreth secilit nga këto raste, ai duhet të thotë: "Unë nuk di se çfarë është në shtëpinë time në këtë moment. Unë di vetëm se në shtëpi kam lënë një libër që tani mund të jetë shndërruar në kalë, i cili e ka ndotur tërë bibliotekën dhe se kam lënë në shtëpi një kavanoz me ujë që ka shumë mundësi të jetë shndërruar në një dru frutor. Meqenëse Zoti është i aftë të bëjë çfarë të dojë, atëherë nuk është e domosdoshme që kali të krijohet nga sperma dhe as pema të krijohet nga fara, me të vërtetë nuk është e domosdoshme që asnjëra

prej të dyjave të krijohet nga diçka lëndore. Ndoshta Perëndia ka krijuar gjëra që nuk kanë ekzistuar më parë." Me të vërtetë, nëse një person i tillë shikon një njeri që se ka parë kurrë dhe pyetet nëse ai njeri është krijesë e lindur, le ta lejojmë atë të ngurrojë dhe të thotë se nuk është e pamundur që një lloj fruti në treg të jetë shndërruar në njeri, pikërisht në këtë njeri që ai po e sheh për herë të parë, pasi Zoti ka pushtet absolut mbi çdo gjë të mundshme dhe kjo gjë është e mundur, kështu që njeriu duhet të ngurrojë në këtë çështje. Kjo është një pikë e hapur për një numër të madh ilustrimesh, por mendojmë se mjafton me këto që u përmendën.

(14) Përgjigjja jonë ndaj kësaj është të thuhet:

(15) Nëse është pranuar që e mundshmja është e tillë që për njeriun nuk mund të krijohet dija për mosekzistencën e saj, atëherë do të ishte e domosdoshme që këto të pamundura të vijonin. Mirëpo, ne nuk bëhemi skeptikë nga ilustrimet që ju keni paraqitur për shkak se Zoti ka krijuar për ne dijen se Ai nuk i ka dekretuar këto mundësi. Ne nuk kemi pretenduar se këto gjëra janë të domosdoshme. Përkundrazi, ato janë të mundshme që mund apo mund të mos ndodhin. Por, shprehia e vijueshme e ndodhjes së tyre në mënyrë të përsëritur, ngulit në mendjen tonë besimin e patundur se ato do të ndodhin në të ardhmen ashtu siç kanë ndodhur në të kaluarën.

(16) Me të vërtetë, është e mundur që një nga profetët të dijë nëpërmjet mënyrave të përmendura nga filozofët (aftësive të dhuruara nga Zoti), bile në shembullin tonë, ai e dinte se një person i caktuar nuk do të arrijë nga rrugëtimi i tij "nesër", kur arritja e tij është e mundshme. Kjo është tamam sikur të vërejmë një njeri të rëndomtë, për të cilin e dimë se pa udhëzime ai nuk e di të fshehtën, të mistershmen, dhe se mendja e tij nuk kap të kuptueshmet. Prapëseprapë, askush nuk mohon se shpirti dhe intuita e këtij personi të zakonshëm mund të forcohen, përmes besimit të tij të palëkundshëm dhe veprimeve që e afrojnë atë me Perëndinë, aq sa ai të kuptojë edhe ato që kuptojnë profetët, e gjithë kjo në përputhje të plotë me ato që pranojnë filizofët, megjithëse ata e dinë se një mundësi e tillë ende nuk ka ndodhur.



(17) Atëherë, nëse Perëndia ndërpret kursin e zakonshëm të natyrës duke bërë që mrekullia të ndodhë në të njëjtën kohë me ndërprerjen e ndodhive të zakonshme, këto bindje të fituara përmes procesit intelektual se mundësi të tilla të pazakonta nuk do të ndodhin, rrëshqasin nga zemra e njeriut dhe Zoti nuk i krijon ato. Kështu që nuk ka asgjë që mund të parandalojë një gjë të jetë e mundshme, gjithmonë duke menduar se gjithshka është brenda kapacitetit të Perëndisë, por përmes dijes së Tij të mëparshme Ai e dinte se nuk do ta bënte atë gjë në kohë të caktuara, me gjithë mundësinë e një gjëje të tillë, dhe se Ai krijon për në dijen që Ai nuk do ta krijojë në atë kohë. Si rrjedhim, në të gjitha këto thënie e argumente të filozofëve, nuk ka gjë tjetër veç thjesht denegrim.

(18) Qëndrimi i dytë, me të cilin vjen çlirimi nga këto denigrime, është që ne të pranojmë se zjarri është i krijuar në mënyrë të atillë që, në qoftë se dy copa të njëjta pambuku bien në kontakt me të, do të digjeshin të dyja, duke mos bërë dallime midis tyre nëse ato janë të njëjta në të gjitha aspektet. Mirëpo, megjithatë, ne pranojmë mundësinë që një profet të hidhet në zjarr dhe të mos pësojë djegie, sigurisht pa ndryshuar cilësinë e zjarrit dhe as atë të trupt të profetit. Në këtë rast zjarrit do t’i jepej nga Zoti ose engjëjt një cilësi, e cila do t'i kufizonte nxehtësinë e zjarrit brenda tij, pra në mënyrë që ai të mos e përcjellë atë, duke ruajtur në të njëjtën kohë formën dhe natyrën e vërtetë të zjarrit. Ose përndryshe trupit të profetit do t'i jepej një cilësi, e cila nuk do ta ndryshonte atë nga një trup prej mishi e gjaku, por do t'i jepte aftësinë të përballojë ndikimin e zjarrit. Kemi parë që një person, i cili e mbulon veten me talk dhe hyn në një furrë përvluese, nuk pëson asgjë. Një person që nuk e ka dëshmuar një gjë të tillë, do ta mohojë atë. Pra, mohimi i kundërshtarit se fuqia hyjnore përfshin aftësinë për t’i dhënë zjarrit apo trupit njerëzor cilësinë e caktuar që do të parandalonte djegien, është si mohimi i atij që nuk ka parë kurrë talkun dhe ndikimin e tij. Mes objekteve që përfshihen në fuqinë e Zotit janë gjëra të çuditëshme e të pabesueshme që ne nuk i kemi parë.

Atëherë, pse të mohojmë mundësinë e gjendjes apo ndodhjes së tyre dhe t'i gjykojmë ato si të pamundshme?

(19) Të mundshme në këtë mënyrë janë edhe ngjallja e të vdekurit dhe shndërrimi i shkopit në gjarpër, pra materia mund të shndërrohet në çdo gjë. Kështu që toka dhe të gjitha elementet e tjera shndërrohen në bimë, të cilat pasi hahen nga kafshët shndërrohen në gjak dhe vetë gjaku në spermë. Mandej, sperma lëshohet në mitër dhe në faza evoluohet si një kafshë. Zakonisht, periudha e këtij procesi është e gjatë. Atëherë, pse kundështari e gjykon si të pamundshme se është brenda fuqive të Perëndisë ta plotësojë këtë cikël të materies brenda një kohe më të shkurtër sesa është e ditur? Dhe, nëse është e mundur që ky proces të plotësohet brenda një kohe më të shkurtër, nuk ka kurrfarë kufizimesh që ky cikël të jetë edhe më i përshpejtuar. Kështu që këto fuqi do të përshpejtoheshin edhe më shumë në veprimet e tyre dhe në këtë mënyrë do të arrihej ajo që njihet si mrekulli për profetin.

(20) Nëse shtrohet pyetja: "A vjen kjo gjë nga shpirti i profetit apo nga ndonjë burim tjetër me sugjerimin e profetit?" ne themi:

(21) "Duke pasur në mendje ato që keni pranuar përsa i përket mundësisë së rënies së shiut, shpërthimit të stuhive apo ndodhjes së tërmeteve nga fuqia e shpirtit të profetit, a ndodhin këto zhvillime sipas vullnetit të profetit apo të një burimi tjetër? Pohimi i jonë në përgjigjen që i kemi dhënë pyetjes tuaj është i njëjtë me pohimin tuaj në përgjigjen që i keni dhënë pyetjes tonë. Mirëpo, është më e përshtatshme si për ne ashtu edhe për ju që ta lidhim këtë me Zotin, drejtpërdrejt apo me ndërmjetësinë e engjëjve. Mirëpo, koha e meritueshme për paraqitjen e saj (mrekullisë) është kur vëmendja e profetit është krejtësisht e përqendruar në të dhe rendi i mirësisë varet posaçërisht nga paraqitja e saj, kështu që rendi i ligjit të shpallur të vazhdojë të mbetet në fuqi. E gjithë kjo i jep epërsi ekzistencës së mrekullisë, duke qenë në vetëvete e mundshme dhe burimi që e dhuron atë, mirëdashës e bujar. Por, Ai (Zoti) e dhuron mrekullinë vetëm kur nevoja për ekzistencën e saj merr epërsi dhe rendi i mirësisë gjithashtu i varur prej saj. Dhe rendi i



mirësisë bëhet i varur në mënyrë të posaçme nga mrekullia vetëm në qoftë se profetit i nevojitet të vërtetojë se është i dërguari i Perëndisë, me qëllim që të përhapë mirësinë.

(22) E gjithë kjo është në përputhje me kahen e atyre që ata thonë dhe një pasojë e domosdoshme për ta për sa kohë që ata shtrojnë për diskutim doktrinën e tyre, atë të pajisjes speciale të profetit me një karakteristikë krejtësisht të kundërt nga ato që njerëzit i shikojnë si të zakonta. Në të njëjtën kohë, duhet pasur parasysh se numri i mundshëm i këtyre cilësive speciale profetike nuk mund të kapet nga mendja e njeriut. Atëherë, përse duhet, me të gjitha këto, që njeriu të mos besojë në ato, ndodhja e të cilave është vërtetuar nga raporte të panumërta, si dhe në ato që janë urdhëruar nga ligji fetar?

(23) Përgjithësisht, pasi vetëm sperma mund të zhvillohet në formë kafshërore, fuqitë kafshërore që i jepen asaj nga engjëjt, të cilët, sipas filozofëve, janë burimet e qenies, gjë që do të thotë se nga sperma e njeriut mund të krijohet vetëm njeriu dhe nga sperma e kalit vetëm kali, pasi, po të marrim rastin e dytë, realizimi i tij nga kali është epërsi më e domosdoshme për shkak të përshtatjes shumë më të madhe të formës së kalit sesa formave të tjera. Në këtë mënyrë, evoluimi pranon vetëm formën që ka epërsi. Për këtë arsye, gruri nuk ka mugulluar kurrë nga elbi dhe as sythat e mollës nuk kanë shpërthyer kurrë nga farat e dardhës.

(24) Për më tepër, ne kemi parë lloje kafshësh që prodhohen në mënyrë të natyrshme nga dheu e nuk riprodhohen kurrë, si për shembull krimbi, dhe të tjera siç janë miu, gjarpri dhe akrepi të cilët prodhohen spontanisht dhe reprodhohen. Natyra e tyre për të marrë forma ndryshon për arsye të panjohura nga ne, duke qenë jashtë aftësive njerëzore për t'i ditur ato, pasi, sipas filozofëve, format nuk rrjedhin nga engjëjt rastësisht apo kur t'u teket. Përkundrazi, secili receptor merr vetëm formën që është caktuar të marrë sipas natyrës që ka. Natyrat e receptorëve ndryshojnë dhe burimet e tyre, sipas filozofëve, janë pozicioni i yjeve dhe marrëdhëniet e ndryshueshme të trupave qiellorë në lëvizjet e tyre.

(25) Nga kjo është bërë e qartë se parimet e natyrave përfshijnë gjëra të çuditshme dhe të mrekullueshme, aq shumë sa që me ndihmën e dijes së tyre rreth cilësive speciale të substancave minerale dhe diturisë rreth yjeve, mjeshtrit e artit të magjive kanë arritur të fitojnë aftësinë për të bashkërenduar fuqitë qiellore dhe cilësitë speciale të mineraleve. Ata kanë marrë forma të caktuara cilësish tokësore dhe kanë caktuar për to horoskopë të posaçëm, duke sjellë gjëra të çuditëshme në këtë botë. Kështu që ata kanë arritur nganjëherë të dëbojnë gjarprin dhe akrepin nga një qytezë, çimkën nga një qytezë tjetër e kështu me radhë, dy shembuj nga rastet e njohura në artin e magjisë. Atëherë, nëse burimet e natyrave të receptorëve janë të panumërta, thellësia e natyrës së tyre e pa kapshme nga mendja e njeriut, pra e pamundur që ne t'i gjykojmë ato saktësisht, si mund ta dimë ne se është e pamundur që të ndodhë një ndyshim i caktuar në natyrën e disa trupave, duke lejuar shndërrimin e tyre gjatë procesit të evoluimit në kohën më të shkurtër në mënyrë që ato të bëhen të gatshme të marrin një formë për të cilën nuk kanë qenë kurrë të përgatitura të marrin dhe se kjo nuk duhet shikuar si mrekulli? Mohimi i kësaj është rrjedhim i mungesës së kapacitetit tonë për të kuptuar, i mungesës së familjaritetit tonë me qeniet e lartësuara dhe i padijes sonë për sekretet e Zotit, qoftë lavdëruar, në krijim dhe natyrë. Kushdo që studion mrekullitë e shkencës në mënyrë induktive, në asnjë mënyrë nuk do ta ndjente veten larg fuqive të Perëndisë për sa u përket atyre që janë thënë rreth mrekullive të profetëve.

(26) Mund të thuhet:

(27) Ne mund t'ju ndihmojmë ju duke mbrojtur qendrimin se çdo gjë e mundur është brenda fuqive të Zotit, ndërsa ju mund të na ndihmoni ne duke ngulur këmbë se çdo gjë e pamundshme është jashtë fuqive hyjnore. Ka gjëra, pamundësia e të cilave është e ditur siç ka gjëra mundësia e të cilave dihet, por ka edhe gjëra për të cilat mendja jonë mbetet e pavendosur, duke mos qenë në gjendje t'i gjykojë ato si të pamundshme apo të mundshme. Atëherë, sipas mendimit tuaj, cili është përkufizimi i pamundësisë? Nëse çështja



thjeshtësohet deri te kombinimi i mohimit dhe i pohimit për një gjë të caktuar, atëherë mund të thoni: "Në rastin e dy gjërave, ku 'kjo' nuk është 'ajo' dhe 'ajo' nuk është 'kjo', ekzistenca e njërës nuk është e domosdoshme për ekzistencën e tjetrës," dhe thuaj se Zoti mund të krijojë vullnetin pa dijeninë e objektit për të cilin është krijuar vullneti dhe mund të krijojë dijeni pa nevojën e jetës; Perëndia mund të lëvizë dorën e një njeriu të vdekur, ta bëjë atë të qendrojë ndenjur dhe me dorën e tij të shkruajë libra të tëra, të angazhohet në zejtari, ndërkohë që i vdekuri qëndron me sytë hapur duke vështruar drejt përpara, por pa parë gjë, pa jetë dhe pa pasur kurrfarë kontrolli mbi ato që po ndodhin. Të gjitha këto veprime të urdhëruara janë krijuar nga Zoti, së bashku me lëvizjen e dorës së njeriut të vdekur, e cila bëhet me drejtimin e Perëndisë. Duke lejuar mundësinë e kësaj, aty përfundon dallimi midis lëvizjes së vullnetshme dhe dridhjes. Ky veprim i planifikuar mirë nuk vërteton as dijeninë dhe as fuqinë e vepruesit. Atëherë, Zoti duhet të jetë në gjendje të ndryshojë lloje të panumërta. Kështu që Ai do të ndryshonte substancën në aksident, dijeninë në fuqi, të zitë në bardhësi, tingullin në kundërmim, taman ashtu siç ka qenë në gjendje të ndryshojë të pashpirtin në të gjallë dhe gurin në flori, dhe si pasoja të domosdoshme do të vijonin pamundësi të panumërta.

(28) Na iu përgjigjemi:

(29) E pamundshmja nuk është brenda fuqisë së realizimit. E pamundshmja përbëhet nga pohimi i një gjëje i bashkëlidhur me mohimin e saj, duke pohuar më të posaçmen dhe mohon më të përgjithshmen, ose duke pohuar dy gjëra dhe në të njëjtën kohë duke mohuar njërën prej tyre. Ajo që zvoglohet në këtë pikë, nuk është e pamundshme dhe çfarë nuk është e pamundur është brenda fuqive hyjnore.

(30) Për sa i përket kombinimit të të zezës dhe bardhësisë, kjo është diçka e pamundur, pasi duke pohuar formën e të zezës në receptor, ne kuptojmë (a) mohimin e paraqitjes së bardhësisë dhe (b) pohimin e ekzistimit të së zezës. Pasi mohimi i bardhësisë të bëhet i

qartë nga pohimi i të zezës, pohimi i bardhësisë, së bashku me mohimin e saj, bëhet e pamundur.

(31) Është gjithashtu e pamundur për një parson të jetë në dy vende në të njëjtën kohë, pasi na e kuptojmë se duke qenë në shtëpi, për shembull, ai nuk është në një vend tjetër. Pra, është e pamundur të supozohet se ai është në një vend tjetër si edhe në shtëpi, gjë që shpreh mohimin se ai ndodhet diku tjetër e jo në shtëpi.

(32) Me vullnet ne kuptojmë, në të njëjtën mënyrë, kërkimin e diçkaje që dihet nga kërkuesi. Por, në qoftë se supozohet që kërkimi bëhet pa dijeni, atëherë aty nuk ka vullnet. Kjo sjell mohimin e asaj që ne kemi kuptuar (me vullnet).

(33) Për më tepër, është e pamundur të krijohet dijeni në materie të pajetë. Është e ditur që me lëndë të pajetë na kuptojmë atë që nuk kupton. Nëse aftësia e të kuptuarit krijohet në të, atëherë përkufizimi i saj si e pajetë në mënyrën siç e kemi kuptuar ne bëhet i pamundur. Dhe në qoftë se ajo nuk kupton, atëherë të quhet dijeni ajo që është krijuar kur receptori i saj nuk kupton asgjë, është gjithashtu e pamundur. Kjo është atëherë mënyra në të cilën kjo gjë është e pamundur.

(34) Përsa i përket shndërrimit të llojeve, disa teologë dialektikë islamikë kanë thënë se kjo është brenda kapacitetit të Perëndisë për t’u realizuar. Mirëpo, ne themi:

(35) Shndërrimi i një diçkaje në diçka tjetër është i pakuptueshëm. Për shembull, nëse të zitë ndryshohet në një enë gatimi, a vazhdon e zeza të ekzistojë apo jo? Nëse nuk ekziston më, e zeza nuk është shndërruar në diçka tjetër, por ajo pushon së ekzistuari dhe diçka tjetër vjen në ekzistencë. Nëse e zeza vazhdon të ekzistojë se bashku me enën e gatimit, atëherë të zitë nuk ka ndryshuar, por diçka tjetër është shtuar. Në anën tjetër, nëse e zeza mbetet aty ndërkohë që ena e gatimit nuk ekziston, atëherë e zeza nuk ka ndrydhuar, por mbetet ashtu siç ka qenë. Po ashtu, kur themi se gjaku është shndërruar në spermë, me këtë kuptohet se lënda ka kaluar nga një formë në tjetrën. Kjo tregon faktin se një formë është zhdukur dhe një tatër ka zënë vendin e saj, pra një lëndë



ekzistuese mbi të cilën dy format kalojnë njëra pas tjetrës. Dhe kur themi se me anë të ngrohjes uji shndërrohet në avull, ne theksojmë se lënda e përgatitur të marrë formën e ujit e ka marrë atë formë dhe tani ka marrë një formë tjetër. Kështu që materia është e përbashkët, vetëm cilësia ndryshon. E njëjta gjë është e vlefshme edhe kur themi se shkopi është shndërruar në gjarpër dhe dheu në kafshë.

(36) Aksidenti dhe substanca nuk kanë lëndë të përbashkët, ashtu siç nuk kanë as e zeza dhe ena e gatimit. Lëndë të përbashkët nuk kanë as llojet e tjera. Atëherë, duke u mbështetur në këtë pikëpamje del që shndërrimi i llojeve të ndryshme në njëra-tjetrën është i pamundur.

(37) Lidhur me shembullin, ku Zoti lëviz dorën e një njeriu të vdekur, duke e ngritur atë në formën e një njeriu të gjallë, i cili qëndron ndenjur dhe shkruan në mënyrë të tillë që nga lëvizja e dorës së tij, del shkrimi i urdhëruar, kjo në vetvete nuk është e pamundur për sa kohë që ne e lëmë realizimin e ngjarjeve kohore në vullnetin e një qenieje që ka kapacitetin të bëjë çfarë të dëshirojë. Kjo është shpërnjohur vetëm për shkak se vazhdimisht ka ndodhur e kundërta. Thënia e juaj, lidhur me këtë, se veprimi i planifikuar mirë nuk tregon ekzistencën e dijenisë së vepruesit, nuk është e vërtetë, pasi tani vepruesi është Zoti, i cili ka dijeni të plotë rreth asaj që po ndodh.

(38) Për sa i përket pohimit tuaj se nuk ka dallim midis dridhjes dhe lëvizjes së vullnetshme, ne themi:

(39) Na e kuptojmë këtë dallim në veten tonë. Na kemi ndijuar në veten tonë një dallim të domosdoshëm midis dy gjendjeve dhe për të theksuar këtë dallim kemi përdorur termin “fuqi”. Kështu që ne dimë se ato që ndodhin në dy alternativat e mundshme janë dy gjëra, njëra ndodh në njërën gjendje, kursa tjetra në një gjendje tjetër, pra sjellja në ekzistencë e një lëvizjeje me fuqi mbi të, domethënë të kontrolluara, në njërën gjendje, dhe sjellja e lëvizjes në ekzistencë pa fuqi në gjendjen tjetër. Mirëpo, nëse ne vërejmë një person tjetër dhe shohim shumë lëvizje të komanduara, ne mendojmë me-

njëherë se ato lëvizje janë brenda fuqisë së tij. Këto janë aftësi njohëse të krijuara nga Perëndia sipas kursit të natyrshëm të ngjarjeve, përmes të cilave ne jemi të vetëdijshëm për ekzistencën e dy alternativave të mundshme, por përmes të cilave pamundësia e alternatives tjetër nuk tregohet, siç është thënë më parë.

***Elez Osmani***
*Nju-Jork, nëntor 2011*

**Vërejtje:**
Teksti është i përkthyer në gjuhën shqipe nga Xhevdet Hoxha ish-gazetar i Zërit të Amerikës, nga libri: "Incoherence of philosophers" i përkthyer në gjuhën angleze nga gjuha arabe prej Michael E.Marmura. Ky botim mban paralel edhe tekstin arab. Botuar më 2000 Birgham Young Press. Utah

---

*Literatura:*


- Ebu Hamid El Gazali, nga veprat e tij:
- Iha uluimid-din (Kompleti ) Sarajevë 2005.
- Path to sufizsm - his delivirance from error Al munqidh min e ddal-lal, Louisville 2006, KY USA.
- The incoherence of the philozophers Brighaam Young University, Utah 2000 USA.
- The ninety - nine beautiful Names of God, 2011 Cambridge United Kingdom.
- On Knowing Your self and God, 2002 Chicago.
- The alchemy of happines2009 WLC Books.
- Nga Riperteritja e Diturisë Fetare - Ballsami i Lumturisë Romë 1959 (Imam Vehbi Ismaili: Ebu Hamid El Gazali).
- Shpëtimi nga Lajthitja (El Munqidhu-min eddal-lal) Mitrovice 1996.
- Baba Rexhepi Misticizma Islame dhe Bektashizma. Nju-Jork 1970.
- Ekrem Murtezai, Fjalor i terminologjisë fetare, Prishtinë 2007.





- Macdonald, D.B. Development of the Muslim Teology, jurisprudence and constitutional theory, New York 1993.
- http.Gazali.org./ web. Living Islam.
- Marmura, M.E. (1995) ‘Ghazalian Causes and Intermediaries’, *Journal of the American Oriental Society* 115: 89-100. (Admitting the great influence of philosophy on al-Ghazali, the author tries to demonstrate al-Ghazali’s commitment to Sufism).
- Nakamura Kojiro (1985) ‘An Approach to Ghazali’s Conversion’, *Orient* 21: 46-59.
- Nerkez Smailagiq, Leksikon Islama, Sarajevë 1990.
- Ormsby, E. L. (1984) *Theodicy in Islamic Thought: The Dispute over al-Ghazali’s ‘Best of All Possible Worlds’*, Princeton, NJ: Princeton University Press. (A study of the controversies over al-Ghazali’s ‘optimistic’ remarks in his later works).
- Tahir Kukaj: Punim magjistrature "Fikret el kerame inde ibni Tejmije, Kajro 1997.
- Shehadi, F (1964) *Ghazali's Unique Unknoëable God: A Philosophical Critical Analysis of Some of the Problems Raised by Ghazali's View of God as Utterly Unique and Unknowable*, Leiden: Brill. (A careful philosophical analysis of al-Ghazali’s religious thought).
- Sherif, M. (1975) Ghazali's Theory of Virtue, Albany, NY: State University of New York Press. (A careful analysis of al-Ghazali’s ethical theory in his Mizan and the philosophical influence on it).
- Smith, M. (1944) *Al-Ghazali the Mystic*, London: Luzac. (A little dated, but still a useful comprehensive study of al-Ghazali as a mystic and his influence in both the Islamic and Christian worlds.)
- The Columbia Encyclopedia, (Ghazali)six edition 2006.
- watt, Montgomer y w. (2002) The *Muslim Intellectual: A Study of al-Ghazali*, Edinburgh: Edinburgh University Press. (An analysis of al-Ghazali’s life and thought in the historical and social context from the viewpoint of sociology of knowledge.)

*Elez Osmani*

# ON THE 900th ANNIVERSARY OF THE DEATH OF AL-GHAZALI (1058-1111)

## (Summary)

This year marks the 900th anniversary of the death of Al-Ghazali (1058-1111). Al-Ghazali was an Islamic theologian, jurist, philosopher, cosmologist, psychologist and Sufi mystic of Persian origin, and remains one of the most celebrated scholars in the history of Sunni Islamic thought. He is considered a pioneer of methodic doubt and scepticism, and in one of his major works, *The Incoherence of the Philosophers*, he changed the course of early Islamic philosophy, shifting it away from an Islamic metaphysics towards an Islamic philosophy based on cause-and-effect that was determined by God or intermediate angels.

ألز اسماني

# بمناسبة مرور 900 عام من وفاة: أبو حامد محمد ابن محمد الغزالي (1058–1111)

## (خلاصة البحث)

تم فى هذه السنة الاحتفال بمرور 900 عام من وفاة أبو حامد محمد ابن محمد الغزالي 1058–1111. لا شك بأن الغزالي يعتبر من أهم المفكرين المسلمين في التاريخ الاسلامي ، فهو متكلم و فقيه و فليسوف و عالم النفس و صوفي و سيبقى كأحد أشهر المفكرين في الفكر السني. و يعد الغزالأحد الرواد فى فلسفة الشك و هذا يدل على أنه تأثر بالفلسفة اليونانية حيث تم اعطاء هذه الفلسفة صبغة اسلامية و صفات ا الغيبية التى كانت تتميز بها الفلسفة الاسلامية .

## FILOZOFI

*M.M.Sharif*

# FILOZOFIA*
# Filozofia dhe religjioni
# - sipas Ibni Ruzhdit -

Pajtimi mes filozofisë dhe religjionit, me të drejtë është konsideruar si vija më e rëndësishme e filozofisë islame. Zgjidhja e Ibni Rushdit të këtij problemi me të vërtetë ka qenë gjeniale. Si filozof, e ka ndjerë obligim të vetin për të mbrojtur filozofët nga sulmet e rrepta të fakihve dhe teologëve, sidomos pas kritikës të Gazaliut në veprën e tij: "Inkoherenca e filozofëve". Studimi i Ibni Ruzhdit: "Fasl-al-Mekal fima bain al-sharia val-hikmah min al-ittisal" është mbrojtje e filozofisë, e cila për aq sa duhet është në harmoni me religjionin. Sot dyshohet për këtë çështje se a do të duhej marrë me kaq interesim, mirëpo në shekullin e gjashtë (dymbëdhjetë të e.r.) me të vërtetë ka qenë vitale. Filozofët kanë qenë të akuzuar për shkak të herezisë (kufrit) ose pafesisë. Në realitet el-Gazaliu i ka akuzuar filozofët si joreligjiozë në "Tehafut" të tij. Po të ishte kjo akuzë e tij e vërtetë, filozofët, sipas ligjit islam do të dënoheshin me vdekje, nëse nuk heqnin dorë nga filozofimi ose publikisht të deklarojnë se nuk besojnë në doktrinën e tyre filozofike. Prandaj, ka qenë e domosdoshme që filozofët ta mbrojnë vetveten dhe mendimin e tyre.

Ibni Rushdi studimin e tij e fillon me pyetjen: Filozofia a është e lejuar apo e ndaluar, e porositur apo e urdhëruar me Sheriat (ligj islam). Përgjigjja e tij në vetë fillim është se filozofia nga religjioni është urdhëruar ose së paku është porositur- (religjioni në këtë kontekst është përdorur posaçërisht si sinonim i sheriatit Islam). Sepse funksioni i filozofisë nuk është asgjë më tepër sesa spekulimi mbi krijesat dhe vështrimi i tyre sa që ato çojnë deri te njohja e Krijuesit. Kur'ani i udhëzon njerëzit në një mënyrë të tillë të vështrimit racional. (itibar) në shumë ajete të ngjashme me këtë "Vështroni, o ju që shihni" al-itibar është term kuranor, i cili nënkupton diç më tepër se spekulimi i pastër ose të menduarit e shikuarit (nazar). Duke përkthyer këtë vështrim kur'anor në termat e logjikës, nuk është asgjë tjeter pos pranimit të panjohurës nga e njohura, nëpërmes inferencesë. Ky tip i rezonimit quhet reduksion, forma më e mirë e të cilës është argumentimi (burhan). Meqë Zoti e nxit njeriun për ta njohur përmes argumenteve, njeriu duhet gjithsesi të mësojë se si do t'i ndajë deduksionet demonstrative nga ato dialektike, retorike dhe sofistike. Argumentimi është instrument me ndihmën e të cilit njeriu mund të arrijë njohurinë në Zotin. Metoda e meditimit logjik është ajo që shpie deri te vërtetësia. Rezulton se Kur'ani e inkurajon njeriun për ta studiuar filozofinë, pasi që ai duhet të manipulojë me universin dhe t'i vështrojë krijesat e ndryshme. Tani kemi kaluar nga plani legal i Fikhut në planin filozofik, përkundër dallimit të tij. Qëllimi i religjionit është përkufizuar me përkufizime filozofike dhe përbëhet nga ajo që të nxirret teoria e vërtetë dhe praktika e vërtetë (al-ilm al-hakk val-amal-al-hakk). Kjo ne na përkujton definicionin e filozofisë, të cilin e ka dhënë El-Kin-di dhe ithtarët e tij dhe i cili ka mbetur aktual gjatë tërë filozofisë Islame. Dituri e vërtetë është dituria ndaj Zotit, ndaj të gjitha qenieve tjera si të tilla dhe ndaj fatit dhe fatkeqësisë në të ardhmen. Dy mënyra janë për të ardhur deri të njohuria: të kuptuarit dhe miratimi. Miratimi ose është demonstrativ, dialektik ose retorik. Të gjitha këto tri lloje të miratimit janë përdorur në Kur'an. Njerëzit ndahen në tri klasa: në

* Ky punim ështe marrë nga vep: "Klasicna Kultura Islama" e përgatitur dhe botuar nga Nerkez Smajlagiq, në vitin 1973 Zagreb.

filozofë, teologë dhe njerëzit e thjeshtë (al-xhumhur). Filozofët janë njerëz të demonstrimit.

Teologët - Esh'aritët, doktrina e të cilëve në kohën e Ibni Rushdit ka qenë e pranuar zyrtarisht- janë me gradë më ulët, ngase ata fillojnë nga meditimi dialektik, e jo nga e vërteta shkencore. Masa janë njerëz të retorikës të cilët kuptojnë vetëm përmes shembujve dhe mendimit poetik. Deri më tani religjioni është i pajtueshëm me filozofinë. Veprimi dhe qëllimi i filozofisë janë të njëjta sikur te religjioni. Do të themi diç për pajtueshmërinë e metodave dhe për objektin e tyre. Nëse ndodh që tradicionalja (al-mankul) është në kundërshtim me racionalën (al-makul) duhet interpretuar në atë mënyrë sikur të ishte në harmoni me racionalen. Interpretimi alegorik (ta'wil) bazohet në faktin se ka disa ajete kur'anore të cilat kanë një kuptim të dukshëm (dhahir) dhe një të brendshëm (batin). Dijetarët e hershëm myslimanë duke u përballur me ajete të tilla, i janë shmangur interpretimit të tyre, ngase i janë frikësuar se do t'i sjellin deri te ngatërrimi i trurit të njerëzve të thjeshtë. Esh'aritët disa ajete i kanë interpretuar sikur atë të "Uljes në fron" (al-istiva), ndërsa Hambelitët besonin në kuptimin e tij të dukshëm (jashtëm). Qëndrimi i Ibni Rushdit, si filozof ndryshon nga ai i myslimanëve të hershëm, i Esh'aritëve dhe Hambelitëve.Tevvilin mund ta përdorin vetëm filozofët që janë njerëz të demonstrimit. Madje edhe atëherë, ai tevvil duhet të mbahet anash si dituri ezoterike, larg nga përpjekjet që t'iu shpallet masave.

Ibni Rushd kthehet në planin e Fikhut dhe e krahason metodën logjike të filozofisë me atë tradicionalen të Fikhut, e cila e quajtur sipas parimeve të Fikhut varet nga katër burime: Kur'ani, Tradita (sunneh) Ixhma-u (pajtueshmëria) dhe Kijasi (analogjia legale). Pamë se Kur'-ani duhet të interpretohet në mënyrë racionale. Ixhma, vjen nga pajtueshmëria unanime e mendimit të të gjithë dijetarëve të kualifikuar të kohës së caktuar. Megjithatë, nuk ka pasur pajtueshmëri në çfarëdo kohe qoftë lidhur me çështjet doktrinare, thjesht për shkak se ka disa dijetarë që besonin, siç është përmendur në Kur'an, se janë disa gjëra të cilat duhet të mbulohen (fshehen). Vetëm ata të cilët kanë temel të mirë në dituri (errasihune fil-ilmi) kanë të drejtë t'i dinë. Ndërkaq, pa-



si që nuk ka pasur pajtueshmëri në çështjet doktrinare, el-Gazali nuk ka pasur të drejtë t'i sulmojë filozofët si joreligjiozë në bazë të "Ixhmasë". Sipas mendimit të el-Gazalisë, ata kanë merituar akuzën për herezi (tekfir), për arsye të tri gjërave: mësimit të tyre që i përket përhershmërisë së botës, mohimit të tyre të diturisë hyjnore për gjëra të veçanta dhe mohimit të ringjalljes fizike.

Religjioni, sipas Ibni Rushdit, bazohet në tri parime në të cilat duhet të besojë secili mysliman nga tri klasët e përmendura. Dhe ato janë; ekzistimi i Zotit, profecia dhe ringjallja. Këto tri parime përbëjnë çështjen e religjionit. Pasi profecia varet nga shpallja, filozofia qëndron e ndarë nga religjioni nëse nuk tregohet se mendja dhe shpallja janë në pëlqim njëra me tjetrën. Ky problem është përpunuar detajisht në librat tjerë të tij. Ndërkaq, ai që e hedh cilindo nga parimet e përmendura konsiderohet joreligjioz (kafir-heretike). Ai mund të besojë në atë që dëshiron përmes çfarëdo mënyre qoftë demonstrative, dialektike ose retorike.

Filozofët nuk do të guxonin t'ua shpallin interpretimet e veta ezoterike masave, ngase ajo mund t'i shpjerë deri te herezia. Teologët të cilët e kanë bërë këtë kanë qenë përgjegjës për prejardhjen e sekteve të ndryshme islame, të cilat njëra- tjetrën e kanë akuzuar për herezi. Tekefundit filozofia është motër binjake e fesë, ato janë dy mikesha të cilat nga vetë natyra e tyre duhen mes vete.

## Rruga deri te Zoti

Pas konstatimit se religjioni ka kuptime të jashtme dhe të brendshme simbolike për njerëzit e thjeshtë dhe të fshehta për njerëzit e dijshëm, Ibni Rushd në librin e tij "Al-kashf an menahixh al-adil-la" angazhohet për ta gjetur rrugën deri te Zoti, do të thotë metodat të cilat janë dhënë në Kur'an për t'u arritur besimi në ekzistimin e Zotit dhe në dijen për cilësitë e Tij sipas kuptimit të jashtëm ngase rruga që shpie në besim të ekzistimit të Krijuesit është njohuri e parë, të cilën mund ta pranojnë të gjithë njerëzit e logjikshëm.

Meqenëse ky libër është shkruar në formë teologjike, Ibni Rushd fillon t'i analizojë metodat e sekteve të ndryshme islame, të cilat i klasifikon në pesë lloje kryesore: Esh-aritët, Mutezilitët, Batinitët, Hashavitët dhe Sufitët.

Ka qenë e natyrshme që për bashkohësit e tij Esh-aritët ai rezervoi pjesën më të madhe të analizës, por është pak e çuditëshme se më vonë askund nuk i përmend Batinitët të përmendur në klasifikim, Mutezilitët i përmend shumë shkurt bashkë me Esh-aritët, por jo në veçanti nëpër shkrimet e tyre origjinale, të cilat siç thotë më vonë nuk kishin ardhur në Magrib (përendim).

Hashavitët mendojnë se rruga deri te Zoti është dëgjimi përmes transmetimit gojor (verbal) (es-sem'a) e jo përmes logjikës. Ata konsiderojnë se besimi në Zotin është i arritshëm përmes profetëve, kurse logjika me të nuk ka asgjë. Mirëpo, kjo është në kundërshtim me atë që e përmend Libri i Shenjtë, i cili kërkon që njerëzit përgjithësisht të besojnë përmes argumenteve racionale.

Esh-aritët mendojnë se rruga deri te Zoti është nëpërmes logjikës, mirëpo metoda e tyre është e ndryshme nga mënyra religjioze, në të cilën Kur'ani insiston për ta pasuar njerëzit. Ata paraqesin premisa të caktuara dialektike nga të cilat fillojnë si p.sh. bota është kohore, trupat përbëhen nga atomet, e atomet krijohen, agensi i botës nuk është kalimtar as i përhershëm. Pikëpamjet e tyre, megjithatë, janë larg për t'i kuptuar njerëzit e thjeshtë, e përveç kësaj ato janë jo konsistente dhe jo bindëse. Rruga e dytë e Esh-aritëve është ajo e Ebu- al- Mealisë. Bazohet në dy premise: bota është e mundshme (xhaiz) dhe ajo që është e mundshme është temporale. Mirëpo, kjo mënyrë e nderpret urtësinë e krijimit të krijesave. Në një formë edhe mënyra e Ibn Sinasë është e ngjashme me atë të Ebu-l-Mealisë, vetëm se ai e zëvendëson fjalën e mundshme me - ekziston.

Sufitët pasojnë mënyrën mistike. Ata thonë se dituria për Zotin është hedhur në shpirt prej së larti, pasi që të jemi liruar nga dëshirat tona të kësaj bote. Mirëpo, kjo mënyrë nuk është e pranueshme për mbarë njerëzimin e përveç kësaj e ndërpret spekulimin (meditimin) në të cilin njerëzit janë udhëzuar gjatë tërë Kur'anit.



Si është atëherë rruga e vërtetë deri te Zoti, e cila i përgjigjet mbarë njerëzimit? Dy rrugë janë përmendur në Kur'an , Ibn Rushdi i quan argumenti i providencës dhe argumenti i krijimit. E para është teologjike, e dyta është kosmologjike dhe të dyja fillojnë nga njeriu dhe krijesat tjera e jo nga universi si tërësi. Argumenti i fatit varet nga dy parime; i pari është se të gjitha krijesat janë të përshtatura per ekzistencën e njeriut kurse, i dyti është se ajo përshtatshmëri, domosdoshëm është kushtëzuar me agnes, ashtu për të vepruar me anë të vullnetit, duke qenë se ajo përshtatshmëri nuk mund të arrihet rastësisht. Të gjitha krijesat janë krijuar për t'i shërbyer njeriut: yjet ndriçojnë natën për t'i treguar atij rrugën, organet e tij trupore janë përshtatur për jetën dhe ekzistencën e tij. E gjithë teoria e vlerës mund të nxirret nga kjo pikëpamje.

Argumenti i quajtur krijimi i vështron shtazët, bimët dhe qiejt. Gjithashtu bazohet në dy parime; se të gjitha qeniet janë të krijuara dhe se të gjitha të krijuarave u duhet Krijuesi. Shembujt e dhënë kanë të bëjnë me qeniet e gjalla. Kur e shohim se trupi që është i privuar nga jeta, e fiton jetën, e dimë se ekzistonë krijuesi i jetës, ai është Zoti. Qiejve gjithashtu u porositet që të lëvizin dhe të kenë kujdes për botën tokësore.

Zoti thotë në librin e shenjtë  (Kur'an) " Me të vërtetë ata të cilët ju i thërrisni (luteni), pos Zotit kurrsesi nuk e kanë krijuar as një mizë edhe sikur të ishin bashkuar për të". Ai që dëshiron të njohë Zotin duhet ditur esencën dhe përdorimin (shfrytëzimin) e gjërave për të arritur njohuri mbi krijimin e vërtetë. Këto dy mënyra janë të përbashkëta si për elitën e dijetarëve ashtu për masën. Dallimi mbi diturinë e tyre qëndron në shkallët e detajeve. Njerëzit e thjeshtë mjaftojnë me njohurinë shqisore, e cila është hapi i parë në drejtim të shkencës. Elita është e bindur vetëm me demonstrimet.

Kuptimi i Njeshmërisë hyjnore është shprehur me parimin Kur'anor: Nuk ka Zot përveç Tij". Mohimi i hyjnive tjera konsiderohet kuptim shtesë i afirmimit të Njëshmërisë së Zotit. Çka do të ndodhte sikur të kishte më tepër se një Zot? Bota do t'i nënshtrohej prishjes

(shkatërrimit): Një Zot do të ishte më i madh se tjerët, ndërsa zotat tjerë do të gjenin mjete për ta rrëzuar atë prej pushtetit.

Zoti është kualifikuar me shtatë veti kryesore: me dituri, jetë (i gjallë) fuqi, vullnet, dëgjim, shikim dhe me të folur. Këto kualifikime njerëzore janë marrë në përsosjen e tyre absolute. Tri pozicione mund të merren përballë raportit ndërmjet qenies hyjnore dhe krijesave të Tij. Ky është qëndrimi i Mutizelitëve. E dyta për të vërtetuar në gjendje të përsosmërisë së plotë. E treta duhet të merret me mend si transcendente dhe mbi diturinë e njeriut. Ato janë në sferën e të paimagjinueshmes. Në realitet Kur'ani i vërteton vetit, megjithatë thotë: "Asgjë nuk i përngjan Atij", që do të thotë se Ai është i paimagjinueshëm (që nuk merrët me mend). Njerëzit e thjeshtë mund të besojnë sipas kuptimit të jashtëm të tekstit që Ai sheh, dëgjon, flet etj. Njerëzit e demostrimit nuk do të duhet të përhapin interpretimet e veta para masave. Mësimet e mutizilitëve dhe Esh-aritëve janë të parregullt. Ibn Ruzhdi i kritikon vendimet e tyre në librin e tij Al-Menahixh dhe gjerësisht në Tehafut. Ai konsideron se në rastin e vetive, pa vërtetimin e tyre ose mohimin, njeriu duhet të pasojë kuptimin e natyrshëm të tyre të përmendur në Kur'an. Për sa i takon interpretimit filozofik, ai duhet të mbetet ezoterik.

Veprimet e Zotit janë redaktuar në pesë kryesore; krijimi, dërgimi i profetëve, paracaktimi, drejtësia dhe ringjallja. Ato përmbajnë raportet ndermjet Zotit, botës dhe njeriut. Krijimi është vepër e Zotit. Ai ka krijuar botën me vullnetin e drejtë e jo rastësisht. Bota është vendosur mirë dhe në gjendje më të përkryer të drejtësisë, që argumenton ekzistimin e Krijuesit të Urtë. Shkaktueshmëria është e caktuar. Të gjitha argumentet e Rushdit varen për besim, por asgjë nuk ndodh pa shkak dhe ekziston një seri shkaqesh, të cilat rrjedhin nga shkaku i parë. Ai thotë: "Ai që në gjërat artistike mohon ose nuk mund ta kuptojë pasojën e shkaktuar të shkakut nuk do të ketë njohuri për artin ose artistin, ngjashëm është me atë i cili mohon ekzistimin e varësisë së pasojave në këtë botë, nga shkaqet, ai do të mohojë edhe Krijuesin e Urtë.



Argumenti për dërgimin e profetëve bazohet në dy shembuj të përmendur në Kur'an. I pari është që njerëzit e tipit të tillë janë ata që i hartojnë ligjet nëpërmes shpalljes së Zotit e jo përmes mësimeve njerëzore. Puna e profetëve është që t'i hartojnë ligjet, të cilat nëse njeriu i pason do t'i sjellin atij lumturi të vazhdueshme. Parimi i dytë është që ai i cili është kualifikuar për ta nxjerrë atë akt të Ligjdhënësit të jetë profetë. Pikërisht siç është puna e mjekut për të shëruar trupin dhe ai që kryen shërimin duhet të jetë mjek, puna e profetit është të hartojë ligjet, kurse ai që gjindet për t'i bërë ato duhet të jetë profet. Teologët supozojnë se besimi ynë në të vërtetën e profetëve qëndron në besimin e veprimeve të tyre të çuditshme, të cilat janë të mbinatyrshme.

Mirëpo, Kur'ani refuzon pasimin e rrugës së tillë, e cila ka qenë e përbashkët për religjionet e mëparshme. Kur arabët i thanë Muhamedit a.s. se nuk do të besojmë ty nëse nuk e bën që të burojë nga toka e thatë përroi (burimi i ujit) ai u është përgjigjur përmes shpalljes hyjnore: "Unë jam vetëm qenie njerëzore - profet. Mrekullia e vetme islame është libri i tij i shenjtë, Kur'ani, i cili përmban ligjet për mirëqenien e njeriut. Pra, nuk ka asgjë të mbinatyrshme duke pasur parasysh se çdo gjë vazhdon në përputhje me ligjet natyrore, të cilat rregullohen nga lidhshmëria e afërt e shkaqeve dhe pasojave".

Predestinimi (paracaktimi) është problem tepër i rëndë për të cilin supozimet e mendimtarëve myslimanë sillen nga fatalizmi absolutë deri te vullneti i lirë absolut. Fatalizmi e eliminon lirinë e njeriut e me të edhe përgjegjësinë e tij. Mutezilitët shkojnë në favor të vullnetit të lirë, i cili është themel i përgjegjësisë së njeriut për veprimet e mira dhe të keqija të tij. Nëse pranohet ky botëkuptim, atëherë Zoti nuk ka asgjë me veprimtarinë e njeriut, pasi që njeriu (në këtë rast) është krijues i veprave të tij personale. Ndërkaq, nga kjo pason se do të ketë edhe krijues tjerë përveç Krijuesit. Esh-aritët i përmbahen pozicionit të mesëm, duke thënë se njeriu është i parapërcaktuar (predestinuar) megjithatë, ai merr fuqi për të vepruar. Kjo është doktrina e tyre e njohur e marrjes-fitimit (al-kesb). Mirëpo, ky solucion sipas mendimit të Ibn Ruzhdit, është vetë kundërkushtëzues. Doktrina e tyre shpie deri te fatalizmi. Njeriu nuk është i predisponuar as për fatalizëm as për

vullnet të lirë. Ai është i determinuar. Determinimi është produkt i veprimit në përputhje me shkaqet e tij personale. Shkaqet janë ose të jashtme ose të brendshme. Veprimet tona janë të zbatueshme edhe përmes vullnetit tonë dhe përmes kompatibilitetit të ngjarjeve të jashtme. Vullneti njerëzor është i caktuar me inkurajimet e jashtme të cilat janë të nënshtruara drejtësisë së skajshme dhe rregullit harmonik në përputhje me vullnetin universal të Zotit. Veprimet tona jo vetëm që janë përcaktuar me shkaqet nga jashtë por në raport me shkaqet ato janë brenda vetë nesh. Konfirmimi korrekt i shkaqeve të jashtme dhe të brendshme është ajo që e quajmë paracaktim. Dituria hyjnore mbi ato shkaqe dhe rezultatet e tyre është arsyetim i ekzistimit të tyre.

Zoti është i drejtë dhe asnjëherë nuk i bën padrejtësi njeriut, siç është thënë në Kur'an. Natyra e njeriut nuk është absolutisht e mirë, edhe pse e mira është dominuese. Shumica e njerëzimit janë të mirë. Zoti e ka krijuar të mirën – esencë, ndërsa të keqen - rastësisht për të mirën. E mira dhe e keqja janë te ngjashme me zjarrin, i cili përdoret shumë për gjërat e dobishme, megjithatë, në disa raste mund të jetë i dëmshëm. Kjo teori e Rushdit i jep mbështetje optimizmit, i cili mbizotëron në botë.

Të gjitha religjionet pajtohen për çështjen e ringjalljes. Dallojnë vetëm në atë se a është ajo shpirtërisht apo fizikisht. Ringjallja shpirtërore është ekzistimi i shpirtit, pas ndarjes së tij nga trupi. Besimi në ringjalljen fizike është më i përshtatshëm për masat që nuk mund të arrijnë të kuptuarit e pavdekshmërisë spirituale të shpirtit.

## Rruga deri te shkenca

Shkenca, religjioni dhe filozofia përbëjnë tri fusha të ndryshme. Njeriu nga nevoja është detyruar të gjejë mënyrën me të cilën do t'i harmonizonte këto aspekte të ndryshme të kulturës, që koekzistojnë në shoqëri në të cilat jeton, në të kundërtën personaliteti i tij do të shkatërrohet. Shkenca është e domosdoshme, për mirëqenien e njerëzve, të cilët jetojnë në shoqëri të civilizuar. Ekzistenca e tyre materiale varet dhe është në lidhje reciproke me shkallën e njohurive shkencore.



Religjioni është edhe më i rëndësishëm në shoqërinë njerëzore. Siç bën të ditur Bergsoni: “Kemi gjetur në të kaluarën dhe mund të gjejmë edhe sot, shoqëri njerëzore pa shkencë, pa arkitekturë dhe pa filozofi. Mirëpo, kurr nuk ka ekzistuar shoqëri pa religjion”. Filozofia është gjurmim i së vërtetës.

Është thënë drejt se njeriu është qenie metafizike. Madhështia e filozofëve të njohur: Platonit, Aristotelit, Ibn Sinait, Ibn Ruzhdit, Kantit etj… qëndron në vendosjen e secilës prej këtyre disiplinave në vendin ekzakt dhe në sferën e shkencës e të aksionit. Filozofët e parë i dhanë shkencës kuptimin e saj obligativ dhe nuk e zvogëluan punën e religjionit. El-Kindi, El-Farabi dhe Ibn-Sina, të gjithë kanë qenë shkencëtarë dhe filozofë. Krahas kësaj të gjithë kanë qenë myslimanë të sinqertë edhe pse religjionin e kanë komentuar në dritën e njohurive të tyre shkencore dhe filozofike.

El-Gazali ka qenë i pakënaqur me mësimet e këtyre filozofëve. Ai i ka sulmuar në librin e tij “Inkoherenca e filozofëve”, dhe i ka akuzuar për kufër-herezi në njëzet pika. Elokuenca, (oratoria), njohuria e tij e thellë e mjeshtërisë së kontraversionit dhe argumentacionit si dhe arsimimi i gjerë në çdo dituri, i sollën atij popullaritet të gjerë, kështu që është konsideruar autoritet eminent sa i përket islamit ( Huxh-Xhatul- Islam)

Ibni Rushdi u është përgjigjur pikë për pikë akuzave të tij. Debati ndërmjet këtyre dy personaliteteve të mëdha me të vërtetë është një shqyrtim interesant, i cili paraqet konflikt të vërtetë në shoqërinë myslimane, konflikt ndërmjet religjionit në një anë dhe shkencës dhe filozofisë në anën tjetër. Ibni Rushdi me aftësitë e tij të filozofit që synon të vërtetën, i integroi këto tri lëmi të ndryshme. Me interpretimin racional të Kur'anit ka krijuar harmoninë e religjionit dhe të filozofisë. Zbuloi rrugën e vërtetë deri te religjioni, siç është bërë e ditur në Kur'an. Pastaj niset të trasojë rrugën e shkencës.

Në mbrojtjen e tij entuziaste të religjionit El-Gazali pa qëllim, shkencës ia mbylli dyert. Rruga mistike e sufizmit, të cilën ai e përcaktoi nuk mund të lidhet me metodat racionale të shkencës. Myslimanët, fatkeqësisht e pasuan El-Gazalin, ”Autoritetin Islam” dhe pak nga

pak e lanë pos dore studimin e shkencës. Civilizimi madhështor personal i tyre filloi të zbehet. Nga ana tjetër, Ibni Rushd e mbrojti shkencën dhe Evropa mesjetare, e pasoi rrugën të cilën ai e trasoi. Ajo ka qenë ideja e vërtetë e averoizmit latin, e cila i solli deri te ngritja e shkencave evropiane. Shkenca është tërësia e diturisë së sistematizuar dhe formalizuar, e bazuar në vështrimin dhe klasifikimin e fakteve. Megjithatë, rruga deri te shkenca është më themelore sesa e vërteta shkencore e arritur me të, ngase me metodën mund të vijmë deri te të vërtetat shkencore dhe gjithnjë më tepër të përparojmë në studimin tonë.

Dy ‘Tehafutë’, El-Gazali dhe Ibn Rushdit shfaqin ide të cilat kanë qenë në skenën e civilizimit islam gjatë shekujve gjashtë e shtatë H./ njëmbëdhjetë e dymbëdhjetë e.r..

Disa nga këto ide edhe pse sot konsiderohen se kanë vetëm vlerë historike, kanë qenë me rëndësi të madhe në atë kohë. Dimensioni me të cilin është shqyrtuar problemi i përhershmërisë dhe vendi i saj primar në krye të njëzet diskutimeve orienton në rëndësinë, të cilën ia ka dhënë asaj El-Gazali.

Ibn Rushdi konsideron se tri çështje kryesore janë për shkak të cilave el-Gazali i ka akuzuar filozofët se janë joreligjiozë: përhershmëria e botës, mohimi i dijës së Zotit mbi partikularitetin dhe ringjallja. Sipas mendimit tonë, problemi i cili është ende gjithnjë i rëndësisë vitale është problemi i shkaktueshmërisë.

Mendimi shkencor mund të jetë i vërtetuar në bazë të parimit të kauzalitetit.

Derisa Hume kritikoi shkaktueshmërinë (kauzalitetin). Kanti do të mundohet për të gjetur truall racional, ku do të mund të qëndronte kauzaliteti. Kanti konsideron se shkenca (dituria) është e siguruar apriori përmes formës transcendentale të intelektit të pastër. Induksioni i Stuart Millës paraqet kazualitet universal. Russeli thotë: “Qoftë nga paragjykimi i pastër ose nga ndikimi i traditës apo nga një shkak tjetër, më lehtë është të besohet se ekziston ligji i natyrës, sipas të cilit, gjithmonë i ndjekin shkaqet pasojat e tyre sesa që ato ndodhin zakonisht.



Vetëm shkenca bashkëkohore e ka zëvendësuar koncepcionin e “shkakut” me ligjet e kauzalitetit me linjat kauzale, me statistikat etj.

Ibn Rushdi ia caktoi vetes për detyrë ta ruajë shkencën dhe të tregojë rrugën deri te të vërtetat shkencore, pasiqë el-Gazali kishte minuar raportin e domosdoshëm ndërmjet shkakut dhe pasojave. Çuadri shkruan se ”shkenca ka humbur çdo arsye të ekzistencës. Jeta mëtutje nuk ka pasur bazë … mendimi shkencor është dashur të hulumtohet dhe të shpëtohet”.

El-Gazali e fillon dialogun për shkencat natyrore duke numëruar shkenca të ndryshme “për të theksuar se Ligji i shenjtë nuk kërkon nga individi që t’i kundërvihet dhe ta refuzojë“. Në numërimin e vet përmend edhe dituri të tilla siç është mjeshtria e magjisë, al-kimia, astrologjia etj. Ibn Rushdi i hedh poshtë pseudoshkencat e tilla. Mjeshtria talismanit (simboleve të magjisë) është e kotë. A ekziston al-kimia është shumë e dyshimtë. Astrologjia nuk u përket fenomeneve fizike.

Qëllimi i vërtetë për shkak të cilit el-Gazali ka mohuar lidhjen e domosdoshme të shkakut është ai që me mohim varet mundësia e vërtetimit të ekzistimit të mrekullive, të cilat e ndërpresin rrjedhën e zakonshme të natyrës, siç është shndërrimi i shkopit në gjarpër. Sipas Ibn Rushdit, filozofët nuk guxojnë t’i komentojnë ose hulumtojnë (muxhizet) mrekullitë: “Ai që në to dyshon, meriton dënimin”. Mirëpo, mrekullia islame nuk qëndron në mrekulli të tilla, siç është shndërrimi i shkopit në gjarpër por qëndron në Kur’an, “ekzistenca e të cilit nuk është ndërprerja e rrjedhjes së natyrës të pranuar me traditë … por natyra e tij e mrekullueshme është vërtetuar me anë të perceptimit dhe vështrimit të secilit njeri… Ndërkaq, kjo mrekulli është larg më shumë se të gjitha mrekullitë tjera”. Në realitet Ibn Rushd e përsërit këtu atë që e ka paraqitur më parë në dy librat e tij, në “Fasël dhe Keshf. Teologët e rinj myslimanë Muhamed Abduhu, Aliu etj, e kanë pranuar mendimin e Rushdit, i cili sot është i përhapur në të gjitha shoqëritë myslimane. Kthimi te Ibni Rushdi është një ndër sprovat e Reneseancës së re në Lindje. Muhamed Abduhu thotë: “Eshtë e pamundshme që populli islam të mohojë, në mes shkakut dhe pasojës lidhjen që ekziston në këtë botë”.

Nga kjo hyrje do të kalojmë në atë kryesorën. El-Gazali parashtron gjërat kështu: “Sipas neve, lidhja mes asaj që thjesht konsiderohet si shkak dhe asaj që konsiderohet si pasojë, nuk është lidhje e domosdoshme, secila prej atyre dy gjërave e ka individualitetin e vet dhe nuk është ajo tjetra…” Kënaqësia me etjen nuk e përfshin të pimurit, as të djegurit se përfshin kontaktin me zjarrin … ngase lidhja mes këtyre gjërave bazohet në fuqinë primare të Zotit për të krijuar vargun e pandërprerë, megjithatë, jo pse kjo lidhje është e domosdoshme nga vetvetiu “. Ibni Rushdi e fillon përgjegjen e tij me logjikë të shëndoshë, e cila sipas mendimit të tij, është baza e vërtetësisë. ”Mohimi i ekzistimit të shkaqeve eficijente që duken në gjërat shqisore është sofizëm. Kurse ai që i mohon ata ose e mohon me gjuhë të tij atë që është natyrshëm në logjikën e tij ose është i magjepsur me dyshimin sofistik…”

Megjithatë, filozofia nuk mund të bazohet në logjikën e shëndoshë. Empirizmi është i dobishëm për qëllime praktike e jo për shkencat ekzakte. Të dytë, empirizmi praktik i bazuar në logjikën e shëndoshë dhe njohuria shkencore besojnë në kauzalitet, përveç se i pari është më pak i sigurt, kurse i fundit më tepër në mënyrë precize. Të jesh i dijshëm do të thotë të mund të parashikosh se çka do të ndodhë në të ardhmen, atëherë kur shkaku është i dhënë. Besimi në shkencë dhe forcën e saj rezulton nga mundësitë tona për të paraparë në bazë të domosdoshmërisë. Shkenca moderne ende vazhdimisht beson në kauzalitet, mirëpo jo në formën e vjetër të raportit shkaku-pasoja por në linjat dhe strukturat e kauzalitetit. Kjo jep të konkludohet se besimi në kauzalitet është çështje e bindjes, e cila rrjedh nga bindja e gjallesave në shpresë.

Ibn Ruzhdi ka pasur bindje në natyrë dhe ka konsideruar se në botë të gjitha ndodhin në përputhje me rregullin e përsosur, i cili mund të kuptohet në termat e shkaqeve dhe pasojave. Kjo neve na vë para fotografisë së botës fizike të tillë siç e ka menduar Ibni Rushdi dhe në mënyrë që mund të jetë e njohur shkencëtarisht. Bota është vazhdueshmëri e gjërave dhe personave të cilët janë në marrëdhënie reciproke përmes kauzalitetit të domosdoshëm.



Dy parime janë parashtruar edhe pse nuk janë shprehur; njëra është vazhdimësia e gjërave, dhe tjera është ligji i kauzalitetit.

Këto dy parime janë rezultat i hipotezës metafizike, prejardhja e së cilës është në aristotelizëm përkatësisht në idenë mbi substancën dhe idenë mbi katër shkaqet. El-Gazali mohon këto dy parime. Sa i përket vazhdimësisë së gjërave ai e përsërit kundërargumentin e disa filozofëve në mënyrë komike duke thënë: “Nëse njeriu që ka harruar librin në shtëpi të tij kur është kthyer e ka gjetur të shndërruar në djalë të ri … guri i shndërruar në ari, e ari në guri dhe sikur dikush ta pyet për cilëndo nga këto tri gjëra, ai do të ishte përgjigjur: “Nuk e di se çka gjendet në shtëpinë time në këtë moment”. El-Gazali e pranon provokimin duke deklaruar: “S’ka kontest në shprehjen se për Zotin gjithçka është e mundshme”. Një shembull i kësaj mundshmërie është mrekullia e Ibrahimit a.s. kur ka qenë i hedhur në zjarr, e që nuk është djegur. Zjarri me vullnetin e Zotit e ka humbur kualitetin e tij të djegies. Zjarri prej vetvetiut nuk është efficient, shkaku i vërtetë është Zoti, i cili përmes vullnetit të Tij dhe fuqisë ua jep gjërave kualitetet e tyre. Nuk ka arsye pse atëherë ato të mos jenë të kundërta nga ato që janë.

Për t’u përballur me këtë pohim, Ibni Rushdi problemin e vështron nga aspekti filozofik, të cilin tashmë e kemi theksuar. Vazhdimësia e një gjëje na lejon të vijmë deri tek esenca e përkufizimit të tij dhe t’i japim atij emër “ngase është e qartë nga vetvetiu se gjërat kanë esencë dhe atribute të cilat ia caktojnë funksionet speciale secilës gjë vetmas dhe përmes së cilëve përcaktohet definicioni dhe emërtimi. Sikurse një send të mos kishte pasur natyrë specifike nuk do të kishte emër ose definicion të veçantë dhe se të gjitha gjërat do të ishin një”.

Sa i takon parimit të dytë, i cili ka të bëjë me kauzalitetin “të gjitha gjërat kanë katër shkaqe: agensin, formën, materien dhe qëllimin. Mendja e njeriut i percepton gjërat dhe i kupton shkaqet e tyre. Ndërsa “intelegjenca” nuk është asgjë tjetër përveç se perceptim i gjërave me shkaqet e tyre dhe me këtë shquhet nga të gjitha aftësitë tjera të të kuptuarit, ai që i mohon shkaqet, e mohon intelektin. Logjika e përfshin njohurinë e ekzistimit të shkaqeve dhe pasojave, kurse njohuria mbi pasojat mund të jetë e plotë vetëm përmes njohurisë së shkaqeve

të tyre. Mohimi i shkaqeve përfshin mohimin e njohurisë. Nëse raporti shkak-pasojë quhet shprehi, atëherë shprehia është term i paqartë. A mendohet: 1. me shprehinë e agensës, 2.shprehinë e gjërave ekzistuese, 3. shprehinë tonë për të bërë shprehi rreth gjërave të tilla? Ibni Rushd i refuzon dy kuptimet e para dhe e pranon të fundit, e cila është në harmoni me konceptualizmin e tij. Për shkak se është e pamundshme që Zoti të ketë shprehi. Në realitet shprehia e gjërave ekzistuese është natyra e tyre, ngase shprehia mund të jetojë vetëm në të stimuluarën.

Në fund të fundit rruga drejt shkencës fillon me besim, i cili është themel i së vërtetës, skeptikët dhe agnostikët nuk kanë vend në shkencë. Intelekti i armatosur me këtë bindje në ekzistimin e botës si të tillë, zbulon shkaqet e gjërave. Njohuria shkencore është njohuri e gjërave bashkë me shkaqet e tyre, të cilat i prodhojnë.

*Përktheu nga boshnjakishtja:*
***Hajrullah Hoxha***



*M.M.Sharif*

# PHILOSOPHY
# Philosophy and religion
# - according to Ibn Rushd -

## (Summary)

The reconciliation between philosophy and religion has been considered rightly as the main objective of Islamic philosophy. Ibn Rushd’s solution to this problem was truly brilliant. As a philosopher, he felt compelled to defend other philosophers from the attacks of intellectuals and theologians especially following Ghazali’s criticism in his work: "The incoherence of the philosophers". Ibn Rushd’s study: “Fasl-al-Maqal ekal fima bain al-sharia val-hikmah min al-ittisal" is a defence of philosophy. Nowadays, there are reservations alleging that the issue should not be given much importance. Yet, in the 6$^{th}$ century, it was truly vital.

*م.م. شارف*

## الفلسفة والدين – حسب ابن رشد

### (خلاصة البحث)

الاصلاح بين الفلسفة والدين يعتبر من أهم انجازات الفلسفة الاسلامية ،و قيام ابن رشد بمعالجة هذه المشكلة كان من أهم اعماله فهو كفيلسوف أحس من واجبه أن يدافع عن الفلاسفة من الهجمات الشرسة النى كانوا يتعرضون لها من بعض علماء الدين والفقهاء و خاصة بعد الانتقادات التى وجهها الغزالي في كتابه افت الفلاسفة". الدراسة التى قام بها ابن رشدي في "فصل المقال فيما بين الشريعة والحكمة من الاتصال" يعتبر دفاعا عن الفلسفة و التى حسب ما يبدو هي في توافق تام مع الدين.اليوم ينظر الى قضبة الشك في مدى اعطائه كل هذا الاهتمام الكبير و لكن في القرن السادس الهجري (الاثناعشر تلميلادى) هذه المسألة كانت ذات  اهمية كبيرة.

**JURISPRUDENCË ISLAME**

*Ejup Haziri*

# PARIMET E LEGJISLACIONIT ISLAM - (2)

## Parimi i shtatë: Vëllazëria

Legjislacioni islam i ka kushtuar kujdes të posaçëm vëllazërisë për shkak se ajo përfaqëson shoqërinë, kurse Islami në të gjitha aspektet mbron atë nga të këqijat dhe dukuritë negative. Ligjvënësi ka potencuar:

وَٱعۡتَصِمُواْ بِحَبۡلِ ٱللَّهِ جَمِيعٗا وَلَا تَفَرَّقُواْۚ وَٱذۡكُرُواْ نِعۡمَتَ ٱللَّهِ عَلَيۡكُمۡ إِذۡ كُنتُمۡ أَعۡدَآءٗ فَأَلَّفَ بَيۡنَ قُلُوبِكُمۡ فَأَصۡبَحۡتُم بِنِعۡمَتِهِۦٓ إِخۡوَٰنٗا وَكُنتُمۡ عَلَىٰ شَفَا حُفۡرَةٖ مِّنَ ٱلنَّارِ فَأَنقَذَكُم مِّنۡهَاۗ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمۡ ءَايَٰتِهِۦ لَعَلَّكُمۡ تَهۡتَدُونَ ﴿١٠٣﴾

***“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin** (fenë dhe Kur’anin) **e Allahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju** (para se ta pranonit fenë islame) **ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit në buzë të greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju ta gjeni të vërtetën e lumtur.”***[1]



Ajeti i mësipërm bën fjalë për dy fiset e njohura arabe, Evs dhe Hazrexh, të cilat kishin shkaktuar luftëra dhe beteja të shumta mes vete gjatë kohës së injorancës. Këto dy fise kishin krijuar një urrejtje të madhe ndaj njëra-tjetrës, urrejtje që rezultonte në luftë të pashmangshme. Betejat e tyre janë të njohura për vite të tëra, saqë historianët kanë konstatuar se po të mos vinte islami, këto dy fise nuk do të ekzistonin më, do të shuheshin nga luftërat e përgjakshme që nuk kishin të ndalura. Por, erdhi islami dhe këta armiq të dikurshëm i bëri vëllezër mes vete, ndihmues ndaj njëri-tjetrit. I Madhërishmi për ta kishte shpallur:

وَأَلَّفَ بَيۡنَ قُلُوبِهِمۡۚ لَوۡ أَنفَقۡتَ مَا فِي ٱلۡأَرۡضِ جَمِيعٗا مَّآ أَلَّفۡتَ بَيۡنَ قُلُوبِهِمۡ وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ أَلَّفَ بَيۡنَهُمۡۚ إِنَّهُۥ عَزِيزٌ حَكِيمٞ ﴿٦٣﴾

***“Dhe Ai është që bashkoi zemrat e tyre. Edhe sikur ta shpenzoshe gjithë atë që është në tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu bëri bashkimin e tyre, pse Ai është i gjithëfuqishëm, i urtë.”***[2]

Ishin buzë greminës së zjarrit për shkak të mohimit të tyre, mirëpo Allahu i shpëtoi ata nga ajo gjendje kur ata i udhëzoi në Islam.[3]

Shembullin më sublim të vëllazërisë e kemi nga jeta e të Dërguarit të Allahut, kur u dëbua nga Mekka, e në Medine formuloi të mirënjohurën ‘Kartën e Medinës’, sipas së cilës u bë vëllazërimi mes të imigruarve nga Meka që nuk kishin asgjë me vete dhe vendësve nga Medina. Ishte vëllazërim mes tyre mbi parimet e ndershmërisë dhe drejtësisë që bota deri atëherë nuk e kishte përjetuar. Mes të të shpër-

---

[1] Kur’ani, Ali Imran: 103.
[2] Kur’ani, Enfal: 63.
[3] Ibni Kethir, Ebu-l Fida Ismail, *“Tefsiru-l Kur’anu-l Adhim”*, vëll. I, fq. 380.

ngulurve që s'kishin asgjë me vete me mikpritësit që ndanë pasurinë dhe gjithë atë që posedonin karshi vëllezërve të tyre imigrantë.[4]

Akti i vëllazërimit është akti i mençurisë dhe i vigjilencës së të Dërguarit të Allahut, dhe ishte një zgjidhje e mrekullueshme për problemet e shumta që ishte përballur ajo shoqëri.[5]

Në koleksionin e Buhariut lidhur me këtë vëllazërim, citohet një ngjarje e mrekullueshme mes Abdurrahmanit dhe Sa'd ibn Rebias, gjegjësisht dy personave (njëri nga Meka e tjetri nga Medina) që i ka vëllazëruar i Dërguari i Allahut. Sa'di i ka thënë Abdurrahmanit: "Unë jam më i pasuri mes ensarëve (medinasve). Pasurinë time e ndaj në dy pjesë. Kam dy gra, shikoje cila të pëlqen më shumë e unë do të ndahem prej saj..."[6]

Lidhur me këtë vëllazërim, historiani i njohur Thomas W. Arnold, thotë: "Konstituimi i rendit të ri shoqëror në formë të vëllazërisë islame nga vetë fillimi e ka lëkundur fuqinë e lidhjes së unitetit të gjakut, i cili sipas mbikëqyrjes së vjetër fisnore ka qenë themel i llojit të vet social. Kthimi i një personi dhe hyrja e tij në rendin e ri shoqëror ka pasur kuptim të rrënimit të njërit prej principeve kryesore të jetës arabe."[7]

Vëllazëria fetare që ushqehet nga besimi nuk e dobëson vëllazërinë e përgjithshme, përkundrazi, e përforcon atë; krijon grupim vital njerëzish që besojnë dhe e aplikojnë atë vëllazëri, thërrasin në të dhe e mbrojnë. Pra, mund të konkludojmë se nuk ekzsiton kurrfarë antagonizmi mes vëllazërisë së përgjithshme njerëzore dhe asaj fetare, të cilën e hasim në fjalët hyjnore[8]:

[4] Në lidhje me këtë vëllazërim, Muhamed Gazali thotë: "Vëllazërimi i këtillë ka qenë i kapluar me ndihmesën reciproke, me ndjenja bamirësie dhe dashamirësie, dhe kjo ka marrë pjesë në ndërtimin e një shoqërie të re e cila do të ketë shembuj të lavdishëm." Gazali, Muhamed, *Fikhus-Sireh*, boton: Dar el-Kitab el-Arebij, bot.II-të, Kairo-Egjipt, 1375h/1995, fq. 140-141.

[5] Haziri, Ejup, "*Traktatet në të drejtën Islame*", fq. 85.

[6] Shih për me tepër: *Sahihul Buhari*, kaptina mbi vëllazërimin e ensarëve dhe muhaxhirëve: vol.I, fq. 555.

[7] Arnold, W. Thomas. "*Historia e Përhapjes së Islamit*", Prishtinë 2004, fq. 49.

[8] Kardavi, Jusuf, "*Veçoritë e përgjithshme të islamit*", fq. 101.



إِنَّمَا ٱلۡمُؤۡمِنُونَ إِخۡوَةٌ ... ﴿١٠﴾

***"S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër..."***[9] dhe në ato të të dërguarit të Zotit ku thuhet: *"Myslimani është vëlla i myslimanit, nuk i bën padrejtësi e as që e tradhton atë..."*[10]

Islami këtë vëllazëri sublime e ka vënë në praktikë, mbi të ka ngritur shoqëri të shkëlqyer të gërshetuar me ngjyrime hyjnore dhe njerëzore, moto e së cilës janë fjalët: *"Nuk ka besuar askush prej jush përderisa nuk ia dëshiron vëllait të vet atë që ia dëshiron vetvetes!"*[11]

Kjo vëllazëri ka qenë shembull dhe model i pakrahasueshëm, ngase në gjirin e saj ka pasur sllavin e dikurshëm, të ziun nga Abisinia, Bilalin; Selmanin nga Persia, Suhejbin nga romakët etj., ku ka shuar mosmarrëveshjet dhe grindjet racore, gjenetike, sociale dhe autoritative.[12]

## Parimi i tetë: Mëshira

Një prej parimeve të legjislacionit islam është edhe mëshira, si veçori e Ligjvënësit që shquhet për mëshirën e Tij të pakontestueshme për robërit e Tij në këtë jetë dhe në jetën e përtejme:

... وَٱللَّهُ رَءُوفُۢ بِٱلۡعِبَادِ ﴿٢٠٧﴾

***"...Allahu është shumë i mëshirshëm për robtë e vet."***[13] Mëshira e Ligjvënësit ka përfshirë çdo gjë:

[9] Kur'ani, Huxhurat: 10.

[10] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2262, 6437; Muslimi në Sahihun e tij, nr. 4650. Hadithi është autentik.

[11] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 12; Muslimi në Sahihun e tij, nr. 64; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 2439 dhe thotë se hadithi është autentik.

[12] Gjithashtu kjo vëllazëri ka ekzsituar në shkallë të altruizmit, mirësisë dhe synimit për t'iu bërë mirë tjerëve, e këtë e argumenton më së miri shembulli i ofertës së Sa'd ibn Rebias karshi Abdurrahman ibn Avfit. Me fjalë tjera kjo vëllazëri ka pastruar shpirtrat dhe zemrat e tyre nga çdo gjë negative.

[13] Kur'ani, Bekare: 207.

... وَرَحۡمَتِي وَسِعَتۡ كُلَّ شَيۡءٖۚ ... ﴿١٥٦﴾

***"...mëshira Ime ka përfshirë secilin send..."***[14] Ai është më i mëshirshëm se çdo gjë tjetër. E përveç kësaj, cilësia e mëshirës është edhe si veçori e porositur për njerëzimin, që ta praktikojnë atë në jetën e kësaj bote, në mënyrë që në të përtejmen të jenë të mëshiruar.

Ligjvënësi dërgoi të Dërguarin e Tij si një njeri të mëshirshëm e të ndijshëm:

لَقَدۡ جَآءَكُمۡ رَسُولٞ مِّنۡ أَنفُسِكُمۡ عَزِيزٌ عَلَيۡهِ مَا عَنِتُّمۡ حَرِيصٌ عَلَيۡكُم بِٱلۡمُؤۡمِنِينَ رَءُوفٞ رَّحِيمٞ ﴿١٢٨﴾

***"Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët."***[15] Ai ishte mëshirë për mbarë njerëzimin:

وَمَآ أَرۡسَلۡنَٰكَ إِلَّا رَحۡمَةٗ لِّلۡعَٰلَمِينَ ﴿١٠٧﴾

***"E Ne të dërguam ty*** *(Muhammed)* ***vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat."***[16]

Për ta fituar mëshirën hyjnore, duhet të jemi të mëshirshëm me krijesën njerëzore, e jo të jemi të ashpër, të egër dhe të pamëshirshëm, ndaj i Dërguari i Allahut thoshte: *"Mëshiruesit i mëshiron Mëshiruesi (Allahu). Mëshirojeni atë që është në tokë që të ju mëshirojë Ai që është në qiell..."*[17] Ndërsa në një rast tjetër ai thoshte: *"Ai që nuk i mëshiron njerëzit, atë nuk e mëshiron Zoti."*

Por përveç kësaj, legjislacioni islam ka paraparë dhe caktuar që mëshira të ekzistojë për çdo qenie të gjallë, jo vetëm për natyrën njerëzore, por ajo duhet të ekzistojë edhe për atë shtazore. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Një grua është dënuar për shkak të një maceje, e cila e lidhi atë derisa ngordhi, është hyrë në Xhehennem (për shkak të asaj), as nuk e ushqeu atë dhe as nuk e la të hajë nga insektet e tokës."*[18]

[14] Kur'ani, Araf: 156.
[15] Kur'ani, Tevbe: 128.
[16] Kur'ani, Enbija: 107.
[17] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr.1847. Sipas Albanit hadithi është autentik. Albani, Sahih ve Daif Sunenu-t Tirmidhi, nr. 1924.



Shikojeni dhe analizojeni mirë këtë thënie profetike dhe meditoni rreth saj, ku një grua do të hyjë në zjarr për shkak se nuk kishte mëshirë ndaj një mace, të cilën jo që nuk e ushqeu por edhe e pengoi të ushqehet nga insektet e mundshme të tokës. Me fjalë tjera ishte zhveshur nga parimi i mëshirës, ndaj dënimi për të do të jetë i dhembshëm. Lidhur me këtë i Dërguari i Allahut thoshte: *"Mëshira nuk braktiset vetëm se nga arroganti (i keqi)."*[19]

Pra, vetëm ai që nuk posedon mëshirë vepron të liga e marrëzi, për faktin se është zhveshur nga cilësitë e mirësisë, mirëpo i tilli do të pyetet në Ditën e Llogarisë për keqpërdorimin e mëshirës. I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Kush mbyt një shpend kot (pa nevojë), në Ditën e Gjykimit do ta ngrejë zërin (shpendi) dhe do të thotë: "O Zot, filani më ka mbytur mua kot, e nuk më ka mbytur për ndonjë dobi."*[20]

Pra këto janë skicat që ka legjislacioni islam konsideratë të madhe për to, duke e bërë parimin e mëshirës si parim fondamental që ngrihet ky legjislacion, që rrezet e mëshirës i merr drejtpërdrejt nga mëshira hyjnore e pakufishme e Krijuesit dhe urdhëron haptazi që mëshira të jetë e realizuar në këtë jetë ndaj të gjithëve, pa përjashtime.

## Parimi i nëntë: Bashkëpunimi i ndërsjellë

Legjislacioni islam është ngritur edhe mbi bazën e bashkëpunimit të ndërsjellë, duke porositur njerëzimin që të jenë në bashkëpunim ndaj njëri-tjetrit e jo të jenë të ndarë e të përçarë, ngase përçarja krijon urrejtje, urrejtja krijon luftë, e lufta mbytje. E për këtë ka sjellë një shembull të veçantë për dy fiset e hasmëruara mes vete për kohë të

[18] Transmeton Buhariu në Sahihun e tij, nr. i hadithit 2236, Muslimi në Sahihun e tij, nr. i hadithit 2619, Ibni Maxheh, nr. i hadithit 4256, dhe Daremiu 2814.
[19] Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1846; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 4291.
[20] Ibni Hibbani në Sahihun e tij, nr. 5993; Taberaniu në Mu'xhemu-l Kebir, nr. 7095.

gjatë, saqë nga një gjë e vogël krijuan luftëra e beteja të gjata që përlyen edhe historinë njerëzore, ndaj i porositi që të jenë të bashkuar dhe pas bashkëpunimit ua rikujtoi se ato dy fise ishin buzë greminës së shkatërrimit të tyre, por Allahu i bashkoi dhe ata më vonë patën një bashkëpunim të çuditshëm, pra urrejtja e dikurshme u kthye në dashuri të vërtetë. Për këtë Allahu tha:

وَٱعْتَصِمُواْ بِحَبْلِ ٱللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُواْ ۚ وَٱذْكُرُواْ نِعْمَتَ ٱللَّهِ عَلَيْكُمْ إِذْ كُنتُمْ أَعْدَآءً فَأَلَّفَ بَيْنَ قُلُوبِكُمْ فَأَصْبَحْتُم بِنِعْمَتِهِۦٓ إِخْوَٰنًا وَكُنتُمْ عَلَىٰ شَفَا حُفْرَةٍ مِّنَ ٱلنَّارِ فَأَنقَذَكُم مِّنْهَا ۗ كَذَٰلِكَ يُبَيِّنُ ٱللَّهُ لَكُمْ ءَايَٰتِهِۦ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١٠٣﴾

***"Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin** (fenë dhe Kur'anin)* ***e Allahut, e mos u përçani! Përkujtojeni nimetin e Allahut ndaj jush, kur ju** (para se ta pranonit fenë islame)* ***ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër. Madje ishit buzë greminës së xhehennemit, e Ai ju shpëtoi prej tij. Po kështu Allahu ua sqaron juve argumentet e veta që ju ta gjeni të vërtetën e lumtur."***[21]

Ky legjislacion ka urdhëruar që kooperimi dhe bashkëpunimi të jetë për të mirën dhe për të mbarën e jo për mëkate apo armiqësi, ndërkaq lidhur me këtë Ligjvënësi ka potencuar:

... وَتَعَاوَنُواْ عَلَى ٱلْبِرِّ وَٱلتَّقْوَىٰ ۖ وَلَا تَعَاوَنُواْ عَلَى ٱلْإِثْمِ وَٱلْعُدْوَٰنِ ۚ ... ﴿٢﴾

***"...Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi..."***[22]

Legjislacioni islam rregullon bashkëpunimin e ndërsjellë mes individëve, sistematizon dhe rregullon raportet e anëtarëve të familjes në mënyrë reciproke, sjell bashkëpunim mes fiseve të popullit dhe ndërmjet gjykatësit dhe të gjykuarit.[23]

[21] Kur'ani, Ali Imran: 103.
[22] Kur'ani, Maide: 2.
[23] Sabik, Sejjid, *Hasaisu-sh Sheriatu-l Islamijetu ve Mumejjizatuha*, fq. 21.



Në bashkëpunim arrihet kënaqësia e individit e ngritja e shoqërisë dhe arrihet shkalla e lartë e jetës. Në këtë bashkëpunim të ndërsjellë hyn fjala e mirëkuptimit dhe ndalimi nga e keqja. Për këtë ka urdhëruar qëmoti Krijuesi duke thënë:

وَلْتَكُن مِّنكُمْ أُمَّةٌ يَدْعُونَ إِلَى ٱلْخَيْرِ وَيَأْمُرُونَ بِٱلْمَعْرُوفِ وَيَنْهَوْنَ عَنِ ٱلْمُنكَرِ ۚ وَأُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُفْلِحُونَ ﴿١٠٤﴾

***"Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit."***[24]

Kështu grupi i krijuar që porosit Allahu në ajetin e mësipërm është për qëllim që të jetë ai për punë të dobishme dhe të mira, e kurdo që shohin vepra të liga e të pahijshme t'ua tërheqin vërejtjen kryerësve të tyre. Nëse fajtorët nuk përmirësohen atëherë ndaj tyre do të merren masa ndëshkuese, kjo bëhet për të ruajtur rendin dhe sigurinë shoqërore.

Bashkëpunimi mes individëve dhe shoqërive është i domosdoshëm, pothuajse në të gjitha sferat shoqërore, ku individi duhet të jetë përkrah individit e shoqëria përkrah shoqërisë, në punë të mira e të mbara, në udhëzim, proklamim të drejtësisë dhe vërtetësisë së saj, e nëse një individ është shkelës i parimeve të mirësisë, atëherë edhe të tjerët do të preken me virusin e tij, e kjo padyshim do të ishte një kanosje edhe për shoqërinë. Në këtë kontekst i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Besimtari për besimtarin është sikurse ndërtesa që njëra anë plotëson anën tjetër*[25]*."*[26]

Ndaj, për të qenë individë e shoqëri e shëndoshë nevojitet një bashkëpunim i ndërsjellë në të gjitha çështjet, në të kundërtën aty ku mungon bashkëpunimi i sinqertë suksesi është i limituar dhe i stagnuar.

[24] Kur'ani, Ali Imran: 104.
[25] Sikurse tjegullat që janë të ngjitura njëra pranë tjetrës dhe secila lidhet me tjetrën.
[26] Buhariu në Sahihun e tij, nr. 459, 2266, 5567; Muslimi në Sahihun e tij, nr. 4684; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1851.

## PESË QËLLIMET PARIMORE TË LEGJISLACIONIT ISLAM

Legjislacioni islam prej qëllimeve të tij primare ka ruajtjen dhe kujdesin ndaj pesë gjërave të domosdoshme, e që janë: Ruajta e fesë, individit, mendjes, pasardhësve dhe pasurisë.

Këto janë pesë parimet dhe qëllimet thelbësore që ka konsideratë të madhe legjislacioni islam, që konsiderohen interesa individuale dhe interesa shoqërore të përgjithshme pa të cilat nuk mund të ngrihet një popull, ngase janë shtyllat e një kombi.[27] Madje jeta e njeriut varet nga këto pesë qëllime kryesore, e nëse prishen ato apo disa prej tyre, do të prishet edhe sistemi i jetës, do të përhapen skandalet, krimet, do të përhapet frika, shqetësimi dhe prishja e rendit, ndaj të gjitha legjislacionet erdhën për t'u kujdesur dhe ruajtur këto qëllime, ngase me to qëndron edhe sistemi botëror, e lloji njerëzor nuk mund të jetë i drejtë dhe i sigurt gjersa të mos jenë këto qëllime, kujdesi ndaj tyre nënkupton jetë të drejtë, shoqëri të organizuar dhe popull të mirë.[28]

**Ruajtja e fesë:** ka për qëllim ruajtjen nga të këqijat, rrëshqitjet morale, shkarjet, veprat irrituese, kujdes dhe ruajtja nga epshi, e gjërave tjera që kanë për qëllim çorientimin e besimtarit në rrugë të devijuar, ndaj këshillat fetare shërbejnë për rimëkëmbjen e njeriut dhe largimin nga të këqijat.

Ruajtja e fesë nënkupton përfaqësimin e besimit të pastër e të shëndoshë, besim që është i pranuar, si dhe distancimin dhe largimin nga idiolatria, besimi në politeizëm e idhuj, si dhe distancimin nga humbjet e ndryshme dhe mashtrimet. Për këtë arsye Ligjvënësi i ka kujtuar njeriut që të përqendrohet sinqerisht në fenë e Tij të drejtë e të pastër, Ai tha:

[27] Sabik, Sejjid, *Hasaisu-sh Sheriatu-l Islamijetu ve Mumejjizatuha*, fq. 12.
[28] Sudejs, Abdurrahman, *Durus Lishejh Abdurrahman Sudejs*, ligjëratë.



فَأَقِمْ وَجْهَكَ لِلدِّينِ حَنِيفًا ۚ فِطْرَتَ ٱللَّهِ ٱلَّتِى فَطَرَ ٱلنَّاسَ عَلَيْهَا ۚ لَا تَبْدِيلَ لِخَلْقِ ٱللَّهِ ۚ ذَٰلِكَ ٱلدِّينُ ٱلْقَيِّمُ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ ٱلنَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٠﴾

***"Përqëndro vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote,*** *(e ajo fé)*, ***feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s'ka ndryshim*** *(mos ndryshoni)* ***të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë."***[29] Kjo është e vetmja fe që Ligjvënësi porosit në të:

وَإِنَّ هَٰذِهِۦٓ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَٰحِدَةً وَأَنَا۠ رَبُّكُمْ فَٱتَّقُونِ ﴿٥٢﴾

***"Kjo feja juaj është e vetmja fé e Unë jam Zoti juaj, ruajuni dënimit Tim."***[30] Dhe njëherit kjo është e vetmja fe e pranuar tek Allahu:

إِنَّ ٱلدِّينَ عِندَ ٱللَّهِ ٱلْإِسْلَٰمُ ۗ ... ﴿١٩﴾

***"Feja e pranueshme tek Allahu është Islami..."***[31] Ligjvënësi pasi ka sqaruar për fenë e Tij reale e të pranuar, ka potencuar se kush zmbrapset nga kjo fe e pranuar, e vdes si pabesimtar, atij do t'i zhduken veprat e veta në të dy botërat. Ai do ta përjetojë dënimin e tmerrshëm të botës së përtejme, ku do të qëndrojë përjetësisht në zjarr:

... وَمَن يَرْتَدِدْ مِنكُمْ عَن دِينِهِۦ فَيَمُتْ وَهُوَ كَافِرٌ فَأُو۟لَٰٓئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَٰلُهُمْ فِى ٱلدُّنْيَا وَٱلْءَاخِرَةِ ۖ وَأُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ۖ هُمْ فِيهَا خَٰلِدُونَ ﴿٢١٧﴾

***"...E kush zmbrapset prej jush nga feja e tij dhe vdes si pabesimtar, ata i kanë zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm."***[32] Madje, ai që zmbrapset nga kjo fe duke pretenduar se feja tjetër është më e mirë dhe më realiste, gabon rëndë dhe përjeton një dëshpërim të thellë

[29] Kur'ani, Rum: 30.
[30] Kur'ani, Muminun: 52.
[31] Kur'ani, Ali Imran: 19.
[32] Kur'ani, Bekare: 217.

në botën tjetër, ku atje do ta kuptojë gabimin më të madh në jetën e tij:

وَمَن يَبْتَغِ غَيْرَ ٱلْإِسْلَٰمِ دِينًا فَلَن يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِى ٱلْءَاخِرَةِ مِنَ ٱلْخَٰسِرِينَ ﴿٨٥﴾

***"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit."***[33]

Ruajtjen dhe kujdesin ndaj fesë Ligjvënësi e ka renditur njërin nga prioritetet kryesore, madje ka kërkuar edhe përhapjen e fesë pasi që ajo të jetë ngulitur thellë në shpirtrat dhe zemrat tona, si dhe të distancohemi njëherë e përgjithmonë nga risitë, mitet dhe besimet e kota dhe epshet që na sprovojnë në rrugën e mirësisë.

I Dërguari i Allahut ka hartuar skicën se si të ruhet feja, e kjo bëhet atëherë kur pasohen dy aktet kryesore të saj, ai thoshte: *"Unë u kam lënë juve (në mesin tuaj) dy gjëra që nuk do të humbni për asnjë çast gjersa mbështetni në to: Librin e Allahut dhe synetin (traditën profetike) e të Dërguarit të Tij."*[34]

Ndaj, kurdo që këto dy akte pasohen e ndiqen, robi asnjëherë s'do të jetë i humbur, por do të jetë i udhëzuar dhe në rrugë të drejtë, e nëse eventualisht robi braktis njëren apo të dy këto akte, atëherë shmangia e tij nga feja është e sigurt.

**Ruajtja e individit:** ka për qëllim ruajtjen e jetës së tij, në mënyrë që çdo të drejtë të tij që i takon, ta fitojë. Sikurse që ka për qëllim mbrojtjen e tij nga çdo akt i ashpër e agresiv. Legjislacioni islam mbron individin dhe çdo gjë që e cenon atë e konsideron mëkat, në këtë kontekst e ka ndaluar sulmin ndaj tij, pa të drejtë, madje e ka konsideruar si njërin ndër mëkatet më të mëdha, duke e krahasuar me politeizmin:

[33] Kur'ani, Ali Imran: 85.
[34] Maliku në Muvetta, nr. 1395.



۞ قُلْ تَعَالَوْا۟ أَتْلُ مَا حَرَّمَ رَبُّكُمْ عَلَيْكُمْ ۖ أَلَّا تُشْرِكُوا۟ بِهِۦ شَيْـًٔا ۖ وَبِٱلْوَٰلِدَيْنِ
إِحْسَٰنًا ۖ وَلَا تَقْتُلُوٓا۟ أَوْلَٰدَكُم مِّنْ إِمْلَٰقٍ ۖ نَّحْنُ نَرْزُقُكُمْ وَإِيَّاهُمْ ۖ وَلَا
تَقْرَبُوا۟ ٱلْفَوَٰحِشَ مَا ظَهَرَ مِنْهَا وَمَا بَطَنَ ۖ وَلَا تَقْتُلُوا۟ ٱلنَّفْسَ ٱلَّتِى حَرَّمَ
ٱللَّهُ إِلَّا بِٱلْحَقِّ ۚ ذَٰلِكُمْ وَصَّىٰكُم بِهِۦ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٥١﴾

***"Thuaj: "Ejani t'ju lexoj atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne u ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë."***[35] Madje për ata që mbysin individë apo grupe, Ligjvënësi ka përcaktuar dënim e ndëshkim të ashpër, të shoqëruar me kërcënime të mëdha:

وَمَن يَقْتُلْ مُؤْمِنًا مُّتَعَمِّدًا فَجَزَآؤُهُۥ جَهَنَّمُ خَٰلِدًا فِيهَا وَغَضِبَ ٱللَّهُ عَلَيْهِ وَلَعَنَهُۥ
وَأَعَدَّ لَهُۥ عَذَابًا عَظِيمًا ﴿٩٣﴾

***"Kush e mbyt një besimtar me qëllim, dënimi i tij është xhehennemi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur dënim të madh."***[36] Ndërsa i Dërguari i Allahut kishte thënë: *"Largohuni nga shtatë gjëra shkatërruese." E përmendi prej tyre mbytjen e njeriut që e ka ndaluar Allahu, përpos me të drejtë.*[37] Madje Ligjvënësi përveç ndalimit të mbytjes së individit pa të drejtë, mbytjen e një individi të vetëm e ka konsideruar si mbytje të mbarë njerëzimit, Ai ka thënë:

[35] Kur'ani, Enam: 151.
[36] Kur'ani, Nisa: 93.
[37] Më gjerësisht shih hadithin komplet: Buhariu në Sahihun e tij, nr. 2560, 6351; Muslimi në Sahihun e tij, nr. 129; Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 2490.

...مَن قَتَلَ نَفۡسَۢا بِغَيۡرِ نَفۡسٍ أَوۡ فَسَادٖ فِي ٱلۡأَرۡضِ فَكَأَنَّمَا قَتَلَ ٱلنَّاسَ جَمِيعٗا
وَمَنۡ أَحۡيَاهَا فَكَأَنَّمَآ أَحۡيَا ٱلنَّاسَ جَمِيعٗاۚ ... ﴿٣٢﴾

***“...kush mbyt një njeri** (pa të drejtë), **pa mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë** (krimi i tij) **është si t’i kishte mbytur gjithë njerëzit.”***[38]

E për parandalimin e kësaj dukurie, i Madhërishmi ka përcaktuar edhe dispozita të qarta e të prera, ku sipas tyre ai që mbyt dikë pa të drejtë, meriton të mbytet:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ كُتِبَ عَلَيۡكُمُ ٱلۡقِصَاصُ فِي ٱلۡقَتۡلَىۖ ٱلۡحُرُّ بِٱلۡحُرِّ وَٱلۡعَبۡدُ
بِٱلۡعَبۡدِ وَٱلۡأُنثَىٰ بِٱلۡأُنثَىٰۚ ... ﴿١٧٨﴾

***“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi për dënim për mbytje: i liri për të lirin, robi për robin, femra për femrën...”***[39] Nëse vrasësi do të lihej i lirë, atëherë kjo do të ndikonte që ai të kryejë edhe vepra tjera të ngjashme, pa u dënuar, ndaj është përcaktuar dispozita ndaj tij për të siguruar rend e qetësi, për mbrojtjen e shoqërisë, për parandalimin e krimit të tillë dhe për të penguar përhapjen e skandaleve të tilla. Por përveç kësaj, ekziston edhe dispozita e faljes nga ana e familjes së të vrarit:

... فَمَنۡ عُفِيَ لَهُۥ مِنۡ أَخِيهِ شَيۡءٞ فَٱتِّبَاعُۢ بِٱلۡمَعۡرُوفِ وَأَدَآءٌ إِلَيۡهِ بِإِحۡسَٰنٖۗ ذَٰلِكَ
تَخۡفِيفٞ مِّن رَّبِّكُمۡ وَرَحۡمَةٞۗ فَمَنِ ٱعۡتَدَىٰ بَعۡدَ ذَٰلِكَ فَلَهُۥ عَذَابٌ أَلِيمٞ ﴿١٧٨﴾

***“...Kurse atij që i falet diçka nga vëllai i vet, atëherë ajo le të përcillet** (e atij që fal) **kuptueshëm dhe shpagimi** (nga dorasi) **atij le t’i bëhet me të mirë. Kjo është një lehtësim dhe mëshirë prej Zotit***

[38] Kur’ani, Maide: 32.
[39] Kur’ani, Bekare: 178.



***tuaj. E kush tejkalon pas këtij** (pajtimi), **ai ka një dënim të hidhur.”***[40]

Këto dispozita janë shpallur dhe përcaktuar që kolektivi dhe individët të jenë të sigurt, ndaj ajeti i radhës na tregon këtë me një stil të qartë që prek mendjet tona:

وَلَكُمۡ فِي ٱلۡقِصَاصِ حَيَوٰةٞ يَٰٓأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِ لَعَلَّكُمۡ تَتَّقُونَ ﴿١٧٩﴾

***“O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni** (nga mbytja e njëri-tjetrit)**.”***[41] Këtu kuptohet urtësia e kësaj mase të dënimit, e që është ruajtja dhe kujdesja ndaj jetës së njeriut, ngase kurdo që vrasësi e di se nëse mbyt dikë kërkohet edhe mbytja e tij, atëherë ai do të jetë i kujdesshëm dhe do të frikësohet të bëjë një akt të tillë, e kjo është mbrojtje e jetës së tij dhe e jetës së atij që dëshiron mbytjen e tij, si dhe është mbrojtje e njerëzve në përgjithësi.

Kur jemi te mbytja duhet theksuar se legjislacioni islam e ka ndaluar vetëvrasjen dhe ka përcaktuar ndëshkim të ashpër kundër atyre që kryejnë një akt të tillë. I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Kush mbyt veten me (mjet) hekur, hekuri do të jetë në dorën e tij që do të drejtohet në barkun e tij në zjarr të xhehenemit, aty do të jetë përgjithmonë, e kush pi helm dhe mbyt veten ai do të (pi helm dhe) përpëlitet në zjarr të xhehenemit përgjithmonë e përjetësisht, e kush hedhet nga një kodër dhe mbyt veten, ai do të hedhet nga zjarri i xhehenemit, përgjithmonë e përjetësisht do të jetë në të.”*[42]

**Ruajtja e mendjes**: ka për qëllim ruajtjen dhe distancimin e mendjes nga çdo gjë që ndikon negativisht tek ajo, si pijet alkoolike apo drogat.[43]

Ligjvënësi ka sjellë Ligjin për ruajtjen e mendjes, ngase mendja është ajo e cila dallon të mirën nga e keqja, e për këtë arsye Ligjvënësi ka pasur për qëllim që ajo të mbetet e pastër, e dëlirë dhe të mos

[40] Kur’ani, Bekare: 178.
[41] Kur’ani, Bekare: 179.
[42] Muslimi në Sahihun e tij, nr. 158; Tirmidhiu në Sunenin e tij, nr. 1967.
[43] Sabik, Sejjid, *Hasaisu-sh Sheriatu-l Islamijetu ve Mumejjizatuha*, fq. 13.

njolloset me asgjë të keqe e të ligë. Për këtë arsye ka ndaluar edhe të këqijat që prekin thellë kthjelltësinë e mendjes. Ka ndaluar gjitha pijet dehëse dhe alkoolike, ka ndaluar drogën dhe ka ndaluar gjërat që ndikojnë negativisht në mendje. Ligjvënësi ka thënë:

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِنَّمَا ٱلۡخَمۡرُ وَٱلۡمَيۡسِرُ وَٱلۡأَنصَابُ وَٱلۡأَزۡلَٰمُ رِجۡسٞ مِّنۡ عَمَلِ ٱلشَّيۡطَٰنِ فَٱجۡتَنِبُوهُ لَعَلَّكُمۡ تُفۡلِحُونَ ﴿٩٠﴾

***“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës*** *(për fall)* ***janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.”***[44]

Më pastaj Ligjvënësi ka cekur urtësinë e ndalesës së tillë, ku thotë:

إِنَّمَا يُرِيدُ ٱلشَّيۡطَٰنُ أَن يُوقِعَ بَيۡنَكُمُ ٱلۡعَدَٰوَةَ وَٱلۡبَغۡضَآءَ فِي ٱلۡخَمۡرِ وَٱلۡمَيۡسِرِ وَيَصُدَّكُمۡ عَن ذِكۡرِ ٱللَّهِ وَعَنِ ٱلصَّلَوٰةِۖ فَهَلۡ أَنتُم مُّنتَهُونَ ﴿٩١﴾

***“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund*** *(alkoolit e bixhozit)****?”***[45]

Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut thoshte se *“alkooli është nëna e të këqijave”*[46], për faktin se alkooli është përmbledhësi i gjitha të këqijave, e i dehuri gjatë procesit të dehjes mund të bëjë gjithçka duke mos e kuptuar se çfarë ka bërë, ndaj qëndrimi i islamit ndaj alkoolit është mjaft i rreptë dhe shumë i arsyeshëm.

Legjislacioni islam ka për qëllim që mendja të mbetet në formën që është krijuar, e pastër nga çdo njollë, ndaj i pengon dhe lufton të gjitha dukuritë e shëmtuara që e cenojnë rëndë atë, e atëherë kur ajo humbet njeriun e quan të çmendur, por në një rast tjetër kur njeriu e humb vetëdijen dhe humb kontrollin, gjegjësisht humb mendjen, e

[44] Kur’ani, Maide: 90.
[45] Kur’ani, Maide: 91.
[46] Darekutniu në Sunenin e tij, nr. 4669, 4672; Taberaniu në Mu’xhemu-l Kebir, nr. 1543.



quan shtazë, e që është njeriu i dehur kur humb kontrollin dhe vetëdijen, saqë nuk di se çfarë vepron. Madje e vë në një situatë edhe më të keqe sesa shtaza, e për këtë Ligjvënësi thotë:

...لَهُمۡ قُلُوبٞ لَّا يَفۡقَهُونَ بِهَا وَلَهُمۡ أَعۡيُنٞ لَّا يُبۡصِرُونَ بِهَا وَلَهُمۡ ءَاذَانٞ لَّا يَسۡمَعُونَ بِهَآۚ أُوْلَٰٓئِكَ كَٱلۡأَنۡعَٰمِ بَلۡ هُمۡ أَضَلُّۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡغَٰفِلُونَ ﴿١٧٩﴾

***“...Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë ata të marrët.”***[47]

Mendja është ajo që njeriun e shtyn në punë të mira dhe të mbara, ndaj i thuhet njeriut që mendon mirë dhe vepron mirë ‘i mençur’. Madje në librin e Allahut shpeshherë e gjejmë fjalën ‘o të zotët e mendjes’, ‘ata që kanë mend’ e të ngjashme:

كِتَٰبٌ أَنزَلۡنَٰهُ إِلَيۡكَ مُبَٰرَكٞ لِّيَدَّبَّرُوٓاْ ءَايَٰتِهِۦ وَلِيَتَذَكَّرَ أُوْلُواْ ٱلۡأَلۡبَٰبِ ﴿٢٩﴾

**“***(Ky është)* ***Libër i begatshëm, Ne ta shpallëm ty këtë, që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.”***[48] Po ashtu thotë:

لَقَدۡ كَانَ فِي قَصَصِهِمۡ عِبۡرَةٞ لِّأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِۗ... ﴿١١١﴾

***“Në tregimet e tyre*** *(të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër)* ***pati mësime e përvojë për të zotët e mendjes...”***[49]

Gjithashtu thuhet:

إِنَّ فِي خَلۡقِ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلۡأَرۡضِ وَٱخۡتِلَٰفِ ٱلَّيۡلِ وَٱلنَّهَارِ لَأٓيَٰتٖ لِّأُوْلِي ٱلۡأَلۡبَٰبِ ﴿١٩٠﴾

***“Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt.”***[50]

[47] Kur’ani, Araf: 179.
[48] Kur’ani, Sad: 29.
[49] Kur’ani, Jusuf: 111.
[50] Kur’ani, Ali Imran: 190.

Legjislacioni islam e konsideron humbjen e mendjes si humbje të jetës së atij individi, ngase ekzistenca e jetës është e ndërlidhur ngusht me ekzistencën e mendjes dhe ruajtjen e saj, kurdo që njeriut i humb mendja, ai konsiderohet i vdekur, edhe pse ende frymon.

Mendja është veçori dalluese dhe një prej mjeteve të njohjes, kuptimit, meditimit...etj., ndaj kjo mendje është ajo që e njeh Krijuesin, njeh të mirën dhe e pason, ashtu siç e njeh të keqen dhe ruhet e distancohet nga ajo. Kështu legjislacioni islam i ka dhënë rëndësi të posaçme mendjes, duke e bërë atë rrugë të veçantë për njohjen e gjërave në gjithësi.

E sikur të mos ishte mendja, do të pushonin edhe të gjitha obligimet e kërkuara për njeriun.

**Ruajtja e pasardhësve**: ka për qëllim formimin e një gjenerate duke e ruajtur nga denigrimi, veprat shëmtuese dhe gjërat negative, me fjalë tjera ruajtja e nderit, trupit, mendjes, fesë dhe moralit.[51] Kjo arrihet atëherë kur martesa e çifteve është në baza të shëndosha dhe brenda parimeve të etikës martesore. Në këtë mënyrë pritet të jetë një shoqëri e ardhshme e ndërtuar në kritere të drejta e të qarta. Me ligjësimin e martesës, ka ndaluar shthurjet morale dhe degradimin e shoqërisë nga ana etike-morale. Ligjvënësi ka thënë:

... هُنَّ لِبَاسٌ لَّكُمْ وَأَنتُمْ لِبَاسٌ لَّهُنَّ ... فَٱلْـَٔـٰنَ بَـٰشِرُوهُنَّ وَٱبْتَغُوا۟ مَا كَتَبَ ٱللَّهُ لَكُمْ ... ﴿١٨٧﴾

***"...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato... bashkohuni me to dhe kërkoni atë që ua ka caktuar Allahu..."***[52] Ligjvënësi e bëri legjitime martesën për të mbrojtur moralin njerëzor, ngase po të mos ishte ajo legjitime do të kanosej nderi, morali dhe etika njerëzore. Shembull konkret kemi abuzimet nëpër kisha të ndryshme të shumë shteteve, ku abuzimet e ndryshme s'kanë të ndalura. Skandalet e tilla

[51] Sabik, Sejjid, *Hasaisu-sh Sheriatu-l Islamijetu ve Mumejjizatuha*, fq. 13.
[52] Kur'ani, Bekare: 187.



kanë krijuar situata delikate, e kjo padyshim që vjen për shkak se martesa ende nuk është legalizuar, ndaj në mënyrë të fshehtë praktikohet abuzimi dhe prostitucioni. Pyesim se çfarë gjenerate mund të rrjedhë prej tyre? Sigurisht gjeneratë e shthurur, e degraduar, pa vlera morale dhe e zhytur në vese dhe rrugë të këqija.

Duke pasur parasysh gjithë këto, islami thërret në martesë për parandalimin e efekteve negative, e nga martesa e mirë rrjedh fëmija i mirë që është fryt i një martese të begatshme. Shatibiu kishte plotësisht të drejtë kur tha se "martesa si qëllim primar dhe parësor e ka kultivimin e një gjenerate",[53] ndërsa Ibni Kajimi për martesën thoshte se ajo është bërë legjitime për tre arsye, e si arsye të parë përmendte këtë: "Ruajtja e gjeneratës dhe kultivimi i llojit njerëzor..."[54]

Kështu nga begatia e martesës ruhet lloji njerëzor, e braktisja e saj sjell ndërprerjen e llojit njerëzor. Por, edhe nëse braktiset martesa, epshi nuk mund të ndalet, ndaj ai do të përdoret në mënyrë të jashtëligjshme, ku si pasojë ndikon në braktisjen e foshnjave, mosdija se kush është prind i foshnjës, dhe sëmundje epidemike të shumta që kanë kapluar njerëzimin në të gjitha anët. Ndaj, martesa është preventiva më e mirë për parandalimin e epshit në vende të gabuara. Përveç kësaj, martesa sjell edhe qetësi shpirtërore, prehje, krijon dashuri dhe sjell mëshirë të ndërsjellë, e për këtë Ligjvënësi ka thënë:

وَمِنْ ءَايَـٰتِهِۦٓ أَنْ خَلَقَ لَكُم مِّنْ أَنفُسِكُمْ أَزْوَٰجًا لِّتَسْكُنُوٓا۟ إِلَيْهَا وَجَعَلَ بَيْنَكُم مَّوَدَّةً وَرَحْمَةً ۚ إِنَّ فِى ذَٰلِكَ لَـَٔايَـٰتٍ لِّقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ ﴿٢١﴾

***"Dhe nga faktet*** *(e madhërisë së)* ***e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën*** *(gratë)****, ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."***[55] Të jetuarit vetëm, pa martesë, është gjë e bezdisshme dhe e papranuar, por në rast të tillë atëherë kjo

[53] Shatibi, *El-Muvafekat*, vëll. II, fq. 396.
[54] Xhevziu, Ibni Kajjim, *Zadu-l Mead*, vëll. IV, fq. 249.
[55] Kur'ani, Rum: 21.

do të krijonte efekte negative të dëmshme për individin dhe shoqërinë, ndaj islami që në start ka qenë kundër saj dhe ka obliguar martesën.

Familja është nevojë njerëzore për ruajtjen dhe kujdesin e fëmijëve, ruajtjen e tyre nga rrëshqitjet e ndryshme dhe kujdesin maksimal për edukimin e tyre në baza të shëndosha.

Për të pasur një gjeneratë të mirë duhet që prindërit të kujdesen maksimalisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për ta, e të mos i anashkalojnë ata për asnjë çast, ngase po qe se fëmijët anashkalohen dhe braktisen, atëherë ata do të devijojnë. Ibni Omeri thoshte: "Edukoje fëmijën tënd se ti do të pyetësh si e ke edukuar dhe si e ke mësuar atë."[56]

**Ruajtja e pasurisë**: ka për qëllim fitimin e pasurisë sipas rrugëve të lejuara dhe vendosja e saj në duar të sigurta dhe pengimi i kërcënimit ndaj saj.[57] Kështu legjislacioni islam ka bërë legjitime rrugët e fitimit të pasurisë së lejuar dhe na ndaluar rrugët e fitimit të pasurisë në mënyrë të pandershme e të padrejtë, ndaj ka bërë legjitim shitblerjen dhe ka ndaluar kamatën:

... وَأَحَلَّ ٱللَّهُ ٱلۡبَيۡعَ وَحَرَّمَ ٱلرِّبَوٰاْۚ ... ﴿٢٧٥﴾

***"...Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën..."***[58] Me fjalë tjera ndalon pasurinë e paligjshme si kamatën që e cekëm, uzurpimin, vjedhjen, mashtrimin, korrupsionin, ndaj ka përcaktuar edhe masë ndëshkuese për vjedhësin duke i prerë dorën atij për shkak të ruajtjes së pasurisë së njerëzve. Ligjvënësi ka shpallur:

وَٱلسَّارِقُ وَٱلسَّارِقَةُ فَٱقۡطَعُوٓاْ أَيۡدِيَهُمَا جَزَآءَۢ بِمَا كَسَبَا نَكَٰلٗا مِّنَ ٱللَّهِۗ وَٱللَّهُ عَزِيزٌ حَكِيمٞ ﴿٣٨﴾

[56] Shih më tepër librin: Tuhfetu-l Mevdud Biahkami-l Mevlud, fq. 255.
[57] Sabik, Sejjid, *Hasaisu-sh Sheriatu-l Islamijetu ve Mumejjizatuha*, fq. 13.
[58] Kur'ani, Bekare: 275.



***"Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart, si shpagim i veprës që bënë,*** *(kjo masë është)* ***dënim nga Allahu. Allahu është i fuqishëm, ligjdhënës i urtë."***[59]

Vjedhja nuk është gjë tjetër veçse dhunim dhe keqtrajtim i pasurisë, e cila është ndër gjërat më të shtrenjta për njeriun. Ndëshkimi për prerjen e dorës së vjedhësit[60] është detyruar me qëllim parandalimin e njerëzve të tjerë nga kryerja e një veprimi të tillë. Në këtë mënyrë, çdo individ i shoqërisë do të ishte më i sigurt për pasurinë e tij, e cila, siç e thamë, është ndër gjërat më të dashura dhe më të çmuara për njeriun.[61]

Prerja e dorës nuk është krim, por është ndëshkim dhe gjobë për veprën e tij të kryer që prish rendin dhe qetësinë publike, ngase ajo vepër është abuzim në pasuritë e të tjerëve dhe veprim që cenon rëndë qetësinë shoqërore.

Kështu legjislacioni islam ka për qëllim ruajtjen e pasurisë së njerëzve, në mënyrë që ajo të mos keqpërdoret dhe të mos vidhet, e kur dënon vjedhësin apo fajtorin, duhet shikuar kolektivin dhe shoqërinë ngase ajo po mbrohet nga fajtori apo vjedhësi, pra kjo rezulton në rritjen e qetësisë dhe sigurisë publike, sikurse që rezulton në mbrojtjen e pronës së individëve nga dhunimi dhe abuzimi.

Legjislacioni islam e respekton tejmase pasurinë e individit, ngase ajo është baza e jetës dhe njerëzit kanë të drejtë të kenë pronësi, e në këtë kontekst islami ka respekt të veçantë për pronën e secilit individ dhe mbron me çdo kusht cenimin e saj nga njerëz të papërgjegjshëm, duke ndërpritur gjitha rrugët që shpien në vjedhje dhe marrje të pasurisë pa të drejtë.

Nga ana tjetër, legjislacioni islam ka përcaktuar të gjitha rrugët që fitohet pasuria në mënyrë të ndaluar, të papërgjegjshme dhe në mën-

[59] Kur'ani, Maide: 38.
[60] Sejjid Sabiku thotë: "Dora vjedhëse konsiderohet një organ i sëmurë në trupin e njeriut. Ky organ duhet të pritet, në mënyrë që pjesa tjetër e trupit të mbetet e shëndoshë. Pra, duhet sakrifikuar një pjesë për të shpëtuar trupin në tërësi." Sabik, Sejid, *Fikhus-Suneh-Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s.*, vëll.II, fq. 563.
[61] Sabik, Sejid, *Fikhus-Suneh-Legjislacioni i Traditës së Profetit a.s.*, vëll.II, fq. 432.

yrë abuzive, duke ndaluar rrugët e pandershme që shpien në fitim të pasurisë, pa mund. Kështu për ilustrim ka ndaluar shitblerjen e gjërave inekzistente,[62] të pazotëruara, gjërat e ndaluara,[63] sikurse që ka ndaluar mashtrimin nga ana e tregtarëve që ua bëjnë konsumatorëve.[64] Po ashtu ka ndaluar lojërat e fatit, bixhozin dhe të ngjashme me të, ngase janë mënyra të paligjshme të pasurisë, sikurse që ka ndaluar kamatën.

Me fjalë tjera, legjislacioni islam ka pasur konsideratën më të lartë për mbrojtjen dhe fitimin e pasurisë së njeriut, duke ia treguar gjitha rrugët e lejuara që shpien tek ajo, si dhe duke ia tregua rrugët e paligjshme që të mos trokasë në to.

[62] Si shitja e gjërave që nuk ekzistojnë, si shitja e pjellës së lopës, apo shitja e viçit të lopes që ende s'ka lindur, apo shitja e frutave që nuk ekzistojnë. Profeti thoshte: ***"Mos bleni peshkun në ujë, ngase është mashtrim."*** Ahmedi në Musnedin e tij, nr. i hadithit 3494.

[63] Si shitja e alkoolit, mishit të derrit, ngordhësirës, e të ngjashme.

[64] Si në rastet kur tregtarët u dalin njerëzve jashtë tregut për t'ia marrë gjërat më lirë, apo ia marrin mallin e ia shesin më shtrenjtë, ose lënia e kafshëve pa mjelë për disa ditë për t'i hutuar blerësit.



*Ejup Haziri*

# PRINCIPLES OF ISLAMIC LEGISLATION - (2)

## Seventh principle: brotherhood

### (Summary)

Islamic legislation has paid special attention to the concept of brotherhood.

And hold firmly to the rope of Allah (religion and the Qur'an) all together and do not become divided. And remember the favor of Allah upon you - when you (before you accepted Islam) were enemies and He brought your hearts together and you became, by His favor, brothers. And you were on the edge of a pit of the Fire, and He saved you from it. Thus does Allah make clear to you His verses that you may be guided all together and do not become divided. And remember the favor of Allah upon you - when you were enemies and He brought your hearts together and you became, by His favor, brothers. And you were on the edge of a pit of the Fire, and He saved you from it. Thus does Allah make clear to you His verses that you may be guided.

أيوب حازيري

# مبادئ التشريع الاسلامي (2)

## (خلاصة البحث)

### المبدأ السابع: الاخوة

اهتم التشريع الاسلامي كثيرا بالاخوة التي تمثل المجتمع الاسلامى و الاسلام يدافع بها في كل المجالات عن المساوي والمظاهر السلبية و حول هذا الموضوع نري القرآن الكريم يقول:

"واعتصموا بحبل الله جميعا ولا تفرقوا واذكروا نعمة الله عليكم إذ كنتم أعداء فألف بين قلوبكم فأصبحتم بنعمته إخوانا وكنتم على شفا حفرة من النار فأنقذكم منها كذلك يبين الله لكم آياته لعلكم تهتدون"

**JURISPRUDENCË ISLAME**

*Dr. Munir Xhumua*[*]

# DISPOZITAT E SHERIATIT... MES STABILITETIT DHE FLEKSIBILITETIT

Ekuilibri (baraspesha) mes çështjeve konstante (ose postulateve) dhe atyre të ndryshueshme në dispozita paraqet njërën prej veçorive më të rëndësishme të fesë Islame, gjë e cila e ka bërë atë të aftë për udhëheqjen e njerëzimit shekuj me radhë dhe e cila e sugjeron atë që të rikthehet përsëri si udhëheqëse e saj.

## I. RRETH KONCEPTIT: DISPOZITAT E SHERIATIT ISLAM NDAHEN NË DY PJESË:

**Pjesa e parë:** Dispozita fikse (konstante): rreth këtyre dispozitave nuk mund të bëhet ndonjë hulumtim, ato nuk pranojnë reformë apo zhvillim. Ato janë dispozita të cilat kanë ardhur përmes teksteve të prera-definitive (në transmetim dhe domethënie), ose përmes një analogjie reale gjatë tre shekujve të parë të artë. Dispozitat e tilla nuk ndryshohen me kalimin e kohës apo ndryshimin e vendit. Argument për këtë stabilitet nga Kur'ani është ajeti, ku thotë Allahu xh.sh.: ***“Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta** (çka lajmërojnë) **dhe plot të***

[*] Profesor në Universitetin “Ummul-Kura” në Mekke.



***drejta** (çka gjykojnë). **S'ka kush që të ndryshojë fjalët** (vendimet) **e Tij. Ai është që dëgjon e di.”*** Kaptina, el-En'am:115., ndërsa argumenti nga thëniet e të Dërguarit të Allahut xh.sh. është hadithi, të cilin e transmeton Ebu Derdaja r.a. i cili thotë se Pejgamberi a.s ka thënë: ‘*Atë çfarë Zoti e ka lejuar në librin e Tij ajo është e lejuar (hallall), ndërsa atë çfarë e ka ndaluar Ajo është e ndaluar (haram), ndërsa për ato çështje që nuk ka folur fare ajo është një lehtësim, andaj pranojeni prej Zotit këtë lehtësim sepse Zoti nuk harron, më pas e lexoi këtë ajet*: ***“Zoti yt nuk është që harron.”***[1] Kaptina, Merjem: 64.

Këto lloje dispozitash në legjislacionin Islam quhen: dispozita konstante.

**Pjesa e dytë:** dispozita të cilat janë subjekt i interpretimit, opinionit dhe shqyrtimit, ato përfshijnë dy anë.

**E para:** ngjarjet e reja për të cilat nuk ka tekst, interpretimi i tyre përmes analogjisë, el-mesleha el-murseles, (Interesit të përgjithshëm e të padefinuar sheriatikisht) istihsanit (Rezonimit të bazuar në preferencë juridike) apo ndonjë burimi tjetër është i lejuar për të nxjerrë një dispozitë të përshtatshme, me kusht që kjo dispozitë të nxirret nga njerëzit të cilët janë kompetentë.

**E dyta:** të ashtuquajturat dispozitat supozuese-spekulative (el-ahkam edh-dhannijje) për nga transmetimi ose domethënia. Këto dispozita pranojnë interpretimet njerëzore dhe të tillat quhen me emrin: dispozita të ndryshueshme, apo çështje-dispozita, të cilat janë subjekt i reformave dhe zhvillimit.

## Jurisprudenca-fikhu është prodhim njerëzor!

Mund të themi se pandryshueshmëria dhe ndryshueshmëria janë përshkrim i dispozitave e jo i teksteve, siç mund të themi gjithashtu se lloji i parë i dispozitave përbëjnë sheriatin, dhe në të njëjtën kohë llojin e dytë mund ta quajmë jurisprudencë-fik'h. Andaj, sheriati është prodhim i pastër hyjnor pa ndërhyrje të njeriut në te, ndërsa jurispru-

[1] Transmeton Imam el-Hakimi dhe ibn Maxhe, ndërsa haditologu Nasrudin Albani thotë se është hadith autentik.

denca-fik'hu është prodhim njerëzor, ku përmes saj juristët orvaten për të arritur deri te dispozitat e Krijuesit. Ajo thjesht është një orvatje, e cila përmban në vete edhe suksesin edhe dështimin, sepse asnjëri nuk është i mbrojtur nga gabimet pas pejgamberëve të Zotit.

## II. BAZAT MBI TË CILAT MBËSHTETET IDEJA E STABILITETIT (PANDRYSHUESHMËRISË SË DISPOZITAVE):

**1. Burimi hyjnor:** shoqëria nuk është autore apo themeluese e programit hyjnor, në mënyrë që ai program t'u nënshtrohet apo t'u përshtatet rrethanave të saj, por ky program buron nga Krijuesi fuqiplotë, dhe detyra e njeriut është që ta pranojë atë dhe t'i përgjigjet atij, ***"Dhe nuk është për besimtarin dhe besimtaren-kur Perëndia dhe Pejgamberi i Tij e caktojnë një gjë-ata të bëjnë zgjedhje në atë gjë."*** Kaptina, el-Ahzab:36.

**2. Stabiliteti i natyrshmërisë:** përderisa kjo natyrshmëri është ***"feja e All-llahut në të cilën i krijoi njerëzit"*** dhe e cila në thelbin e saj nuk ndryshon nga një periudhë në periudhën tjetër apo nga një popull në popullin tjetër, dhe sa do që të evoluojnë detajet dhe çështjet dytësore, kjo prapëseprapë nuk tejkalon çështjen e të qenit një llojllojshmëri për të hapur rrugën drejt pesë çështjeve-parimeve mbi të cilat Krijuesi e ka mbështetur sigurinë e gjendjes së njeriut në këtë botë dhe lumturinë e tij në botën tjetër, ato janë: mbrojtja e fesë, jetës, mendjes, gjinisë dhe pasurisë.

**Stabiliteti i Islamit është i lidhur me stabilitetin e gjuhës**

**3. Stabiliteti i gjuhës:** stabiliteti i Islamit në themelet-bazat e tij të përgjithshme është i lidhur me stabilitetin e gjuhës, në mënyrë që të jetë e mundur vendosja e koncepteve dhe kuptimeve bazike, pa shkaktuar boshllëk mes përdorurit gjuhësor bazë dhe formës e domethënies së tij, sepse dispozita mbështetet mbi një koncept real, prandaj domethënia e Namazit (es-salah) në aspektin terminologjik-sheriatik nuk mund të ndryshojë, gjithashtu as domethënia e Zeqatit, Haxhit



dhe Agjërimit, sepse këto adhurime kanë një koncept stabil, i cili nuk ndryshon me ndryshimin e kohës.

## III. ARSYET JUSTIFIKUESE TË EKZISTIMIT TË FLEKSIBILITETIT DHE ZHVILLIMIT NË LEGJISLACIONIN ISLAM

**1. Zhvillimi i jetës dhe përtëritja e saj**: njeriu është në një gjendje të vazhdueshme kërkimi për sekretet e jetës dhe për të fshehurën, e cila i ekspozohet atij herë pas here. Krijuesi fuqiplotë ka thënë: ***"E juve ju është dhënë fort pak dije"*** Kaptina, el-Isra:85, andaj njeriu nuk duhet të vetëkënaqet me atë që di dhe të jetë i bindur se karshi dijes së tij ekziston një dije tjetër dhe ai duhet ta kërkojë gjithherë atë ***"dhe thuaj: Zoti im, më shto dituri"***. Kaptina, Ta'Ha: 114. Kur'ani famëlartë në shumë tekste ka cekur fazat e jetës dhe fshehtësitë e universit: ***"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai*** *(Kur'ani)* ***është i vërtetë."*** Kaptina, Fussilet:53. Gjithashtu në Kur'an ka aludim, për shembull, edhe për zhvillimin dhe avancimin e mjeteve të transportit: ***"Edhe kuajt*** *(i krijoi)*, ***edhe mushkat edhe gomarët, për t'ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijon*** *(për hipje)* ***çka ju*** *(tash)* ***nuk dini."*** Kaptina, en-Nahel: 8.

**2. Universaliteti i fesë Islame:** Feja islame ka ardhur për të gjithë njerëzit dhe popujt, andaj duhet që patjetër të jetë e aftë për zgjidhjen e të gjitha nevojave përcjellëse të këtyre popujve, në përputhje me civilizimet, të cilat jetojnë nën hijen e saj, në realizimin e interesave të ligjshme që evoluojnë dhe përtëriten në çdo kohë dhe vend, në themelimin e legjislacioneve të përshtatshme dhe të duhura për çdo shoqëri duke u mbështetur në njohuritë e ekspertëve të lëmive përkatëse.

## IV. SFERAT-FUSHAT E DISPOZITAVE KONSTANTE NË LEGJISLACIONIN ISLAM:

### 1. Bazat, shtyllat, parimet-konceptet themelore, ligjet konstante dhe teoritë themelore

- *Bazat (el-Usulu)* përfshijnë çështjet e besimit (el-akaid), si p.sh. gjashtë shtyllat e besimit, faktin se besimi (akidja) e vërtetë me të gjitha shtyllat e saj janë kusht për vlefshmërinë dhe pranimin e veprave, faktin se fe e vetme e pranuar te Zoti është feja Islame, faktin se lidhja e pranuar për bashkimin e njerëzve është bindja (akidja) e jo toka, ngjyra apo gjuha, këto janë disa baza konstante, të cilat nuk ndryshojnë me kalimin e kohës përveç që forcohen dhe bëhen më të qëndrueshme.

- *Shtyllat dhe parimet-konceptet themelore*: për këtë si shembull mund të përmendim parimin e drejtësisë, ajo është një bazë konstante, e cila i rregullon marrëdhëniet në shtëpi, në shtet dhe në gjykatë. Gjithashtu parimi i konsultimit, të cilin Zoti e ka përmendur si një atribut konstant për besimtarët në bazë të të cilit duhet të veprojnë vazhdimisht, pastaj parimi i barazisë në të drejta dhe detyrime para ligjit dhe zbatimit të dispozitave, etj.

- *Ligjet konstante hyjnore:* si shembull mund të përmendim: konfliktin mes të vërtetës dhe së kotës, siç thotë Allahu xh.sh. në Kuran: ***“Dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve, do të shkatërrohej toka”.*** Kaptina, el-Bekare:251. ky është një ligj konstant, i cili nuk ndryshon. Në çdo kohë gjejmë përkrahës të së vërtetës dhe përkrahës të së kotës dhe konflikti mes tyre është i vazhdueshëm, mirëpo e vërteta, me ndihmën e Zoti, shfaqet dhe triumfon ndërsa e kota humb.

- *Teoritë themelore:* si shembull mund të përmendim sistemin familjar, i cili mbështetet mbi parimin e martesës ligjore e jo mbi tradhtinë bashkëshortore (kurvërinë), atë se përgjegjësia në shtëpi bie mbi



bashkëshortin, mirëkuptimi dhe mirësjellja mes bashkëshortëve, ligjshmëria e shkurorëzimit..etj.

Ndërsa në sistemin ekonomik gjejmë këto çështje konstante: ndalimi i kamatës, ndalimi i fitimit të papastër, obligueshmëria e zeqatit. etj.

Gjithashtu në sistemin penal ekzistojnë disa çështje të pandryshueshme, si p.sh: mbytja e vrasësit me qëllim, prerja e dorës së hajdutit. Pejgamberi a.s. e kishte refuzuar ndërmjetësimin në ndëshkime dhe kishte thënë: *“Sikur Fatimja e bija e Muhamedit të vidhte do t’ia preja dorën e saj”*.

### 2. Çështjet e adhurimit (ibadetet) dhe vlerat morale - stabilitet në adhurime dhe moral

- *Adhurimet* në fenë Islame nuk ndryshojnë në formën e tyre, siç është forma e sexhdes, forma e rukusë, agjërimi dhe koha e tij, mënyra e veshjes së ihramit dhe bërjes së tavafit, sasia e dhënies së zeqatit..etj.

- *Morali themelor* i shoqërisë siç është: ndershmëria, besnikëria, dëlirësia, turpi, dhënia e përparësisë, gjithashtu edhe rregullat e mirësjelljes siç janë dhënia e selamit (përshëndetja) respektimi i të moshuarit etj. Të gjitha janë virtyte, pa të cilat asnjë shoqëri e ndershme nuk mund të krenohet.

Me këtë që u tha deri më tani bëhet e qartë se stabiliteti i jep njerëzimit bilancin e drejtë dhe të qëndrueshëm, tek i cili rikthehet njeriu sa herë t’i shfaqet atij ndonjë mendim, ide apo perceptim, dhe qëndron vazhdimisht në një rreth të sigurt, i cili e mbron atë nga humbja dhe devijimi. Ky bilanc i shoqërisë Islame janë parimet konstante në bazë të të cilave gjykojnë shoqëria dhe udhëheqësit në mënyrë të barabartë, për të shpëtuar nga mjerimi në të cilin kanë rënë shoqëritë, të cilat kanë startuar nga aspekti i besimeve dhe perceptimeve themelore për gjithësinë dhe jetën, duke ndryshuar perceptimet dhe referimet e tyre ashtu siç i ndryshojnë rrobat e tyre varësisht shtëpive të modës, aq sa parimet në mendjet e tyre janë shndërruar në prapambeturi! Si-

pas supozimit të tyre! ***“Kjo ishte një nga argumentet e Allahut. Atë që e udhëzon Allahu, ai vërtet është udhëzuar, e atë që e humb, ti nuk do të gjesh për të ndihmës që do ta udhëzonte.”*** Kaptina, el-Kehf:17.

## V. Sferat-fushat e fleksibilitetit dhe zhvillimit në legjislacionin Islam

Realisht ana fleksibile e legjislacionit Islam e ka bërë atë në gjendje që të përshtatet, të ballafaqohet me zhvillimin dhe të përputhet me çdo rrethanë të re, sa që nuk ndodh diçka e re përveç se do të gjesh që legjislacioni Islam ka një rregull për atë, ose përmes ndonjë teksti të prerë ose përmes hulumtimit (ixhtihadit). Në këtë mënyrë ai nuk e ngushton hapësirën për risitë të cilat ndodhin dhe për nevojat e njerëzve dhe interesat e tyre.

## Harmonizimi (përshtatja) mes kontradiktave

Gjithashtu pranimi i idesë së zhvillimit dhe fleksibilitetit nga ana e sistemit Islam dhe bashkimi mes tij dhe mes çështjeve konstante ka çuar deri te njohja apo pranimi i kontradiktave shoqërore, të cilat ekzistojnë në jetë, dhe t’i llogarisë ato (si negative dhe pozitive) mjete-instrumente të bashkëpunimit dhe integrimit e jo të konfliktit dhe luftërave duke besuar se e vërteta është e ndarë në dy pjesë dhe ato dy pjesë mund të integrohen me bashkimin e tyre: individi dhe shoqëria, materia dhe shpirti, mendja dhe zemra. Legjislacioni Islam e sheh të domosdoshme ekzistimin e këtyre kundërthënieve, të cilat cilësohen si kontradikta dhe mes të cilave bën një harmonizim-përshtatje.

Ndërsa sa i përket pikëpamjes-opinionit perëndimor, ai para renesancës besonte në stabilitetin në të cilin ftonte Aristoteli. Më pastaj ata morën teorinë e Darvinit, e cila flet për evoluimin biologjik, si pikënisje për ndryshimin shoqëror në të cilin ftoi Herbert Spencer dhe shkolla e tij. Më pastaj filozofia perëndimore bëri një zhvendosje-transferim të rrezikshëm atëherë kur Hegeli e shfaqi teorinë e tij mbi ndryshimin absolut karshi idesë së kontradiktës dhe konfliktit, dhe kjo



është filozofia materialiste, e cila është bërë fe e qytetërimit perëndimor në kohën e tanishme.

Ndërsa sa u përket çështjeve të ndryshueshme në legjislacionin Islam, arena e tyre është si më poshtë:

**- Çështjet dytësore dhe degët të cilat bazohen mbi argumente supozuese** (delil dhannijj). Siç është rasti me dallimin në sasinë-numrin e ushqimit me gji të cilat e bëjnë martesën të ndaluar. Disa kanë thënë se mjafton vetëm një gjidhënie, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se duhet të jenë pesë gjidhënie. Gjithashtu dallimi mes dijetarëve rreth shkurorëzimit me tri shprehje në një vend se a llogaritet një shkurorëzim apo tre shkurorëzime? Mund të ndodhë që për çështje të tilla i njëjti jurist të ndryshojë mendimin për shkak të ndryshimit të kohës dhe vendit, duke u bazuar në parimin i cili thotë: *“Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave me ndryshimin e kohës”*.

**- Metodat dhe mjetet:** p.sh. ideja e rikuperimit të tokës mund të realizohet me mjete të shumta e të ndryshme, dhe këto mjete me kalimin e kohës zhvillohen dhe evoluohen, ndërsa në ditët e sotme përdoren edhe satelitët për të zbuluar se ku mund të gjenden thesaret në tokë apo në det, etj. Gjithashtu për të arritur njeriu deri te një shpërblim ka rrugë dhe mjete të ndryshme, prej tyre: vizita e të sëmurit, lehtësimi i vështirësive, kërkimi i diturisë, etj. Gjithashtu realizimi i parimit të konsultimit nuk është i kufizuar vetëm me një formë, nuk është e ndaluar që të përdoret ndonjë metodë më e avancuar me kusht që të ndodhë konsultimi.

Me këtë feja Islame ka vërtetuar se nuk është vetëm fe e përshtatshme për çdo kohë dhe vend, por ajo njëkohësisht është edhe reformatore e çdo kohe dhe vendi, sepse ajo buron nga Krijuesi: ***“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë”.*** Kaptina, el-Mulk: 14.

*Përktheu dhe përshtati në gjuhën shqipe:*
***Vedat Shabani***

Burimi: http://www.hadielislam.com/arabic/index.php?pg=articles/article&id=35683

*Dr. Munir Xhumua*

## The provisions of the Sharia... between stability and flexibility

### (Summary)

The equilibrium between basic principles (or postulates) and other principles represents one of the most important features of Islam, which has enabled it to lead mankind for centuries.

*د. منير جمعة*

## أحكام التشريع الاسلامى بين الاستقرار والمرونة

### (خلاصة البحث)

التوازن بين المسائل الثابتة (أو المسلمات) و المتغيرة في التشريع يمثل واحدا من أهم سمات الإسلام والتي جعلته قادرا على قيادة البشرية لعدة قرون والتي تشير الى امكانية للعودة مرة أخرى.

**AKAID**

*Dr. Mustafa Ceriq*

# INFLUENCA E MATURIDIUT

Nëse madhështia e një teologu do të matej nga sasia e shënimeve biografike dhe historike rreth tij lidhur me jetën dhe arritjet e tij intelektuale, emri i El-Maturidiut nuk do të zinte ndonjë vend të lartë në listën e teologëve të mëdhenj myslimanë. Por, nëse kjo madhështi do të matej me origjinalitetin e ideve dhe metodës teologjike të tij, El-Maturidiu paraqet njërin prej kandidatëve më serioz për vendin e parë në atë listë.

El-Maturidiu nuk e fitoi namin e tij në mesin e teologëve ortodoksë, as përmes famës së mësuesve të tij, as përmes përpjekjes së nxënësve të tij. Por, ai fitoi namin për shkak të arritjeve të tij intelektuale dhe origjinalitetit të tij teologjik. Për sa i përket teologjisë islame, asnjëri prej mësuesve, për të cilët kemi folur në kapitullin e parë, nuk mund të krahasohet me mësuesin e El-Esh'ariut, El-Xhubba'iun, ose me mësuesin e El-Gazaliut, El-Xhuvejniun, për sa i përket aktivitetit teologjik dhe popullaritetit në mesin e mutekelimunëve.

Sa u përket nxënësve të drejtpërdrejt të El-Maturidiut, katër prej tyre janë më të spikatur, kurse ata janë: Ebu El-Kasim Is'hak El-Samerkandi, i njohur si El-Hakim Es-Samerkandi (vd. 340/951), Ali El-Rustughaniu (vd. 350/961), 'Abd El-Kerim b. Musa El-Bezdeviu (vd.



390/1001), dhe Ebu El-Lejth El-Buhariu (data vdekjes e panjohur). Vetëm dy prej tyre kanë shkruar libra.

El-Hakim Es-Samerkandi shkroi:

a) Akidet El-Imam;

b) Sherh El-Fikh El-Ekber;

c) Es-Sawad El-A'dham, dhe

d) Risalah fi bejan enne el-iman xhuz' min islam. Kurse,

Ali el-Rustughfaniu shkroi:

a) Kitab El-Irshad el-muhtedi;

b) Kitab El-Zewa'id we 'l-fewaid fi enwa' el-ulum;

c) Kitab El-Khilaf;

d) El-Es'ileh we el-exhwibeh

Përpos veprat *Es-Sawad El-A'dham*, dhe *Risalah fi bejan enne el-iman xhuz' min islam* të El-Hakim Es-Samerkandit dhe veprës *El-Es'-ileh we el-exhwibeh* të El-Rustaghfaniut, asnjëra prej këtyre veprave nuk është ruajtur. Që të dyja, edhe *El-Sewad El-A'dham* edhe *Risalah fi bejan enne el-iman xhuz' min islam* janë botuar[1], ndërsa *El-As'ileh we'l-exhwibeh* gjendet vetëm si dorëshkrim[2]. Vepra *El-Sewad* është vepra më e vjetër teologjike në përputhje me shkollën maturidite. Në të El-Hakim Es-Samerkandi ka zhvilluar 62 pohime besimore, moszbatimi i të cilave do të thotë se njeriu nuk i përket shumicës së myslimanëve (Es-Sewad el-a'dham), një ide të cilën ai e bazoi në një hadith.[3]

Edhe pse "Es-Sewad el-a'dham" nga El-Hakim Es-Samerkandi mund të ketë kontribuuar në përhapjen e pikave kryesore të doktrinës së El-Maturidiut, unë nuk mendoj që ajo përfaqëson një vlerësim të mirëfilltë të ideve thelbësore teologjike të El-Maturidiut. Unë nuk mendoj që El-Maturidiu do të kishe qenë shumë i kënaqur me idenë e 62 pohime besimore, për shkak se, me gjasë, mund të ketë më shumë se aq, dhe për shkak të orientimit të tij që të merret me çështjet teologji-

---

[1] Shih, GAS, fq. 606.

[2] Sipas GAS (versioni arabisht), [fq. 382] një dorëshkrim i kësaj vepre gjendet tek Murad Mula 1829 (154a-176b, kopjuar në shekullin e dhjetë të hixhretit).

[3] Cf. Rotter, Islam XVIII, 41.

ke në mënyrë edukative, e jo në mënyrë indoktrinuese, siç ishte, qartazi, qëllimi i El-Hakim Es-Samerkandit.

Por, një vlerësim më serioz i mendimit teologjik të El-Maturidiut filloi më tepër se një shekull më vonë nga Fahr el-Islam ‘Ali El-Bezdeviu (vd. 482/1089)[4] dhe u vazhdua nga një numër i madh i mjeshtërve të maturidizmit.

Këta në vijim janë emrat dhe veprat e interpretuesve dhe promovuesve të shkollës teologjike të El-Maturidiut:

1. Sadr El-Islam Ebu El-Jusr Muhammed El-Bezdeviu (vd. 493/1099)[5]
   - Usul ad-Din
2. Ebu El-Mu’in Mejmun b. Muhammed El-Mekhuli En-Nesefiu (d. 508/1114)[6]
   - Tebsirat el-edil-leh
   - Temhid li kawaid et-tewhid
   - Bahr el-kelam
3. Nexhm Ed-Din Umer En-Nesefi Mufti Eth-Thekalejn (vd. 537/1145)[7]
   - El-Akideh en-Nesefijjeh (thuhet që ai shkroi rreth 100 libra)
4. Alauddin Ebu Bekr Muhammed Es-Samerkandi (vd. 540/1145)[8]
   - Tuhfat el-fukaha
   - Sherh Te’wilat ehl es-sunnah
5. Nur Ed-Din Ahmed Es-Sabuni (vd. 580 / 1185)[9]
   - El-Hidajeh
   - El-Bidajeh fi usul ed-din
   - Kitab el-‘umdeh
6. Hafiz Ed-Din Ebu El-Berekat ‘Abdullah En-Nesefiu (vd. 710/1310)[10]

[4] Ali el-Bezdeviu shkroi veprën Usul el-Bezdevi, cf. Fawa’id, fq. 124.
[5] Cf. Fawa’id, fq. 188.
[6] Ibid., fq. 116-117.
[7] Ibid., fq. 149-250.
[8] Ibid., fq. 157.
[9] Ibid., fq. 42; Murteda, II, fq. 3.
[10] Fawaid, 102.



   - El-Umdeh
   - El-I’timad (Sherh El-Umdeh)
7. Ubejdullah Sadr Esh-Sheri’ah El-Mahbubi (vd. 747/1348)[11]
   - Ta’dil El-Ulum
   - Kitab Et-Tewhid
8. Ala’ Ed-din Abdulaziz El-Bukhariu (730/1329)[12]
   - Keshf el-esrar
9. Ali El-Sejjid Eshl-Sherif El-Xhurxhani (vd. 816 / 1413)[13]
   - Et-Ta’rifat
   - El-Mewakif
10. Kemal Ed-Din Muhammed ibn El-Humameh (vd. 861/1455)[14]
   - El-Musajereh fi el-kawa’id el-munxhijeh fi el-ahireh
11. Ahmed b. Sulejman Er-Rumi Shams ed-din Kemal Pasha (940/1533)[15]
   - Texhrid et-texhrid
   - Tehafut el-felasifeh li Hawaxh Zadeh
12. Ali b. Sulltan Muhammed El-Mekki Mulla Ali El-Karij (vd. 1014/1605)[16]
   - Sherh ala El-Fikh El-Ekber
13. Kemal ed-din Ahmed El-Bejadiu (vd. 1083/1672)
   - Isharat el-meram min ibarat el-imam
14. Hasan Kafia Prushçak Bosnewiu (vd. 1025/1616)
   - Rewdat el-xhennet fi el-i’tikadat

Padyshim, secili prej këtyre dijetarëve të shquar hanefitë ka kontribuuar shumë sipas mënyrës së tij në përhapjen, të kuptuarit dhe zgjerimin e pikëpamjeve teologjike të El-Maturidiut. Por, me sa duket, “El-Akideh En-Nesefijeh” e Nexhmudin En-Nesefiut i parapriu

[11] Ibid., fq. 109-110.
[12] Shih, Ala’el-Din ‘Abdulaziz, Keshf el-Esrar ‘an Usul Fahr el-Islam el-Bezdevi, (Dar el-Kitab el-‘Arabi, Bejrut, 1934/1974).
[13] Ibid., fq. 165.
[14] Ibid., fq. 180.
[15] Ibid., fq. 21.
[16] Cf. El-Ta’likat el-Sunnijeh ‘ala el-Fewa’id el-Behijjeh, fq. 8.

këtij aktiviteti. Edhe pse jo qartazi e ndërlidhur me El-Maturidiun, edhe metodologjia edhe përmbajtja e veprës së tij padyshim lë gjurmë në ndikimin e tij. Kjo vepër ishte përmbledhëse, elokuente dhe sintetike. “El-Akideh” jo vetëm që u bë libër mësimor për maturiditët, por po ashtu tërhoqi shumë dijetarë esh’aritë, shembulli më i mirë i të cilës është esh’ariu Et-Taftazaniu, i cili shkroi një komentim të gjatë mbi të. Vepra tjetër pas kësaj për nga rëndësia, për elaborimin e doktrinës së El-Maturidiut, është “Tebsiret el-edil-leh” nga Ebu Muin En-Nesefiu (është e botuar). Prandaj, përmes veprave të këtyre dy nesefitëve dhe të tjerëve prej dijetarëve të sipërpërmendur hanefitë, doktrina e sunnizmit u furnizua me elementin vital të maturidizmit, procedura dhe struktura e të cilit do të kishte qenë tërësisht ndryshe pa të.

## a) Maturidizmi

Është fakt i njohur në mesin e studentëve të Islamit, që shkenca e fikhut reprezenton modelin më të hershëm për veprimtarinë kulturore islame në përgjithësi. Duke u përpjekur për krijimin e një komuniteti mysliman të bazuar në ligjin e etikës dhe moralitetit islam, dijetarët e hershëm e panë fushën e jurisprudencës të jetë aspekti më i rëndësishëm i kësaj shoqërie etike myslimane të presupozuar. Meqë kryesisht praktik në qëllimin e tij, studimi i hershëm i fikhut, në përmbajtjen e tij po ashtu përfshinte aspektet e nevojshme teorike të teologjisë islame. Shkurtimisht, shkenca e hershme e fikhut përmbante të gjitha perspektivat e jetës fetare teorike dhe praktike të myslimanëve.

Të ballafaquar me probleme të ndryshme që jeta i paraqitte dhe me mundësi të ndryshme teorike dhe praktike për zgjidhjen e atyre problemeve, juristët e hershëm mësuan të tolerojnë pikëpamjet kundërshtare dhe kështu të jenë sinkretikë në qasjet e tyre lidhur me çështjet e ndryshme fetare. Prandaj, prania e katër shkollave ligjore, së bashku me dy të tjera më pak të rëndësishme, d.m.th. ajo shi’ite dhe dhahirite, nuk ishte asnjëherë vërtet problem për ortodoksizmin islam. Përcaktimi për malikizmin, hanefizmin, shafi’izmin ose hanbelizmin, dhe në shkallë më të ulët për shi’izmin dhe dhahirizmin, ishte, dhe ende konsiderohet, i natyrshëm në mesin e myslimanëve ortodoksë. Në fakt, sa u përket çështjeve të fikhut, zyrtarisht nuk ka mysliman heretik. Mirëpo, ky nuk ishte rasti me teologjinë islame. Duke nisur qysh me herezinë e Abdullah b. Saba'as, pastaj me atë të Mu'bed El-Xhuheniut (vd. 80 h.), Gheilan El-Dimeshkiut (125 h.), Xhehm b. Safwanit (vd. 128 h.) dhe të tjerëve, teologjia islame ka qenë gjithmonë me qëndrime kontraverse, akuzime dhe kundërakuzime. Por, me gjasë, ndodhia më e theksuar që i ndihmoi këto pikëpamje të papajtueshme teologjike të zhvillohen, ishte përvetësimi i teologjisë racionaliste të mu’tezilëve nga El-Me’muni në fillim të shekullit të dytë të Islamit, dhe, si pasojë tentimi i tij për të imponuar me forcë doktrinën mu’tezilite mbi myslimanët përmes fuqisë së shtetit.



Siç është e ditur, kjo teologji e imponuar nga shteti nuk mbijetoi gjatë. Sidoqoftë, u zëvendësua me një teologji po aq jotolerante të tradicionalistëve. Prandaj, në kontekstin e këtyre fakteve të historisë islame dhe për shkak të nevojës për një qasje të balancuar teologjike, studiuesit seriozë myslimanë duhet të ndërmerrnin krijimin e një perspektive sintetike të teologjisë sunnite. El-Maturidiu në lindjen e largët, El-Esh’ariu në mes, dhe Et-Tahaviu në perëndimin e largët të perandorisë myslimane në shekullin e nëntë-dhjetë, ishin të besueshëm dhe të përshtatshëm për këtë detyrë. Qysh prej emergjencës së këtyre tre teologëve të mëdhenj sunnitë besohet vendosmërisht që mendimi teologjik islam është ruajtur prej polit të djathtë të tradicionalistëve dhe prej polit të majtë të racionalistëve. Por, përbrenda shembullit të fikhut, myslimanët ortodoksë e kishin të mundur, brenda kornizës së punës së këtyre tre dijetarëve, të përvetësojnë pikëpamje specifike të njërit prej këtyre teologëve ose prej tjetrit e madje edhe t'i integrojnë pikëpamjet e të gjithë atyre në pikëpamjet e tyre të veçanta teologjike. Prandaj, teologjia islame më në fund u lirua nga barra e herezisë dhe, ashtu si jurisprudenca islame, u furnizua plotësisht me ajër ashtu që të mund të merrte frymë lirshëm në zonën e vetë të kufizuar. Observimi i Ejub Aliut, që për dallim nga esh’aritët pas El-Esh’ariut, maturiditët nuk shtuan asgjë substanciale në mendimin

teologjik të El-Maturidiut, është korrekt. Për të mbështetur këtë, ai dha tre shpjegime:

1.) Maturiditët ishin më shumë të preokupuar me çështjet e fikhut sesa ato të kelamit dhe nuk ishin mirë të stërvitur në kelam që të shtojnë diçka të re në të.

2.) Burimi i mendimit teologjik hanefito-maturidit ishte bërë nga Ebu Hanife dhe pastaj u përkrye nga El-Maturidiu, në të cilën pak mund të shtohet, ndërsa në fakt El-Esh’ariu vetëm nisi bazat e teologjisë së tij që duhej përfunduar nga pasardhësit e tij, dhe;

3.) Kundërshtimi ndaj esh’arizmit edhe nga mu’tezilët edhe nga hanbelitët kërkonte kërkime të mëtutjeshme më të thella nga esh’aritët për qëllim të mbrojtjes së esh’arizmit.[17] Të gjitha këto shpjegime mund të merren parasysh. Mirëpo, unë mendoj që arsyeja më e vërtetë pse esh’arizmi i esh’aritëve është ndryshe dhe më i avancuar sesa mendimet e vetë (Ebu Hasan) El-Esh’ariut, ndërsa maturidizmi i maturiditëve është identik me atë të El-Maturidiut, qëndron në faktin që qëndrimet teologjike të El-Esh’ariut *për se* nuk kanë sistem metodologjik të përcaktuar, ndërsa ato të El-Maturidiut përfundimisht e posedojnë, siç kemi parë në lëndën e studimit tonë. Me fjalë të tjera, El-Esh’ariu ishte më shumë indoktrinues teologjik sesa edukues teologjik, ose, ai ishte më i interesuar t’u tregojë njerëzve çka të besojnë sesa si të besojnë. Nga ana tjetër, El-Maturidiu e zhvilloi një sistem të arsyetimit teologjik që i dha pasuesve të tij direktivë përmes së cilës ata gjithmonë mund të kërkojnë për mundësi të reja doktrinore dhe prapë të mos dalin nga shtegu i veçorive kryesore të doktrinës së tij.

Pikërisht për shkak të këtij fakti ne e shohim shkakun për zhvillimin e maturidizmit përbrenda kornizave të mendimit teologjik sunnit. Dhe, unë guxoj të them, po të mos kishte qenë për shkak të rivalitetit mes shafi’itëve dhe hanefitëve, si dy shkollat më tradicionalo-racionale, dhe po të mos kishte qenë për faktin që El-Maturidiu jetoi larg prej qendrës së perandorisë islame, maturidizmi do të kishte mbizotëruar

[17] Cf, Ali, fq. 387-390.



në mesin e shumicës së teologëve myslimanë. Në fakt, një shqyrtim i thellë në teologjinë e Esh’ariut dhe të Maturidiut, dhe një krahasim serioz i tyre me mendimet teologjike edhe të esh’aritëve e edhe të maturiditëve të mëvonshëm do të tregojë se sa e afërt, pothuajse identike, është metoda teologjike e El-Maturidiut, me metodën e të gjithë atyre teologëve, dhe në anën tjetër, sa e mangët është metoda e El-Esh’ariut. Prandaj, nëse jemi duke kërkuar një teolog, i cili dha drejtimin më të mirë për metodologji në teologjinë islame, si ajo e Esh-Shafiut në jurisprudencën islame, El-Maturidiu padyshim është kandidati më i përshtatshëm për këtë nderim.

Nëse dëshirojmë të përmbledhim ndikimin e mendimit teologjik të El-Maturidiut për teologjinë ortodokse islame, ne me vendosmëri do të thoshim që vjen prej teorisë së tij të njohjes, aftësisë së tij për ta sintetizuar traditën dhe arsyen dhe prej besnikërisë së tij të thellë ndaj dogmave qendrore islame.

## b) Një perspektivë moderne teologjike

Është e mahnitshme sa produktivë kanë qenë dijetarët myslimanë të shekullit të dytë, tretë, katërt dhe pestë të Islamit, në të gjitha fushat e aktivitetit intelektual, dhe është edhe më e çuditshme si myslimanët e kohëve moderne kanë humbur kontaktin me këtë trashëgimi të pasur intelektuale, që është pashembullt sipas të gjitha standardeve në histori. Kjo është në veçanti e vërtetë për teologjinë islame. Jo vetëm që pak myslimanë kanë mundësi t'i ofrojnë arenës botërore të mendimit ide të reja teologjike, por po ashtu vetëm pak veta janë me të vërtetë të mishëruar me madhështinë e së kaluarës së tyre. Sigurisht, disa myslimanë e lavdërojnë këtë trashëgimi historike të Islamit ditë e natë, por pak përfitojnë nga përvoja e madhe e paraardhësve të tyre. Ata ndonjëherë shkojnë aq shumë në të kaluarën, saqë humbin gjurmët e kthimit në të tashmen dhe të planifikimit për të ardhmen. Ata duhet të mësojnë prej trashëgimisë së kaluar në vend që të lavdërojnë atë verbërisht dhe pakuptim. Ata duhet të jetojnë, mendojnë dhe punojnë siç kanë bërë paraardhësit e tyre në kohën e tyre. Edhe pse më shumë se

një mijëvjeçar larg prej kohës sonë, qasja teologjike e El-Maturidiut mund të aplikohet për problemet tona dhe zgjidhjet e tij mund të na japin një kuptim të vërtetë të sintetizimit të traditës me arsyen. Për më tepër, mënyra e tij natyrale, pa paragjykime dhe e sinqertë e të menduarit është shembull për t'u ndjekur i një dijetari mysliman të ndershëm dhe serioz. Sensi i tij për analizë dhe syri kritik prej dijetari, mund të tërheqë madje edhe dijetarët më seriozë të kohëve tona. El-Maturidiu nuk shkruan për të kënaqur apo konvertuar, as për të impresionuar apo tërhequr aty për aty lexuesin e tij, por në fakt ai shkruan sepse Zoti i dha atij mendjen për të menduar dhe për arsye sepse ka shumë gjëra në këtë botë mbi të cilat duhet reflektuar.

Prandaj, nuk është i habitshëm fakti që mendimi teologjik i njërit prej mendimtarëve më të mëdhenj myslimanë, Muhamed Abduhu, mund të identifikohet lehtësisht me atë të El-Maturidiut. Prandaj, El-Maturidiu, e jo El-Esh'ariu, duhet të jetë modeli për një perspektivë serioze moderne ortodokse teologjike. Për shkak se mendimi teologjik i El-Maturidiut nuk është kontravers, as politik dhe është më natyral dhe edukativ sesa ai i El-Esh'ariut.[18]

*Përktheu:*
***Fatih Ibrahimi***

[18] Përkthimi i kapitullit IV të doktoraturës së Dr. Mustafa Ceriq, Roots of Synthetic Theology in Islam, ISTAC, Kuala Lumpur, 1995, fq. 227-235.



*Dr. Mustafa Ceriq*

## THE INFLUENCE OF AL-MATURIDI

### (Summary)

If the greatness of a certain theologian were to be measured by the number of writings on his life and his intellectual achievements, the name of Al-Maturidi would not be high in the list of Muslim theologians. But, if it were to be measured by the originality of one's ideas and theological methods, Al-Maturidi would represent one of the most serious candidates for the first position in that list.

*د.مصطفى تسريش*

## تأثير الماتوردي

### (خلاصة البحث)

اذا تم قياس عظمة عالم دين من خلال كمية البيانات السيرية والتاريخية المتعلقة بحياته وإنجازاته الفكرية لن يأخذ اسم الماتوردي الصدارة في قائمة علماء الدين المسلمين. و لكن لو كانت هذه العظمة ستقاس بأصالة أفكاره و طريقته فى شرح المسائل العقائدية يمثل الماتوردي أحد أجدى المرشحين ليقود تلك القائمة.

**KUMTESË**

*Dr. sc. Nehat Krasniqi*

# REFLEKSE TË TRADITËS KULTURORE TË VENDLINDJES NË PERSONALITETIN E HASAN EFENDI NAHIT

Hasan efendi Nahi lindi në Gjakovë më 12 mars të vitit 1905. Rrjedh nga një familje me traditë arsimore edukative, fetare dhe kombëtare, si nga vija gjenealogjike e të et, po ashtu edhe nga vija gjenealogjike e së ëmës. I ati i tij ishte myderriz Islam efendiu (1865-1929)[1]. Gjyshi i Hasan efendiut ishte haxhi Jahja i biri i mulla Osmanit i biri i mulla Ibrahimit i biri i haxhi Hasanit[2]. Gjyshi i Hasan Efendiut, nga e ëma Bajram Jusuf Doli (1833-1917) gjithashtu i përket lagjes së intelektualëve. Ai ka merita të jashtëzakonshme për ruajtjen

[1] Sipas të dhënave me shkrim të Hasan Islam Nahit, të datës 1.03.1986, të cilat bashkë me librin me titull ”Multeka’l-ebhur” ia dhuroi Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Këto të dhëna, për shkak të rëndësisë që kanë për jetëshkrimin e të atit të Hasan Efendiut, Islam Efendiun, po ia bashëngjesim këtij punimi si faksimil. (Shih faksimilin nr. 3).

[2] Këto të dhëna gjenealogjike për paraardhësit e Hasan Efendiut i kemi gjetur të shkruara nga i ati Islam Nurudin, në vitin 1326 H./ 1908 në një mexhmua në dorëshkrim të vakufuar në Bibliotekën e Medresesë së Madhe të Gjakovës nga bibliofili dhe vakifi i pashoq i dorëshkrimeve, haxhi Hasan Xhiha.



e shkrimeve shqipe me alfabet arab në Kosovë. Ishte mësimdhënës, libërlidhës (muxhelit) dhe kopjues i palodhshëm dorëshkrimesh[3].

Pas mbarimit të mësimeve fillestare, Hasan efendiu i vijoi studimet në Medresenë e Madhe në Gjakovë, ku mori ixhazet (diplomë) nga i ati, njëherësh profesori i tij, Islam efendiu, më 20 shtator të vitit 1928[4].

Pas diplomimit, dy vjet punoi asistent në Medresenë e Madhe të Gjakovës dhe nga shtatori i vitit 1930 vazhdoi studimet në Universitetin Ez’her në Kajro, ku ndoqi ligjëratat nga dijetarë të shquar, prej të cilëve Hasan efendiu ka veçuar Shejh Muhamed Nexhîb El-Mutʽî, autor i shumë veprave dhe Shejh Jusuf ed-Dexhevi, filozof i shquar islam[5].

*Faksimile të Ixhazetnamesë së Islam ef. Nahit*

[3] Nehat Krasniqi, **Vasijetnameja e Mulla Dervish Pejës,** Në: Studime Orientale, 2, Prishtinë 2002, f. 15, shënimi 9.

[4] Shih faksimilin e ixhazetnamesë së Hasan efendiut, bashkangjitur këtij punimi.

[5] Ixhazetnameja e Raif Fehmi i biri Mustafa Fejzullah Prizrenit, lëshuar nga Hasan efendi Nahi, myderriz në Medresenë Mehmet Pasha në Prizren, (pa vit lëshimi).

Pas diplomimit në Ez’her, në vitin 1934 Hasan efendiu u kthye në vendlindje dhe prej vitit 1935 e deri kur u pensionua në vitin 1978, punoi në një varg punësh dhe detyrash, si predikues fetar në teren (sejjar vāiz), myderriz në medresenë e Ferizajt, myderriz në medresenë Mehmet Pasha në Prizren. Nga viti 1943 Këshilli i Naltë i Sheriatit, me seli në Tiranë, e emëroi Hasan efendiun Kryemyfti të Zonës së Prizrenit dhe drejtor të Medresesë Mehmet Pasha, ku punoi deri në mbylljen e sajë nga organet e pushtetit jugosllav në vitin 1948. Dhjetë vjet punoi imam dhe predikues në Gjakovë, pastaj nga viti 1958 deri në vitin 1978 punoi profesor në Medresenë “Alaudin” në Prishtinë. Pas pensionimit përktheu nga arabishtja në shqip Kur’anin e madhërishëm dhe e botoi në Prishtinë në vitin 1988. Vdiq në Prishtinë, më 5.02.1991.

Personaliteti i Hasan efendi Nahit, gjithsesi është produkt i ndikimeve të drejtpërdrejta e të tërthorta të traditës kulturore të vendlindjes. Prandaj, njohja e kësaj tradite ka rëndësi parësore për ta njohur dhe për ta kuptuar më mirë profilin e personalitetit të Hasan efendiut dhe karakterin e tij.

Gjakova gjatë shekujve 18, 19 e deri në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit 20, ka qenë përfaqësuesja më tipike e një qendre kulturore, në të cilën tradita fetare dhe tradita kombëtare shqiptare janë zhvilluar të pleksura aq harmonishëm në mes veti në të gjitha format e vetëdijes shoqërore, që vetvetishëm e bëjnë këtë qytet një qendër veçanërisht të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare. Më shumë se për një traditë kulturore të konsoliduar në Gjakovë gjatë periudhës së përkufizuar më lartë, ka mjaftë elemente që na japin dorë të flasim për praninë e një qarku kulturor specifik të cilin do ta quanim ***Qarku Kulturor i Gjakovës***. Këtë qark kulturor e karakterizon vetëdija e lartë për trinomin **arsim - fe - atëdhe.**

*Faksimilet e Ixhazetnamesë së Hasan ef. Nahit*

Për zhvillimin e këtij qarku kulturor, Gjakova në radhë të parë i detyrohet familjes fisnike Kurtpasha apo Kryeziu, siç u mbiemërua më vonë. Oxhaku i Kryezinjve nga fundi i shek. XVII dhe sidomos në fillim të shek. XVIII, kur ky oxhak sikundër edhe tre oxhaqet tjera të Kosovës së sotme, oxhaku i Mahmut-begollëve të Pejës, oxhaku i Rrollave të Prizrenit dhe oxhaku i Gjinollëve të Prishtinës e Gjilanit, fitoi të drejtën e trashëgimit familjar të posteve, ofiqeve dhe gradave të larta, gjë që iu mundësoi atyre një fuqizim ekonomik dhe politik të paparë deri atëherë në Kosovë. Kjo i mundësoi familjes fisnike Kurtpasha (kryeziu) që të ndajë një pjesë të konsiderueshme të pasurisë dhe ta shpenzojë për qëllime bëmirësie (hajrate) në fushën e superstrukturës arsimore edukative dhe fetare, në Gjakovë dhe më gjerë.

Një ndër investimet më të rëndësishme, mbase edhe më i rëndësishmi, që bëri kjo familje fisnike në Gjakovë, është ndërtimi dhe vakëfimi i **Medresesë së Madhe**, e njohur në burimet osmane si **Me-**

**drese-i atîk** dhe si **Medrese-i atîk Murad paşa**. Kjo medrese, sipas të dhënave të pakontestueshme që kemi në dispozicion, është ndërtuar nga dera fisnike e Kurtpashëve - Kryezive të Gjakovës në vitin 1707[6]. Këtë institucion të lartë arsimor e ndërtoi dhe e vakëfoi Murad Begu (pastaj Pasha) i biri i Adem Pashë Gjakovës. Murad begu, kësaj medreseje i bashkëngjiti edhe objekte tjera përcjellëse, përfshirë këtu edhe vakëfe ekonomike fitimprurëse, nga të cilat paguheshin mësimdhënësit dhe personeli në përgjithësi, si dhe mirëmbaheshin objektet fetare dhe edukative arsimore, përfshirë edhe medresenë. Vakifi gjithashtu u kujdes që të siguronte libra për bibliotekën e medresesë së tij, duke blerë dhe duke kopjuar edhe vet tekste të nevojshme, disa nga të cilat janë ruajtur edhe sot. Nga një shënim i Murad begut në veprën në dorëshkrim, "El-Hidâje fī sherhi'l-Bidaje" kuptojmë se ai këtë e kishte blerë nga një prizrenas i quajtur Jusuf efendi, në vitin 1708[7]. Murad begu bashkë me shokë të tjerë, në vitin 1710 ka kopjuar një dorëshkrim që ruhet në bibliotekën e Gazi Husrev Beut në Sarajevë (Nr. 700). Kopjimin e këtij dorëshkrimi e ka bërë nga kopja personale e Ali Efendi Perës, kadi dhe myderriz në Gjakovë. Një dorëshkrim tjetër që kemi në dorë, të cilin e ka shkruar myderrizi Jahja efendiu i biri i Jusuf efendi Gjakovës në vitin 1828 në Medresenë e Madhe, konfirmon se kjo medrese, njihej me emrin e ndërtuesit të sajë, si **Medreseja e vjetër e Murad Pashës** *(Medrese-i atîk Murad Paşa).*

Medreseja e Madhe e Gjakovës shquhej për nga niveli i lartë intelektual i myderrizëve të sajë, që nga të parët Ali efendiu dhe Yvejs Efendiu e këndej. Në këtë medrese kanë dhënë mësim edhe këta dijetarë e myderrizë gjakovarë: Jahja efendiu i biri i Jusuf efendiut, Ismail Efendiu e biri i Uvejs efendiut, Hasan efendi Shllaku i biri i Mehmed

[6] Autorë që janë marrë më parë me historikun e kësaj medreseje, kanë dhënë vite tjera të ngritjes së saj, Madžida Bečirbegović, **Prosvjetni objekti islamske arhitekture,** në: "Starine Kosova", VI-VII, Prishtina, 1972-1973, f. 90, ka dhënë vitin 1794. Vitin e ngritjes së kësaj medreseje e kemi gjetur në Divanin e Sylejman Axhiz Babës, në kopjen që ruhet në Teqenë e Sheh Banit, një fotokopje të së cilës e kam në dorë.

[7] Dorëshkrimi, është vepër e Burhanuddin Ali b. Ebu-Bekr el-Margjinani el-Hanefi (vd. 593 H./1196). Ky dorëshkrim, bashkë me tërë bibliotekën e Hasan efendiut, i është dhuruar Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës nga pasardhësit e Hasan efendiut, pas vdekjes dhe sipas premtimit të tij. Është koleksionuar në Sektorin e Dorëshkrimeve të BKUK-së me nr. të signaturës D.A. 186.



efendiut (vd.1911)[8], Iljaz efendiu i biri i Muhamedit i biri i Ismail efendiut (vd. 1920), Seid efendiu, Islam efendiu i biri Jahja Mulla Osmanit (vd. 1929), Hasan efendi Nahi (12.03.1905-5.02.1991) dhe myderrizi i fundit i sajë, nga viti 1930 deri në vitin 1948 kur edhe u mbyll, ka qenë Fahri efendi Iljazi (1903-1985).

Në fillim të shek. XIX, rreth vitit 1807, d.m.th. rreth njëqind vjet pas Medresesë së Madhe, u hap Medreseja e Vogël e Gjakovës, e njohur në burime të shkruara osmane si Medrese-i xhedîd (Medreseja e Re). Myderrizi i parë i kësaj medreseje, ka qenë Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova (lindi rreth vitit 1770, vdiq rreth vitit 1850). Ai ka qenë shkrimtar, poet, myderriz dhe njëri nga intelektualët tonë më të angazhuar me shkrime dhe veprimtari pedagogjike, në gjysmën e parë të shek. XIX[9]. Myderrizë tjerë të kësaj medreseje kanë qenë: Ali efendi Mici, Haxhi Ali - Myrteza Luzha, Haxhi Emin efendi Hoxha, Fetah efendi Buza, Haxhi Jusuf efendi Çarkaxhiu, Bajram Jusuf Doli, Hafiz Ibrahim Pallaska, Jahja efendi Bakalli etj.

Mbështetur në plan-programet mësimore të këtyre medreseve, si dhe në nivelin mjaftë të lartë profesional dhe intelektual të profesorëve (myderrizëve) që jepnin mësim në to, gjë që pasqyrohet në veprat e tyre të mbetura në dorëshkrime, mund të konkludojmë se këto medrese kanë krijuar një shtresë intelektuale fetare e akademike të admirueshme. Në këto medrese janë kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, fushash dhe disiplinash të ndryshme fetare, shkencore, e letrare, përfshirë edhe letërsinë shqipe alhamiado.

Edhe pse tekstet mësimore dhe literatura profesionale në medresesë e Gjakovës, sikurse edhe në mbarë Perandorinë osmane ishin në arabishte, osmanishte dhe persishte, shpjegimi i mësimeve në këto medrese bëhej në gjuhën shqipe. Lidhur me këtë, ish studentë të medreseve të Gjakovës, duke bërë krahasim midis medresesë e famshme Mehmet Pasha në Prizren dhe Medresesë së Madhe në Gjakovë, kanë deklaruar se ***"Po nuk dite turqisht në medresenë e Prizrenit, nuk ke mundur të***

[8] Abdullah Belegu, **"Târih'ul-Vukūāt"** (Kronikë në dorëshkrim),fl.65B.

[9] Më gjerësisht shih punimin tim: **Tahir efendi Boshnjaku – Gjakova,** Në: **Edukata Islame,** nr.88, Prishtinë: 2009, f.31-58.

***kuptosh mësimet, anasjelltas, për Medresenë e Madhe në Gjakovë: po nuk dite shqip nuk ke mundë të kuptosh mësimet në te”[10].***

Futja e gjuhës shqipe në medresetë e Gjakovës, qoftë përmes letërsisë shqipe alhamiado dhe qoftë përmes shpjegimit të mësimeve në këtë gjuhë, i ka dhënë kulturës shqiptare dimensione të kulturës shkollore. Kjo ka prodhuar efekte shumë pozitive në zhvillimin kulturor të masave popullore shqiptare, jo vetëm në Gjakovë dhe rrethinë, por edhe më gjerë.



Këtë libër, me titullin: "Myltekal-ebhyr" dhe me komentimin e tij - me titullin: "Damadi", po ia dhuroj Bibliotekës Popullore e Universitare, në Prishtinë.

Ky libër ishtë përdorë nëpër gjyqet e ish-Perandorisë Osmane, e në të cilin janë përfshirë të gjitha dispozitat ligjore që i përkasin gjyqeve.

Për rëndësinë e madhe të tij, ky libër ka zgjuar interesim të dukshëm dhe ishtë përkthyer edhe në gjuhën frëngjishte.

E, Islam Efendi Nahi, këtë libër e ka ligjëruar (ua ka mësuar) nxënësve-studentëve të Medresës së Madhe, në Gjakovë.

Duke ua shpjeguar (mësuar) studentëve këtë libër, e me thellimin në komentimin e tij, Islam Efendiu - ka bërë shënime e shpjegime plotësuese, duke shfrytëzuar,- me atë rast, literaturë të pasur nga kjo lëmi. E, këto plotësime, Ai i ka shkruar me dorën e vet - për anash tekstit të shtypur.

Islam Efendi Nahi, ka qenë i lindur në Gjakovë, në vitin 1865, e ka vdekur në vitin 1929, në Gjakovë.

Shkollimin fillor dhe atë të lartë (Medresën e Madhe), e ka kryer në Gjakovë. Në Medresën e Madhe, ka ndjekë ligjëratat e të mirënjohurit dijetar të teologjisë - Hasan Efendi Shllakut,-i cili, n'atë kohë - ka pasur titullin akademik Reus, që i përgjigjet titullit të sotëm: doktor i teologjisë.

Në vitin 1903, Islam Efendiu ishtë emëruar - caktuar për ligjërimin e lëndës që u përmendë në fillim - sipas librit "Dyrer". Kjo dëshmon për dijeninë e tij të madhe, meqë ky libër ka qenë tekst universitar në Universitetin e Stambollit.

Prishtinë, më 1.05.1986

Dhuruesi - i biri tij,
Hasan Islam Nahi
profesor i teologjisë,
i diplomuar në Universitetin Al-Azhar, në Kajro.

*Faksimili i dëshmisë së Hasan ef. Nahit për dhurimin e veprës "Multeka el-Ebhur" Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës*

Në këto medrese kanë vijuar mësimet edhe studentë nga viset jashtë Kazasë së Gjakovës, përfshirë edhe viset e Sanxhakut. Në Sanxhak, madje mbretëronte bindja se pa e mësuar këndimin e Kur’anit në Gjakovë, nuk mund të bëheshe imam. Njëri nga studentët sanxha-

[10] Pleurat Krasniqi, **Aspekte kulturo-historike të Gjakovës dhe ixhazetlinjtë 1870-1940,** Gjakovë, 2002, f. 22.



kas që u diplomua në Medresenë e Madhe në Gjakovë ishte Ibrahim efendi Paçarizi (1852-1922) i lidur në fshatin Bilçë, i njohur tash me emrin Bioç, i cili gjendet në mes të Akovës (Bjello Polje) dhe Beranës (Ivangrad) në anën e djathtë të lumit Lim. Ibrahim efendiu ka shkruar vepra poetike në gjuhën boshnjake dhe në gjuhën shqipe. Siç ka shkruar për te Alija Bejtiq, ***“Gjakova ka pasur shumë rëndësi për arsimimin e tij, sepse në medresenë e këtij vendi, përveç tjerash, ka zotëruar turqishten dhe shqipen me shkrim dhe konvezacion”.*** Ibrahim efendi Paçarizi në Gjakovë mësoi nga Seid efendi Gjakova dhe nga Ismail efendiu, të cilët edhe i lavdëron me një kaside të shkruar në vitin 1904, ku ka përdorë pseudonimin poetik Ashki[11].

Myderrizët e medreseve të Gjakovës kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare. Veprimtarët më të dalluar politik nga radhët e myderrizëve të Gjakovës, janë Hasan Hysni efendi Shllaku i biri i Muhamed efendiut, myderriz kryesor në Medresenë e Madhe dhe veprimtar politik shqiptar me ndikim, pjesëmarrës aktiv në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)[12] dhe në Lidhjen Shqiptare të Pejës “Besa Besë” (1899)[13], Ali efendi Mici, myderriz në Medresenë e Vogël dhe pjesëmarrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit[14], Ismail efendi Yvejsi, muderriz në Medresenë e Madhe dhe veprimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit[15], e të tjerë. Është dokumentuar qartë roli i myderrizëve gjakovarë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen Shqiptare të Pejës “Besa Besë”, si dhe në të gjitha ngjarjet me rëndësi kombëtare gjatë *kryengritjeve të mëdha* në Kosovë, para shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Aktivitetin e tyre politik, shumë dijetarë e myderrizë gjakovarë e paguan me internime në Anadolli, nga Porta e Lartë. Një dëshmi për këtë na sjell gazeta

[11] Alija Bejtić, **Kasida Ibrahima Biočaka Spomenik aljamiado literature sandžačkih Muslimana,** Në: Anali Gazi Husrev-begove biblioteke, Knjiga IV, Sarajevo, 1976, f. 163.

[12] Masar Rizvanolli, **Dega e Lidhjes Shqiptare në Gjakovë**, Në: Konferenca Shkencore e 100-Vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, I, Prishtinë, 1981, f.218.

[13] Ismet Dërmaku, **Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Pejës “Besa Besë” (Dokumente)**, Prishtinë, 1997, f. 90.

[14] Iljaz Rexha, **Lidhje e Prizrenit në Dokumente Osmane (1878-1881),** Prishtinë, 1978, f. 139.

[15] Po aty, f.73; Masar Rizvanolli, **Dega e Lidhjes...** Pun. cit. f.218.

"Drita" që botohej në Sofje nën drejtimin e Shahin Kolonjës. Në nr.70 të vitit 1905 kjo gazetë shkruante: ***"Majshim shum uzdaj n'to por tash e morëm vesh fort mir qi Baba Dovleti po dashka me na gzue tue na dergue kah nji kah nji syrgyn n'Anadoll si myderrizat e Gjakoves e të Pejës, e të tjerë të Prizrenit! Çe kishtu e ksi sojt do me na gzu neve dhelpna plak Baba Dovleti".***

Dijetarët dhe myderrizët e shquar të Gjakovës, kanë lënë emër të mirë për vete dhe për vendlindjen e tyre. Disa prej tyre madje arritën majat më të larta të famës edhe në kryeqendrën e Perandorisë Osmane. Ideologu i shquar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Sami Frashëri, në fjalorin e tij enciklopedik Kamus al-Alam, në sythin "Jakova" (Gjakova) ndër të tjera shkruan: *"Şehir ehālīsi her vakıt meşhūr ülemā yetişir ve müderrisleri zararsız olduğu gibi, ikmali tahsıl içün Derseādet'te gelenleri de çoktur."* ***"Nga banorët e këtij qyteti gjithmonë kanë dalë dijetarë të shquar dhe, ashtu siç iu përshtatet myderrizëve, ka shumë nga ata që vijnë edhe në Stamboll për të plotësuar shkollimin"[16].*** Ndërsa, po në këtë vepër, në sythin "Arnavutllar" (Shqiptarët), Samiu duke vënë në dukje zgjuarsinë dhe etjen e madhe të shqiptarit për dituri, gjatë historisë së tyre, para dhe në kohën e Perandorisë Osmane, veçon **Ali efendi Gjakovën** dhe **Hoxha Tahsinin,** si dy nga dijetarët shqiptarë më të mëdhenj të kohës së tij, që kishin arritur shkallën më të lartë të diturisë[17].

Hasan e fendi Nahi ka qenë një pasardhës i denjë **Qarkut Kulturor të Gjakovës.** Trinomin **arsim-fe-atdhe** e ka pasur lajtmotiv dhe orientim jetësor. Jeta e tij, preokupimet, angazhimet dhe vepra e tij, e karakterizojnë Hasan efendiun si pasardhës të fundit të këtij qarku kulturor. Një dëshmi e veçantë për këtë karakterizim është biblioteka e Hasan efendiut. Kjo bibliotekë numëron 852 njësi bibliografike, prej të cilave 782 janë libra të rrallë dhe revista dhe 70 dorëshkrime në katër gjuhë, në arabishte, osmanishte, persishte dhe në shqipe me alfabet arab. Biblioteka si tërësi dhe në veçanti koleksioni i dorëshkrimeve, paraqesin një thesar jashtëzakonisht të çmuar të trashëgimisë kulturo-

[16] Sh. Sami Frasheri, Kamūs al-alam, VI, Istanbul, 1889, f. 4786-4787.
[17] Sh. Sami Frasheri, Kamūs al-alam, I, Istanbul, 1889, f. 147.



re shqiptare dhe më gjerë. Kjo bibliotekë, sipas dëshirës së Hasan efendiut, të shprehur edhe publikisht në Medresenë "Alaudin" në vitin 1987 me rastin e Takimit të Gjeneratës së parë të medresantëve, i është dhuruar Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, duke u bërë kështu një referencë e rëndësishme për kërkimin shkencor. Merita për këtë iu takon edhe familjarëve dhe pasardhësve të Hasan efendiut që quan në vend dëshirën e tij.

Një element tjetër që hedh dritë në personalitetin e Hasan efendiut, në vazhdën e punëve të tij atdhetare, është edhe angazhimi i tij në detyrën e Kryemyftiut të Zonës së Prizrenit, i emëruar nga Këshilli i Naltë i Sheriatit, me seli në Tiranë, në vitin 1943. Nga ky angazhim është ruajtur një fetva e Hasan efendiut në gjuhën shqipe, e cila paraqet një dëshmi me interes jo vetëm për Hasan efendiun si nismëtar i administratës shqipe në Kosovë në fushën e fetvasë, po edhe më gjerë për këtë administratë. Duke qenë një fetva me interes, po e botojmë në formë faksimili.




*Faksimile e një fetvaje të dhënë nga Hasan ef. Nahi si kryemyfti i Prizrenit (autograf)*

*Dr. sc. Nehat Krasniqi*

## REFLECTIONS OF THE CULTURAL TRADITION OF HASAN EFENDI NAHI'S BIRTHPLACE ON HIS PERSONALITY

**(Summary)**

Hasan effendi Nahi was born in Gjakova, on March 12, 1905. He was born in a family of rich educational, religious and national tradition. His father was muderiz Islam efendi (1865-1929). Hasan's grandfather was hajji Jahja, the son of mullah Osman, the son of mullah Ibrahim, the son of hajji Hasan. His maternal grandfather was Bajram Jusuf Doli (1833-1917). He too was a distinguished intellectual. Hasan effendi Nahi has merits for the preservation of Albanian texts, written in Arabic letters. He was a teacher, a bookbinder (mujelit) and an industrious copy maker of manuscripts.

*د. نحات كراسنيكي*

## ردود الفعل للتقاليد الثقافية لبيئة المولد فى شخصية حسن أفندي ناهي

**(خلاصة البحث)**

ولد حسن أفندي ناهي في مدينة جاكوفا في 12 مارس 1905 و هو من العائلة عرف بتقليد تعليمية و دينية و وطنية و ذلك سواء من سلالة أبه و أمه. و كان أبوه الإمام إسلام أفندي (1865–1929) مدرسا أما جده كان الحاج يحي ابن الامام عثمان ابن الامام ابراهيم ابن الحاج حسن. و جده من الأم بايرام يوسف دولي (1833–1917) كذلك من المفكرين و له دور بارز في حفظ المخطوطات و بقية الكتابات الألبانية مع الأبجدية العربية في كوسوفا و هو كان معلما و مجلدا و ناسخا لا يكل للمخطوطات.

KUMTESË

*Qemajl Morina*

# KONTRIBUTI I MULLA SADRI EF. PRESTRESHIT NË EDUKIMIN E BREZAVE TË RI

**(17 tetor 1917 - 16 janar 2002)**

Përpjekjet e Bashkësisë Islame për ta ndriçuar të kaluarën e figurave më të njohura fetare dhe kombëtare, të cilët lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë tonë janë një obligim i yni që ua kemi borxh brezave të mëparshëm. Për arsye se sikur mos të ishin përpjekjet e tyre titanike për ta ruajtur identitetin tonë fetar dhe kombëtar, vetëm Allahu i madhërishëm do ta dinte se cili do të ishte fati i ynë sot?!

Në këtë aspekt, pa dyshim se rol të veçantë luajtën xhamitë, mejtepet dhe medresetë si vatra të arsimit fetar islam. Po në të njëjtën kohë nuk duhet harruar edhe kontributin e madh që dhanë ulematë tanë gjatë historisë tonë prej disa shekujsh.

Në këtë drejtim vlen të përmendim edhe gjeneratën e ulemave, të cilët vepruan në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, e cila konsiderohet prej periudhave më të vështira të historisë sonë fetare dhe kombëtare.

Pa mëdysheje se prej këtyre figurave, është imami dhe myderrizi ynë i respektuar, Mulla Sadri ef. Prestreshi, i cili jetoi dhe veproi në periudhën e ndryshimeve të mëdha që u bënë në trojet shqiptare, në gjysmën dytë të shekullit njëzet.

## Përgatitja shkollore

Mulla Sadri Prestreshi u lind më 17 tetor 1917, në katundin Mazgit, në rrethin e Prishtinës. Mësimet fillestare i kreu në Obiliq.

Si shumë bashkëkohanikë të tij të asaj kohe, më 1930 u regjistrua në Medresenë “Pirinaz” të Prishtinës, ku mësoi te myderrizët e njohur, Mulla Hamdi ef. Gërçina dhe Mulla Ahmed ef. Mardoçi.

Pas përfundimit të Medresesë, në vitin 1944, caktohet imam në xhaminë e fshatit Dobrajë e Madhe në rrethin e Lypjanit, kurse më vonë shërbeu edhe si mësues po në të njëjtin fshat.

## Anëtarësimi në NDSH

Në fillim të vitit 1946, kur forcat partizane-çetnike sapo e kishin konsoliduar pushtetin, ndër kohë që ndaj popullit shqiptar silleshin me egërsi, Mulla Sadriu u inkuadrua në organizatën ilegale NDSH, (Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar) që përpiqej për çlirimin e Kosovës e bashkimin me Shqipëri.

Pasi u zbulua nga oficerët e OZN-ës jugosllave, më 15 prill të vitit 1947, Gjyqi Ushtarak i Divizionit të Prishtinës, pas hetimeve, maltretimeve, e dënoi hoxhën, Mulla Sadriun, me katër vjet burgim.

Burgun e filloi në Prishtinë, për ta vazhduar në Mitrovicë, Nish dhe e përfundoi në Pozharevac.

Pasi lirohet nga burgu u ballafaqua me peripeci të shumta sa i përket punësimit, qoftë si hoxhë apo mësues.

## Rikthimi në gjirin e Bashkësisë Islame

Pas një pritjeje të gjatë, edhe pse Kosova kishte nevojë për shërbimet e tij, ai emërohet mësues në Shkollën Fillore të Obiliqit, për t’u transferuar pastaj në fshatin Korroticë, të Drenicës.

Pas shumë peripecish e transferimeve prej fshati në fshat, në vitin 1962, Mulla Sadri ef. Prestreshi, emërohet imam, dhe hatib në Xhaminë e Madhe, apo e njohur si Xhamia e sulltan Fatihut në Prishtinë.

Rikthimi i tij në gjirin e Bashkësisë Islame kishte qenë dëshirë e tij e kahmotshme, na pat thanë hoxha ynë i nderuar, Mulla Sadri ef. Prestreshi, kur ne ishim nxënës të tij në Medresenë “Alauddin” e në veçanti caktimi i tij imam dhe hatib në xhaminë kryesore të kryeqendrës së Kosovës.

Kontributin më të madh, për Islamin, Mulla Sadri ef. Prestreshi e dha gjatë punës së tij si imam qoftë nëpër fshatra apo më vonë në Prishtinë. Kontaktet me njerëz, ligjërimet, manifestimet e ndryshme, siç ishte mevludi, qelimeja, synetija, kurorëzimi, organizimi i të pameve, ishin raste ku hoxhallarët ishin në kontakt me shtresa të ndryshme të shoqërisë. Andaj, këtë e shfrytëzuan ulemaja e asaj kohe, këtë e shfrytëzoi edhe Mulla Sadri ef. Prestreshi, për t’ua mësuar besimtarëve parimet kryesore të fesë Islame.

Kështu, fillimi i punës së Mulla Sadriut në xhaminë e Madhe të Prishtinës u konsiderua një fitore e madhe për Bashkësinë Islame dhe për myslimanët. Sepse ai me pamjen, sjelljet, dhe oratorinë e tij, bëri një kthesë të madhe. Ai shumë shpejt përfitoi zemrat e besimtarëve, jo vetëm të kryeqendrës, por edhe të qyteteve tjera të Kosovës. Për këtë, besimtarë nga vende të ndryshme ia mësynin Xhamisë së Madhe për të dëgjuar këshillat që ai jepte, ditëve të xhuma, në fillim të viteve të gjashtëdhjeta të shekullit njëzetë.

Edhe pse, sipas kushtetutës së atëhershme të Federatës jugosllave, liria e fesë ishte e grarantuar me ligj, por regjimi komunist me të gjitha mjetet përpiqej ta pengonte çfarëdo aktiviteti fetar. Për këtë, organet e pushtetit të asaj kohe, me një vendim të veçantë e largojnë, si të papërshtatshëm, nga Xhamia e Madhe e kryeqytetit.



Në vitin 1966, mbahet Plenumi i gjashtë i Komitetit të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në Brione, ku Aleksander Rankoviqi shkarkohet nga të gjitha postet partiake dhe shtetërore që mbante në atë kohë. Kjo bëri që në një farë mënyre të rehabilitohen edhe shumë të ish-burgosur politik shqiptar.

Kështu në fund të viteve të gjashtëdhjeta, të shekullit njëzetë, Mulla Sadri ef. Prestreshi kalon për të punuar si myderriz në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës, ku shërbeu deri sa doli në pension, në vitin 1983. Puna e tij me nxënës ishte një dëshirë e tij e kah motshme si dhe një satisfaksion për kontributin e tij që ai kishte dhënë për Islamin dhe për myslimanët për dekada të tëra. Ai ishte i vetëdijshëm se në Medresenë “Alauddin” të Prishtinës mësonin nxënës nga të gjitha trojet shqiptare të ish-Federatës Jugosllave, andaj plasimi i ideve fetare dhe kombëtare tek ata të rinj do të thoshte afirmimi i idesë së bashkimit të trojeve shqiptare, ide për të cilën ai kishte kaluar katër vite në kazamatet e ish-Jugosllavisë.

Andaj, deshi fati të jemi prej gjeneratave të para që të jemi nxënës të myderrizit tanë të nderuar, nga i cili mësuam lëndën e Ahlakut (Moralit) dhe Fikhut. Mirëpo, prej tij mësuam edhe shumë virtyte tjera të larta, të cilat na shërbyen në jetën tonë të përditshme. Përvoja e tij si mësues e kishte bërë që ai të jetë një pedagog i mirë që depërton thellë në botën e brendshme të nxënësit. Ai për ne ishte myderriz, hoxhë, arsimtar dhe një idealist, që në zemrat tona kaliti atdhedashurinë si një virtyt të veçantë.

Andaj edhe pse nga kjo periudhë kohore kanë kaluar mbi katër dekada, kujtimet për myderrizin tonë të nderuar ende janë të freskëta. Këtë më së miri edhe një herë ma vërtetuan shumë kolegë të gjeneratës sime të cilët kur ishin informuar se do të organizohej sesioni shkencor për “Jetën dhe veprën e Mulla Sadri ef. Prestreshit“, me të cilët kishte vite që nuk isha në kontakt më pyetën për mundësinë e pjesëmarrjes. Po përmendi vetëm emrat tre prej tyre: Muxhteba Shehu nga

Struga, Irfan Abazi nga Ohri dhe Hasan Gjokaj nga Dinosha e Podgoricës.

Pas pensionimit ai ishte angazhuar në leximin e literaturës së nduarnduarshme islame. Kishte një bibliotekë të pasur. Në të kishte edhe dorëshkrime të rralla. Thoshte se pas vdekjes do t'ia dhuronte Bashkësisë Islame. Mirëpo, me djegien e shtëpisë u dogj edhe biblioteka e myderrizit tanë të respektuar.

Zoti i madhërishëm, myderrizit tanë të nderuar i dha jetë të gjatë. Në moshën 82 vjeçare ai përjetoi dëbimin nga shtëpia e tij si dhe ishte dëshmitar i djegies së saj nga forcat pushtuese serbe në mars të vitit 1999.

Pas kësaj tragjedie, ai jetoi i lumtur, sepse u realizua ëndrra e tij e kahershme e dëbimit të të gjitha formave të okupimit serb të Kosovës.

Mulla Sadri Prestreshi ndërroi jetë, më 16 Janar 2002, në moshën 85 vjeçare. Siç ishte madhështor në jetë, ashtu ishte edhe në vdekje.

Në Xhaminë e Madhe të Prishtinës, ku kishte shërbye, si imam dhe hatib ishin tubua me qindra qytetarë në faljen e namazit të xhenazes, nën udhëheqjen e Myftiut të Kosovës, dr.Rexhep Boja…

Në katundin Mazgit të Kastriotit, ku lindi me 17 tetor 1917, Mulla Sadri ef. Prestreshi u varros me nderime, me 16 janar 2002.

Për kontributin e tij të palodhshëm, që ai dha në lartësimin e fjalës së Allahut të madhërishëm, lusim të Gjithëfuqishmin ta shpërblejë me xhenetin Firdefs.!!!

Amin!!!



*Qemajl Morina*

# THE CONTRIBUTION OF MULLA SADRI EF. PRESTRESHI IN THE EDUCATION OF YOUNGER GENERATIONS
## (October 17, 1917 – January 16, 2002)

### (Summary)

The efforts of the Islamic Community to shed light on the past of distinguished religious and national personalities, who left their traces on our past, is an obligation of ours - something we owe to the previous generations. If it were not for their gigantic efforts to preserve our religious and national identity, only Allah the magnificent knows what our fate would be nowadays.

There is no doubt that mosques, maktabs and madrassas as centers of Islamic religious education played a special role in this direction. Furthermore, we should not forget the great contribution of our ulama during our history.

*كمال مورينا*

# مساهمة ملا صدري برستريشي في تعليم الجيل الجديد
## (17 أكتوبر 1917 – 16 يناير 2002)

## (خلاصة البحث)

ان الجهود التى يبذلها الاتحاد الاسلامي في كوسوفا لإلقاء الضوء على ماضي الشخصيات المشهورة الدينة و الوطنية والذين تركوا بصمات لا تمحى في تاريخنا يعتبر واجبنا للأجيال السابقة. اذ لو لا الجهود التى بذلوه للحفاظ على هويتنا الدينية والوطنية لكان الله وحده علم بما آل مصيرنا اليوم؟!

في هذا الصدد لا شك أن المساجد والمدارس الدينية كمراكز للتعليم الديني الإسلامي لعبت دورا خاصا و في نفس الوقت ينبغي أن لا ننسى المساهمة الكبيرة من قبل علمائنا خلال تاريخنا من عدة قرون.

## TRASHËGIMI ISLAME

*Ahmed Ebu Zejd*

# BIBLIOTEKA E KAJREVANIT - THESAR I KULTURËS DHE CIVILIZIMIT ISLAM

**Depoja e librave dhe e dorëshkrimeve e Kajrevanit, në qytetin e Fesit në Marok, paraqet thesar të njohurive dhe të civilizimit shumë të pasur. Konsiderohet njëra prej bibliotekave publike më të rëndësishme në nivel të botës arabe dhe asaj islame. Ajo përmban një thesar të çmuar të dorëshkrimeve dhe librave të rrallë. Në të njëjtën kohë, ajo paraqet një burim të këndshëm për studiues dhe hulumtues si dhe adresë të rrallë të shkencës për hulumtuesit arabë dhe të huaj, të cilët ia mësyjnë atij tempulli të dijës për të thithur nga nektari i saj... Në brendinë e saj gjenden 21.000 libra, 6.000 dorëshkrime dhe 500 shkrime të gdhendura në gurë.**

Ajo është një depo e llojit të rrallë që në vete ngërthen të gjitha llojet e shkencave dhe arteve. Aty gjejmë, mus'hafa, libra të tefsirit, të fikhut, hadithit, usulit, të historisë, të biografive, të udhëpërshkrimeve, të letërsisë, të gjuhësisë, të tesavufit, të filozofisë, të mjekësisë, të astronomisë, të matematikës, si dhe të shumë arteve tjera, datat e shkrimit të tyre u takojnë periudhave të ndryshme kohore.

Konsiderohet prej depove më të vjetra në botën arabe. Aty gjejmë dorëshkrime që janë të shkruara në shekullin e tetë të erës së re. Për-



mban dorëshkrime të rralla (autografe), disa prej tyre janë të shkruara nga vetë autorët e tyre. Prej tyre veprat e ibnu Haldunit, ibnu Tufejlit, ibnu Rushdit si dhe vepra të ndryshme nga disa mbretër të Magrebit arab.

Gustav Lubon, në librin tij të njohur "Civilizimi i arabëve" thotë: "Qyteti Fesit i bënte konkurrencë Bagdadit në shekullin e dhjetë. Në atë kohë aty jetonin gjysmë milioni banorë, kishte 800 xhami dhe "depo përplot me dorëshkrime greke dhe latine". Sipas disa bashkëkohanikëve të historianit Delfan, thuhet se depoja e Fesit përmbante më shumë se 30.000 vëllime.

Biblioteka sot përmban 21 mijë libra, disa nga ato janë libra të rinj, të cilët kanë të bëjnë me kohën e zbulimit të shtypshkronjës, 6 mijë dorëshkrime të përmbledhura afërsisht në 2043 grupe, 600 periodik, 500 shkrime të gdhendura në gurë, vjetërsia e të cilëve shkon deri në një mijë vjet.

## Themelimi dhe historia

Kjo bibliotekë e vjetër, e cila është ndërtuar në gjysmën e shekullin të tetë të hixhretit, i përket Xhamisë së Kajrevanit të qytetit Fes. Depoja është themeluar në fillim si një bibliotekë e vogël në xhami, për të ndihmuar në misionin e mësimdhënies, pastaj u kthye në kupolë të Sadijinëve dhe iu hap një derë jashtë xhamisë, me qëllim të zgjerimit të njohurive për çdo fe.

Themeluesi i saj është sulltani i Marokut Ebu Anan El Merijni, i cili bëri hapjen zyrtare të saj në vitin 750h/1349. Ai hartoi rregulloren e veçantë për lexim, shfrytëzim, përshkrimin e librave si dhe shtoi fondin me libra të rrallë dhe libra me vlerë nga të gjitha fushat e shkencave dhe arteve.

Sadijinet, gjatë shekullit të gjashtëmbëdhjetë pas erës së re, shtuan fondin me libra të rinj, duke i sjellë nga depoja El-Merinije nga i njëjti qytet. Po ashtu ata e pasuruan me dorëshkrime dhe dokumente të rralla, gjë që fondi i saj tejkaloi 32.000 vëllime në vitin 1613.

## Ndërtesa e depos

Depoja e Kajrevanit gjendet përballë sheshit “Saffarin” në qytetin e vjetër të Fesit. Ndërtesa e saj në shikim të parë duket e ngushtë, nga paraqitja e saj e jashtme duket e vjetër, por brendia e saj është shumë e zgjatur dhe me anekse të gjera.

Interesim për të, kanë tregua edhe sulltanët e Marokut. Kështu, në vitin 1940, mbreti i ndjerë Muhamedi i pestë, zyrtarisht i dha atributin e një institucioni shtetëror që të jetë i hapur ndaj studiuesve dhe hulumtuesve të të gjitha feve dhe kulturave, pasi që rrezatimi i njohurive të saj për gjashtë shekuj kishte qenë i dedikuar vetëm për studiuesit myslimanë.

Vendim i rindërtimit të saj edhi me urdhërim mbretëror në vitin 2004, dhe vendosjen e saj në vendin ku ndodhet sot pasi ka qenë e rrethuar nga Xhamia e Kajrevanit. Vendimi i bartjes së saj jashtë xhamisë u bëri të mundur besimtarëve të feve tjera ta frekuentojnë atë, pasi kanë qenë të ndaluar të shkojnë aty, kur ajo ishte pjesë e xhamisë, dhe kur dyert e saj ishin të hapura brenda xhamisë. Dera e saj kryesore ishte e hapur në sheshin e Saffarineve, që ishte e ngjitur me portat kryesore për të hyrë në qytetin e vjetër.

Kupola e bibliotekës është zbukuruar me zbukurime plasteri dhe me drunj të gdhendur sipas modelit të artit autokton. Kjo tregon për ndikimin e arkitekturës së Magrebit, me krijimtarinë e arkitekturës së përkryer të Andaluzisë, e cila kishte lulëzuar në shtëpitë, dhe xhamitë e Magrebit të Largët duke treguar për atë pjesë të historisë së ndritshme.

Biblioteka përmban hapësira magjepse të zbukuruara me zbukurime islamike e mozaike që i jep vendit një vlerë të lartë të trashëgimisë.



## Roli i saj në shkencë dhe kulturë

Kjo bibliotekë e rrallë, me sistemin e saj të përkryer me një fond shkencor, i cili përmban një mori të veprave dhe të dorëshkrimeve të dijetarëve të mëdhenj të Magrebit Islamik si: Ibnu Tufeji, ibnu Rushdi, të cilët u bënë të njohur me veprat e tyre madhështore në kohen e artë të Jakub El-Mensurit.

Ashtu siç kanë luajtur rolin e tyre të njohur në aspektet e shkencës dhe njohjes, ato lehtësuan vështirësitë me të cilat përballeshin hulumtuesit dhe studiuesit. Fondi i bibliotekës është pasuruar nga dhuratat e zyrtarëve, mbretërve dhe dijetarëve, të cilët dhuruan libra të veçanta, të shtrenjta nga aspekte të ndryshme të dijes.

Në Xhaminë e Kajrevanit, është studiuar, pranë fikhut dhe tefsirit, matematika, mjekësia, astronomia. Aty janë sjellë apo janë përshkruar të gjitha veprat që kishin të bënin me këto shkenca, gjë që shtoi fondin e dorëshkrimeve në Magreb, si në aspektin e kualitetit po ashtu edhe në aspektin e kuantitetit. Kjo i kishte stimuluar dijetarët, njerëzit e pasur dhe mbretërit të hulumtojnë për dorëshkrime dhe t’i blejnë ato sado i lartë të jetë çmimi i tyre.

Është e sigurt, se Universiteti i Kajrevanit nuk do të mbante ritmin shkencor të lloj-llojshëm dhe nuk do ta realizonte nivelin e duhur shkencor, të cilin e ka njohur gjatë shekujve, veçse me mbështetjen themelore në deponë e shkencës të pasur me libra dhe dorëshkrime.

Mbretërit e Marokut dhe princat janë përkujdesur për furnizimin e deposë së Kajrevanit me dorëshkrimet më të çmuara dhe janë përkujdesur në veçanti për t’i ruajtur ato. Po ashtu kanë bërë përshkrimin e tyre me qëllim që t’ua dhuronin vëllezërve të tyre mbretër dhe sunduesve të vendeve në Lindje të atdheut arab.

Kjo bibliotekë ishte shumë e pasur me libra. Ajo përmbante 33 degë të bibliotekave, që ishin përplot me libra të çmuara, ku referoheshin mësuesit dhe nxënësit për studime dhe hulumtime.

Ajo sot është e hapur në hapësirën e saj botërore, duke marrë pjesë aktive me ekspozita dhe takime të trashëgimisë dhe të kulturës ndër-

kombëtare, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përfitim nga përvojat botërore në këtë fushë.

## Katalogu i dorëshkrimeve

Në qoftë se shikojmë katalogun e dorëshkrimeve do të vërejmë me gjithë përpjekjet e mëdha që bënë marokenët e vjetër lidhur me katalogizimin e dorëshkrimeve, megjithatë ato mbesin lista dhe indekse që nuk i nënshtrohen kurrfarë sistemimi apo radhitje. Mirëpo, katalogizimi i vërtetë filloi me nismën e sistemimit të deposë në shoqërinë marokene në shekullin e tanishëm. Andaj, katalogu i parë i këtij lloji është katalogu i hartuar nga orientalisti francez Alfred Ektef Bel për një grup të librave të depos së Kajrevanit, për të cilin bën fjalë Ezerkili, i cili thotë: “Orientalisti Alfred Bel, i cili ka qëndruar një kohë në Afrikën Veriore dhe ishte drejtor i shkollës Tilmsan kishte hartuar një katalog në gjuhën arabe dhe atë franceze për bibliotekën e Xhamisë së Kajrevanit në qytetin Fes.

## Dorëshkrime të rralla

Nëse i hedhim një vështrim përmbajtjes së dorëshkrimeve në depo do të shohim se ato përfshijnë të gjitha shkencat dhe artet. Kurse sa i përket materies se ku janë shkruar ato, një numër janë shkruar në lëkurë kaprolli, ndërkohë që një numër i këtyre dorëshkrimeve ishte me vlerë të lartë shkencore dhe artistike.

Për sa i përket kohës së përshkrimit të tyre shohim se disa prej tyre shkojnë në shekullin e tretë të hixhretit, disa prej tyre janë shkruar me shkrimin e autorëve (autografe). Shumica e këtyre dorëshkrimeve posedojnë dokumente vakëfnore në depo. Dokumentet e vakufimit (testamentit), japin të kuptojmë se vakiflënsit u takonin shtresave të gjera të shoqërisë. Kemi vakufime nga mbretërit Merijin, Sadijine dhe Alevijin. Kemi vakufime nga princat, princeshat si dhe tjera prej udhëheqësve dhe dijetarëve, disa prej këtyre dorëshkrimeve, autorë të tyre janë personalisht mbretërit e Marokut dhe sulltanët, si në kohët më të vjetra, po ashtu edhe në ato më të reja.



Në depo gjenden dorëshkrime që janë vakufuar nga vetë autorët, prej tyre, po përmendim “Historinë e ibni Haldunit”, ku një pjesë e dokumentit të vakufimit mban nënshkrimin e autorit “Abdurrahman bin Haldun”.

Këto Vakufname, të cilat bartin dorëshkrimet e depos, vërtetojnë përhapjen e vetëdijesimit të madh te marokenët për rëndësinë e vakufimit kulturor, duke mos konsideruar të mjaftueshëm vakufimin fetar. Kjo tregon, po ashtu për dëshirën e tyre në stimulimin e përhapjes së leximit, kujdesin për masivizimin e kulturës, zgjerimin e rrethit të saj, në konkurrencën e tyre ata dëshirojnë të jenë në shërbim të dijetarëve dhe studentëve. Dëshira e tyre për posedimin e librave me vlerë, përshkrimi i dorëshkrimeve të çmuara dhe vendosja e tyre nëpër depo për dobi të përgjithshme, si dhe mbështetja e botimit të librave dhe propagandimi i tij.

## Dorëshkrimet më të vjetra

Vlera e dorëshkrimeve në depo qëndron në atë se dorëshkrimi më i vjetër në të është i shekullit të dytë të hixhretit. Ai është dorëshkrimi i “Es-sijeg” (Formulat) i Ebu Is-hak ibnu Ibrahim el-Kazari (186h), transmetuar prej Muhamed ibnu Vedah el-Kurtubi, redaktuar prej Dr. Faruk Hamade. Rëndësia e këtij dorëshkrimi të rrallë qëndron në atë se është i shkruar në lëkurë kaprolli që përbëhet prej 365 letrave, është prodhuar në Marok, konsiderohet prej vlerave më të çmueshme që posedon biblioteka.

Prej dorëshkrimeve të rralla dhe më të çmueshme që gjenden në depo janë:

1. Një pjesë e vjetër e Kur’anit e shkruar në lëkurë me shkrim kufi.
2. Rezyme e Ebi Musab Ez-zehri i shkruar në një letër të vjetër në Kordovë në Andaluzi, në vitin 359 h, në kohën e Halifit emevit El-Hakem El-Mustensir, që shoqërohet me shumë komente.
3. “El-bejan vet-Tahsil” nga Ibni Rushdi i shkruar në lëkurë, me shkrim të imët e të bukur. Ai është vëllim autentik gjigant që përshkojnë një numër zbukurimesh artistike. Flet për kundërshtimet

në lëmin e fikhut, që ishin aktuale në mesin e dijetarëve arabë në shekullin e shtatë të hixhretit.

4. "Mehadhi El-Muvetta", është nga përmbledhja El Mehdi ibnu Tumerit dhe sipas transmetimit të tij. Kopja e tij është shumë e bukur sa i përket formës dhe lidhjes.
5. Një pjesë nga Inxhili në gjuhen arabe i shkruar në lëkurë me shkrim të vjetër andaluzian.
6. Poemë mjekësisë nga ibnu Tufejli (i vdekur në vitin 581 h.). Është një dorëshkrim i vjetër, i cili flet për mjekësinë në formë të matematikës dhe është kopja e vetme që gjendet në botë nga ky libër.
7. Pjesë nga Muvatta i Malikut, (vdiq më 179 h), janë shkruar për deponë e Ali bin Jusuf bin Tashefin El Murabiti në lëkuren e kaprollit.
8. Libri "Biografia (Sire) ibnu Is-hak", (vdiq në vitin 151 h), është shkruar në vitin 207 h dhe ai është libri më i vjetër që gjendet në depo.
9. Mus-hafi i madh të cilin e ka lënë vakuf në depo, Sulltan Ahmed El-Mensur Edh-Dhehebi në vitin 1011, me rastin e inaugurimit të saj.
10. Libri "El-Iber" (Mësimet) nga ibni Halduni (vdiq më 808 h), të cilin shkroi në emër të sulltan Ibn Faris El Merini dhe ia dhuroi depos së Kajrevanit në muajin safer të vitit 799 h.

Depoja posedon një grup të botimeve të vjetra dhe të rralla, të cilat për shkak të vjetërsisë janë konsideruar si dorëshkrime, disa prej tyre janë botuar në Evropë, e disa të tjera janë botuar në Lindje. Një grup prej tyre të gdhendura në gurë që i përkasin Fesit, u botuan në Fes, duke u klasifikuar si libra të rrallë.

Depoja përmban një numër të revistave dhe periodikëve, nga Lindja dhe nga Perëndimi. Numri i të cilave arrin mbi 600 periodik të ndryshëm sa i përket trajtimit të temave, interesimit dhe vendeve ku janë botuar. Ato kanë vlera të ndryshme sa i përket aspektit shkencor.



## Neglizhencë dhe prapambeturi

Por, në një kohë të vonshme gjendja e depos u përkeqësua dukshëm, derisa kishte arritur në një situatë të dhimbshme për shkak të lënies pasdore dhe neglizhencës. Kohëve të fundit ishte vërejtur një deformim në veçanti i ndërtesës së saj, ku kishte filluar lagështia të depërtonte në fondin e dorëshkrimeve. Librat ishin gjuajtur njëra mbi tjetrën pa ndonjë sistemim të duhur. Ato rrezikoheshin të prisheshin nga lagështia dhe insektet e ndryshme. Për shkak se nuk gjendej katalogu i duhur, ato rrezikoheshin të humbeshin.

Disa dorëshkrime që gjendeshin në depo rrezikoheshin të humbeshin apo të vidheshin, veçanërisht ato të kohës së okupimit francez të Marokut. Si rezultat i kësaj u zhdukën dorëshkrime të rralla, nga ana e disa personaliteteve që kanë pasur poste të larta në shtet në kohën e okupimit.

## Mirëmbajtja e librave dhe dorëshkrimeve

Por, pa humbur kohë, Ministria e Kulturës së Marokut e rregulloi këtë çështje dhe mori për sipër restaurimin, mirëmbajtjen dhe shërimin e dorëshkrimeve në depo, ku filloi pastrimi, fotografimi dhe vendosja e tyre në kuti, ku nuk mund të depërtonte lagështia, duke zbatuar vendimet mbretërore.

Biblioteka sot është e pajisur me mjetet e teknologjisë më bashkëkohore për ruajtjen e atyre dorëshkrimeve të çmuara nga lagështia, zjarret, dhe vjedhja duke u mbështetur në standarde të niveleve ndërkombëtare.

Sa i përket mirëmbajtjes së bibliotekës dhe fondit të saj shkencor të çmuar. Biblioteka posedon laboratoriumin më bashkëkohor për restaurim në nivel arab dhe ajo tash përcjell zhvillimin e të arriturave botërore në këtë fushë për përkujdesje ndaj thesareve të saj të çmueshëm.

Për përkujdesjen e dorëshkrimeve të çmuara ekspertët janë mbështetur në metodën e konservimit të tyre në mikrofilm, gjë që lehtëson

punën e hulumtuesve dhe ruajtjen e këtyre gjërave të çmueshme nga dëmtimi dhe humbja. Leximi i dorëshkrimeve bëhet nga mikrofilmi, i cili është një kuti që lexon nëpërmjet një aparati që i përngjan kompjuterit dhe quhet “Lexuesi”. Në depo gjenden përafërsisht 768 mikrofilma dhe 6 pajisje për lexim.

Salla e dorëshkrimeve posedon pajisje elektronike bashkëkohore, për ta kondicionuar sallën sipas natyrës së kohës. Aty ka rezerva të tjera që të mos ndikojnë rrezet e diellit. Përveç kësaj, çdo dorëshkrim është i vendosur në kopertina të veçanta, ku nuk mund të depërtojnë insektet e as të ndikojnë moti i papërshtatshëm.

Restaurimi nuk përfshiu vetëm dorëshkrimet, por ai përfshiu edhe ndërtesën e depos. Kështu pra iu kthye konsiderata kësaj ndërtese me pamje të arkitekturës arabo-islame.

*Përktheu nga arabishtja:*
***Desara Vathaj***

Marrë nga revista:
*Al-Hajj ve Al-Umra, Al-aded 65, 5 maj 2010*



*Ahmed Ebu Zejd*

# THE KAIROUAN LIBRARY - A TREASURE TROVE OF ISLAMIC CULTURE AND CIVILIZATION

## (Summary)

The collection of books and manuscripts of the Kairouan library in the city of Fes in Morocco represents a treasure trove of knowledge and civilization. It is considered as one of the most important public libraries in the Arab and Islamic world. It has in its possession a treasure trove of valuable manuscripts and rare books. At the very same time, it represents a valuable source of information for scholars and researchers (be they Arabs or others), who come to this temple of knowledge to suck on its nectar.... The library has 21.000 books, 6.000 manuscripts and 500 writings carved in stone.

*أحمد أبو زيد*

# مكتبة القيروان – كنز الثقافة والحضارة الإسلامية

## (خلاصة البحث)

يمثل مستودع الكتب والمخطوطات القيروان في مدينة فاس في المغرب كنزا من المعرفة و الحضارة غنية جدا و هي تعتبر واحدة من أهم المكتبات العامة على مستوى العالم العربي والإسلامي و هي تحتوي على كنز ثمين من المخطوطات والكتب النادرة. و في نفس الوقت هي تمثل مصدر بحث للعلماء والباحثين و عنوانا نادرا للباحثين العرب والأجانب الذين يقصدون هذه القلعة للمرفة ليمتص الرحيق منها. و يوجد في داخلها 21000 كتاب و 6000 مخطوطةا و 500 كتابات منقوشة على الحجر.

*Liridon Kadriu*

# ABETARJA E FIRENCËS, E VITIT 1942, ME ELEMENTE ISLAME

Një abetare e rrallë, e gjetur nga një studiuese e shquar shqiptare, e quajtur Lumnije Çitaku, më zgjoi kërshëri të madhe, sepse ishte Abetarja e parë në gjuhën shqipe, që ka vlera të shumta e në mesin e këtyre vlerave ka edhe disa elemente islame. Është Abetarja e parë, e botuar në kolor. Fillova ta lexoj dalëngadalë dhe vërejta se në të kishte shumë gjëra interesante që ia vlen t'ia bëjmë të ditur publikut shqiptar. Është shumë e vërtetë se abetarja e shkruar në kohën e fashizmit italian, ka edhe elemente ku lavdohet Italia e Duçes, por një karakteristikë tjetër që e bën të dallueshme nga abetaret tjera është se në të gjenden edhe tregime për figura të caktuara të kombit tonë, siç është Ismail Qemajli dhe vëllezërit Frashëri, ndërkaq lartësohet dashuria ndaj atdhet.

Dy faqe të plota iu kushtohen vëllezërve Frashëri. Në faqen 54 shkruhet:

"Naim Frashëri kishte katër vëllazën. Nga katër vëllazën po përmendim Abdylin dhe Samiun. Naimi ka punue shumë për Shqipni. Ai ka shkrue edhe shumë libra të bukura. Edhe Abdyli e Samiu kanë pu-



nue për lirinë e Shqipnisë. Ata që punojnë për Shqipni janë shqiptarë të mirë."

Siç duket nga teksti i shkruar më lart, Abetarja është shkruar në dialektin gegë, i cili ishte prezent në atë kohë në Shqipëri. Në këtë faqe gjendet edhe tregimi Atdheu, ku ngrihet lart dashuria ndaj atdheut. Në faqen e parë shkruan: Abetare gegënishte dhe në ballinë ka një çupë dhe një çun duke luajtur me flutura. Në faqen e parë është fotografia e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, në faqen e tretë lart shkruan: BOTIM I MINISTRISË S'ARSIMIT dhe poshtë krejt: SHTËPIA BOTUESE MARZOCCO=FIRENZE 15 shtatuer 1942-XX.

Në faqet në vijim gjenden prononcimet e punëtorëve shkencorë të Institutit Albanologjik të Prishtinës, dr.Mehmet Halimit dhe dr.Shkelzen Raçës, ku ndër të tjera shkruajnë: "Ndonëse abetarja, botim i Ministrisë së Arsimit e botuar në Firencë më 1942, ka të meta nga aspekti i metodikës dhe shembuj të frymëzuar nga periudha fashiste, abetarja në fjalë ka një rëndësi të veçantë, sepse është ndër abetaret e para të botuara në gjuhën shqipe, e shkruar në dialektin e gegërishtes letrare, por ka edhe shembuj poezish në dialektin e toskërishtes", më pas dr. Daut Bislimi tregon historinë interesante se si erdhi kjo abetare në vendin tonë në Kosovë, i cili ndër të tjera shkruan: "Kjo Abetare bëri rrugë të gjatë e të mundimshme. Erdhi në Kosovë dhe u shpërnda kur në çdo anë ndihej fryma e Luftës së Dytë Botërore. Vendosmërisë së popullit për të qëndruar me armë i erdhi në ndihmë edhe dituria… Ajo padyshim arriti të ndezë zjarrin e shqiptarizmës".

Mr. Enver Rexha, sekretar shkencor në Institutin Arkeologjik të Kosovës shkruan: "Abetaren që e keni në dorë është një monument historik, meqë shquhet ndër të parat e këtij lloji ndër ne. Kam nderin të propozoj që kjo të ruhet si vlerë e veçantë jo vetëm në biblioteka të çdo librofili shqiptar, por edhe në çdo familje, meqë ajo ishte dhe është pjesë e traditës së familjeve tona", përfundon mr. Enver Rexha.

E fascinuar pas librave të vjetra, znj.Lumnije Çitaku-Orana, e cila i ka të gjitha meritat që sot kjo abetare u botua, sepse është znj.Orana ajo e cila e gjeti të grisur këtë abetare, por me punën e saj të palodhur e mori dhe e tuboi dhe ja ku e kemi sot në dorë të plotë ashtu siç ishte

në vitin 1942, ndër të tjera znj. Orana shkruan: ”Ekzemplari i kësaj abetarje, krahas gëzimit që më solli edhe brengosje po ashtu të mëdha, sepse që nga kopertina e deri në faqet e fundit ishte tejet e dëmtuar …., por me përpjekje arrita ta kompletoj. U shfaq një dëshirë e zjarrtë që kjo të ribotohet edhe në kohën tonë. Ribotimi i saj shpresoj se do të na ngjallë sadopak edhe ndonjë element të kujtesës sonë nacionale. Znj.Orana përfundon se kjo abetare frymon shqipen e pastër dhe se u gjend në bankat e shkollarëve tanë, pikërisht në kohën kur ata kishin nevojë për të”.

Eshtë interesante se si fillon renditja e shkronjave në këtë abetare. Në vazhdim po paraqesim renditjen e shkornjave si vijon:

**Renditja alfabetike;**

| | | |
|---|---|---|
| Shkronja i | Shkronja ll | Shkronja k |
| Shkronja u | Shkronja b | Shkronja gj |
| Shkronja n | Shkronja h | Shkronja z |
| Shkronja m | Shkronja j | Shkronja sh |
| Shkronja e,ë | Shkronja s | Shkronja zh |
| Shkronja v | Shkronja c | Shkronja nj |
| Shkronja r,rr | Shkronja ç | Shkronja x |
| Shkronja o | Shkronja p | Shkronja th |
| Shkronja a | Shkronja q | Shkronja dh |
| Shkronja t | Shkronja g | Shkronja xh |
| Shkronja d | Shkronja y | |
| Shkronja l | Shkronja f | |

GJITHSEJ: (36).

Siç e shohim nga renditja alfabetike alfabeti nuk është i renditur sipas shkronjave në gjuhën shqipe: a,b,c,ç,d,dh, e……..etj, por me një renditje tjetër, e cila ndoshta për ndonjë arsye metodike që të mësohet më lehtë alfabeti në mënyrë zik-zake apo ndoshta edhe për ndonjë arsye tjetër që ne nuk e dimë. Është interesante që shkronja “r” dhe ”rr” janë të shkruara në një faqe të vetme dhe e njëjta gjë është edhe me shkronjat “e” dhe “ë”.



Një gjë interesante që na bie në sy në këtë abetare është elementi islam që është i dukshëm në disa faqe të kësaj abetareje. Në faqen 44 duket qartazi elementi islam, ku te shkronja “xh” kemi këtë formulim:

xh,a, xhamia, hoxha, xhepi. Xh- një xhep, një xhybe, një xhamadan, ruej se e then xhamin! hoxha falet në xhami. sa xhami ka qyteti ynë?

Në fotografi është një xhami e bukur që ta ilustrojë më mirë mësimin e shkronjës xh te nxënësit. Fjala xhami, hoxhë, sepse shkronjën e parafundit e ka me xh të fortë, pastaj fjala xhybe që është veshje e hoxhës, pastaj fjalia Hoxha falet në xhami dhe pyetja sa xhamia ka qyteti ynë? janë dëshmi e qartë për përkatësinë e elementit islam në këtë Abetare. Do ishte shumë e udhës që edhe në abetaren moderne te shkronja xh të gjendej kjo foto dhe nxënësit të mësonin për shtëpinë, ku adhurohet Zoti, pasi që shumica e nxënësve te ne janë të besimit islam. Për t’ua bërë më të qartë lexuesit po sjellim të skenuar këtë faqe.

xh

xh, a, xhamija,
hoxha, xhepi.

**xh** nji xhep, nji xhybe, nji xhamadan, ruej se e then xhamin! hoxha falet në xhami. sa xhamija ka qyteti i ynë?

— 44 —

Elementi islam është paraqitur edhe në shumë faqe të tjera të kësaj abetareje, ku nëna shqiptare është paraqitur gjithnjë e veshur me kostum kombëtar shqiptar, kostum i cili është ekuivalent me veshjen islame. Nëna shqiptare askund nuk paraqitet me ndonjë veshje tjetër përveçse me veshje normale siç i ka hije një femre të ndershme. Kjo paraqitje gjendet në shumë raste si duke e ushqyer fëmijën e vet, duke punuar, duke e shëtitur fëmijën si dhe duke e vënë në gjumë fëmijën. Më poshtë po sjellim disa fotografi që gjenden në këtë abetare që lexuesi ta kuptojë më mirë këtë që e shtjelluam më lart.

c

c.i.ciu. ciu.ec!

ec,ec!ecim,ecni!

c cili? cila? ecni, ecni, cuca të mira! daci bân: miau, miau! a lueni ciemic? be bi ble bli bleta, blini.

— 26 —

n

n.i.u.i.n.

nuni,nu ni

n n, i, u, ni, nu, u, n, n, i n, un, ni ni, nu ni.

—11—

Një element tjetër islam, siç është besimi dhe frikë-respekti ndaj Zotit, paraqitet edhe në këtë abetare, ku synohet që fëmijëve qysh në vegjëli t’iu mbillet në zemra besimi në Zot, siç paraqitet te shkronja z në faqen 47, ku në mënyrë decidive shkruhet:

z, Z, Zoti, më poshtë vazhdon Zogu i ri. Zogu i vogël kishte ranë prej çerdhes.”Zen-e zen-e! “ i tha Zeka, së motrës. Zekë mos i ban gjë të keqe Zogut të vogël, se edhe atë e ka falë Zoti, si të gjithë kafshët tjera”, u-përgjigj e motra.

Në këtë tregim të shkurtër demostrohet shumë mirë besimi te Zoti dhe dhembshuria ndaj atyre që kanë shpirt.

Kjo abetare është ribotuar në gjuhen shqipe, në vitin 2003.

*Liridon Kadriu*

# THE FLORENCE PRIMER OF 1942 – THE ISLAMIC ELEMENTS IN IT

**(Summary)**

This rare book, which was found by Lumnije Çitaku, a distinguished Albanian scholar, caught my attention as it was the first primer in the Albanian language, and as such had many qualities including certain Islamic elements. It is the first primer printed in color. While going through it, I noticed that there were many interesting things in it which were worth being made public. It is true that the primer, which was printed during the fascist reign in Italy, also has elements praising Duce's Italy. Yet, what makes it different from other primers is the fact that it contains stories on distinguished personalities (from our national history) as are Ismail Qemajli and the Frashëri brothers. Furthermore, it glorifies love towards the motherland.

*ليريدون قدريو*

# أبجدية فلورنسا لعام 1942 مع عناصر إسلامية

**(خلاصة البحث)**

الابجدية النادرة التى وجدت من قبل الباحثة الالبانية البارزة لمني تشيتاكو اثارت باهي لأنها كانت الابجدية الأولى باللغة الالبانية و لها العديد من القيم و من بين هذه القيم هناك بعض العناصر الإسلامية و هي الابجدية الأولى ملونة.

لقد بدأت قرائتها ببطء و لاحظت الكثير من الاشياء المثيرة التى يجب أن يعرفها الجمهور الالباني. صحيح أن الابجدية المكتوبة في وقت الفاشية الايطالية تحتوى على عناصر حيث يمجد فيها إيطاليا موسوليني و هناك سمة أخرى تميزها من لابجديات الأخرى بأنها تحتوى على قصص عن شخصيات معينة مثل أسماعيل تشيمالي و اخوة فراشري و أيضا يمجد الحب عن الوطن.

*Mr. Rexhep Suma*

# DIALOGU KULTUROR, FETAR DHE KOMUNIKIMI MEDIAL

Marrëdhëniet e ndërsjella mes medieve të kulturës, fesë dhe shoqërisë në përgjithësi, nuk kanë qenë asnjëherë aq të perceptueshme sa u bënë pas shfaqjes së televizionit dhe sidomos pas rënies së sistemit sovjetik. Asnjëherë ndikimet e ndërsjella mes medieve (të reja e të vjetra) dhe natyrës së lidhjeve shoqërore, mënyrës sipas së cilës shoqëria përcakton vetveten si njësi organike(Germenninschaft ose Corporate), ose si Societas (Gesellschaft ose Patnership) nuk kishin qenë kaq të qarta. Kjo kundërvënie, sipas Michel Terestchenko-s (Philosophie Politique,1994) reflekton të njëjtën marrëdhënie që ekziston mes vizionit të qytetit antik ose ”harmonisë së bukur” greke sipas Hegelit dhe vizionit individualist të shoqërive moderne. Mediet qoftë ato elektronike apo të shtypit në shoqërinë demokratike luajnë rolin më krucial të informimit të drejtë dhe të saktë të shoqërisë. Së paku kështu duhet të ishte roli dhe rëndësia e ekzistimit të medieve si formë e pushtetit të katërt, krahas atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pas çdo politike redaktuese gazetareske dhe informative, qëndrojnë qarqe, klane, oligarki të fuqishme që kanë ndikim të jashtëzakonshëm në sajimin dhe komunikimin e një informacioni për publikun e gjerë të një vendi apo edhe më gjerë.



Përmbajtja e kulturës së një populli nuk mund të kuptohet jashtë fesë ose feve që ai beson, jashtë ndikimeve të tyre në mënyrën e të menduarit, të veshjes dhe të sjelljes. Një nga sociologët më të shquar në fushën e sociologjisë së fesë, E. Durkheim ka shkruar: “Feja nuk është vetëm një sistem praktikash; është edhe një sistem idesh, synimi i të cilit është të shprehë botën. Lidhur mbi impaktin e fesë në jetën tonë të përditshme qartësohet edhe nga një studim interesant që është zhvilluar në Shqipëri, ku shpjegohet se 34.53% e nxënësve (të dyja besimeve-myslimanë dhe krishterë) frekuentojnë rregullisht institucionet fetare, kurse 40.04% e tyre frekuentojnë vetëm në ditë festash fetare, ndërkaq 16.12% e tyre rrallë, kurse vetëm 9.31% asnjëherë nuk vizitojnë objektet dhe institucionet fetare (xhamitë apo kishat).[1]

Njëri nga sociologët më të shquar në shkencat e komunikimit, MacLuhan, ka shkruar se nëpërmjet rrjetit të dendur të medieve, veçanërisht të televizionit, bota e sotme është zvogëluar mjaft. Informacioni qarkullon shpejt si figurë, si zë dhe si shkronjë në të katër anët e botës dhe për një kohë shumë të shkurtër. Gati të gjithë njerëzit kanë të njëjtin informacion, të njëjtat stereotipa mediatike, për të mos thënë të njëjta reagime ndaj jetës.

Varshmëria e njeriut modern nga mjetet e komunikimit masiv në shoqëritë demokratike, po edhe në të tjerat është rritur deri në përmasa kritike. Shpeshherë njeriu nuk është i aftë të mendojë dhe të veprojë pa sugjerimin e mas-medies: ekzistimi i tij varet nga ato urdhëresa elementare, kështu që futja e çfarëdo dykuptimësie të vetëdijshme, e çfarëdo sugjerimi për anulimin e vendimit për një kohë të pacaktuar të introspektimit dhe analizës, do të kishte pasoja katastrofike. ”Për të qenë më e plotë fotografia e mjerimit të njeriut modern, fotografia që sugjerojnë potencialet “apokaliptike” të mas-medieve, kësaj që u the-

[1] Artan Fuga, Zyhdi Dervishi, Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit global, f. 202 Dudaj, Tiranë, 2010

ksua i duhet shtuar edhe fakti se mas- mediet kushtëzojnë jo vetëm strukturën e tij psikike, por edhe sjelljen e tij fizike.[2]

Në fillim të vitit 2000, një dhjetëvjeçar pas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, dukej se globalizimi i ekonomisë dhe revolucionit numerik po përuronin një erë të re. Shumëfishimi i këmbimeve ndërkombëtare ishte tregues i kalimit nga një ekonomi shumëkombëshe në një ekonomi botërore apo “globale”. Nën ndikimin e “konvergjencës” së rrjeteve, mediet e kanë shoqëruar këtë globalizim, fillimisht duke marrë pjesë vetë në të, pastaj duke përshpejtuar rrjedhën, sidomos nëpërmjet flukseve të informacionit dhe flukseve financiare.

Në prill të vitit 2000, shpërthen fluska financiare rreth vlerave të internetit, duke tërhequr me vete në rënien e tyre pjesën më të madhe të vlerave TMT (Teknologji-Media-Telekomunikacione); premtimet nuk ishin mbajtur dhe filizat e rinj po zbulonin ligjet e zakonshme të ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës. Pse paralajmërimi i prillit të 2000 nuk prodhoi efektin e një njoftimi? Sepse globalizimi i njëkohshëm i tregjeve dhe medieve para 11 shtatorit të 2001, nuk kishte vënë ende sado pak në dyshim këto figura të të ardhmes nën kujdesin e të cilave kishte lindur shekulli XXI, disa vite më përpara se në kalendar: shoqëria e informacionit, ekonomia e re dhe “fundi i historisë”.

Iluzionet e humbura dhe ëndrrat e thyera të shekullit paraprirës arrijnë ende të fshehin që revolucioni numerik, sipas shumë shenjave, s’është veçse në belbëzimet e tij të para. Të lindur me internetin, Google, Yahoo dhe e-Bay u nënshtrohen ligjeve të hekurta të ekonomisë së tregut. Betejat për përmbajtjet dhe për standardet, më të ashpra se kurrë, u hapin rrugën produkteve apo shërbimeve të reja, ndërkoh që e drejta për konkurrencë rrekt të afirmohet në shkallë rajonale dhe botërore. E shqyer ndërmjet ndarjeve të veta dhe ëndrrës së saj për unitet, bota më e padeshifrueshme se kurrë, pre e diktaturave dhe terrorizmit, nuk pret më nga teknika apo ekonomia, por vetëm

2 Dr. Ismail Bardhi, ”Karikatura e Karikaturës”, Dituria Islame, f.13, viti 20 nr 188, mars 2006, Prishtinë



nga urtësia e politikanëve, që këta të pajtojnë kërkesat e kulturave të veçanta, rajonale, etnike apo fetare, me ato të universalizmit të të drejtave të shenjta dhe të patjetërsueshme të qenies njerëzore.[3]

Deri më sot në historinë e njerëzimit janë themeluar me dhjetëra qytetërime dhe kultura të mëdha, të cilat në themelin e tyre kishin tekstet e shenjta sikurse janë: Vedat, Upanishadët, Bibla dhe Kur'ani. Marrë në përgjithësi ato ishin qytetërime edukatore të njeriut që i mësuan njeriut përgjegjësinë apo thënë ndryshe, disa qytetërime i krijoi njeriu i mendjes së përgjegjshme. Në ato qytetërime kishte kode të përgjegjësisë së shumanshme, të përkthyera në gjuhën e thjeshtë, mund të shprehen me një formulë thelbësore: njeriu është përgjegjës para Zotit, para natyrës, para njerëzimit, para vetvetes...Papjekuria fetare, siç thoshte Kant-i (1724-1805) është jo vetëm më e dëmshmja, por edhe më e pandershmja nga të gjitha. Të dëmshëm dhe të pandershëm janë edhe ata që dinë pak për fe e pak për shkencë e grinden. Millikan-i (1868-1953), fitues i Çmimit Nobel për fizikë, për këtë, thoshte: ”Kur të grinden njerëzit që dinë pak për fenë dhe ata që dinë pak për shkencën, ndokush mund të mendojë se aty ka vend mosmarrëveshja ndërmjet fesë dhe shkencës, ndërsa aty kanë vend, në të vërtetë, dy lloj injorancash”

## As shkenca s'mund të strehohet te religjioni, as qytetërimi të kthehet te familja klasike

Brenda qytetërimit, pa dalë nga ai, nuk shihen kurrfarë forcash që do t'u kundërvihen të gjitha këtyre dukurive. Për më tepër, në shkallën e vlerave që qytetërimi njeh, nuk gjendet asnjë argument për t'u theksuar kundër të këqijave që i shkaktoi shkenca e papërgjegjshme dhe të tjerat nga kriza e moralit, sikurse janë, vërshimi i shundit, pornografisë, alkoolit, etj. Kjo është po ajo ndjenjë e pafuqisë dhe rezignimit që ndihet në qëndrimin e kriminologëve amerikanë para ardhjes së baticës së kriminalitetit. Në të vërtetë, kjo është pafuqia e shkencës

3 Mediat & shoqëritë, Francis Balle, përkthim grup autorësh f. 441 bot 15 botimet papyrus, Tiranë, 2011.

kundër ligësive, të cilat përveç dimensionit shoqëror kanë edhe atë moral.

Mohimi i qytetërimit s'është i mundshëm nga vetë ai, por nga jashtë, pra nga kultura. Edukata religjioze - etike dhe familja paraqesin sheshazi shtegdalje. Mirëpo, as shkenca s'mund të strehohet te religjioni, as qytetërimi të kthehet te familja klasike. Nga aspekti i qytetërimit, rrethi është mbyllur. (A. Izetbegoviç).

Koncepti perëndimor për prerje të thuktë mes të shenjtës dhe shekullares është një rezultat i një procesi të gjatë historik, është produkt i pushtetit dhe kundërtive lidhur me ngjashmërinë e autoritetit. Luftërat e reformacionit janë pasqyruar si në besnikërinë proto-nacionale, ashtu edhe në qëllimet fetare (Riis, 1998b). Ne s'duhet ta zhvlerësojmë edhe ndikimin e fuqisë së të panadershëme dhe mbizotërimin në krijimin e këtyre kufijve. Zhvillimi i hershëm modern i kulturave kombëtare evropiane ka qenë i lidhur fort me identitetet fetare të njerëzve. Këtë lidhje mund ta ilustrojmë me ndëthurjen e identitetit luterian me atë suedez, të identitetit katolik me atë irlandez, të identitetit anglikan me atë anglez. Ndonëse në dekadat e fundit shtetet kombëtare e patën eliminuar përcaktimin "e shtetit" ose "të kishës bazë, supozime të shumta të mishëruara thellë në fetë kombëtare kanë mbetur në kuadër të ligjit, të politikës publike (siç janë të ardhurat vjetore prej taksave), në mbarështrimet institucionale (si ato në shkolla) si dhe në të kuptuarit e natyrës së autoritetit "shekullar"[4]

Mediet e hapura dhe të pavarura kanë rëndësi të veçantë në çdo shoqëri demokratike. Rëndësia e informatave dhe qasshmërisë së tyre për audiencën e gjerë është parakusht jetësor për të drejtat e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes politike.[5] Respektimi i të drejtës fetare është e garantuar me ligj. "Nëse jeni pjesëtar i një komuniteti në Kosovë, ju keni të drejta kushtetuese për ta shprehur, mbajtur dhe zhvilluar më tej kulturën dhe traditat tuaja. Ju gjithashtu keni të drejtë të administroni zhvillimet tuaja kulturore[6].

[4] Meredith B. McGuire, Religion: The Social Context (Religjioni: konteksti shoqëror), përktheu nga anglishtja dr. Ali Pajaziti f. 476 Logos-A. 2007, Shkup.

[5] www..ecmikosovo.org



Noam Chomsky, vazhdimisht vë në dukje një përfundim të thjeshtë: "Nuk ka nevojë për asnjë zbulim komploti për të analizuar devijimet e medies në vendet perëndimore". Një grusht njerëzish dhe korporatash që sot kanë në pronësi shumicën e organeve të medies, i fituan firmat e tyre duke mbështetur hapur elitat politike në vendet ku veprojnë mediet e tyre. Vite më parë, kur Chomsky-n e pyetën se si e kontrollonin elitat e korporatave medien, ai u përgjigj: "Kjo është njësoj si të pyesësh se si elitat e korporatave kontrollojnë General Motors. Ata nuk kanë nevojë ta kontrollojnë atë. Ajo është pronë e tyre.[7]

Studimet analitike kulturore përkitazi me rolin medieve tashmë është bërë paradigmë dominante në hulumtimet e komunikimit. Hulumtimet kulturore shkencore vë në spikamë njohjen e rëndësisë e ashtuquajturës "kërkime administrative" që zakonisht përdoren për të ditur shkallën dhe efektin e programeve, por pajtohen që efektet kuantitative e hulumtimeve vërtet nuk ofron përgjigje mbi pyetjen qenësore për mediet fetare. Studimet kulturore koncentrohen mbi atë se individë në grup përdorin medien për të ndërtuar botëkuptime fetare në jetën e tyre dhe së dyti sa këto botëkuptime fetare ndërlidhen me shumë aspekte të ndryshme jetësore.

Deri në vitet e 70-ta i gjithë koncepti fetar i programeve dhe shkrimeve ndërlidhej me efektin e audiencës që kishte si rezultat apo impresionizmin se çka ndonjë mund të bëjë për ceremoninë e së dielës dhe që të angazhohej që sa më shumë të konvertojë njerëz. Por, gradualisht studimet u largoheshin" efekteve" të këtyre pyetjeve duke u orientuar kah ajo se sa është e gatshme audienca të krijojë opinion nga mediet etj.

Nga ana tjetër, antagonizmi karshi islamit gjithmonë ka qenë i ngulitur në Evropë, që nga koha e kryqëzatave. Por, kjo ishte në kufij të largët nga distanca gjeografike. Por, bazuar në realitetin e sotëm,

[6] Kushtetuta, Neni 59.1; Ligji për Komunitetet, Neni 5.1.http://www.ecmikosovo.org/

[7] Pronësia e Mediea dhe ndikimi i saj në pluralizmin dhe pavarësinë e medias, përkthim, edicion elektronik Botues: Instituti Shqipar i Medias, f.1, 2004.

kur kemi një numër të madh emigrantësh si dhe shumë evropianë por edhe amerikanë që po e përqafojnë islamin, për fat të keq ka edhe asi zërash që kjo shoqëri të ndjekë rrugën e konfrontimit me myslimanët.

Për fat të keq, mediet në Perëndim në këtë drejtim kanë luajtur një rol shumë destruktiv në afrimin e feve dhe besimeve për të jetuar në paqe dhe harmoni fetare, bile kanë kontribuar në mbjelljen e armiqësive duke paraqitur stereotipe për myslimanët, se ata janë fundamentalistë dhe terroristë. Psh., pas 26 janarit 1995 kur ndodhi shpërthimi në Qendrën Tregtare Botërore, mediet në mënyrë gjenerale portretizuan myslimanët amerikanë si shkak i katastrofës. Pra, ishte një gabim qoftë me dije apo pa të dhe mediet morën rolin e gjykatësit duke i fajësuar dhe i shpallur fajtorë të gjithë myslimanët amerikanë.

Ka shumë pikëpamje të përbashkëta që obligojnë të gjitha religjionet, që ndonëse me botëkuptime të ndryshme, të gjenden në të njëjtën detyrë sepse ato lidhen nga premisa të ngjashme morale dhe horizonte të ngjashme shpirtërore.[8] Si do që të jetë në raportet e medieve hasim shpeshherë fjalën fundamentalist. Në sinonim të fjalës ekstremist dhe kjo është gabim i pafalshëm që bëhet nga mediet pasi që në realitet islami e ka ndaluar ekstremizmin rreptësisht. Pejgamberi a.s. ka thënë, “Ata persona që kalojnë në ekstremitet (në praktikimin e fesë) ata janë të mallkuar (nga Zoti)”. Prej besimit që mbjell Islami te myslimanët është edhe fakti se krahas Muhamedit a.s. ata i besojnë të gjithë të dërguarit pa kurrëfarë dallimi dhe filluar që nga Ademi, Nuhu, Ibrahimi Musa dhe Isa, por në Kuran më shumë përmendet Isa sesa Muhamedi a.s. Dhe ky fakt heshtet nga mediet të cilat janë të thirrura që të prezantojnë dhe të publikojnë të vërtetat mbi këto argumente e të mos të fokusohen vetëm në propagandën e zezë kundër një feje e në këtë rast Islamit. Pra, nuk ka aspak ndërlidhje me portretizimin e islamit si fe dhe si realitet, kundër asaj që prezantohet në medie, dhe paraqitjet e tilla në opinion vetëm sa e forcojnë mitin dhe të pavërtetat që po shpifen për këtë fe. Ndërkaq, plasimi i informacioneve të tilla vetëm sa nxit dhe rrit vëllimin e urrejtjes mes feve dhe popujve të ndryshëm.

[8] www.horizonti.com



## Ruajtja e identiteteve

"Dialogu ndërkulturor, vetëm kontribuon drejt mirëkuptimit të faktit se pavarësisht veçantive tona, ndajmë vlera pozitive dhe ballafaqohemi me sfida të ngjashme. Para fundit të dekadës së KB-së për dialog midis civilizimeve, dhe Dekadës për kulturën e paqes, në kushte kur procesi i globalizmit gjithsesi se na bashkon, me rëndësi esenciale është që të mos lejojmë që religjioni dhe kultura të shndërrohen në forca që çojnë drejt konflikteve dhe ndarjeve."Prej atje del edhe fuqia e madhe e liderëve të bashkësive fetare dhe të tjera që pozitivisht të ndikojnë për mirëkuptim dhe bashkëjetesë të ndërsjellë, si dhe të kontribuojnë në edukimin e të rinjve në këtë drejtim, posaçërisht në rajonet multikulturore dhe multikonfesionale, siç është rajoni i Evropës Juglindore", thotë drejtoresha përgjithshme e UNESKO-s, Irina Bokova[9].

Meqë burimet ekonomike, teknologjike dhe financiare nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë rreth botës, disa grupe etnike, kulturore dhe kombëtare përballen, me më shumë vështirësi në ruajtjen e identiteteve dhe traditave të tyre. Për rrjedhojë, për të kuptuar problemet rreth imperializmit kulturor, është e rëndësishme të analizojmë ndikimin e kulturës popullore amerikane. Nuk ka mënyra të lehta për të marrë ndikimin e kulturës popullore, por duhet të jemi të ndjeshëm ndaj ndikimeve të saj në komunikimin ndërkulturor.

Shumë grupe kulturore përreth botës shqetësohen rreth ndikimit të imperializmit kulturor. Qeveria e Kebekut, për shembull, është e shqetësuar për efektet e medieve në gjuhën angleze mbi gjuhën dhe kulturën franko-kanadeze. Francezët kanë shprehur gjithashtu shqetësim rreth dominimit të kulturës popullore të SHBA-së dhe ndikimit të saj në shoqërinë franceze. Imazhet e prodhuara nga industritë e kulturës siç janë filmi dhe televizioni, na mundësojnë “udhëtimin” në shumë vende të botës. Kultura popullore gjithashtu na ndihmon të mësojmë rreth grupeve të tjera kulturore. Ne priremi të mbështetemi më fuqimi-

[9] www.yllpress.com, 7 Maj. 2010.

sht në imazhet e medies të grupeve kulturore për të cilat kemi pak apo pothuajse aspak përvojë personale, por në këtë rast steretipizimi mund të përbëjë një problem. Një pjesë e madhe kulturës popullore prodhohet në SHBA dhe qarkullon në të gjithë globin. Mungesa e ekuilibrit të shkëmbimit midis kulturës popullore amerikane dhe teksteve të tjera të kulturës popullore, ka ngritur shqetësime rreth imperializmit kulturor.[10]

Identiteti ynë kombëtar ndikon me siguri mbi natyrën se si ne e shohim botën dhe komunikojmë me njerëz të kombësive tjera. Ashtu sikurse njëri prej studenteve tanë nënvizoi: “Sa më shumë zgjeroj horizontin kulturor, aq më i mrekullueshëm jam nga mënyra se si e shikoj jetën, si rezultat i të qenit amerikan”. Ka kaq shumë gjëra që ne i marrim të mirëqena, si mënyra e vetme për të bërë diçka apo për të menduar, ashtu si i gjithë ajo që ka të bëjë me individualizmin dhe sjelljet, vlerat e lidhura me të. Ka kaq tipa njerëzish dhe personalitetesh që nuk i kisha imagjinuar kurrë më parë.[11]

Duhet theksuar se neve na nevojitet edhe vetëm një hap i vogël në drejtim të mirëkuptimit të tërësishëm, se jetesa në botë me shumë kultura dhe religjione të ndryshme vetëm mund të na i forcojë raportet tona në shumëllojllojshmëri të besimeve, ideve dhe mendimeve, por normalisht duke respektuar gjithsecili kulturën, besimin e vet.

## Dhunë është çdo imazh që e lëndon rëndë spektatorin dhe që e shkëput atë përkohësisht nga realiteti

Duke analizuar rrethanat e frymëzimit të fesë islame në trojet shqiptare, nuk iu është dhënë vendi i merituar në hapësirat mediale të të gjitha zhanreve, por këtu duhet të kihet një gjë e qartë se kjo nuk ka kaluar në shenjë harrese, por ka qenë një model laik (kundër islam) që është praktikuar vetëm për fenë islame, e cila ka një shtrirje vertikale dhe horizontale shumë të gjerë në trojet tona etnike. Disa medie deri

[10] Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama Hyrje në komunikim ndëlkulturor, përkthyer nga Elena Bozheku f.229- 231, UET Press, 2010, Tiranë.
[11] Judith N. Martin, Thomas K. Nakayama, Ibid. f.124.



më tash islamin e kanë trajtuar si fe të një kulture e civilizimi të prapambetur, si të huaj për shqiptarët, si fe të dhunës dhe fanatizmit, që pengon modernizimin e jetës, lirinë e të menduarit dhe të të shprehurit; fe afriko-aziatike e madje disa e kanë quajtur fe të Lindjes.

Kryeministri maqedon Nikolla Gruevski, në hapjen e Konferencës së dytë botërore për dialog ndërfetar dhe ndërcivilizues, me moton “Religjioni dhe kultura - lidhja e pashkëputshme mes popujve”, që u mbajt në Ohër, pos tjerash tha: “Personaliteti është i shenjtë. Ai është qenie shpirtërore që është krijuar në mënyrë të barabartë, kur përqendrohemi tek tjetri dhe i duam të afërmit si vetveten, mund të jetojmë në paqe, mirëkuptim dhe tolerancë njëri me tjetrin. Edhe krahas dallimeve në religjionet dhe civilizimet tona, kur koncentrohemi drejt nevojave të justifikueshme të fqinjëve tanë, kur i duam sa e duam vetveten dhe kur e duam Zotin tonë, mund të mësojmë të jetojmë së bashku”, [12]

Më 3 dhjetor 1977 gazeta britanike “The Independent” e ka botuar një shkrim të Robert Fiskut, që ka të bëjë me mënyrën e trajtimit të çështjeve të myslimanëve në mediet perëndimore, ku sqaron se Perëndimi vazhdimisht dhe me qëllim e ofendon fenë islame me të gjitha mënyrat, me anë të shtypit dhe të mjeteve tjera. Në këtë shkrim, ai i përmend dy shembuj për këtë, njëri prej të cilëve është i njohur dhe aktual: pas eksplodimit të soliterit tregtar internacional në Nju-Jork, revista “Time” faqen e parë e fillon me këtë titull: “Terrorizmi islamik”! E nga ana tjetër, vazhdon Fisku, kur serbët ushtruan lloj-lloj gjenocidi e krimi mbi myslimanët e Bosnjës e Hercegovinës, ajo në mediet franceze paraqitej si konflikt nacional e jo fetar. Dhe, asnjëherë nuk ka ndodhur të konsiderohen krimet serbe si terror i krishterë evropian.

Përkundrazi, ai konflikt është paraqitur në shumicën e medieve perëndimore si konflikt për sundim të tokës apo për shkak të kufijve gjeografikë.

[12] www.shqipmedia.com/2010/05

Nganjëherë mediet shndërrohen edhe në mjet dhune. Publikimi i 12 karikaturave të Profetit Muhamed a.s., nga e përditshmja daneze “Jyllands –Posten” më 30 shtator të vitit 2005, ka nxitur dhe ka provokuar miliona opinione të botës islame dhe më gjerë. Mbase vetë qëllimi i gazetës ka qenë rritja e tirazhit të lexueshmërisë që të thithë sa më shumë reklama dhe publicitet. ”Se amullia e botës lindore myslimane ka marrë edhe trajta të tragjedi-komedisë si te tregtari i flamujve i Koliqit, dëshmon edhe lajmi se në Egjipt është rritur shitja e flamujve danezë, të cilët myslimanët i blejnë për t’i djegur. Një dalldi për t’u vajtuar”.[13]

Ndërkaq, a e dini se kujt i drejtohet Ernesto Sabato?! Gjithë atyre që janë për një botë të lirë, ku të gjithë duhet patjetër të ndërtojnë një strategji të re me Islamin, dhe kjo strategji nuk do të jetë një strategji lufte mes dy qytetërimeve e kulturave, por një strategji bashkëpunimi, mirëkuptimi dhe pranimi, duke integruar qytetërimet, kulturat dhe civilizimet mes feve. Ernesto Sabato i referohet në një vend Helder Linit: “...... Qeveritë kanë harruar në mbarë botën se qëllimi i tyre është të promovojnë të mirën e përbashkët. Solidariteti luan, kështu, një rol vendimtar në këtë botë pa krye, përjashtuese të llojeve të ndryshme...........Miliona qenie mbijetojnë heroikisht në mjerim. Ata janë martirët...........Në këtë varfërim ekzistencial dhe metafizik, të gjithë janë viktimë të një qielli dhe të një çatie..........Banalitetet, ku kalben ndjenjat më fisnike, e degjenerojnë njeriun në një karikaturë patetike që nuk e gjen më veten në të qenit njeri......Mjerë njeriu që mbështetet vetëm tek arsyeja-shpëtojmë hera-herës e mbi të gjitha falë grave, jo thjesht sepse dhurojnë jetën, por janë ato që mbrojnë këtë specie enigmatike.......”

Por, edhe kultura edhe media nga një aspekt tjetër vetes ia kanë vënë obligim duke u shndërruar në një fushë profitabile të lartë. Bazuar në një studim të botuar në janar 2009 nga Sindikata e Regjive Internet (SRI), reklamapaguesit në Francë investuan gati 2 milionë euro në VEb në vitin 2008. Ky vlerësim i realizuar nga shoqëria Cap Ge-

[13] Zekirija Ibrahimi “Karikaturimi i Lirisë“, Gazeta Besa, f. 15. nr 19 viti i 2, shkurt 2006.



mini Consulting me kërkesën e SRI, mban parasysh lidhjet e sponsorizuara (të papërfshira në studimin e tregut publicitar të botuar nga IREP), të cilat në vitin 2008 përfaqësojnë segmentin kryesor të tregut të reklamës në linjë ose 800 milionë euro. Pjesa kryesore e kësaj dhurate kapet nga Google që në të kundërt, nuk jep statistika. Kështu, sipas këtij vlerësimi, të ardhurat e Internetit përfaqësojnë 59% të të ardhurave publicitare të televizionit dhe rreth 6% të shpenzimeve totale të reklamapaguesve. Investimet publicitare në Internet do të binin me 14% në vitin 2009, sipas SRI-së.[14]

Shpeshherë mediet jo vetëm që nuk luajnë rolin e ndërafrimit kulturor por ata shfaqin imazhe të dhunshme apo përçon mesazhe të cilat lëndojnë ndjenjat e fetarëve e sidomos fesë islame që mediet e etiketojnë me lloj-lloj etiketimi. Dhuna nuk matet, ajo është cilësore. Dhuna është relative, ajo varet nga secili njeri, nga kuptimi që ai i jep, nga kuptimi që mund të ketë sipas tij, por edhe nga shoqëria nga e cila ajo është e pandashme, e cila e konsideron si një gjë të keqe që mund të kapërcehet me anë të drejtësisë dhe duke shkuar drejt “qytetërimit, ose si një të keqe të domosdoshme për lindjen e”mbinjeriut” ose për një të plotëlumturi. Sipas Serge Tisseron, psikiatër dhe psikanalist, mund të konsiderohet si i dhunshëm “çdo imazh që e lëndon rëndë spektatorin dhe që e shkëput atë përkohësisht nga realiteti”. Aq më shumë që sot imazhet janë akoma edhe më të rrezikshme, meqë “ato synojnë dëshirat tona” sepse përdorin dhe abuzojnë me fuqinë e tyre të joshjes. Por, duhet të kujtojmë se çështja e dhunës lidhet me çështjen e moralit me gjëra të ndaluara e gjërat e detyruara dhe se vetëm mësimi i normave na mundëson të bëjmë dallimin midis asaj që psikanalisti Daniel Sobony e quan “dhuna e jetës”, që ka të bëjë me të takuarin e të tjerëve dhe “dhunës së vdekjes”, synimi i vetëm i të cilit është t’i bëjë keq të tjerëve pa arsye si dhe duke u mburrur.[15] Gjithnjë e më tepër ndëreligjiziteti dhe konfliktet ndërkulturore nga do në botë kanë bërë që gjithsesi të promovohet inter-religjioziteti dhe dialogu

[14] Mediat & shoqëritë. Ibid f.553.
[15] Ibid. 735.

ndërkulturor. Shkaqet apo arsyet e këtyre konflikteve mund të jenë disa sosh. Bota ishe e ndarë në dy pole, jugor dhe verior, ku poli verior kishte shënuar një zhvillim të hovshëm ekonomik sesa poli jugor, i cili i goditur me ngecje, analfabetizëm dhe varfëri.

Në epoka të shkuara, shkruan Robert Eco, çdo komunikim i drejtohej një marrësi të përcaktuar mirë, kodet interpretuese të të cilit përkonin me ato të dërguesit. Çdo keqkuptim karakterizohej si “dekodifikim rravgues”, që rrallë përjashtonte rregullat kulturore të pranuara nga të gjithë. Ndërsa në shoqërinë e masave, ku publiku është me përkufizim i vagullt dhe i diferencuar, dekodifikimi rravgues bëhet normë. Lind, kështu, nevoja e një studimi semiologjik, që të kontrollojë flukset e komunikimit dhe që të pajiset me mjetet e nevojshme të analizës, për të kuptuar procedurat e dekodifikimit rravgues (dhe, po të doni, edhe për të shmangur shfaqjen e saj në të ardhmen). Kjo parakupton, duke e krahasuar me çdo hetim sociologjik apo vlerësim estetik, analizën e strukturave komunikuese që TV-ja vë në jetë, pra të kodeve paraprake të dërguesit, të formës që ka marrë mesazhi dhe kodeve të përdorura nga marrësi.[16]

## Ndërreligjioziteti dhe dialogu ndërkulturor

Çështja e dialogut mbetet e vetmja rrugë që të arrihet dhe mbështetet mirëkuptimi mes grupeve konfliktuoze. Dialogu mund të zhvillohet midis tre lloj grupeve. E para grupet politike; 2) grupet fetare dhe 3) mbështetësit e grupeve politike dhe fetare. Sigurisht që gjithashtu ka edhe dallime mes nivelit të dialogut dhe procesit gjithëpërfshirës që dialogu i involvon të gjitha këtë nivel. Ai mund të vendoset në nivelin e liderëve politikë apo fetarë, apo në nivelin e intelektualëve nga grupe të ndryshme, por edhe të masës. Natyra e dialogut ndryshon varësisht prej niveleve, si psh., në nivelin intelektual kërkon dhe është më analizues, më detajues për ngjarjet dhe kuptimin e natyrës së for-

[16] Gianfranco Marrone, Corpi sociali (Trupat shoqërorë proceset komunikuese dhe semiotika e tekstit), përkthyer nga Dhurata Shehiri dhe Persida Asllani, shtypur Guttenberg, f.74, Tiranë, 2008.



cës që është involvuar në mbështetjen e konfliktit. Në këtë nivel të dialogimit gjithashtu duhet që të bëhet strategjia e promovimit të ndërreligjiozitetit dhe harmonisë ndërkulturore. Kurse në nivelin politik dialogu mund të bëhet me ata politikanë që besojnë në politikat sekulare dhe që refuzojnë çdo ideologji, politik të fesë apo konfrontimit kulturor. Në rrafshin politik dialogu mund të trajtojë strategjinë e sjelljes së aleancave sekulare për të izoluar forcat shoqërore dhe fundamentale. Ndërkaq në rrafshin fetar, dialogu duhet të trajtojë fenë dhe aspektet teologjike. Po ashtu edhe feja duhet të kuptohet në nivele të ndryshme, në atë të ritualeve, besimit, institucioneve dhe vlerave. Edhe pse ritualet, besimet dhe institucionet ndryshojnë nga feja në fe, vlerat janë të detyruar të jenë plotësuese, p.sh., feja islame veç tjerash karakterizohet për drejtësi dhe barazi mes njerëzve. Ritualet, besimet dhe institucionet janë unike në çdo fe dhe kjo shpeshherë çon në keqkuptim. Çdo traditë fetare thekson rëndësinë e ritualeve të caktuara dhe besimi mbetet qendra në traditën e fesë dhe krahas kësaj tregon edhe superioritetin e ritualeve dhe besimit në përgjithësi. P.sh., feja islame rreptësisht e ndalon faljen dhe qëndrimin para idhujve për iradet. Po ashtu Islami vë në fokus besimin në një Zot dhe largon çdo lloj rivaliteti në adhurim përveç Tij. Në hinduizëm çështja është më ndryshe pasiqë ata besojnë dhe lejojnë përuljen dhe luten para idhujve. Këto koncepte e bindje fetare në disa vende siç është India, kanë çuar në konflikte të dhunshme dhe të përgjakshme. Si do që të jetë nga ana tjetër, kjo dhunë nuk është mbështetur apo nxitur nga liderët fetarë, të kundërtën e liderëve politikë, të cilët shqetësohen seriozisht nga ritualet dhe besimet. Kjo assesi nuk do të thotë se liderët fetarë nuk ndryshojnë. Këto ndryshime për një dialog të duhur, duhet të kuptohen dhe vlerësohen, e jo të luftohen. Shumë nga sufistët e bhakti shenjtorët e bëjnë pikërisht këtë. Ata jo vetëm që u përpoqën për të bërë vlerësimin e këtyre ndryshimeve konceptuale por u përpoqën për t’i pajtuar ato.

Institucionet fetare kanë bërë sigurisht shumë deklarata mbi të drejtat e njeriut dhe drejtësinë shoqërore.[17]

Asgar Ali Engineer në shkrimin e tij “On religious and interculturaleal dialogue”, **veçon disa rregulla që mendon se janë një ndihmesë e madhe në rezultatin e një dialogu.** Rregullat vijuese që do të ishin një ndihmë e madhe për të ndihmuar dialogun ndërfetar janë:

1.) Palët që përfshihen në dialog duhet të jenë të brumosur fort në traditën e tyre dhe duhet të kenë besim dhe bindje të brendshme. Kjo është bindja e vërtetë dhe është një themel i fortë për dialog.

2.) Në dialog assesi të mos të zhvillohen polemika, ngase stili polemizues është antitezë e dialogut, ngase polemika shtyn dialogun në kahe të gabuar dhe moskuptimin e palëve.

3.) Dialogu nuk duhet të zhvillohet vetëm për të kuptuar tjetrin, por edhe duhet të respektojë integritetin e tij. Çdo dialog që nuk përmban respekt për integritetin dhe bindjet e tjetrit është i prirë të dështojë.

4.) Ideja e dialogut duhet të jetë në funksion të shpjegimit të pikëpamjeve e jo të shndërrohet në një pikëpamje, sepse për ndryshe një përpjekje e vogël tjetër do të dëmtonte dhe shembte frymën e dialogut, dhe kjo po ashtu do të çonte në pakënaqësi mes palëve dialoguese.

5.) Palët në dialog po ashtu duhet të kenë parasysh diversitetin si një bazë qenësore të jetës. Pa diversitet jeta kalon në monotoni dhe do ta humbte bukurinë e saj. Nga ana tjetër, edhe Kur’ani jo vetëm që e njeh diversitetin por edhe e legjitimon atë. Kjo është dëshira e Allahut xh.sh, që te njerëzit të ketë diversitet. “Ne edhe ty (Muhamed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që Allahu e zbriti, e mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Allahu,

[17] Azzam Temimi/Xhon L. Esposito, Islam and secularism in the Middle East (Islami dhe shekullarizmi në Lindjen e Mesme), përktheu nga anglishtja Bujar Hoxha f. 110, Logos –A, 2010, Shkup



do t’ju bënte një popull (në fe e sheriat), por deshi t’ju sprovojë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu, e ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshi. (El Maide, 48). Po ashtu thotë “Secili (popull) ka një anë, të cilës ai i kthehet, ju shpejtoni kah punët e mbara, kudo që të jeni Allahu ka për t’ju tubuar të gjithëve, Allahu ka fuqi për çdo send”. (El Bekare, 148). Mungesa e diversitetit dhe zbatimit të një sistemi ideologjik në fund të fundit mund të shpjerë drejt fashizmit dhe autoritarizmit.

6.) Një gjë duhet kuptuar mirë, dallimin mes dialogut dhe monologut për të pasur një dialog efektiv. Sepse dëshira për të dominuar dialogun shpie në monolog. Secila palë në dialog duhet të ketë hapësirë të barabartë për të prezantuar pikëpamjet e veta. Dialogu mund të marrë kuptimin e saktë vetëm atëherë kur bëhet në frymën e vërtetë demokratike duke respektuar, njohur të drejtat e të gjithë pjesëmarrësve në dialog.

7.) Në fund, duhet të kuptojmë se realizimi i një dialogu efektiv është i mundur jo vetëm atëherë arrijmë të dëgjojmë këndvështrimin e tjetrit, por të kuptohet dhe vlerësohet saktë në kontekstin e dhënë.

Nëse këto rregulla gjejnë zbatueshmëri në terren në dialogun ndërfetar dhe ndërkulturor, atëherë rezultati do të jetë mjaft inkurajues. Asnjë vend sot nuk mund të mburret me krenarinë e të qenit rigoroz njëbesimor apo njëkulturor. Zhvillimi i hovshëm ekonomik dhe komunikimi i shpejtë ka krijuar diversitet te grupe të ndryshme fetare e kulturore kudo në botë që të kenë qëndrime të përafërta ose të njëjtë në mendime. Disa grupe do të jenë mazhorancë në numër, kurse të tjerët minoritet. Apo mund të ndodhë edhe e kundërta që disa minoritete mund të bashkohen e të përbëjnë shumicën siç mund të ndodhë në Kanada në një të ardhme të afërt. Mozaiku i modeleve të shoqërisë mund të mbajë bukurinë e saj vetëm në harmoni. Plasja e një konflikti

mund të çojë në zbehje të këtij mozaiku për shkak të rritjes së pakënaqësisë dhe tendosjes së marrëdhënieve ndëretnike.[18]

Bota myslimane mund të krijojë një gjallëri të re qytetërimore, nëse elitat intelektuale, ekonomike dhe politike mund të riformulojnë qëndrueshmërinë e pasurisë historike të civilizimit islam për realizimin e një aktivizimi efikas në arenën sociale, ekonomike dhe politik. Rendi i ditës i ri politik i botës myslimane si një kundërpërgjigje Rendit të Ri Botëror hipokrit, duhet të mbështetet nga produktiviteti intelektual, efikasiteti ekonomik dhe dinamizmi social. Një gjallëri e tillë qytetërimore jo vetëm që do të sigurojë një zgjidhje për botën myslimane, por ajo do të sigurojë një alternativë për të gjithë njerëzimin.[19]

Për fund, dialogu konsiston në ngritjen e bashkëjetesës dhe harmonisë e tolerancës mes kulturave e feve të ndryshme. Bashkërisht mund ta përballojnë çdo problem, çdo sfidë e çfarëdo rrafshi qoftë. Ky është dialogu real i jetës, dialog që paraqet jetën të përbashkët, ku mjetet e komunikimit masiv do të fokusoheshin në respektim dhe mbjelljen e dashurisë, respektin dhe avancimin e së drejtës qytetare për njerëzit e një vendi.

## Konkluzione

1. Feja, kultura dhe mediet të mos shndërrohen në forca që çojnë drejt konflikteve dhe ndarjeve.
2. Dialogu ndërkulturor, vetëm kontribuon drejt mirëkuptimit të faktit se pavarësisht veçantive tona, ndajmë vlera pozitive dhe ballafaqohemi me sfida të ngjashme"
3. Mediet forcojnë ndikimin e religjionit dhe kulturës që të kenë një lidhje të pashkëputshme mes popujve.
4. Luajtja e një roli tepër aktiv dhe efektiv që të mos lejohet ndarja e botës mes “Perëndimit dhe të tjerët”, ashtu siç ka bërë Samuel Huntigtoni në librin e tij “The Clash of Civilzations” (Përplasja e qytetërimeve).
5. Mediet mund të ndikojnë në përmirësimin e jetës së njerëzve dhe në vendosjen e paqes dhe sigurisë. Ata mund të ngrenë lart moralin dhe spiritualitetin në mesin e njerëzve dhe t'i kënaqin njerëzit.

[18] Asgar Ali Engineer, http://andromeda.rutgers.edu
[19] Ahmet Davutoglu, Transformimi qytetërimor dhe bota muslimane, f. 232 Logos-A, 2005 Shkup.

*Mr. Rexhep Suma*

## CULTURAL AND RELIGIOUS DIALOGUE AND MEDIA COMMUNICATION

### (Summary)

The relationship between cultural and religious media and the society in general has never before been as perceptible as has become since the appearance of television and in particular since the fall of the Soviet system. Never before has the influence between the media (old and new) and the nature of social relationships, the way in which the society determines itself as an organic unit (Germenninschaft or Corporate), or as Societas (Gesellschaft or Patnership), been as clear as it is now. The latter, according to Michel Terestchenko (Philosophie Politique, 1994), reflects the same relationship that exists between the vision of an ancient city or the Greek “beautiful harmony” according to Hegel and the individualist vision of modern societies.

*رجب سوما*

## الحوار الثقافي و الديني و الاتصال الإعلامي

### (خلاصة البحث)

العلاقات المتبادلة بين وسائل الإعلام الثقافية والدين والمجتمع بشكل عام لم تكن مدركة كما أصبحت بعد ظهول التلفاز و خاصة بعد سقوط النظام السوفيتي. التأثيرات المتبادلة بين وسائل الإعلام (الجديدة والقديمة) و طبيعة العلاقات الاجتماعية و الطريقة التي المجتمع تعرف نفسها كوحدة عضوية (Germenninschaft or Corporate) لم تكن واضحة أبدا. هذه المعارضة حسب مايكل ترستشنكس (Philosophie Politique,1994) تعكس نفس العلاقة القائمة بين الرؤية للمدينة القديمة أو الانسجام اليوناني الجميل لهيغل والرؤية الفردية للمجتمعات الحديثة

*Ramadan Shkodra*

# POZITA KUSHTETUESE E KOSOVËS NË FEDERATËN JUGOSLLAVE GJATË VITEVE 1946-1974 (vështrim historik)

## Hyrje

Pas Luftës së Dytë Botërore, rrjedha objektive e ngjarjeve që çonte drejt zgjidhjes së drejt të çështjes së Kosovës, u ndërpre. Popullsia shqiptare e Kosovës u përball me presionet, me mashtrimet dhe me dhunën e udhëheqësve komunistë jugosllavë, sidomos të atyre serbë. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës u harruan. Derisa brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrah popujve jugosllavë për çlirimin e plotë të Jugosllavisë, mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi u ushtrua një shtypje e egër kombëtare, pati arrestime, terror e persekutime të shqiptarëve, u ndalua përdorimi i flamurit kombëtar, nëpunësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me ata serbë. Kufomat e shqiptarëve të torturuar i gjeje kudo nëpër rrugët e qyteteve dhe fshatrave të Kosovës. U mobilizuan me forcë në ushtrinë jugosllave djem shqiptarë, të cilët derisa arrinin në destinacion, ecnin në kolonë



për katër, të çarmatosur dhe ruheshin anash nga rojat serbe e malazeze, sikur të ishin të burgosur. Gjatë rrugës u pushkatuan mijëra shqiptarë, që përpiqeshin të arratiseshin për t'u shpëtuar provokimeve e mundimeve nga serbët. Vetëm në Tivar brenda një nate dhe një dite u masakruan afro 1600 shqiptarë të mobilizuar. Këto veprime ngjallën reagimin e natyrshëm të popullsisë shqiptare për t'u vetëmbrojtur. Që t'u shpëtonin ndjekjeve e persekutimeve, shumë fshatarë braktisën fshatrat e tyre dhe dolën në male. Nga malet ata filluan të sulmonin repartet e ushtrisë jugosllave të vendosura në qytete. Shpërthyen revolta masive në Ferizaj (fillim i dhjetorit 1944), në Gjilan (dhjetor 1944), në Drenicë (dhjetor 1944, janar, shkurt 1945), në Mitrovicë (janar 1945). Numri i të revoltuarve arriti në rreth 30.000 veta.

Pas shtypjes së revoltave masive popullore, qëndresa kundër pushtetit jugosllav vazhdoi në rrugë ilegale. U krijuan disa organizata të fshehta. Më të rëndësishmet ishin: Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare (ONDSH) dhe Besa Kombëtare.

ONDSH ishte një organizatë politike që u angazhua për evidencimin e shqiptarëve të zhdukur, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Goditjet që u ndërmorën mbi popullsinë shqiptare menjëherë pas luftës e gjatë Administratës Ushtarake ishin në përputhje me elaboratin e Vasa ÇubriLloviqit "Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re", dërguar qeverisë së re jugosllave ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor të vitit 1944.

Kështu shqiptarët në Jugosllavi, jo vetëm mbetën në statusin e paraluftës, të shkëputur nga shteti amë, por as nuk u bashkuan në një njësi të vetme federative. Ata u copëtuan administrativisht, midis tri republikave jugosllave, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Qëllimi i kësaj ndarjeje, ishte çintegrimi dhe shkombëtarizimi i shqiptarëve.

## I. Statusi kushtetues-juridik i Kosovës (1945-1948)

Pas shtypjes së revoltave masive popullore, me masa të dhunshme, Serbia më 18 shkurt të vitit 1945, në një mbledhje të udhëheqjes më të lartë të Komitetit Qendror të PKJ në Beograd, nën diktatin e përfaqësuesve serbë mbi ata malazez e maqedonas, u vendos që Kosova t'i bashkëngjitej Serbisë. Për t'i dhënë ngjyrime juridike, madje dhe parimore këtij vendimi të marrë nga lart, pas dy muajsh, më 7-9 prill të vitit 1945, u organizua Mbledhja e Jashtëzakonshme e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë dhe më 8-10 korrik 1945, në Prizren, u mblodh një i ashtuquajtur Kuvend i Këshillit Popullor të Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, i cili në historiografi njihet si “Kuvendi i Prizrenit”[1].

Në të dy këto forume u bënë përpjekje që aneksimi i Kosovës Serbisë të paraqitej si shprehje e vullnetit të vetë popullit të Kosovës. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Serbisë (7-9 prill 1945) u gjet një pjesëmarrës malazez nga Kosova, për të shprehur "dëshirën e KANÇ të Kosovës, që edhe popujt e Kosovës t’i aneksoheshin Serbisë federale motër". Megjithëse ky pjesëmarrës vuri në dukje në fund të fjalimit të tij se "ne nuk e kemi marrë akoma këtë vendim në Kuvendin tonë, për shkak se në Kosovë ekziston pushteti ushtarak", Kuvendi i Serbisë e konvertoi dëshirën në vendim dhe e pranoi aneksimin e Kosovës Serbisë.

Pas tre muajsh, më 8-10 korrik 1945, në “Kuvendin” e mbledhur në Prizren, ku nga 137 pjesëmarrës vetëm 32 ishin shqiptarë, të cilët survejoheshin nga njerëz të armatosur të UDB-së, u miratua me duartrokitje, pa votime e nënshkrime, një rezolutë e ardhur e gatshme nga Beogradi. Në Rezolutë shprehej dëshira e popullit të Kosovës për t'iu bashkëngjitur Serbisë federale si pjesë përbërëse e saj. Përfundimisht, më 3 shtator 1945, ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë "Mbi caktimin dhe ndërtimin e Rajonit Autonom të Kosovë-Metohi-

[1] Historia e popullit shqiptar - IV, Tiranë 2008, fq. 341.



së" sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome. Ky sanksionim përsëritej edhe në Kushtetutën Jugosllave të janarit 1946[2].

"Kuvendi" i Prizrenit u mbajt dy ditë pas heqjes së Administratës Ushtarake. Njerëzit, të tmerruar pas 5 muajsh masakre e dhune shtetërore të Administratës Ushtarake, nuk guxonin të thoshin hapur atë që mendonin për të ardhmen e tyre politike. Në "Kuvendin" e Prizrenit, as nuk u krijuan kushtet dhe as nuk u realizua e drejta e vetëvendosjes nga shqiptarët.

## Kosova rajon autonom në Kushtetutën jugosllave të vitit 1946

Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë e janarit 1946 përcaktonte tërësinë e federatës me të gjitha subjektet përbërëse, duke përmendur krahas Republikës së Serbisë, të Maqedonisë, të Bosnjë e Hercegovinës, të Kroacisë, të Sllovenisë e të Malit të Zi, Krahinës Autonome të Vojvodinës edhe Rajonin Autonom të Kosovë-Metohisë. Por, në të njëjtën kohë, Rajoni Autonom i Kosovë-Metohisë, së bashku me Krahinën Autonome të Vojvodinës, përfshihej edhe në kuadër të Republikës Popullore të Serbisë[3].

Kushtetuta e RFP të Jugosllavisë e vitit 1946 sanksiononte lidhjen dhe varësinë e dyfishtë të Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë si nga Federata Jugosllave, ashtu edhe nga Republika e Serbisë. Ajo garantonte ekzistencën e RAKM dhe përcaktonte parimet themelore të organizimit e të funksionimit autonom të tij. Si i tillë, RAKM, pavarësisht se ndodhej në përbërje të RP të Serbisë, së pari, ishte kategori kushtetuese e RFP të Jugosllavisë.

Sipas Kushtetutës së RFP të Jugosllavisë të vitit 1946, organi më i lartë pushtetit popullor në RAKM ishte Këshilli Popullor i RAKM, të cilin e zgjidhnin qytetarët, jo në mënyrë të drejtpërdrejt, me mandat trevjeçar. Organi ekzekutiv politik dhe i administratës ishte Këshilli Ekzekutiv i RAKM, qeveria, të cilin e zgjidhte këshilli popullor krahi-

[2] Po aty.
[3] Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë 1999, fq. 120.

nor. Për punën e tij, Këshilli Ekzekutiv i RAKM përgjigje para Këshillit Popullor të RAKM.

Kushtetuta e RFP të Jugosllavisë e vitit 1946 nuk i njihte RAKM autonominë financiare dhe gjyqësore. Gjykata popullore e RAKM, si gjykatë e shkallës së dytë, e formuar më 10 korrik të vitit 1945, ishte suprimuar në dhjetor të po atij viti. RAKM përfaqësohej drejtpërdrejt në Këshillin e Kombeve të Kuvendit Popullor të RFP të Jugosllavisë, nëpërmjet delegacionit të vet, të përbërë prej 15 deputetësh. Në të gjitha forumet tjera politike-shoqërore dhe organet administrative-ekzekutive të federatës, përfaqësuesit e RAKM mungonin, RAKM nuk mund të nxirrte ligjet e veta, por vetëm vendime[4].

## II.
## Statusi kushtetues-juridik i Kosovës (1953-1963)

Pas shpalljes së Rezolutës së Informbyrosë, më 28 qershor 1948, në Jugosllavi u krijua një situatë e ndërlikuar. Qeveria jugosllave çdo qëndrim miratues ndaj Rezolutës së Byrosë Informative e konsideronte si "vepër penale të tradhtisë ndaj shtetit dhe popullit".

Në janar të vitit 1953, Kuvendi Popullor i RFP të Jugosllavisë miratoi "Ligjin Kushtetues mbi bazat e rendit shoqëror e politik në RFP të Jugosllavisë dhe të organeve federative të pushtetit', me të cilin ndryshoheshin një varg nenesh të Kushtetutës federative të vitit 1946[5].

Ligji Kushtetues i RFP të Jugosllavisë i vitit 1953 sanksiononte procesin e decentralizimit që kishte filluar në RFP të Jugosllavisë dhe në bazë të të cilit një pjesë të të drejtave të federatës kalonin në republikat e federale, duke zgjeruar kompetencat e tyre. Konkretisht për RAKM, lidhjet e tij me Federatën Jugosllave u dobësuan, ndërsa kontrolli i RP të Serbisë mbi të u rrit.

U likuidua Dhoma e Këshillit të Kombeve, si dhomë e pavarur në Kuvendit Popullor të RFPJ dhe ia bashkëngjiti atë Këshillit Federativ të Kuvendit Popullor të RFPJ. Ndërkohë u krijua si dhomë e re e

[4] M. Verli, Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate, vëllim II, Tiranë 2007, fq. 304.
[5] Dr. Hysni Bytyqi, Kosova dhe shqiptarët, Prishtinë, 2006, fq.68.



veçantë Këshilli i Prodhuesve, që së bashku me Këshillin Federativ, përbënin Kuvendin Popullor të RFPJ[6].

Ligji Kushtetues i Republikës Popullore të Serbisë, i miratuar më 17 janar të vitit 1953, ruante akoma raportet hierarkike të nënshtrimit të organit përfaqësues ekzekutiv të RAKM jo vetëm ndaj organeve përfaqësuese, edhe ndaj atyre ekzekutive republikane.

Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1963, e forcoi më tej tendencën e shndërrimit të RAKM në subjekt ekskluziv të Republikës së Serbisë.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, e vitit 1963, dëshmonte më hapur për minimizimin e pozitës autonome të Kosovës. Qysh në fillim vëmë re se ajo nuk e përmendte Krahinën si pjesë të veçantë administrative politike të Serbisë, por në një radhë me 17 distriktet e tjera administrative të RSS.

## III.
## Amendamentet kushtetuese e viteve 1971-1972, bazë e ndryshimit të statutit juridik të Kosovës

Në korrik të vitit 1966 në Brione u mbajt Mbledhja e IV e KQ të LKJ, që njihet me emrin Plenumi i Brioneve, i cili shënoi një etapë të re në zhvillimin e Jugosllavisë. Në këtë Plenum u mënjanua rryma unitariste e ultrashoviniste e udhëhequr nga serbët, ku triumfoi rryma më demokratike në krye me Titon e përkrahësit e tij. Vendimet e Plenumit të Brioneve patën një rëndësi të veçantë edhe për Kosovën dhe viset tjera shqiptare jo vetëm sepse u zvogëluan në një farë mase dhuna dhe terrori mbi shqiptarët, por edhe për arsye se për herë të parë do t'u kushtohej kujdes më i madh Kosovës e shqiptarëve dhe zgjidhjes së problemeve të tyre të shumta.

Për herë të parë shqiptarët mund të organizonin jetën e tyre, të paktën në një pjesë të rëndësishme të viseve të tyre etnike, që tani drejtoheshin nga një qendër politike, administrative, nga Prishtina.

[6] Po aty.

Më 1976 u formuan komisionet për ndryshimin e plotësimin e akteve më të larta politike-juridike në Federatë, në republika dhe në krahina autonome[7].

Diskutimet kushtetuese që u organizuan kudo në Kosovë, i udhëhiqte një Komision i Posaçëm në krye të të cilit ishte Fadil Hoxha, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Në shumë tubime të aktivëve politike si në Gjakovë, në Prishtinë, në Gjilan, në Pejë, në Mitrovicë etj....u kërkua që me Kushtetutën dhe ligjet e RSFJ kombësia shqiptare të emërtohej kombi shqiptar, të lejohej përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe Kosova të shpallej Republikë. Në këtë mënyrë kërkohej që popullit shqiptar t'i njihej e drejta e vetëvendosjes.

Përveç diskutimeve kushtetuese, manifestimet me rastin e 500-vjetorit të Skënderbeut, lëvizjet studentore në Evropë (1968), etj... qenë faktorë shtytës në luftën për çlirim e bashkim kombëtar. Pozita e re që fitoi Kosova në sistemin federativ kushtetues të Jugosllavisë, e në të njëjtën kohë dhe në atë të RS të Serbisë, me amendamentet kushtetuese të viteve 1967-1969, ngjalli pakënaqësi te forcat hegjemoniste serbe. Hapat konkretë që u morën për më shumë barazi kulturore, ekonomike e politike të shqiptarëve me popujt tjerë në Kosovë e në Jugosllavi, i shihnin si padrejtësi ndaj popullit serbo-malazez, si qëndrime që “respektonin vetëm interesat e popullit shqiptar.”

Ndërkohë, duke u shprehur kundër të drejtës së ligjshme të popullsisë shqiptare për të qenë të barabartë në Federatën jugosllave, këto forca manifestuan hapur ambiciet e tyre nacionaliste ekstremiste, ku dolën me teza të vjetra si: ”Pozita kushtetuese e KSA të Kosovës është çështje e RS të Serbisë “dhe se sovraniteti dhe shtetësia e krahinës pasqyrohet dhe realizohet nëpërmjet sovranitetit dhe shtetësisë së republikës”, u shprehën hapur në forumet e larta politike të Serbisë, si në Kryesinë e LS të Serbisë (1971) etj.[8]

Tezat e lartpërmendura dëshmuan se udhëheqësit serbë, megjithëse kishin miratuar vendosjen e marrëdhënieve të reja në federatë nuk

[7] Po aty, fq. 92.
[8] Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë .2000, f. 205.



niseshin nga të njëjtat parime kur shtrohej çështja e ndryshimit të statusit politik kushtetues të Kosovës. Kundër këtyre deklaratave e qëndrimeve të tyre u shprehën me guxim forcat përparimtare të krahinës.[9]

Ky konfrontim forcash vazhdoi edhe më i tensionuar gjatë diskutimit të amendamenteve të reja të Kushtetutës federative, të Kushtetutës republikane dhe të Ligjit Kushtetues të KSA të Kosovës, i cili do të rishikohej sërish. Pati në këto momente funksionarë politikë kosovarë që e kuptuan rëndësinë e çastit historik, perspektivën e procesit të decentralizimit të Federatës jugosllave, dhe kërkesën mbarëpopullore në Kosovë, në forumet e ndryshme kërkuan thellimin e mëtejshëm të ndryshimeve kushtetuese.[10]

Jo, pak intelektualë shqiptarë, me argumente hodhën dritë mbi faktorët që çuan në lindjen e Kosovës, si njësi e veçantë territoriale politike, duke veçuar, së pari faktorin kombëtar. Ata theksonin dhe dëshmonin se shqiptarët e Kosovës në të gjitha dokumentet e partisë dhe të pushtetit gjatë LANÇ quheshin komb ose popull e jo kombësi. Me argumente historike shkencore u kundërshtuan dhe pikëpamjet antishqiptare të shfaqura në simpoziumin e Novi Sadit nga dr. Radomir Lukiç dhe dr. Jovan Gjorgjeviç, të cilët mohonin qenien e Kosovës si element kushtetues i Federatës jugosllave.[11]

Me të drejtë, prej politikanëve kosovarë, konstatohej se pas ndërrimeve kushtetuese të vitit 1968-69, nevoja për pozitë më të avancuar të krahinave ishte bërë domosdoshmëri të zhvillimit historik dhe se, në këtë kuadër përvoja po diktonte nevojën për një rol të ri e vendimtar të KSA të Kosovës në RSF të Jugosllavisë. Gjatë diskutimit të amendamenteve të fundit të Kushtetutës së RSFJ, nga Kosova pati mjaft kërkesa që të përcaktohej qartë funksioni legjislativ i krahinave autonome. Për këtë qëllim përfaqësuesit nga Kosova si: E. Stavileci, S. Kurteshi, H. Hoxha, në publikimet e tyre shtronin nevojën për autorizime më të gjëra, të drejta burimore për mbrojtjen popullore, të siguri-

[9] Po aty.
[10] Syrja Pupovci, Nuk është shkencë ajo që predikon pabarazi, Përparimi ,” Prishtinë”. 10 prill 1971, fq. 205.
[11] Po aty, fq. 207.

mit shtetëror, të planifikimit shoqëror, të politikës së jashtme, duke u formuluar juridikisht të drejtat, kompetencat dhe funksionet e federatës ashtu edhe ato të republikave e të krahinave.[12]

Në fushën e planifikimit shoqëror, të mbrojtjes popullore e të sigurimit të shtetit, Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës edhe më parë, me amendamentet kushtetuese të vitit 1968-69, i njiheshin disa të drejta burimore. Por, fakti që RS Serbisë e kishte unifikuar pjesën dërrmuese të këtyre të drejtave, kishte sjellë për rrjedhojë pasivitetin e minimizimin e rolit të krahinave në fushat e lartpërmendura.[13]

Edhe në fushën e politikës së jashtme, KSA e Kosovës nuk kishte të drejta burimore. Andaj, përfaqësuesit kosovarë theksonin se Kosova si bashkësi kufitare ishte posaçërisht e interesuar të ushtronte funksione kontrolluese në qarkullimin e njerëzve dhe të gjërave tjera të rëndësishme të shtetit. Gjithashtu në kërkesat e kosovarëve dhe në diskutimet publike, kërkohej që në fushat e arsimit, të mbrojtjes shëndetësore dhe asaj sociale, të kulturës dhe të shkencës, të kalonte krejtësisht në organet e Kosovës. [14]

Nisur nga fakti se parimi i barazisë së kombeve dhe kombësive, respektivisht i republikave dhe i krahinave, u ngrit në nivel kushtetues federativ, kosovarët shtronin nevojën e pasqyrimit konsekuent e të plotë të këtij parimi si në amendamentet e reja të Kushtetutës së RS të Serbisë, ashtu edhe në ligjin kushtetues i KSA të Kosovës i vitit 1969, që ende nuk e shprehte në mënyrë adekuate pozitën e re kushtetuese të krahinës dhe autonomitetin e saj.

Në amendamentet e reja të vitit 1971-1972, marrëdhëniet krahinë-federatë rregulloheshin drejtpërdrejt me kushtetutën federative jugosllave. Por, duke qenë se KSA e Kosovës ishte edhe në kuadër të RS të Serbisë, kjo u shfrytëzua nga politikanët e juristët serbë për të ruajtur sa qe e mundur pushtetin e Serbisë në Kosovë.[15]

---

[12] E. Stavileci, Autonomia dhe federalizmi.”Përparimi”, Prishtinë 1971, nr. 1, f. 1.
[13] H. Hoxha, Barazia e pakicave kombëtare, Prishtinë. 1984. f. 132.
[14] Po aty, f. 2.
[15] K. Salihu, - Lindja, zhvillimi, pozita dha aspekte e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste. Prishtinë, 1984. fq. 176.



Por kishte edhe marrëdhënie të tjera unike, që rregulloheshin jo si më sipër, por me një kategori tjetër ligjesh republikane, sipas të cilave, krahinat nuk kishin gjithnjë të drejtë të nxirrnin ligjet e veta. Në këtë mënyrë Republikës së Serbisë edhe me amendamentet e reja i garantohej pushtet jo i vogël në legjislacionin krahinor. Krahinës i jepeshin të drejta me vëllim më të kufizuar se republikës. Në çështjet e saj , për gjërat unike krahina duhej të autorizohej nga republika.[16]

Ndryshimet në Ligjin kushtetues të KSA të Kosovës, Kuvendi Krahinor i miratoi në shkurt 1972. Me amendamentet e reja KSA e Kosovës siguronte të drejta burimore për organizimin e vet, për përcaktimin e politikës ekonomike, tatimore dhe të sistemit të financimit.

Amendamentet e reja federative, duke ngritur në nivel kushtetues parimin e barazisë së kombeve dhe kombësive, e lidhur me këtë, parimin e pavarësisë së republikave dhe të krahinave, bënë që edhe KSA e Kosovës të merrte përgjegjësi për zhvillimin e vet ekonomik, shoqëror e politik, si dhe për funksione të tjera në federatë. Megjithëse amendamentet linin në kompetencat e federatës, mbrojtjen e vendit, sigurimin shtetëror, marrëdhëniet me botën e jashtme, si dhe kujdesin për zhvillimin e viseve jo mjaft të zhvilluara. Krahina e Kosovës ashtu si edhe republikat ishte bashkëpjesëmarrëse edhe në këto fusha, në saje të të drejtave që ia garantonte Kushtetuta e RSFJ.[17]

Gjithashtu institucioni i marrëveshjes që me amendamentet e reja u ngrit në nivel kushtetues federativ, e solli në një pozitë dhe rol të ri KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës jugosllave. Institucioni i marrëveshjes propozonte që krahinat bashkë me republikat të vendosnin për punët e federatës mbi parimin e ujdisë (konsensusit) d.m.th. që një organ federativ në të cilin merrnin pjesë përfaqësues të republikave dhe krahinave, mund të miratonte një vendim vetëm kur për të jepnin pëlqimin të gjithë anëtarët e tij.[18]

Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974 që funksionoi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë, u siguronte Krahinës Autonome të

---

[16] Po aty.
[17] Noel Malcolm,- Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë. 1998, fq 341.
[18] A. Lalaj, - Kosova …vep e perm., f.239.

Kosovës dhe asaj të Vojvodinës, një status të barabartë, në shumë rrafshe me ato të gjashtë republikave. Ato tani kishin përfaqësuesin e tyre të drejtpërdrejt në forumet kryesore të Federatës jugosllave.... Në këtë kushtetutë ishin përfshirë edhe ndryshimet e rëndësishme që tashmë ishin bërë pjesë e amendamenteve të miratuara, më 1971: këto u kishin dhënë krahinave autonome status të barabartë me republikat në shumë forma të marrjes së vendimeve për çështje të ndryshme shtetërore.[19]

Amendamenti XXXVI përcaktonte se Presidenca e Jugosllavisë ishte një trup kolektiv me dy përfaqësues, nga çdo republikë dhe me nga një përfaqësues, nga çdo krahinë autonome. Kushtetuta e vitit 1974 siguronte edhe një të drejtë tjetër të rëndësishme, sipas së cilës, krahinat autonome mund të nxirrnin kushtetutat e tyre.

Në këtë mënyrë KSA e Kosovës, në bazë të institucionit të marrëveshjes, gëzonte të drejtën për të deklaruar qëndrimin e vet dhe për të dhënë pëlqimin në të gjitha vendimet që miraton federata. Vota e krahinave, në bazë të parimit të paritetit, ishte e barabartë me atë të republikave. Edhe në kuadrin e politikës së jashtme të RSFJ dhe marrëveshjes ndërkombëtare të nënshkruar në nivel federate. KSA e Kosovës kishte të drejtë të nxirrte ligje të reja ose t'i ndryshonte ato ekzistueset, si dhe të bashkëpunonte drejtpërdrejt me institucione të ndryshme të shteteve nënshkruese të marrëveshjes dhe me organizatat ndërkombëtare.[20]

Siç shihet amendamentet e vitit 1971, në pikëpamje juridike kushtetuese, i siguronin KSA të Kosovës disa elemente shtetësie të lidhura ngushtë me to edhe qenien si element kushtetues i Federatës jugosllave. Por, duke qenë se statusi i elementit kushtetues të federatës ishte kompleks, kërkonte veprimtari intensive praktike të institucioneve krahinore brenda hapësirave të sanksionuara nga legjislacioni i kohës, mund të themi se amendamentet e vititt 1971 krijonin vetëm mundësi juridike për realizimin e tij. Por, mundësitë nuk janë e njëjta

[19] Po aty. Fq. 240.
[20] Blerim Reka, - Rrënimi i autonomisë së Kosovës, Prishtinë. 1992.



gjë me realitetin. Shkalla e pjesëmarrjes së KSA të Kosovës në përcaktimin dhe zbatimin e politikës së federatës, njësoj si republikat tjera si dhe përgjegjësia që ajo do të kishte për këtë veprimtari, do të duhej të kishte një guxim më të madh të politikës kosovare dhe të një kuadri më të shkathët të Kosovës për t'u bërë rezistencë më të fuqishme presioneve dhe propagandës që vinte nga forcat nacionaliste dhe hegjemoniste të Serbisë.[21]

Pse atëherë nuk u ndërmor edhe hapi i fundit për shndërrimin e krahinave autonome në republika si krahinat tjera? Për këtë ekzistojnë shumë përgjigje, por më e rëndësishmja është se stafi politik i Kosovës, as atëherë por as sot nuk arrijti, e nuk është duke mundur të realizojë qëllimin shekullor të shqiptarëve.

## IV.
## Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974

Vitet 50-të dhe 60-të, nga këndvështrimi i shqiptarëve, janë pika më e ulët e tërë sundimit të periudhës të Titos dhe e një pabarazie të madhe etnike, e cila nuk u përmirësua, kur dihet se serbët dhe malazeztë të cilët nuk e përbënin as 17% të popullatës së Kosovës, në saje të regjistrimit të vitit 1953, e përbënin 70% të administratës dhe posteve udhëheqëse.[22]

Këtyre problemeve ekonomike dhe shoqërore, do shtuar edhe statusin “autonom” të Kosovës, i cili ra në pikën absolute më të ulët në nivel të tij, në saje të Kushtetutës së re të Jugosllavisë, të vitit 1963. Megjithëse kjo kushtetutë i solli Kosovës titullin e Krahinës autonome, e cila përcaktonte se republikat kishin të drejtë të formonin krahinat e tyre autonome në saje të iniciativës së tyre, kurse Krahina Autonome e Kosovës dhe ajo e Vojvodinës ishin themeluar me vendim të Kuvendit të Serbisë. Për të parën herë, statusi kushtetues i

[21] Ukshin Hoti, -Filozofia e çështjes shqiptare. Tiranë, 1995.
[22] Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë. 1998, fq. 336.

Kosovës, kishte humbur tërësisht ingjerencat e nivelit federativ dhe ishte vënë vetëm në kuadrin e funksionit të Republikës së Sërbisë.[23]

Me amendamentet kushtetuese të vitit 1967-1972 u bë një reformë e rëndësishme në marrëdhëniet e federatës me republikat e krahinat, u bë ndarja e funksioneve shtetërore midis qendrës federative dhe njësive që e përbënin. U rrit funksioni i republikave dhe i krahinave qoftë si subjekte të federalizmit jugosllav, ashtu edhe si bashkësi të veçanta me funksione politike shoqërore. [24]

Mirëpo, amendamentet e miratuara sollën ndryshime vetëm në disa fusha të sistemit kushtetues. Andaj, vënia në jetë e këtyre amendamenteve qysh në fillim hasi në vështërsi që s'mund të kapërceheshin pa një përpunim të mëtejshëm, më të plotë e më preciz të disa çështjeve themelore, si në sistemin politik në tërësi[25] Për të harmonizuar në nivel federate zgjedhjet kushtetuese të republikave dhe krahinave të veçanta, u krijua Komisioni Koordinues federativ.

Me pëlqimin e kuvendeve të republikave dhe të krahinave për zgjidhjet bazë, Komisioni Koordinues dhe komisioni ekzistues për çështje kushtetuese, së bashku, në prill të vitit 1973, arritën të hartojnë Projektin e Kushtetutës së re të RSFJ, i cili në korrik u dha për diskutim publik, edhe Projektkushtetutat republikane dhe krahinore.[26]

Në debatin publik që u zhvillua në mjedise të gjera, ku morën pjesë të gjitha strukturat e gjëra shoqërore, kudo pati interesim të madh, siç njoftonin mjetet e informimit në atë kohë. Edhe në Kosovë debati kushtetues u vlerësua nga kosovarët si veprimtari me shumë përgjegjësi.

Pas debatit publik që zgjati më shumë se gjysmë viti, Kuvendi federativ miratoi më 21 shkurt 1974, kushtetutën e re të RSFJ. Disa ditë më vonë secili kuvend republike dhe krahine autonome miratoi kushtetutën e vet. Kushtetuta e RS të Serbisë u miratua më 25 shkurt,

[23] Po aty, fq. 337.
[24] Esat Stavileci, Autonomia dhe federalizmi, Përparimi, Prishtinë 1971, nr. 1, f. 71.
[25] Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë. 2000, fq. 223.
[26] Po aty.



kurse Kushtetuta e KSA të Kosovës, më 28 shkurt të vitit 1974. Kjo ishte kushtetuta e parë e KSA të Kosovës.

Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974, nuk kishte kapitull të veçantë për krahinat autonome, por ato e gjenin veten në mjaft prej neneve të saj, duke filluar madje që nga parimet themelore mbi të cilat ishte ndërtuar gjithë sistemi ekonomik, politik e shoqëror i federatës. Kushtetuta Federative e përcaktonte KSA të Kosovës si pjesëmarrëse të drejtpërdrejtë në kushtetutën e federatës.[27]

Në kushtetutën e RSFJ të vitit 1974, pjesëmarrja sipas institucionit të paritetit të republikave dhe krahinave në organet federative dhe vendimmarrjet përmes institucionit të marrëveshjes, sanksionohej si në pjesën parimore ashtu edhe në pjesën normative të saj. Në nene të veçanta jepej mënyra konkrete e pjesëmarrjes dhe e procedurës së vendosjes së republikave dhe krahinave autonome në organet e ndryshme të federatës. Por, në dallim nga parimet themelore, në këto nene shihet se pjesëmarrja e republikave dhe e krahinave nuk është plotësisht e barabartë. Ky diferencim fillonte qysh në organin më të lartë të pushtetit dhe të vetëqeverisjes shtetërore, në Kuvendin e RSFJ.[28]

Gjendja e shqiptarëve në Kosovë u përmirësua dukshëm nga vitet e 70, e sidomos me nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës, së paku në çështjet e teorisë kushtetuese. Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974, që mbet në fuqi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë, i siguronte Krahinës Autonome të Kosovës një status të barabartë, në shumë rrafshe me ato të republikave.

Në veprimtarinë legjislative të KSA të Kosovës, duhet të kemi parasysh që krahas çështjeve që krahina i rregullonte me ligjet e veta dhe në mënyrë të pavarur, e kishte edhe çështje të tjera për të cilat shprehej me ligje federative. Sipas Kushtetutës së RSF të Jugosllavisë, ligjet federative konsideroheshin shprehje e interesave të përbash-

[27] K. Salihu, Amandamentet kushtetuese vazhdim i politikës së barazisë së kombeve dhe kombësive ,"Përparimi", Prishtinë1971, nr. 4, fq. 279.
[28] Po aty, fq. 226.

këta të kombeve dhe të kombësive, e si të tilla ato kishin fushëveprim si në republikat e federale, ashtu edhe në krahinat autonome.[29]

Por, në disa fusha që Kushtetuta federative i kishte caktuar “me interes të përbashkët”, krahina kishte gjithashtu të drejtë të nxirrte normat e veta juridike. Fjala ishte për disa çështje e marrëdhënie që krahina me ligjet e dispozitat e veta i rregullonte hollësisht deri atëherë kur për to ende nuk ishin miratuar e nuk vepronin ligjet federative.[30]

Megjithatë, veprimtaria legjislative e krahinës pas shpalljes së kushtetutës, pavarësisht se pati rritje në krahasim me të kaluarën, ishte nën parashikimet dhe nevojat reale.

KSA e Kosovës karakterizohej nga lidhje e dyfishtë hierarkie. Ajo ishte në të njëjtën kohë element kushtetues i Federatës jugosllave dhe njësi autonome në kuadër të RS të Serbisë.

Kushtetuta e RS të Serbisë, në nenin 299, përcaktonte marrëdhëniet që rregulloheshin njësoj për republikën dhe krahinat dhe për të cilat krahinat nuk mund të nxirrnin dispozitat e veta. Ndërsa neni 300 përcaktonte çështjet që rregulloheshin me ligjin republikan në mënyrë unike për tërë territorin e Serbisë e të krahinave autonome, por ku krahinat kishin të drejtë të nxirrnin ligjet e veta, për ato çështje që nuk ishin rregulluar me ligjin republikan. Në këtë kontekst, jo vetëm për nga vëllimi, por edhe nga terminologjia e papërcaktuar, në Kushtetutën e RS të Serbisë kishte mjaft hapësirë në paraqitjen e funksioneve unike. Të gjitha këto krijonin pasiguri e kontradikta në marrëdhëniet midis republikës e krahinave, pasi linin vend për mëdyshje, duke hapur diskutime të panevojshme e duke gjetur zgjidhje të ndryshme varësisht nga raporti i forcave republikane e krahinore në momentin e vendosjes.[31]

Është e vërtetë e më se e qartë se RS e Serbisë, në emër unitetit, me anë të ligjeve unike punonte për të ruajtur forcën e saj dhe pushtetin dominues centralist mbi Kosovën, duke zgjedhur kuadër e njerëz

[29] Po aty, fq.230.
[30] Po aty.
[31] K. Salihu, Lindja... Vep e përm., f. 95-99.



me të cilët më lehtë mund të punonte e realizonte qëllimet e saj shtetërore.

Me Kushtetutën e RS të Serbisë ekzistonte edhe një nen tjetër, ai 301, sipas të cilit, me ligjin republikan në bazë të marrëveshjes, mund të rregulloheshin në mënyrë unike për territorin e republikës edhe ato çështje, të cilat republika e krahinat i rregullonin pavarësisht nga njëra-tjetra, secila në territorin e vet. Sipas këtij neni të Serbisë, respektohej vullneti i secilit subjekt, si për nxjerrjen e ligjit unik, ashtu edhe për t’u tërhequr e për të rregulluar këto marrëdhënie me ligjin e vet. Ligjin unik e nxirrte Kuvendi RS të Serbisë, pasi të kishte marrë pëlqimin prej kuvendeve të krahinave [32].

Për të pasur një përfytyrim më real për shkallën e autonomisë që kishte arritur KSA e Kosovës me aktet kushtetuese të vitit 1974, është e nevojshme që t’i kuptojmë edhe në funksionet tjera të saj, si në atë ekzekutiv, financiar, gjyqësor, arsimor, e kulturor.

Për zgjidhjen e konflikteve, që mund të lindnin midis ligjeve republikane e dispozitave juridike të kuvendeve krahinore gjatë zbatimit të ligjeve unike, vepronte një Këshill i Posaçëm pranë Gjykatës së Lartë të Serbisë.

Në bazë të autorizimeve që rridhnin nga ligji republikan për mbrojtjen e përgjithshme popullore, KSA e Kosovës me kushtetutën e vet ka caktuar organet si dhe detyrat e të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes popullore ( Kryesinë e krahinës, Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit, Këshillin e Mbrojtjes Popullore, Shtabin Kryesor për Mbrojtjen Popullore e civile, dhe Sekretariatin krahinor të Mbrojtjes Popullore).[33]

Duke qenë se në sistemin politik jugosllav gjykatat ishin organizuar mbi parimet unike, ishte kërkesë kushtetuese që ligjet republikane e krahinore të harmonizoheshin dhe të mos bien ndesh me kushtetutën jugosllave, por të harmonizohen dhe të koordinohen në bazë të sistemit të shumicës.

[32] Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës..., .kap.III.
[33] Po aty.

Gjithsesi, kushtetuta e re e Kosovës, si një proces pozitiv i pas vitit 1966, ka në përmbajtje përpjekjet e përbashkëta të gjitha kombeve dhe kombësive të krahinës, për të zhvilluar më tej statusin politik shoqëror e ekonomik të saj.

Për të pasur kushtetutën e tyre, kosovarëve iu është dashur të zhvillonin një luftë të ashpër me forcat nacionaliste e konservatore në Kosovë, në serbi e në Jugosllavi. Në këtë kushtetutë, gjithmonë brenda sistemit ekzistues hibrid të vetadministrimit, ishte shtuar mëvetësia, por edhe përgjegjësia e krahinës për zhvillimin e vet të përbashkët. Pozita e re kushtetuese e KSA të Kosovës e vitit 1974, ishte një segment i përvijimeve përparimtare të kohës. Për këtë qëllim vetë pozita kushtetuese e Kosovës dëshmon procesin demokratik që ndodhte në Kosovë, e në gjithë Jugosllavinë. Megjithatë, duhet thënë se problemi i Kosovës nuk ishte vetëm kushtetues, po edhe shumë më shumë sesa kushtetues. Me veprimet e vetë përfaqësuesve të pushtetit në krahina, mund të plotësoheshin shumë boshllëqe midis parimeve të shpallura dhe praktikave të përditshme.

Pavarësisht nga arritjet pozitive për autonominë e Kosovës, që bartte sistemi kushtetues i vitit 1974, ai kishte edhe kufizimet e veta. Parimi kushtetues i barazisë kombëtare që sanksiononte Kushtetuta e RSF të Jugosllavisë për statusin politik të popullit shqiptar, respektivisht të KSA të Kosovës, nuk ishte konsekuent. Kjo shihej në gjithë përmbajtjen e Kushtetutës, po edhe me rastin e ngjarjeve të pas vitit 1981, deri në mbarim të luftës së fundit.

Përmasat e statusit të KSA të Kosovës nuk ishin konsekuente. Përmasat e statusit të KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës jugosllave ishin të pamjaftueshme për ta zgjidhur drejt e përfundimisht problemin kosovar. Pavarësisht se pozita e KSA të Kosovës në sistemin federativ ishte përcaktuese për statusin e saj, në raportin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, legjislacioni serb, me ligjet e veta unike, e reduktonte dhe e çrregullonte mjaft shumë veprimtarinë e pavarur të krahinës.

Me zhvillimin e një klase të re të shqiptarëve të shkolluar e të edukuar-njëmend, një klasë që ishte tepër e madhe për numrin e vendeve



ekzistuese për një personel të këtillë në sistemin ekonomik ende tepër të pazhvilluar të Kosovës- pabarazia etnike në disa fusha të jetës publike, u korrigjua pjesërisht, ku u dashtë të kalonte ca kohë për zhvillimin e këtij procesi deri me amendamentet e vitit 1971.[34]

## Përfundim

Në qoftë se viti 1963 ishte pika më e ulët e interesave kombëtare shqiptare në Kosovën titiste, atëherë viti 1974, ishte kulmi i interesave kombëtare shqiptare, së paku në çështjen e teorisë së të drejtave të një populli. Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974 - që do të mbetej në fuqi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë - u siguronte Krahinës Autonome të Kosovës dhe asaj të Vojvodinës një status të barabartë, në shumë rrafshe me ato të republikave, ku ato tashti kishin përfaqësuesin e tyre të drejtpërdrejtë në forumet kryesore të Federatës jugosllave.[35]

Në këtë kushtetutë ishin përfshirë edhe ndryshimet e rëndësishme që ishin bërë në bazë të serisë së amendamenteve të miratuara, më 1971: këto u kishin dhënë krahinave autonome status të barabartë me republikat në shumë forma të marrjes të vendimeve për çështje ekonomike, madje edhe marrjes së vendimeve në disa fusha të politikës së jashtme. Amendamenti XXXVI përcaktonte se Presidenca e Jugosllavisë ishte një trup kolektiv me dy përfaqësues, nga çdo republikë dhe me nga një përfaqësues, nga çdo krahinë autonome[36].

Megjithëse Kushtetuta e vitit 1974, vazhdonte të deklaronte se Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë të Serbisë, në saje të shumicës së kritereve të Ligjit kushtetues, ato ishin në të njëjtën kohë, po të njëjta dhe me të drejta të plota të forumeve federale.[37] Pavarësisht nga arritjet pozitive për autonominë e Kosovës, që bartte sistemi i amendamenteve kushtetuese, ai kishte edhe kufizimet e veta. Përmasat e statusit

[34] Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë 1998, fq. 340.
[35] Kushtetuta e Krahinës Socialiste e Kosovës ..., vep. e përm, Neni 3.
[36] Po aty.
[37] Po aty.

të KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës jugosllave, ishin të pamjaftueshme për ta zgjidhur drejt e përfundimisht problemin kosovar[38].

Edhe pse në sistemin kushtetues të vitit 1974, statusi i popullsisë shqiptare diferencohej nga ai i pakicave të tjera kombëtare, duke u konsideruar kombësi e madhe dhe duke krijuar formën e vet të organizimit politik, shoqëror të Krahinës Socialiste Autonome, ajo nuk e zgjidhi problemin kombëtar të popullsisë shqiptare në Kosovë.

Kosova, përsëri nuk kishte status që e meritonin shqiptarët në Jugosllavi. Pavarësisht tendencave për të barazuar në fusha të ndryshme funksionet e krahinave autonome me republikën, pavarësisht të gjitha pengesave që paraqiteshin, Kushtetuta e RSF të Jugosllavisë e vitit 1974, i krijonte KSA të Kosovës hapësira të reja për një evoluim të mëtejshëm të statutit të saj. Historia e pranon një realitet të tillë evolucionesh që shkojnë drejt tendencave për kërkesa, aspirata dhe përpjekje të popullit të atij vendi për t'u barazuar me popujt shtetformues të një vendi.

Pas vdekjes së Titos dhe ngjarjeve të vitit 1981, statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vetë Krahinës Autonome të Kosovës erdhi duke u minimizuar. Ky fenomen u forcua dhe u shpejtua pas ardhjes së Milloshevigit si president i Serbisë, më 1985, i cili u mbështet në forcat më konservatore e nacionaliste serbe. I inkurajuar nga heshtja e faktorit ndërkombëtar dhe i republikave tjera jugosllave ndaj problemit të Kosovës, si dhe për të forcuar pushtetin serb në Jugosllavi, filloi të luajë me kartën nacionaliste që është e njohur si teori e luftërave gjatë tërë historisë, për të sensibilizuar opinionin serb për pozitën e disfavorshme kushtetuese, territoriale, ekonomike e shoqërore të Republikës së Serbisë në Federatën jugosllave.

[38] Ana Lalaj, vep e cit, fq.243.



*Literatura:*


- HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR IV (Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990, Redaktor shkencor, prof. Dr. Xhelal Gjeçovi, Toena, Tiranë 2008.
- LALAJ, Ana, KOSOVA RRUGA E GJATË DREJT VETËVENDOSJES, Tiranë 2000.
- MALCOLM, Noel, KOSOVA NJË HISTORI E SHKURTËR, Prishtinë 1998.
- SALIHU, Kurtesh, LINDJA, ZHVILLIMI, POZITA DHE ASPEKTET E AUTONIMITETIT TË KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS NË JUGOSLLAVINË SOCIALISTE, Prishtinë, 1984.
- HOTI, Ukshin, FILOZOFIA E ÇËSHTJES SHQIPTARE, Tiranë 1995.
- HOXHA, Haradin, BARAZIA E PAKICAVE KOMBËTARE, Prishtinë 1984.
- PUPOVCI, Syrja, NUK ËSHTË SHKENCË AJO QË PREDIKON PABARAZI, Prishtinë. 10. Prill. 1971.
- KUSHTETUTA E KSA E KOSOVËS E VITIT 1974, Prishtinë 1974.
- KOSOVA NË VËSHTRIM ENCIKLOPEDIK, Toena , Tiranë 1999.
- VERLI, Marenglen, SHQIPËRIA DHE KOSOVA, HISTORIA E NJË ASPIRATE, vëllimi II, Botinpex, Tiranë 2007.
- BYTYÇI, Hysni, KOSOVA DHE SHQIPTARËT, POZITA KUSHTETUESE-JURIDIKE E SHQIPTARËVE NË ISH – JUGOSLLAVI, Prishtinë 2006.
- SALIHU, Kurtesh, AMENDAMENTET KUSHTETUESE VAZHDIM I POLITIKËS SË BARAZISË SË KOMBEVE DHE KOMBËSIVE, "Përparimi", Prishtinë 1971, nr. 4, fq. 279.

*Ramadan Shkodra*

# THE CONSTITUTIONAL POSITION OF KOSOVA IN THE YUGOSLAV FEDERATION BETWEEN 1946-1974 HISTORICAL OVERVIEW

**(Summary)**

## Introduction

After WWII, the objective course of events which led towards the just solution of the Kosova issue was interrupted. The Albanian population of Kosova was subjected to oppression and violence from the communist leadership of Yugoslavia, in particular by Serbs. The promise that the people of Kosova would be guaranteed the right to self-determination was not kept. While the partisan brigades (from Kosova and Albania) marched towards the north fighting alongside the other peoples of Yugoslavia for the liberation of Yugoslavia, the Albanian population in Yugoslavia was subjected to brutal national oppression, thousands were arrested, terrorized and persecuted, the use of the national flag was banned, Albanians were dismissed from work and replaced by Serbs. Corpses littered the streets of towns and villages throughout Kosova.



*رمضان شكودرا*

# الموقف الدستوري لكوسوفا في الاتحاد اليوغوسلافي خلال السنوات 1946–1974

**(خلاصة البحث)**

**(لمحة تاريخية)**

**مقدمة**

بعد الحرب العالمية الثانية انقطع مجرى الاحداث التي كانت تؤدي إلى حل لمسألة كوسوفا و السكان الألبان في كوسوفا واجهوا الضغوط و التزوير والعنف من قادة الشيوعيين اليوغوسلافيين و خاصة الصرب منهم . و نسيت تصريحاتهم الواعدة في تقرير المصير للألبان بعد الحرب. في حين كانت الالوية الالبانية يسيرون شمالا و يقاتلون جنبا الى جنب مع الشعوب اليوغسلافية لتحرير كل شبر من أراضي يوغسلافيا. و فى نفس الوقت على سكان الالبان في يوغسلافيا مورست ضغوط مختلفة اذ كانت هناك اعتقالات والإرهاب والاضطهاد للألبان و منع استخدام العلم الوطني و تم ابعاد المسؤولين الالبان و تم استبدالهم من قبل الصرب. ووجدت جثث ضحايا الالبان المعذبين في كل مكان في شوارع المدن والقرى في كوسوفا.

*Zachary Karabell*

# EVROPA DHE PERANDORIA OSMANE

Kur përfundimi erdhi më në fund, ishte katastrofë. Ajo ishte gjithashtu e pakuptimtë. Pas më shumë se një mijë vjet, qyteti i Kostandinopojës, vatra e perandorisë më të madhe që bota e krishterë ka njohur, u pushtua nga një ushtri myslimane. Por, derisa Sulltani Mehmedi II, që më pas u bë i njohur si “Pushtuesi”, marshoi në Kishën e Aja Sofisë, në qendër të Kostandinopojës, Bizanti që atëherë pushoi së ekzistuari si perandori, përveç si emër.

Mehmedi erdhi në pushtet i ngarkuar me kompleksin real Oedipal. Babai i tij, Murati, kishte zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme kufijtë e sundimit otoman, dhe kur Murati vdiq më 1451, Mehmeti e pasoi atë - për herë të dytë. Pas fitoreve kundër hungarezëve dhe serbëve, Murati abdikoi më 1444, për t’u kthyer vetëm nga gjykata kur Mehmeti adoleshent, kokëfortë dhe përbuzës i këshilltarëve të babait të tij, u dëshmua i paaftë për të qeverisur me efikasitet dhe jo i gatshëm të punojë me vezirin e caktuar nga Murati, për ta udhëhequr princin e ri. Megjithëse nuk ka dokumente për atë që kishte ndjerë Mehmeti kur u emërua dhe pastaj befas u largua nga babai i tij autoritar, është vështirë të besohet se e mori këtë me lehtësi. Në portrete, nga fytyra e tij e definuar nga hunda e gjatë dhe e mprehtë dhe mjekra klasike e një



princi otoman, është e vështirë të dallohet karakteri i tij. Por, sjellja e tij e mëvonshme sugjeron se ai kurrë nuk ia fali apo harroi atë që babai i tij kishte bërë që Kostandinopoja pagoi çmim të lartë dhe fatal.

Babai i tij kishte fituar gati çdo konfrontim me gati çdo kundërshtar, me të cilin otomanët ishin përballur, por një çmim e shmangu atë. Kostandinopoja ishte marrë saktësisht njëherë, më 1204, por jo nga myslimanët. Venedikasit kishin arritur atë që asnjë fuqi tjetër nuk e kishte bërë - as sllavët, as hunët, as vala e parë e ushtrive arabe që ishin shfaqur në shekujt VII dhe VIII, dhe as turqit selxhukë në shekullin e njëmbëdhjetë. Për pesëdhjetë vjet pas plaçkitjes brutale të Kostandinopojës më 1204, latinët sunduan qytetin perandorak, dhe perandori bizantin qëndroi në mërgim. Në mes të shekullit të XIII, u kthye familja perandorake, por jotriumfuese. Për dyqind vjetët e ardhshme, Bizanti ishte më shumë emër dhe legjendë sesa fuqi reale e aftë të përcaktojë se çka të zhvillohej në lindje të Mesdheut apo në Ballkan. Duke kontrolluar vetëm disa mijëra milje katrorë tokë, sundimtarët modernë të perandorisë dikur të fuqishme shikonin të paaftë otomanët që po i mbyllnin në qytetin e tyre.

Megjithëse Bizanti ishte tkurrur dhe perandoria e saj ishte kthyer në një njeri me mantel, i cili mezi arrinte të mblidhte pesë mijë njerëz për të mbrojtur qytetin, ai mbeti simbol i fortë si relikti i fundit e Romës. Vetëm për këtë arsye, ishte cak meritor për ambiciet e Mehmedit të ri. Madje me një grusht mbrojtësish, muret e qytetit dhe vendosja e tij strategjike midis ujërave të Cepit të Artë dhe Bosforit paraqisnin një sfidë të vështirë për çdo kundërshtar që dëshironte ta pushtonte atë. Teknologjia e rrethimit nuk kishte avancuar mjaft për të çarë mbrojtjen. Nga majat matanë skajit të ujërave, disa mbrojtës mund të shkatërronin anijet që tentonin të ankoronin. Disa nga paraardhësit e Mehmetit ishin përpjekur ta merrnin qytetin dhe kishin dështuar, madje numerikisht më të shumtë. Kostandinopoja ishte e dobët, por akoma mund të mbronte veten.

Mehmedi ishte i vrullshëm, arrogant dhe vlonte nga fyerja, por madje edhe në moshën 21-vjeçare, e dinte më së miri për të sulmuar qytetin të papërgatitur. Ai përgatiti një ushtri të madhe, krijoi flotën

dhe autorizoi ndërtimin e një artilerie vigane para se të niste sulmin kundër Kostandinopojës në pranverën e vitit 1453.

Bizantinët bënë më të mirën që mundën. Disa anije e mercenarë gjenuezë dhe venedikas erdhën t'i ndihmojnë, derisa shumica e Evropës refuzoi kërkesën e perandorit të Kostandinopojës për ndihmë. Disa të krishterë perëndimorë sugjerojnë se nëse perandori do të ishte i gatshëm t'i përkulej papës, do të merrte ndihmë më aktive, por ky nuk ishte çmimi që ishte i gatshëm të paguante. Derisa Kisha Romake kishte shpallur veten si autoriteti doktrinar suprem në Perëndim, Kisha Ortodokse Lindore kurrë nuk e kishte pranuar që papa ishte diçka më shumë sesa peshkopi i Romës, i denjë për respekt, por jo përkulje. Duke pasur zgjedhjen midis kapitullimit ndaj papës dhe dorëzimit të otomanëve, Kostandinopoja preferoi të pafetë. "Më mirë turbani i myslimanit midis Kostandinopojës", thoshte shprehja, "sesa shamia e kokës së latinit". Perandori Konstantin ishte lënë me dredhinë e tij, njohurinë e brendshme të mureve që ishin ndërtuar nga perandori Teodosius, një mijë vjet më parë. Dhe këto nuk mjaftonin.

Megjithëse Konstantini ndante emrin e themeluesit të qytetit, ai nuk ndante fatin e njëjtë. Gjeneralët otomanë bënë atë që ishte konsideruar e pamundshme dhe çanë portën e hekurt që mbronte Cepin e Artë nga anijet armike. Mehmeti kishte numrat në anën e tij, dhe shfrytëzoi dendësinë e mbrojtjes dhe dobësitë në fortifikime. Dhjetëra mijëra ushtarë të tij u futën në qytet dhe e pushtuan atë. Konstantini hoqi simbolet e tij perandorake, u përfshi në sulmin e furishëm dhe vdiq. Ai deklaroi se nuk do të kujtohet si perandori, i cili shpëtoi qytetin më të madh në botë në momentet më të nevojshme të tij.

## Liria e religjionit dhe "Pushtuesi"

Ushtria otomane hyri në qytet, më 29 maj 1453. Pasi bizantinët kishin refuzuar të dorëzoheshin, Mehmedi i kishte lejuar trupat e tij të grabisnin dhe të plaçkitnin; ata do të rebeloheshin po të mos e kishin bërë këtë. Por, qyteti tashmë ishte shprazur dhe të gjithë, përveç disa kishave e pallateve, ishin braktisur. Disa kronika të mëvonshme perëndimore përshkruajnë plaçkitjen tmerruese, por ka pak evidenca për këtë. Pavarësisht sesa shkretues psikologjikisht, dëmi fizik ishte relativisht i butë, ndaj pasurisë dhe njerëzve.



Mehmeti u drejtua për Aja Sofia. Për një milenium, kisha kishte qëndruar si monument i perandorisë, qendrës së Krishterimit Lindor. Në fund të majit 1453, një gjuhë e huaj u dëgjua nën kubetë e saj, dhe pushtuesit zëvendësuan ritet e vjetra me të tyre. Kisha jehoi me zërin e shehadetit dhe thirrjen myslimane për namaz. Pas kësaj, Aja Sofia do të bëhej xhami, me emrat e katër kalifëve të parë që rrethonin kubenë e saj kryesore. Kur Mehmeti hyri i pari, ashtu siç thotë legjenda, një ushtar po përpiqej të nxirrte me forcë pllakat në dysheme. Sulltani e goditi me cep të shpatës, dhe i tha: "Për ju thesari dhe të burgosurit mjaftojnë. Ndërtesat e qytetit më takojnë mua".

Sulltani shumë shpejt ndaloi plaçkitjen. Qyteti do të bëhej kryeqytet i perandorisë së tij, dhe ai nuk dëshironte ta ngarkonte me rinovime të panevojshme. Vendi në formën e tanishme ishte për të ardhur keq dhe kishte nevojë për meremetime. Në muajt e ardhshëm, otomanët i dhanë formë qytetit, në aspektin material dhe kulturor. Disa fisnikë bizantinë kishin ikur; të tjerët ishin zënë robër; disa ishin liruar me shpërblesë, të tjerët ishin ekzekutuar. Por, Mehmeti nuk mund t'ia lejonte vetes që i gjithë qyteti të boshatisej nga banorët e tij grekë. Për të ruajtur funksionimin e tij, ai siguroi popullsinë se të drejtat e tyre do të respektoheshin. Ai, madje u përpoq të joshte ata që ishin larguar për t'u kthyer dhe u ofroi pagimin e dëmshpërblimeve nëse pasuria e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar.

Si një nxitje shtesë, Mehmeti premtoi se nuk do të ndërhynte në religjion. Perandori bizantin ishte në krye të Kishës ortodokse, dhe me shkuarjen e tij, patriku ishte zëvendësimi logjik. Por, në kohën e rënies së qytetit, patriku në pushtet ishte jashtë vendit, dhe në vend të tij, Mehmeti iu drejtua Gennadiusit - një nga murgjit më të respektuar në qytet, i cili ishte i njohur si shumë i pavarur dhe njësoj i egër me kundërshtarin e tij në Romë - dhe shpalli se ai do të ishte lideri i kishës.

Më vonë është thënë se Mehmeti urdhëroi zyrtarët e tij të kërkojnë në Kostandinopojë për dikë që është i denjë për emërim. Sipas fjalëve

të një kronisti bashkëkohor grek, “Gennadiusi ishte njeri shumë i zgjuar dhe i shquar... Kur sulltani e pa atë, dhe për pak kohë u dëshmua urtësia, maturia dhe ndershmëria e tij, dhe gjithashtu fuqia e tij si orator e karakteri i tij religjioz, ai u impresionua shumë dhe fitoi shumë respekt e nder tek ai, dhe i dha të drejtën që të vijë tek ai në çdo kohë, dhe e nderoi me liri e bisedë.” Në janar 1454, sulltani caktoi patrikun e ri dhe i dha autoritet mbi çështjet e përditshme të popullsisë së krishterë, “jo më pak sesa gëzonte më parë nën sundimin e perandorëve bizantinë”.

Shkalla e pushtetit të patrikut ishte shkruar në një kartë të hartuar nga veziri i sulltanit. Gennadiusi ishte më shumë se udhëheqës shpirtëror i grekëve ortodoksë, të cilët kishin rënë nën sundimin otoman. Ai ishte në shumë mënyra mbreti i tyre, me pushtetin për të taksuar e gjykuar dhe autoritetin për të caktuar përfaqësuesit lokalë kudo në perandori. Ngjashëm si perandori bizantin, ai kishte më shumë ndikim sesa krerët e kishave të tjera të krishtera në Lindje. Derisa në fund i përgjigjej sulltanit dhe shtetit otoman, në çështjet që radhiteshin që nga lindja e martesa e deri te vdekja, duke përfshirë pronat, taksat dhe tregtinë ndërkomunale, ai kishte liri të gjerë veprimi. Otomanët sundonin, por Mehmeti II nuk kishte interes në menaxhimin në detaje të jetëve të nënshtetasëve të krishterë. Kjo do të kishte kërkuar më shumë burokraci dhe më shumë përpjekje. Më mirë të gjente një partner dhe t’ia delegonte punën e ndyrë të administratës tek ai.[1]

Nuk dukej e qartë për askënd në atë kohë që Mehmedi, njëherësh mund të ishte aq i pamëshirshëm me fisnikët dhe klasën sunduese dhe aq i mëshirshëm ndaj pjesës më të madhe të njerëzve dhe liderëve të tyre fetarë. Por, kjo është në kundërshtim me nocionin modern se nuk ka ndarje midis fesë dhe shtetit në Islam. Mungesa e ndarjes thuhet të jetë në kontrast me murin që ndan pushtetin sekular dhe religjioz në Perëndim. Deri tani, të paktën deri në shekullin e XI, këto mure nuk

[1] Lord Kinross, *The Ottoman Centuries: The Rise and Fall of the Turkish Empire* (New York: Morrow, 1977).



ekzistojnë në botën perëndimore, dhe e gjithë struktura nuk ka qenë kurrë koherente kur është zbatuar për botën myslimane.

Për shembull, Perandoria Bizantine, të cilën e shkatërruan otomanët, kurrë nuk ka ndarë sferat për religjion dhe politikë. Perandori ishte njëherësh kreu i shtetit dhe kreu i kishës - dhe kjo formulë është kopjuar edhe në pjesë të tjera të botës së krishterë, duke përfshirë Reformimin e Anglisë, ku mbreti kërkoi bindjen e kryepeshkopit të Canterburyt. Gjatë gjithë historisë bizantine, perandori impononte doktrinën, udhëhiqte fushatat ushtarake dhe ftonte gjykatësit të ndëshkonin ata që nuk pajtoheshin me ortodoksinë perandorake. Siç e kemi parë, refuzimi i të krishterëve koptë të Egjiptit për t’iu përkulur autoritetit të perandorit dhe patrikut në Kostandinopojë në shekujt VI dhe VII, ishte një nga arsyet për lehtësimin e pushtimit arab të Egjiptit, shpejt pas vdekjes së Muhamedit a.s..

Përkundrazi, derisa ka pasur raste kur sundimtarët myslimanë tentuan të diktonin doktrinën, këto ishin përjashtim dhe jo rregull. Në një kuptim, sulltani otoman kishte pushtet të pakufizuar mbi nënshtetasit e tij. Ai kishte pushtet mbi jetën dhe vdekjen. Por, me fjalë të tjera, ai ishte po aq i detyruar, dhe në teori ashtu si nënshtetasit, ndaj ligjit fetar, siç çdo mysliman tjetër. Sikur sundimtarët e mëhershëm, ai u nënshtrohej dijetarëve dhe gjykatësve, të cilët përbënin *ulemanë*. Madje, edhe kur sulltani otoman shtoi titullin e kalifit në shekujt e mëvonshëm, ai nuk ushtronte autoritet total doktrinar. Vërtet, ai mund të nxirrte vetë ligje nëse ishin apo jo në pajtim me ligjin fetar (sharia). Por, ai kishte nevojë, dhe kultivoi, mbështetjen e *ulemasë*. I vetmi kuptim në të cilin mund të thuhet se nuk ka ndarje midis fesë dhe shtetit në Islam, është se nuk ka fe. Përjashtimi i mundshëm është Irani. Pas shekullit të XVI, mullahët shiitë të Iranit gradualisht u bashkuan në një institucion që në hierarkinë dhe koherencën e tij i ngjan Kishës Katolike, por pa mundësinë për të detyruar besimtarët e devijuar. Pothuajse kudo tjetër, Islami nuk ka asnjë trup qendror e qeverisë fetar. Gjatë gjithë historisë së shoqërive myslimane, nga shfaqja e institucionit klerikal në Bagdad gjatë kalifatit abasid përgjatë evolucionit të

Sufizmit dhe formave të tjera të devocionit individual, sferat politika dhe doktrinare janë dalluar dhe janë qeverisur nga njerëz të ndryshëm.

Ndarja de fakto ndihmon shpjegimin se pse Mehmeti ishte aq indiferent ndaj religjionit të nënshtetasve të vet. Si shumica e sundimtarëve perandorakë, otomanët bënin dallim midis shtetit dhe njerëzve. As Mehmeti e as ndonjë nga otomanët nuk tregoi interes në konvertimin e popullsisë së krishterë greke të Kostandinopojës. Përkundrazi, otomanët siguruan nxitje për të inkurajuar grekët të punojnë me regjimin e ri për rigjallërimin e qytetit dhe për t'ia kthyer madhështinë. Për pjesën e tyre, të krishterët e Kostandinopojës, të drejtat e tyre fetare të paprekura, dukej se kishin pranuar sundimtarët e rinj. Arkitektët e krishterë grekë hartuan planet për të forcuar dhe rindërtuar muret dhe fortifikimet e shkatërruara që në fund dështuan të mbronin qytetin. Ata dizajnuan xhami dhe ndihmuan Mehmetin të transformojë Aja Sofinë në shtëpi myslimane të adhurimit. Ata gjithashtu ndërtuan një treg të gjerë të ri të mbuluar, i cili do të bëhej Bazaari i Madh i famshëm i Stambollit, dhe drejtuan shumë prej stendave e dyqaneve të tij.

Po të kishte ndaluar Mehmeti me pushtimin e Kostandinopojës, ai do të kishte marrë nofkën "Pushtuesi". Por, ai ishte akoma i ri dhe ambiciet e tij nuk ishin ngopur. Ai mposhti kundërshtarët e vjetër të babait të tij në Hungari dhe Serbi, dhe ngurtësoi kontrollin otoman mbi pjesën më të madhe të Ballkanit dhe bregdetin jugor të Detit të Zi. Përgjithësisht, qytetet dorëzoheshin, hapnin portat e tyre për sulltanin, në vend që të provonin vdekjen dhe shkatërrimin. Otomanët nderuan flamurin e armëpushimit. Kur premtuan të mbronin të drejtat e popullsisë lokale, e bënin.

Sigurisht, disa dekada pas udhëheqjes së ushtrive të tij, Mehmeti u lodh dhe u sëmurë. Ai nuk u plak me hirësi dhe arritjet e tij nuk e bënë të gëzuar. Ai piu shumë dhe u bë gjithnjë e më dyshues për ata që ishin rreth tij. Duke i bërë një psikanalizë të padrejtë nga një distancë disa shekullore, mund të thuhet se ai bëri gjithçka që mundi për të larguar memorien e babait të tij, dhe dështoi. Po të kishte konsultuar një udhëheqës sufist, mund të kishte mësuar se mund të shkonte në fund të botës, të fitonte çdo betejë, dhe të bëhej i pasur përtej imagjinatës,



por derisa ia dorëzoi shpirtin e tij Zotit, mbeti i shqetësuar dhe i pasuksesshëm. Dhe i tillë ishte, derisa vdiq më 1481, i shëndoshë, i rrethuar nga mjekë çifutë dhe persianë të paaftë për ta shëruar, në moshën 49-vjeçare.

Megjithëse evropianët ishin frikësuar nga humbja e qytetit për të cilin kishin bërë aq pak për ta ndihmuar dhe aq shumë për ta minuar, çfarëdo afiniteti që ndjenin ishte një iluzion. Në të vërtetë, të krishterët e Evropës Perëndimore ishin më të huaj dhe më armiqësor nga Bizanti Ortodoks sesa otomanët. Otomanët dhe bizantinët kishin luftuar për mbi njëqind vjet, dhe ata gjithashtu kishin jetuar krah për krah, derisa secili kujdesej për armiqtë e tjerë. Babai i Mehmetit ishte martuar me një princeshë bizantino-serbe, që nuk ishte hera e parë e as e fundit që një otoman mysliman marton një të krishtere për arsye të shtetit. Të dy perandoritë ishin lidhur jo vetëm me lidhje martesore, por edhe me ato financiare. Për shumë vite, para Mehmetit, sulltani otoman i paguante një tarifë vjetore perandorit bizantin, pasi që otomanët preferonin një Bizant joefektiv sesa një fuqi rivale në Kostandinopojë që kontrollonte udhëkryqet vitale. Më vonë, në shekullin e XIX, fuqitë evropiane do të bënin të njëjta kalkulime rreth otomanëve, ndërkaq perandoria do të mbijetonte jo për shkak se ishte e fuqishme, por për shkak se ishte e dobët.

## Lidhjet e Perandorisë Osmane me Evropën

Perandoria Otomane zgjati gati pesëqind vjet, më shumë sesa një grusht i dinastive që ka njohur bota. Bizanti dhe Roma para saj, secila kanë mbijetuar më shumë se një mijë vjet, por vetëm otomanët mund të pohojnë se e njëjta familje ka sunduar njëri pas tjetrit që nga fillimi e deri në fund. Megjithëse mund të ketë pasur disa shkrime të favorshme të trungut familjar, ka pasur një zinxhir të vazhdueshëm që shtrihej nga Osmani në shekullin e XIV, e deri te sulltani i fundit, Mehmeti VI, në dekadën e parë të shekullit njëzet. Për krahasim, dinastitë evropiane rrallë kanë zgjatur më shumë se disa qindra vite dhe zakonisht kanë sunduar një zonë jo më të madhe se një provincë otomane. Në

pjesën më të madhe të pesë shekujve, megjithatë, Perandoria Otomane ka rrethuar gjithë Mesdheun lindor. Që nga fillimi i shekullit të XVI e deri në fillim të shekullit XX, ajo ka sunduar gjithashtu Afrikën Veriore dhe Egjiptin; Kaukazin midis Detit të Zi dhe atij Kaspik; Gadishullin e Krimesë dhe rajonet rrethuese; gjithë Lindjen e Mesme nga Izraeli i sotshëm e deri te kufijtë e Iranit; dhe Ballkanin, duke përfshirë Greqinë, Serbinë, Kroacinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe pjesë të Hungarisë së sotme.

Në memorien kolektive të Perëndimit, shfaqen gjatë. Më shumë sesa vala e parë e pushtimeve arabe, më shumë se myslimanët e Spanjës apo Salahudini e ushtritë e tij, Otomanët janë thurur në vetëdijen e Evropës moderne. Në kohën kur monarkitë e centralizuara të Perëndimit dhe Evropës Qendrore po shfaqeshin, ata u përballën me një kundërshtar, madhësia, organizimi, pasuria dhe fuqia e të cilit rrëgjonte çdo gjë që mund të grumbullohej. Sunduesit e Spanjës, Francës, Anglisë, tokave gjermane, dhe Perandorisë së Shenjtë Romake mund të kenë menduar veten si titanë, por kundër otomanëve, ata mezi vlerësoheshin si pigme. Duke vepruar në marrëveshje, flotat e italianëve, kalorësit e Spanjës e Francës, dhe këmbësorët e Hungarisë, Polonisë, Austrisë dhe Prusisë arritën të menaxhojnë humbjen totale, por deri në shekullin e XVIII, hija e asaj që e quajtën “turqit e pabesë” mbuloi madje kthjelltësinë e ditëve të tyre.

Gradualisht, otomanët humbën avantazhin e tyre konkurrues dhe në fund të shekullit të XVIII, monarkët e Evropës dhe Rusisë ndryshuan rrjedhën. Edhe atëherë, perandoria u tkurr, por nuk u shkatërrua. Ndryshe nga shumë rajone të tjera të globit, pjesa qendrore e Perandorisë Otomane kurrë nuk u pushtua apo u sundua nga evropianët. Perandoria u tkurr, por tokat qendrore të Turqisë dhe pjesë të mëdha të Lindjes së Mesme, duke përfshirë Irakun dhe Arabinë, mbetën nën sundimin otoman deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Të afërt në gjendje, otomanët dhe evropianët ishin ndarë nga një humnerë e gjerë kulturore. Religjioni, megjithatë, ishte ndoshta linja më pak e rëndësishme ndarëse. Otomanët ishin udhëhequr nga një familje turke, origjina e së cilës, siç kanë theksuar shumë studiues, ishte



e mbështjellë me paqartësi. Shumë pak dihet për Osmanin, themeluesin e dinastisë, ashtu siç dihet pak për Romulin e Remin, të parët mitikë të Romës. Pothuajse nuk ka asnjë të dhënë të shkruar për otomanët për shekullin e parë të ekzistencës së tyre dhe kundërshtarët e tyre të parë - serbët, hungarezët, bizantinët, dhe emirët turq në Anadoll, e as nuk ka shumë të dhëna të lëna për humbjet që kanë pësuar nga otomanët.

Gjatë kohës, Evropa u bë familjare me shtetin Otoman, por deri në shekullin e XIX, punët e saj të brendshme mbetën të errëta. Sulltani dhe haremi i tij u bënë legjendar, por disa perëndimorë kuptuan sesi qeverisnin, luftonin apo jetonin otomanët. Ambasadorët e huaj në Stamboll shkruan kronika për kryeqytetin perandorak, por ata kishin kontakte të kufizuara me elitën dhe iu ishin treguar vetëm ato aspekte të jetës në pallat që ishin të lejuar t’i shihnin. Deri në shekullin e XIX, kur otomanët ishin të detyruar të hapnin më shumë shoqërinë e tyre për shqyrtimin e huaj, u hoq maska, dhe atëherë, vetëm pjesërisht.

Një rezultat i injorancës ishte imagjinata. Në kronika imagjinare, shpesh banale, perëndimorët sjellin imazhin e sulltanit të shërbyer në harem nga femra të gatshme të ruajtura nga eunukët nga Afrika nën-Sahariane dhe të mbrojtur nga ushtria e skllevërve të marrë si robër derisa ishin të rinj dhe të trajnuar për jetën e ashpër si luftëtarë, të cilët janë të gatshëm të vdesin posa urdhëron sulltani të marrin frymë. Në dhomën e tij të fronit, të rrethuar nga vezirë që komplotojnë fushatën e ardhshme kundër Perëndimit, sulltani Otoman rri ulur, i mbyllur në mister. Si monarkët lindorë që i ka rivalizuar, ai rrallë lejonte vizitorët t’ia ngulnin sytë, që vetëm rriste atmosferën e misterit. Perëndimorët mbushnin boshllëqet në diturinë e tyre me frikë dhe duke transformuar sulltanin në një luftëtar të shenjtë, i vendosur të asgjësojë fuqinë e krishterë për të përmbushur atë që kishte nisur Muhamedi a.s. dhe për të marrë hakun e votës myslimane për humbjen e Spanjës.

Kjo përzierje e gjysmë të vërtetave dhe legjendave ushqeu shqetësimin perëndimor. I frikësuar, ngurrues dhe admirues kundër dëshirës, sulltani sundoi një perandori të frikshme në kufijtë e Evropës. Megjithëse turqit ishin vetëm një nga grupet e ndryshme në perandori, fjala

"turk" u bë përfaqësim për të gjitha gjërat otomane, dhe jo pozitive. Për anglezët, sikur për shumicën e evropianëve, "turk" do të thoshte barbarizëm dhe egërsi.[2]

Në mungesë të dëshmisë për të kundërtën, karikatura ishte marrë si fakt. Madje edhe pasi që Perandoria Otomane u tregua shtet si të tjerët, me fuqitë e saj dhe më shumë se pjesa e saj e dobësisë, imazhi kurrë nuk u zbeh. Në fakt, ai vazhdoi në gjithë perandorinë. Memoria e luftëtarëve turq që luftonin në emrin e Zotit mysliman kundër ushtrive të Krishterimit mbijetoi rënien e otomanëve dhe u ngulit në kulturën perëndimore. Kur Turqia aplikoi për anëtarësim në Unionin Evropian në fillim të shekullit XXI, zërat francezë, gjermanë dhe holandezë murmuritën jorehatinë që Turqia ishte shumë e huaj, shumë ndryshe, dhe ndoshta shumë myslimane. Megjithëse këto shqetësime ishin aluzione që kishin luftuar otomanët për shekuj dhe në fund kishin fituar, Evropa nuk duhej të lejonte turqit të gëzojnë frytet e kësaj fitore të arritur me vështirësi.

Reputacioni i otomanëve ka vuajtur gjithashtu edhe nga lëvizjet nacionaliste që përfshin Ballkanin dhe Lindjen e Afërt në shekujt XIX dhe XX. Së pari, grekët në vitet 1820 dhe pastaj hungarezët, serbët, bullgarët, rumunët, dhe në fund, arabët e Lindjes së Afërt definuan veten si kombe që ishin pushtuar, brutalizuar, dhe heshtur nga autokratët otomanë. Për grekët dhe njerëzit tjerë të Ballkanit, pati një element shtesë religjioz: myslimanët otomanë pohuan se kishin shtypur të krishterët. Madje edhe arabët, të cilët morën virusin infektues të nacionalizmit para Luftës së Parë Botërore, distancuan veten nga otomanët, megjithëse fortesa e tyre kryesore e grindjes ishte më shumë etnike sesa religjioze.

Këtu si kudo tjetër, konflikti kishte marrë vëmendjen më të madhe, dhe në Perëndim nuanca religjioze ishte theksuar. Pa dyshim, sundimtarët e hershëm otomanë e konsideronin veten luftëtarë myslimanë. Ata e quajtën veten *gazi*, që në arabisht do të thotë "sulmues të

[2] Roger Crowley, 1453: *The Holy War for Constantinople and the Clash of Islam and the West* (New York: Hyperion, 2005), p. 243



shenjtë", me qëllim që të lidhin veten me shokët e Muhamedit a.s. dhe dinastitë arabe që kishin sunduar pas vdekjes së tij. Në lidhjet e tyre me Perëndimin e krishterë, otomanët nuk ishin asgjë tjetër përveç paqësor. Posa kishin mposhtur Bizantin e krishterë dhe kishin marrë kontrollin e Ballkanit, ata u drejtuan në fortesën e fundit të kryqtarëve frankë në ishujt Rodos, Kretë dhe Maltë, dhe në qytetet përgjatë Danubit, duke përfshirë Budan, Pestën, dhe mbi të gjitha, Vjenën.

Por, ajo që zakonisht nuk është vënë re dhe është harruar është se titulli *gazi* ishte vetëm një nga linja e gjatë e titujve, të cilët përfshinin jo vetëm Sundimtari i Dy Tokave, por gjithashtu Sundimtari i Dy Deteve; Sulltani i arabëve, persëve dhe romakëve; Shpërndarësi i Kurorave të Sundimtarëve të Tokës; Sovrani i Detit të Bardhë, Detit të Zi, Rumelisë, Anadollit; Zoti i Rumit dhe Karamas, i Dulkadirit dhe Dijarbakrit, Azerbejxhanit, Sirisë, Alepit, Egjiptit, Jerusalemit të Shenjtë, Mekës së Nderuar dhe Medinës së Shenjtë, Xhidës, Jemenit, dhe shumë tokave të tjera; dhe Vetëtima e Luftës, dhe Pushtuesi i Botës. Otomanët ishin krenarë për fitoret e tyre, krenarë për modelin e tyre si trashëgimtarë jo vetëm të kalifëve të parë, por edhe të Cezarit e Romës dhe monarkëve persianë të antikitetit, krenarë që sundonin Evropën dhe Azinë, Jerusalemin dhe qytetet e shenjta të Arabisë, dhe krenarë që monarkët e Evropës i frikësoheshin dhe i ofendonin. Fakti se otomanët ishin gjithashtu myslimanë, të cilët kishin korrë fitore që rivalizoheshin vetëm nga ato të kalifëve të shekullit VII dhe VIII, ishte vetëm një nder, por jo i vetmi.

Ajo që është harruar gjithashtu është se për pjesën më të madhe të atyre pesëqind vjetëve, otomanët ishin indiferentë ndaj religjionit të nënshtetasve të vet. Perandoria, sundohej nga një numër i vogël i guvernatorëve dhe gjykatësve dhe një ushtri e frikshme në kazerma në kryeqytetet e çdo province kryesore. Përveç për sulltanin dhe familjen e tij, anëtarësimi në klasën sunduese nuk ishte i bazuar në racë apo religjion. Ai ishte i bazuar në sistemin e skllavërimit të organizuar të djemve të rinj. Të marrë nga fshatrat e tyre, ata u dërguan në shkollat në Stamboll dhe në kryeqytetin perandorak në Adrianopojë, dhe u trajnuan si ushtarë apo si burokratë. Ushtarët ishin të njohur si jeniçerë

dhe shumë prej tyre nisën jetën si fshatarë të krishterë, të cilët u konvertuan pastaj në Islam. Islami i tyre, megjithatë, nuk ishte ortodoks, por i mbuluar me misticizmin e rendit sufist, të njohur si Bektashi, që kishte ruajtur shumë rite të krishtera.

Çdo vit, korpuset jeniçere shpërndaheshin në fshatrat e Ballkanit dhe Kaukazit dhe mblidhnin një kuotë të fëmijëve. Disa aspekte të sundimit otoman kishin gjeneruar shumë debat dhe dëshirë të keqe. Në shekullin e XIX, praktika kishte përfunduar në masë të madhe, por memoria mjaftonte për të ngritur popujt e Ballkanit kundër sundimtarëve të tyre. Jeniçerët ishin robër në kuptimin që të drejtat dhe pasuria e tyre, prona dhe statusi ishin në tekë të sulltanit. Por, në shumë aspekte të tjera, ata ishin elitë e privilegjuar. Ndryshe nga afrikanët e robëruar në Amerikë, jeniçerët ishin klasa sunduese e një perandorie dhe gëzonin përfitimet shoqëruese. Megjithëse gjeneratat e mëvonshme të perëndimorëve dënuan hapur rekrutimin e detyruar, mundësia për të pasur djem që do të ngrihen në poste të larta të perandorisë nuk shihej si padrejtësi e rëndë nga shumë familje. Përveç kësaj, në shekujt XV, XVI dhe XVII, asnjë fshatar - qoftë i krishterë apo mysliman - nuk kishte pritje të demokracisë së Jeffersonit. Klasa sunduese otomane ishte e ashpër dhe josentimentale, por ajo dallonte nga sundimtarët e Evropës vetëm në efikasitet. Kur mbretërit e Francës apo Spanjës kishin nevojë për mbledhjen e një ushtrie, trupat e tyre gjithashtu hynin në fshatra dhe dhunshëm rekrutonin të rinjtë e pranueshëm duke mos kërkuar lejen. Rekrutimi i korpuseve të jeniçerëve në Ballkan dhe Greqi, ishte në atë kuptim, jo i ndryshëm.[3]

Derisa klasa sunduese otomane ishte myslimane, perandoria nuk ishte, dhe Islami nuk vepronte si zam për mbajtjen së bashku të pjesëve të ndryshme të shtetit. Shumica e popullsisë së tokave evropiane që kontrollohej nga otomanët ishte e krishterë dhe mbeti e tillë deri në fund. Madje edhe në rajonet si Egjipti dhe Iraku, ku myslimanët ishin shumicë, Islami sunit i klasës sunduese otomane ishte diçka e ndryshme nga Islami i shumë arabëve. Në përgjithësi, derisa sulltani e shpallte veten kalif dhe mbrojtës të qyteteve të shenjta të Mekës dhe Medinës, dukej se ai nuk kujdesej asnjë grimë për religjionin e nënshtetasve të tij. Nuk pati përpjekje për konvertimin e të krishterëve dhe çifutëve, e as otomanët nuk u përpoqën të impononin një version të ligjit mysliman. Të qenit mysliman nuk kishte asnjë garanci për trajtim më të mirë nga guvernatorët lokalë, dhe të qenit i krishterë apo çifut nuk ishte domosdoshmërisht barrë që duhej të kapërcehej.

[3] Kinross, *The Otoman Centuries: The Rise and Fall of the Turkish Empire* (New York: Morrow, 1977).



Derisa otomanët luftuan kundër shteteve të krishtera të Evropës, ata luftuan kundër shahëve shiitë të Iranit, po me të njëjtin intensitet. Në asnjë rast propagandimi i Islamit nuk ishte motiv kryesor. Otomanët ishin dinasti e vendosur në zgjerimin dhe përjetësimin e sundimit të tyre. Sa u përket romakëve, mongolëve, hanëve dhe perandorive të tjera, pushteti ishte primar, dhe gjithçka tjetër ishte sekondare. Religjioni ishte mbi të gjitha një instrument kontrolli. Nëse manteli i religjionit mund të përdorej për të justifikuar zgjerimin, atëherë edhe më mirë. Nëse toleranca fetare ndihmonte qetësimin e nënshtetasve dhe ruajtjen e stabiliteti, atëherë le të jetë.

## Çifutët nën sundimin Otoman

Formula otomane që theksonte bindjen ndaj sulltanit dhe indiferencën ndaj religjionit të nënshtetasve ishte zhvilluar para rënies së Kostandinopojës, por ajo u bë vitale për suksesin e perandorisë vetëm më pas. Duke lënë anash religjionin e nënshtetasve, sulltani ishte në gjendje t’i përdorte ata për rritjen e fuqisë së shtetit. Për shembull, në përpjekjen e tij për të rikthyer lavdinë e Kostandinopojës, Mehmeti urdhëroi mijëra njerëz në gjithë perandorinë të zhvendoseshin. Disa prej tyre ishin turq dhe myslimanë, por shumë të tjerë nuk ishin. Ortodoksët grekë nga qytetet e Anadollit, me shkathtësitë e nevojshme u urdhëruan të lëvizin, dhe megjithëse iu ishte dhënë ndihma dhe iu ishin garantuar të ardhura dhe punë, atyre nuk iu ishte dhënë zgjidhja. Natyrisht, as ushtarët e ushtrive të sulltanit. Dhe as mijëra çifutë, shumë prej të cilëve jetonin në Ballkan. Aftësia e tyre për të vepruar si

ndërmjetës midis Mesdheut lindor mysliman dhe Perëndimit të krishterë do të thoshte ata mund, dhe më vonë e bënë, të luanin rolin kryesor në suksesin tregtar dhe ekonomik të shtetit otoman.

Nën bizantinët, çifutët ishin toleruar, por rrallë ishin pranuar. Në Kostandinopojën e krishterë, komuniteti i pasur çifut kryente të njëjtin funksion si ndërmjetës ekonomikë që kishin kryer në qytete të tjera të shumta në Mesdhe. Ata përfaqësoheshin në pallatin perandorak nga udhëheqësi i rabinëve, i cili ishte lider dhe avokat. Në sistemin bizantin, autoriteti i tij ishte i kufizuar. Nën otomanët, megjithatë, çifutët fituan më shumë autonomi dhe gjatë kohës u bënë mbështetës aktivë të sundimit të sulltanit. Pas pushtimit, Mehmeti lejoi kryerabinin, i cili u kishte shërbyer bizantinëve të mbante pozitën e tij. Ky rabin nuk ishte, siç kishin sugjeruar disa, kreu i të gjithë çifutëve në Perandorinë Otomane, megjithëse pozita e udhëheqësit të rabinëve do të bëhej traditë çifute. Fillimisht, ai ishte përgjegjës vetëm për komunitetin çifut të Kostandinopojës, i cili ishte mjaft i vogël më 1453, por që do të rritej shpejt në mijëra për shkak të politikave të risistemimit të Mehmetit.

I përballur me kryeqytetin pak të populluar dhe numrin e pamjaftueshëm të njerëzve të aftë për kryerjen e detyrave të komplikuara, Mehmeti urdhëroi mijëra çifutë të vinin në Kostandinopojë. Ata ishin zgjedhur jo për shkak të besimit të tyre, por për shkak se ishin grup i bashkuar që posedonte shkathtësitë për të cilat shteti otoman kishte shumë nevojë. Zhvendosja e detyruar e çifutëve nga pjesë të ndryshme të Ballkanit dhe Anadollit mund të mos ishte i kënaqshëm për ata që lëvizën nga shtëpitë e tyre, dhe për këtë ka pasur debate të nxehta midis studiuesve rreth karakterizimit të dekreteve të Mehmetit. Disa kanë krahasuar largimet me masakër dhe persekutime të fundit të shekullit të XX. Të tjerët, duke përfshirë poetin çifut të shekullit pesëmbëdhjetë Elijah Capsali, kishin pak të thonë për zhvendosjen dhe i shihnin otomanët si një përmirësim i rëndësishëm mbi regjimet perëndimore të krishtera në Evropë dhe sundimtarët e krishterë lindorë të Bizantit. Capsali, në fakt, e mori rënien e Kostandinopojës si ndë-



shkim hyjnor kundër atyre që kishin abuzuar çifutët dhe si shenjë e favorit të Zotit për ata që treguan tolerancë.

Shkurtimisht, nuk pati asgjë rreth politikave të Mehmetit që diskriminuan çifutët si çifutë, apo kundër çdo kategorie të krishterë si të krishterë në vetvete. Burokracia otomane i trajtoi të gjithë nënshtetasit si instrumente të shtetit dhe shërbëtorë të sulltanit, duke i përdorur dhe duke i rregulluar ashtu siç i përshtatej. Në këtë kuptim, të gjithë qytetarët e perandorisë u diskriminuan nga sulltani dhe elita sunduese, dhe kishin disa të drejta të ndara nga ajo që sulltani kishte lejuar. Në asnjë pjesë të botës në shekullin e XV, situata nuk ishte në mënyrë dramatike e ndryshme. Derisa çifutët, të cilët u detyruan të zhvendosen në kryeqytetin e ri mund të kenë vuajtur, vetëm disa nga prizmi shumë i veçantë bashkëkohor mund të thuhet se ata kishin vuajtur për shkak të religjionit të tyre.

Dhe në fund të shekullit të XV, çifutët e Kostandinopojës lulëzuan, dhe komunitetet çifute në pjesët e tjera të perandorisë jetonin jetë të sigurta dhe të begata. Skepticizmi dhe frika gjatë viteve të para të sundimit të Mehmetit i kishin hapur rrugën pranimit dhe pastaj entuziazmit të plotë. Derisa çifutët dhe të krishterët duhej të paguanin një taksë për kokë, këto ishin kompensuar nga përfitimet tatimore që kishin marrë për krijimin e bizneseve së pari në Stamboll dhe pastaj në qytetet tjera kryesore. Çifutët dominonin format primitive të bankave që ekzistonin, si dhe tregtinë me xhevahir, perla dhe satin. Komuniteti çifut i Egjiptit mbeti i paprekur, dhe kur Egjipti më në fund u pushtua nga otomanët në fillim të shekullit të XVI, ata patën përfitime ekonomike. Dhe një komunitet i huaj i çifutëve gjeti shtëpinë në perandori dhe u pranua ngrohtësisht, që është shumë në kundërshtim me atë që kishin lënë prapa.

Më 1492, pas rënies së mbretërisë myslimane të Granadës, monarkët triumfues të Spanjës përmbushën ambicien e vjetër të Kishës Katolike spanjolle dhe urdhëruan dëbimin e çifutëve. Me pak kohë për t’u përgatitur dhe në rrezik për jetët e tyre, mijëra persona paketuan atë që mundën dhe u larguan nga vendi. Qytetet e Evropës Perëndimore i shmangën, ndërkaq Afrika Veriore ishte e ndarë në principata

të vogla me vitalitet të vogël ekonomik. Por, otomanët shpallën se çifutët e dëbuar të Spanjës ishin të mirëpritur dhe do të merrnin ndihmë e mbështetje, duke përfshirë transportimin nga Spanja në qendër të perandorisë në anën tjetër të Mesdheut. Çifutët u lejuan të vendosen në Stamboll, por sulltani deklaroi se do të ishte veçanërisht i kënaqur, nëse ata vendosen në një nga qytetet më të vjetra në Ballkan, Selanik, i njohur gjithashtu si Salonica.

Jo të gjithë i mbijetuan udhëtimit. Një kronist i heshtur bashkëkohor thotë: “Një pjesë e spanjollëve të dëbuar shkuan jashtë Turqisë. Disa prej tyre u hodhën në det dhe u mbytën, por ata që arritën atje mbreti turk i priti me mirësi, pasi ata ishin mjeshtër. Këta çifutë të shpërngulur ndanë vullnetshëm urtësinë dhe diturinë me sundimtarët e tyre të rinj, duke përfshirë njohuritë rreth arteve të luftës. Inxhinierët dhe mjeshtërit çifutë ndihmuan otomanët që të avancojnë prodhimin e artilerisë dhe mjetet e komplikuara të rrethimit, të cilat sulltani i përdori mirë kundër evropianëve në shekujt XVI dhe XVII. Të larguarit e Spanjës u bënë kështu një aset i otomanëve”.[4]

Disa nga të dëbuarit u vendosën në Stamboll, por pjesa më e madhe e tyre u vendosën në Selanik. Në mes të shekullit të XVI, qyteti kishte një popullatë të konsiderueshme çifute dhe ishte bërë një metropol që mund të qëndronte krenar afër Stambollit. Çifutët e Selanikut ishin vetëqeverisës, i përgjigjeshin guvernatorit otoman dhe në fund sulltanit, por jo kryerabinit në Stamboll. Kjo filloi të ndryshojë në shekujt e mëvonshëm, pasi që sulltani u dha më shumë autoritet liderëve fetarë në kryeqytetin perandorak, që do të thoshte rritje të kompetencave jo vetëm për kryerabinin, por edhe për patrikët të kishave greke dhe armene. Fillimisht, megjithatë, çifutët e Spanjës, të cilët u vendosën në Selanik, konkurronin jo me çifutët e Stambollit, por me popullsinë e vjetër të çifutëve grekë, të cilët kishin jetuar në qytet për një mijë e pesëqind vjet dhe kishin strehuar Shën Palin në udhëtimet e tij në botën Romake për të përhapur Ungjillin. Këto rivalitete u zbehën, megjithëse kurrë plotësisht, dhe pas çdo shekulli që kalonte, çifu-

[4] Braude and Lewis, *Christians and Jews in the Ottoman Empire, p. 117.*



tët e Selanikut u bënë më të pasur, më të fuqishëm dhe më të rëndësishëm për jetën tregtare të perandorisë.

Historia e famshme e çifutëve të Perandorisë Otomane ndryshon shumë nga trajtimi i vëllezërve të tyre në Evropën e krishterë deri në mes të shekullit të XVIII dhe natyrisht gjatë Holokaustit të shekullit XX. Mbretëritë e Evropës kujdeseshin shumë për religjionin e nënshtetasve të tyre dhe bënë luftëra shkatërruese për të detyruar besimin dhe shtypur herezinë. Otomanët ishin të pamëshirshëm si pushtues, por posa arrinin fitoren ushtarake, ata preferonin sistem administrativ të butë dhe të qetë.

Kjo tolerancë mund të shpjegojë se pse disa të krishterë dhe çifutë u konvertuan në Islam gjatë shekujve otomanë, veçanërisht krahasuar me normat e mëhershme të konvertimit në Andaluzi apo në Lindjen e Afërt, Egjipt dhe Persi pas ardhjes së Islamit në shekullin e shtatë. Prezenca e shteteve të krishtera me rritje të fuqisë në Evropës, të cilat përfaqësonin mundësinë, megjithatë ndryshe, të një rendi dhe regjimi tjetër mund të ketë dekurajuar gjithashtu të krishterët nga konvertimi. Faktorët tjerë, megjithatë, neglizhenca dashamirëse e shtetit otoman i lejoi çifutët, grekët ortodoksë, armenët, katolikët, koptët, dhe të tjerët të jetojnë në paqe e siguri dhe të praktikojnë besimet e tyre të pashqetësuar. Ka shumë arsye se pse otomanët ishin aq të suksesshëm dhe aq elastikë, por më e rëndësishmja ishte se ata i dhanë njerëzve mjaft autonomi për t’i mbajtur të kënaqur, besnikë dhe jo të interesuar në ndryshim.

## Sulejmani dhe kulmi i perandorisë

Shumë prej banorëve të sotëm të Ballkanit do të hedhin poshtë karakterizimin e Perandorisë Otomane si tolerante dhe relativisht dashamirëse. Bullgarët, serbët dhe grekët nuk ndjenë kurrfarë dashurie për otomanët apo për turqit, dhe ata e kujtojnë perandorinë për brutalitetin dhe trajtimin e keq ndaj tyre. Çështja këtu nuk është nëse otomanët ishin mizorë; sikur shumica e fuqive perandorake, ata mund të ishin. Nuk është nëse guvernatorët individualë shfrytëzuan pushtetin e tyre

për të vjedhur, përdhunuar, dhe përndryshe abuzonin nënshtetasit e tyre. Në trajtimin e tyre të fshatarëve të Ballkanit, megjithatë, otomanët nuk ishin as më pak e as më shumë mizorë sesa sunduesit feudalë në Evropë, që ishin ndaj argatëve të tyre. Disa guvernatorë otomanë ishin tiranë, të tjerët nuk ishin, dhe ata që ishin të prirë për të tërhequr vëmendjen. Ka shumë kronika të shkruara nga njerëzit që i sunduan otomanët që përshkruajnë zotërinjtë e tyre në mënyrë shumë të ashpër. Disa nga këta theksojë religjionin si linjë ndarëse, por kjo nuk do të thotë se ishte ashtu. Linja ndarëse për otomanët ishte pushteti, kush e kishte dhe kush nuk e kishte.

Otomanët bënë atë që ishte e përshtatshme. Në kushtet e sotme, ata ishin realistë, jo idealistë. Sulltanët që nga Mehmeti mund të kenë përshkruar veten si luftëtarë të shenjtë kur niseshin kundër armiqve, por kur kishte të bënte me qeverisje, ata ishin në thelb pragmatikë. Formula e pashqiptuar ishte e bukur dhe elegante: perandoria sundohej nga një sulltan me pothuajse pushtet të pakufizuar, që i jepte përgjegjësi vetëm Zotit dhe në teori ulemasë, të cilët gati gjithmonë miratonin atë që dëshironte të bënte. Kjo përfshinte martesën me të krishtera, punësimin e çifutëve, dhe lidhjen e aleancave me shtetet katolike - asnjëra prej të cilave nuk ishte në mospërputhje me Islamin ortodoks siç kuptohej atëherë.

Burokracia otomane, si pasojë, nuk diskrimonte në baza të religjionit apo racës. Nga korpuset e jeniçerëve, shërbimi civil e deri te eunukët e pallatit, qeveria drejtohej nga një koleksion laraman i racave. Derisa të qenit jeniçer nuk detyronte konvertimin, shpesh pati më shumë formë sesa substancë të Islamit te këmbësoria, të cilët luftonin në betejat e sulltanit me shumë aftësi.

Tartarët, serbët, grekët, arabët, berberët, koptët, armenët, çifutët, sunitët, shiitët, druzët, nubianët, sllavët, bullgarët, hungarezët, gjeorgjianët dhe natyrisht turqit kombinoheshin për të formuar një bashkim të çmendur gjuhës, traditash dhe ritesh. Gjykata otomane në Stamboll dhe administratorë të ndryshëm provincialë u shërbyen gjithashtu venedikasve, gjenovezëve, fiorentinasve dhe romakëve, si dhe tregtarëve dhe përkthyesve nga Franca, Austria, Spanja dhe Anglia. Derisa klasa



sunduese adoptoi nocionin e “turqizmit” në fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë nuk pati asgjë veçanërisht turke rreth shtetit otoman.

Gjithashtu, sulltani e shikonte martesën përmes lenteve të politikës më shumë sesa të racës, religjionit apo dashurisë. Bashkëshortet dhe gratë pa kurora të haremit vinin nga një varg i gjerë i grupeve etnike dhe feve të shumta. Qëllimi ishte lidhja e grupeve të ndryshme të perandorisë me sulltanin, dhe që ai vështirë të flinte vetëm me myslimane apo vetëm me turke. Kjo, si pasojë, do të thoshte se shumica e sulltanëve - si dhe fëmijët e unioneve të tilla - ishin me etni të përzier. Perandoria nuk kishte vetëm administratë multikulturore; ajo kishte sulltan multikulturor.

Realiteti i vet haremit është në kundërshtim me mitin. Misteret joshëse të haremit u bënë një obsesion i perëndimorëve, të cilët fantazonin rreth netëve epshore, grave të vullnetshme, mëndafshit të shumtë, shumë jastëkëve dhe eunukëve të zinj me vathë ari dhe rrip të shpatave. Kjo ndodhi, ndoshta, pasi gratë perëndimore që hynë në harem raportuan më vonë, por kishte më pak seks dhe më shumë pirje çaji. Derisa një qëllim i haremit mund të ketë qenë kënaqja e dëshirave të sulltanit, qëllimi primar ishte sigurimi se ishte të paktën një trashëgimtar mashkull dhe grumbulli i nënave të mundshme reflektonte diversitetin e perandorisë. Kjo ishte, në këtë kuptim, një version i demokracisë seksuale, të shkarkuar nga shqetësimet e racës, klasës apo religjionit.

Gatishmëria për të injoruar religjionin, për t’u fokusuar në politikën praktike të definuar nga sundimi i sulltanit më të madh të perandorisë - Sulejmanit. Megjithëse ai ishte i njohur si “Madhështori” në Perëndim, nofka e tij primare në botën otomane ishte e ndryshme dhe e dukshme. Për nënshtetasit e tij, ai ishte “Ligjvënësi”. Gjatë sundimit të tij që zgjati mbi dyzet vjet, perandoria arriti kulmin. Pushtimet e tij sollën otomanët në portat e Vjenës në Perëndim dhe thellë në Persi në lindje. E gjithë Afrika Veriore hyri në kontrollin e tij formal, dhe principata e fundit kryqtare, pronë e Hospitalerëve në ishullin Rodos, e cila i kishte rezistuar të gjithë sfiduesve për mbi 200 vjet, u dorëzua pas një beteje të gjatë dhe të guximshme më 1526.

Por, derisa Sulejmani udhëhoqi ushtritë e tij drejt fitores në periferi, bërthama e perandorisë ishte paqësore, e begatë dhe stabile. Pas disa shekujsh luftë, otomanët arritën të konsolidonin sundimin e tyre. Dyzet e gjashtë vjetët e Sulejmanit në pushtet ishin dramatike, por më pak për shkak të presionit të jashtëm sesa zënkave familjare që u kthyen në vdekjeprurëse, ashtu siç ndodhën rëndom midis princërve otomanë. Në shumicën e aspekteve të tjera, ajo ishte një kohë e qetë dhe stabile. Sulejmani formalizoi dhe kodifikoi praktikat administrative që i kishte trashëguar nga babai dhe gjyshi i tij, dhe për gati treqind vjet pas kësaj, ligjet e tij qeverisën shtetin. Gjatë sundimit të tij, të ardhurat rridhnin në arkat në Stamboll; jeniçerët rekrutonin versionin e tyre të më të mirëve dhe më të zgjuarve; guvernatorët provincialë ishin dërguar nga kryeqyteti për të sunduar rehatshëm në emër të sulltanit; dhe vetëm shahët Safavid të Iranit në lindje dhe Habsburgët e Austrisë në perëndim ndaluan otomanët nga zgjerimi i shtrirjes së tyre nga Kina e deri te Kanali Anglez.

Çdo majë është gjithashtu fillim i rënies. Ushtritë e Sulejmanit arritën fitore të tilla kaq të shpejta kundër hungarezëve më 1529 sa që ishin në gjendje papritmas të avanconin deri në Danub në Vjenë. Ushtria nuk ishte përgatitur për rrethim të gjatë të qytetit dhe nuk ishte e pajisur për dimër. Pas bllokimit disa javësh, Sulejmani, i rehatuar në një tendë më luksoze se shumë pallate të Evropës, vendosi se ishte më e urtë për t'u tërhequr sesa shtyrja e jeniçerëve në një fushatë dimërore. Marshi drejt Vjenës kishte qenë aq i lehtë sa që ai kishte imagjinuar rikthimin pranverën e ardhshme. Në vend të kësaj, kjo ishte një mundësi e humbur, dhe forcat otomane nuk do të kërcënonin më seriozisht qytetin deri në vitin 1683, kur ato dështuan sërish.

Gjatë këtyre viteve, diplomatët dhe tregtarët evropianë patën më shumë kontakte me otomanët. Sulejmani ishte figurë e madhërishme e enigmatike, por ai pranoi audiencat, ndërkaq një numër diplomatësh shkruan përshtypjet e tyre. Shumica e asaj që thanë përforcojnë ndjenjën se otomanët, me Sulejmanin në krye, ishin plotësisht të huaj dhe në mënyrë brutale efektivë.



Diplomacia e rregullt dhe bashkëveprimi i rastit nisi të largojë mistikën. Më 1520, një i dërguar venedikas përshkroi Sulejmanin e ri si "të gjatë e të hollë, me fytyrë të dobët e të madhe. Sulltani dukej miqësor dhe me humor të mirë. Thashethemet thoshin se ai... pëlqente leximin, ishte i ditur dhe tregonte gjykim të mirë".[5] Ai kishte të njëjtën hundë si shqiponjë sikur stërgjyshi i tij Mehmeti, dhe një fytyrë më të ngushtë të zbukuruar nga mjekra e rrallë otomane e favorizuar nga familja e tij. Kjo pamje nuk ndryshoi gjatë dekadave, megjithëse u bë më i zbehtë dhe më i verdhë me kalimin e viteve. Afër fundit të jetës së tij, sulltani pranoi një emisar mendjehollë të quajtur Ghiselin de Busbecq, derisa "ishte i ulur në një divan të ulët, jo më shumë se një pëllëmbë mbi tokë dhe i zgjatur me shumë mbulesa e jastëkë të qëndisur me një punë elegante... Shprehja e tij... ishte asgjë tjetër përveç buzëqeshjes dhe kishte rreptësi, e cila ndonëse e mërzitshme ishte plot madhështi". Duke lënguar nga gangrena, me vështirësi mblidhej dhe i zbehtë për vdekje, Sulejmani vuante nga kombinimi i fuqishëm dhe i dhimbshëm i dinjitetit dhe tragjedisë.

Ai kishte çdo arsye për të qenë i pikëlluar. Pavarësisht fitoreve të tij, jeta e tij personale ishte e paqëndrueshme. Ai kishte thyer rregullin themelor të klasës sunduese otomane dhe ishte martuar me një nga skllavet e haremit. Sulltanët nuk duhej të dashuronin nënat e fëmijëve të tyre, por Sulejmani e bëri këtë. Ajo, si pasojë, përdori pozicionin e saj për të përkrahur djemtë e saj dhe ktheu burrin e saj kundër fëmijëve të grave të tjera. Rezultati ishte vdekje kudo përreth. Sulejmani urdhëroi ekzekutimin e dy djemve të tij, dhe jeta e një tjetri përfundoi në rrethana të diskutueshme. Kur vdiq gruaja e tij, dy djemtë e tij të mbetur u kthyen kundër njëri-tjetrit, dhe kundër tij. Ai ekzekutoi edhe një tjetër, së bashku me disa nipër, duke lënë vetëm Selimin, i cili do ta pasonte atë.

Këto drama janë regjistruar sipas rregullit nga të dërguarit evropianë në qytet. Ngjashëm si perandorët romakë që kishin kombinuar aftësinë e hollë për të sunduar botën e njohur me dramat e errëta dhe

[5] Alan Fisher, *The Life and Family of Suleyman I.*

të shtrembëruara familjare, Sulejmani dhe trashëgimtarët e tij patën jetë të udhëhequra nga pasioni, intriga, seksi dhe vrasja. Derisa disa nga këto histori ushqyen imagjinatën evropiane rreth turqve epsharakë, ajo që na intereson më shumë ne është se religjioni kurrë nuk hyri në ekuacion.

Do të thotë: Sulejmani autorizoi ndërtimin e një xhamie të madhe në Stamboll, Sulejmanije. Ajo ishte monumenti më i rëndësishëm mysliman në atë kohë, por mbi gjysma e punëtorëve dhe mjeshtërve që e ndërtuan atë ishin të krishterë. Veç kësaj, sulltani mund të ketë besuar veten të jetë shërbëtor i devotshëm i Zotit, por ashtu siç ishte e vërtetë për klerin në Romë në atë kohë, një devocion i tillë nuk parandalonte mëkatin. Papët Medici dhe Borgia autorizuan vepra arti, patën dashnore, dhe u përpoqën të sigurojnë mirëqenien e shumë fëmijëve të tyre të paligjshëm. Sulltanët otomanë u sollën në mënyrë shumë të ngjashme.

Mungesa e Islamit të ashpër e doktrinar ishte në kontrast të zymtë me rolin e religjionit në Perëndim. Sa më shumë që i afroheshin otomanët Evropës, ata i ofronin shembullin të krishterëve perëndimorë, të cilët kishin rënë në periudhën e gjatë të jotolerancës. Të lodhur me korrupsionin e Kishës Katolike, murgu gjerman Martin Luter nisi një zinxhir ngjarjesh që shkaktuan Reformimin dhe luftërat disa dekadëshe në Evropë. Luteri e shihte Perandorinë Otomane nën Sulejmanin si një shembull të tolerancës fetare. Megjithëse ai dënonte otomanët si "shërbëtorë të djallit", për Luterin kjo ishte një kritikë e butë krahasuar me atë që tha për Papën dhe çifutët. Luteri shpresonte se një kishë e reformuar dhe e pastër një ditë mund të rivalizonte modelin otoman.

Disa dekada më vonë, filozofi francez Jean Bodin, ndonëse i bindur në besimin e tij katolik shkroi favorshëm për otomanët, "Perandori i madh i turqve me devocionin më të madh se çdo princ tjetër në botë, ka nderuar dhe ka vëzhguar religjionin, të marrë nga stërgjyshërit e tij dhe edhe pse e urren, nuk i duken të habitshme religjionet e të tjerëve; por përkundrazi lejon çdo njeri të jetojë sipas ndërgjegjes së tij dhe lejon katër religjione të ndryshme: atë të çifutëve, të krishterëve, të grekëve dhe të muhamedanëve". Duke jetuar në luftërat e religjionit



që kishin ndarë Evropën në përgjithësi dhe Francën në veçanti, Bodin kishte dëshmuar kostot e jotolerancës. Protestantët dhe katolikët e shikonin njëri-tjetrin me përbuzje, sharje dhe i premtonin ndëshkim në këtë jetë dhe dënim në tjetrën. Perandoria Otomane përfaqësonte një alternativë që Bodinit nuk mund t'i ndihmonte, por ta admironte.

Islami i otomanëve nuk krijoi pengesë në lidhjen e aleancave me shtetet e krishtera, dhe Sulejmani u përfshi në politikën e Evropës, jo vetëm si kundërshtar, por edhe si partner strategjik. Evropa ishte vijëzuar me ndarje, veçanërisht midis protestantëve dhe katolikëve dhe midis dy familjeve mbretërore, habsburgëve dhe valoisëve, armiqësia e të cilëve ishte e hidhur dhe e thellë. Habsburgët sundonin Spanjën, dhe nën Charlesin V ata qeverisën edhe tokat qendrore evropiane të Perandorisë së Shenjtë Romake. Valoisët kontrollonin Francën dhe paraqitnin sfidë për hegjemoninë Habsburge. Nën Francisin I, armiqësia midis dy familjeve u bë personale. Dy monarkitë zhvilluan urrejtjen e qëndrueshme për njëra-tjetrën, e cila ishte e bazuar më pak në eksperiencën direkte sesa në synimet e dinastisë. Por, kjo nuk e bëri urrejtjen më pak të fortë, dhe ajo e shtyri Francisin I të gjykojë armiqtë e Habsburgëve, pavarësisht se kush ishin apo cilin Zot e adhuronin.

Habsburgët kishin më shumë territor dhe më shumë pasuri (veçanërisht duke ditur ardhjen e argjendit nga tokat e reja të Amerikës Jugore), por ata gjithashtu konfrontonin më shumë armiq. Jo vetëm Charles V ballafaqoi Francisin, por ai gjithashtu duhej të luftonte me princërit gjermanë protestanët, borgjezët rebelë holandezë, Anglinë gjithnjë e më të paparashikueshme, dhe natyrisht, Perandorinë Otomane të paduruar dhe ekspansioniste e udhëhequr nga sulltani, i cili tërhoqi burime siç dukej të pashterueshme për të pajisur ushtrinë e tij. Duke pushtuar hungarezët, Sulejmani doli ballë për ballë me habsburgët. Duke shikuar nga Parisi, Francisi vendosi në fillim të viteve 1520 që armiku i armikut të tij ishte mik, dhe i ofroi aleancë Sulejmanit, i cili duke njohur avantazhin strategjik, u pajtua.

Për pjesën e mbetur të jetës së Sulejmanit, francezët dhe otomanët punuan së bashku për të poshtëruar Habsburgët. Aleanca ishte vazh-

dimisht ngacmuese për Charlesin V dhe trashëgimtarët e tij, por ata kurrë nuk u dorëzuan, pjesërisht për shkak të lidershipit të aftë dhe pjesërisht për shkak se Evropa Qendrore kurrë nuk ishte objektiv primar për Sulejmanin. Persia paraqitte kërcënim më të drejtpërdrejtë për otomanët, ashtu si sulmuesit venedikas që pengonin tregtinë në Mesdhe. Por, ashtu siç ka shkruar një historian, "aleanca franceze ishte themeli i diplomacisë evropiane të otomanëve". Sulejmani e dinte se partneriteti i tij me Francën i mbante habsburgët në defensivë, dhe kjo i jepte mundësi të ndiqte ambicie të tjera. Ai gjithashtu minoi fuqinë e habsburgëve duke përzier kazanin brenda Perandorisë së Shenjtë Romake. Ai kontaktoi princërit protestantë dhe u ofroi mbrojtjen e tij, duke pohuar se protestantët, pasi ishin ngritur kundër idhujtarisë së Kishës Katolike, ishin në rrugën e tyre ngjashëm me myslimanët e parë, të cilët kishin refuzuar idhujtarinë e mekasve.[6]

Këto pjesë nga jeta e Sulejmanit, mezi i bëjnë drejtësi sundimit të tij mbi dyzetvjeçar, por ato zbulojnë se shteti otoman ishte jo më shumë, dhe as më pak, i definuar nga besimi ashtu si habsburgët ishin të definuar nga Krishterimi apo romakët nga çfarëdo kulti pagan që ishte i përhapur. Islami ishte pjesë e besimit qeverisës, por ai ndante hapësirën me imperativët e rendit ruajtës, propagandës së dinastisë dhe garës për pozitë në çështjet e jashtme. Sulltanët nganjëherë përdornin Islamin si nxitje dhe justifikim për luftë, por i afroheshin trashëgimisë së Muhamedit dhe kulturës luftuese për pushtimeve të para arabe vetëm kur iu përshtatej atyre. Kur dëshironin të bënin gjëra që mund të shiheshin si problematike sipas ligjit dhe jurisprudencës islame, ata e bënin këtë pa hezitim, duke ditur se madje në ngjarje jo të ngjashme si ato që kundërshtonte ulemaja, të tjerët do të mbështesnin gjithçka që bënte sulltani. Shumë prej veprimeve të tyre do të kishin ngritur flamuj të tillë, nëse Islami do të kishte qenë forca vitale që mbante perandorinë të bashkuar. Nuk kishte asnjë mënyrë për të justifikuar vëllavrasjen dhe rebelimin duke përdorur Kur'anin apo hadithin, e as

[6] Halil Inalcik, *The Ottoman Empire: The Classical Age, 1300-1600.*



haremin apo sistemin e eunukëve për të bashkërenduar me ligjin islamik.

Trashëgimia otomane gjithashtu na detyron të rikonsiderojmë se çka kemi për qëllim kur themi "Islam". Aleancat që Sulejmani i çimentoi me francezët katolikë nuk e kanë shtyrë askënd të pyesë vërtetësinë e tij si mysliman. Autonomia që Mehmedi ua dha çifutëve, grekëve ortodoksë dhe armenëve nuk paraqitën sfida për pozitën e tij si besimtar i devotshëm. Islami, si çdo religjion tjetër i rëndësishëm, është ombrellë që përfshin një gamë të gjerë virtytesh dhe një mori mëkatesh. Dijetarët dhe gjykatësit mund të kenë ruajtur të drejtën për të kritikuar sulltanin, por ata pothuajse kurrë nuk e ushtruan atë. Sundimtarët u panë si element i domosdoshëm pasi frenonin kaosin që pashmangshmërisht do të pasonte nëse shkatërrohej shteti.

Vdekja e Sulejmanit nuk i largoi menjëherë otomanët si kërcënim për Evropën. Një shekull më vonë, më 1683, një sulltan tjetër kërcënoi sërish Vjenën, dhe njëri ishte shumë afër marrjes së qytetit. Por, edhe po të kishte pasur sukses, zor se otomanët do të kishin pushtuar Evropën. Rusët u bënë një armik i frikshëm, ashtu si francezët dhe anglezët. Dhe derisa rivalët e saj u zhvilluan, brenda perandorisë, shumë pak ndryshoi. Otomanët po humbnin ngadalë avantazhin e tyre konkurrues. Pas vitit 1683, Evropa nisi të zmbrapsej, dhe u vu ekuilibri. Për shekuj, otomanët qëndruan si monument të ekuilibrit. Pastaj, perandoria nisi të copëtohej, dhe kur u shkatërrua më në fund në fillim të shekullit njëzet, marrëdhëniet midis myslimanëve, të krishterëve dhe çifutëve morën kahe për të keq.

Pjesë e shkëputur nga libri "Ithtarët e librit:
*"Historia e harruar e Islamit dhe Perëndimit"*.

*Përktheu:*
***Fuad Morina***

*Zachary Karabell*

## EUROPE AND THE OTTOMAN EMPIRE

### (Summary)

After more than one thousand years, the city of Constantinople, the capital of the greatest Christian empire the world had ever seen, was conquered by a Muslim army. The very moment sultan Mehmed II, who later became known as the conqueror, marched in the Aya Sophia Church in the center of Constantinople, Byzantium ceased to exist as an empire, except in name.

*زكريا كارابل*

## أوروبا والدولة العثمانية

### (خلاصة البحث)

عندما جاءت النهاية أخيرا كانت كارثة و كانت أيضا بدون معنى. بعد أكثر من ألف سنة احتل مدينة القسطنطينية مركز أكبر إمبراطوريةعرفها العالم المسيحي من قبل جيش مسلم. لكن في حين أن سلطان محمد الثاني الذي عرف فيما بعد بـ "الافاتح" سار الى كنيسة آيا صوفيا في وسط القسطنطينية ومنذ ذلك الحين بيزنطة لم تعد موجودة كإمبراطورية ولكن فقط كاسم.

**ARABISTIKË**

*Muzafer Shkodra*

# ARABISTIKA NË REVISTËN "DITURIA ISLAME" NR. 1-30/31

## H Y R J E

Arabistika[1] është disiplinë shkencore, që në gamën e saj përfshin gjuhën, traditën letrare, kulturore dhe shkencore. Me fjalë të tjera ngërthen në vete tërë atë që i takon Botës Arabe dhe historisë së asaj bote.

Pranimi i fesë islame te shqiptarët këtu e 6 shekuj më parë ka ndikuar që arabistika, të jetë e pranishme në literaturën shqipe - për rastin tonë në revistën *"Dituria Islame"*. Kjo është e kuptueshme kur dihet se Kur'ani – Libri i shenjtë i myslimanëve është i shpallur në gjuhën arabe. Thënë më thjesht, gjuha arabe si gjuhë e Kur'anit, ka bërë që arabistika te ne të jetë e pranishme, që nga mesjeta kur te ne, krahas fesë islame, depërtuan edhe shkrime të tjera nga kjo fushë.

Arabistika në formë të shkruar me alfabetin shqip me ortografi latine është e pranishme që nga koha e Rilindjes Kombëtare e këtej. Nga ajo kohë kemi vepra të dijetarëve të njohur islamë të përkthyera në gjuhën shqipe. Këto vepra janë kryesisht me karakter fetar të përgatitura për nevojat e besimtarëve myslimanë.

Arabistika në Kosovë zë fill pas Luftës së Dytë Botërore, kur kemi të botuara disa vepra nga letërsia arabe, si në prozë ashtu edhe në poezi, pastaj zë fill edhe botimi i veprave të veçanta nga fusha e islamologjisë[2].

Revista "*Dituria Islame*" si organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, fillon të dalë në qershor të vitit 1986. Është revistë fetare, shkencore e kulturore. Në fillim ka dalë në çdo tre muaj, ndërsa nga viti 1990 del çdo muaj.

Revista "*Dituria Islame*" boton tema nga tefsiri, hadithi, akaidi, fikhu, historia e qytetërimi islam, por këtu kemi gjetur edhe tema nga fusha e gjuhësisë dhe letërsisë arabe.

Ndërkaq objekt i punimit të diplomës sime është që të evidencoj çfarë është botuar nga arabistika në revistën *"Dituria Islame"*, nr. 1-30/31.:

Punimet e publikuara në "Dituria Islame" që kanë të bëjnë me arabistikën i kemi ndarë në këto grupe:

- punime të autorëve arabë që janë përkthyer nga arabishtja;
- punime të autorëve arabë, që janë të përkthyera nga gjuhë të tjera respektivisht nga gjuha serbe (boshnjake);
- punime të autorëve shqiptarë, që kanë të bëjnë me gjuhën, letërsinë dhe kulturën arabe;
- informata nga bota islame, që kanë të bëjnë me ndonjë ngjarje nga Bota Islame.

Renditjen e kemi bërë sipas ABC, ndërsa në punën tonë kemi përdorur sistemin e bibliografisë. Fillimisht kemi dhënë mbiemrin, pastaj emrin e autorit, pastaj kemi dhënë titullin e temës, emrin e përkthyesit, numrin e revistës dhe numrin e faqes. Përveç këtyre të dhënave, kemi bërë edhe komente të shkurtra për temat, të cilat na janë dukur se janë më me interes për opinionin hulumtues.

---

[1] Në këtë punim kam hulumtuar revistën "Dituria Islame" nga nr. 1-30/31, dhe kam marrë në shqyrtim temat që kanë të bëjnë me lëmin e Arabistikës.
Tema është punuar nën kujdesin e mentorit akad. Feti Mehdiu, i cili me këshillat, vërejtjet dhe sugjerimet e tij bëri që kjo temë të jetë e këtij niveli.

[2] Më gjerësisht shih: R. Shkodra & A. Pireva, Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë 1957-1997, Prishtinë 1998.

## Arabistika në revistën “Dituria Islame” nr. 1-30/31

**A.**: ***Shkaku dhe arsyeja që është bërë farz namazi (Salati);*** *Dituria Islame* nr. 6, fq. 22-23. Hutbe (predikim) kushtuar namazit, është e stilit dhe e autorit të njëjtë nga hutbeja e nr. 4.)

**A**.: ***Namazi (Salati);*** *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 31-32. Hutbe (predikim) kushtuar namazit. Hutbes i paraprin ajeti i 238 i sures Al-Bakara, të cilin e ka sjellë edhe në origjinal, por nuk është dhënë emri i autorit të këtij kontributi. Në fund është vetëm shkronja A.

**A.S.A**.: ***Ç'na përkujton mevludi-si ta shënojmë atë?;*** *Dituria Islame* nr. 1, fq. 13-14. Trajtesë kushtuar shënimit të datëlindjes së Muhammedit a.s., që fillon me një hadith të Pejgamberit a.s. ku thuhet: ”Në Mekë e njoh gurin që më ka përshëndetur...”, dhe në fund kemi vetëm inicialet A.S.A., që për lexuesin mund të jetë autor i këtij kontributi.

**A.S.A.**: ***Hyrje (ose drejt devotshmërisë);*** *Dituria Islame* nr. 3, fq. 13-16. Trajtesë kushtuar devotshmërisë, temë nga etika islame-Ahlaku, dhe në fund kemi vetëm inicialet A.S.A., që për lexuesin mund të jetë autor i këtij kontributi.

ABDUL-LATIF; dr. Sejjid: ***A ka qenë, vërtet, Muhammedi a.s. analfabet***; Përktheu: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 27, fq. 11-14. Shënim kushtuar dilemës a ka qenë Pejgamberi analfabet. Autori trajtesën e nis me domethënien e “Ummijjun” që është përkthyer si analfabet, por autori nuk pranon këtë interpretim. Duke u mbështetur në ajetet Kur’anore 3-5 të sures “Alek”: *“Lexo (mëso) dhe lartësoje Zotin tënd, i cili i mësoi (ta përdorin) lapsin. E mësoi njeriun në atë çka nuk dinte”*, pastaj merr shembull edhe ajetet 2-3 të sures “El-Benijjeh”: *“I dërguari i Allahut, i cili lexon prej faqeve të pastra, të cilat mbajnë shkrime të vërtetat”*. Autori, duke u mbështetur në këto ajete dhe të tjera si dhe në hadithet e Pejgamberit, në shkrimin e tij, që është një punim polemizues me komentatorët tradicional të Kur’anit, ndër të tjerat thotë *“Pejgamberi a.s., mësues i njerëzisë mësonte se të gjithë besimtarët janë të obliguar të arrijnë dituri, si meshkuj ashtu edhe femra, e atë mund ta bënin vetëm nëpërmjet pendës”*. Autori në vazhdim flet për rëndësinë që i ka kushtuar Pejgamberi a.s. diturisë, si dhe ngre disa teori për mundësinë e mësimit të shkrim-leximit nga pejgamberi gjatë fëmijërisë së tij.



ABDUL-VAHID; Dr. Mustafa: ***Qëndrimi i myslimanit ndaj Allahut xh.sh.;*** Përktheu dhe përshtati: Avni Aliu; *Dituria Islame*, nr. 12, fq. 23-27. Trajtesë nga Apologjetika islame-Akaidi, që i kushtohet nevojës së njeriut respektivisht myslimanit për besimin në Allahun xh.sh.

ABDUL-VAHID; Dr. Mustafa: ***Besimi në caktimin e Allahut;*** Përktheu dhe përshtati: Avni Aliu; *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 5-13. Trajtesë nga Apologjetika islame-Akaidi, që i kushtohet besimit, autori trajton në mënyrë analitike një nga kushtet themelore të fesë islame caktimin e Allahut *(Kada e Kader).*

ASHURE; Abdul-Latif: ***Mjalta[3] shëruese apo jo?;*** Nga arabishtja e shqipëroi: Ridvan Kurtishi; *Dituria Islame* nr. 12, fq. 30-34. Shënim kushtuar vetive shëruese që ka mjalti. Shënimi fillon me rolin e njeriut që i ka dhënë Krijuesi në Tokë, për të vazhduar me një vështrim të shkruar që i bëhet mjaltit gjatë shekujve, ku vihen në pah elementet pozitive të mjaltit në ruajtjen e vitalitetit të njeriut. Për këtë sillen shembuj nga jeta e Pitagorës, si dhe këshilla e Ibni Sina-it.

ASHURE; Abdu l-Latif: ***Mjalta shëruese apo jo?*** (2); Shqipëroi: Ridvan Kurtishi; *Dituria Islame* nr. 13-14, fq. 20-23. Shënim kushtuar vetive shëruese që ka mjalti (vazhdimi i dytë), ku në mënyrë të shkoqitur janë dhënë vetitë shëruese të mjaltit, si: Përdorimi i mjaltit në shërimin e plagëve; Mjalti dhe sëmundjet e sistemit të tretjes, shërimi i flamës nga mjalti, mjalti dhe sëmundjet e zemrës dhe gjakut, mjalti dhe sëmundjet e lukthit dhe të zorrëve; ndikimi i mjaltit te mushkëritë; përdorimi i mjaltit në shërimin e sistemit nervor; përdorimi i mjaltit në shërimin e syve; përdorimi i mjaltit

[3] Sipas drejtshkrimit duhet të jetë ***Mjalti***

në shërimin e sëmundjeve të gojës dhe dhëmbëve, shërimi i reumës; helmi i bletës dhe shërimi i Aidsit.

AZIZU-S-SAMED; U.: ***Pozita e femrës në islam dhe në krishterizëm***; Përktheu: Nexhat Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 24, fq. 37. Trajtesë që i kushtohet pozitës së femrës në dy fetë: islamit dhe krishterimit. Trajtesa nis me pozitën e femrës në fenë krishtere që nga koha e Shën Palit, për të vazhduar me pozitën që i ka dhënë feja islame.

BAJGORA; Sabri: ***Fjala e hfz. Sabri Koçit në Kongresin Islamik - Kajro;*** *Dituria Islame* nr. 26, fq. 64. Shënim për paraqitjen e Hfz. Sabri Koçit në Konferencën e Përgjithshme Islame në Kajro.

BAJRAMI; Mustafë: ***Koment gjurmëve të një kongresi;*** *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 38-39. Informatë nga Kajroja.

BAJRAMI; Mustafë: ***Letër nga Egjipti - El-Az'hari ndër universitetet e para në botë***; *Dituria Islame* nr. 3, fq. 28. Informatë nga studentët shqiptarë në Kajro.

BAJRAMI; Mustafë: ***Nga bota islame;*** *Dituria Islame* nr. 3, fq. 29. Përmbledhje informatash nga Bota Islame.

BAJRAMI; Mustafë: ***U mbajt kongresi VI me radhë i Da'ves islame;*** *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 36-37. Informatë nga Kajroja.

DIJAB; Sami: ***Sikur të kisha bashkëjetuar me ty o pejgamber i Zotit;*** *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 40. Shënim kushtuar dashurisë ndaj pejgamberit. Shënimi nis me një falje që autori i kërkon Ebul Kasim (Muahmedit a.s): ”...nëse i tejkaloj mundësitë e dëshirave të mia në datëlindjen tënde!”

Dr. L.M.: ***Kur mendja kërkon të vërtetën*** (Përktheu: Ajni Sinani); *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 34. Shënim i shkurtë kushtuar rëndësisë që ka njeriu për fenë.

E.O.**: *Universiteti i Kajros;*** *Dituria Islame* nr. 19, fq. 42. Shënim kushtuar Universitetit të Kajros, ky shënim është përgatitur nga Elez Osmani.

EBDUL-VAHID; Dr. Mustafa: ***Përmende shpesh Allahun dhe kërkoi falje;*** Përktheu dhe përshtati: Avni Aliu; *Dituria Islame* nr. 15-16, fq. 26-29. Trajtesë nga Apologjetika islame-Akaidi, që i ku-



shtohet adhurimit të Allahut, dhe nevojës që ka besimtari për pendim.

ED-DIVANI; Dr. Mustafa: ***Momentet e fundit të jetës së Pejgamberit a.s;*** *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 40-41. Shënim nga historia islame që u kushtohet momenteve të fundit të jetës së Pejgamberit a.s.

BEHXHED; Ahmed: ***A mund të shihet All-llahu?;*** Përktheu: Resul Rexhepi; *Dituria Islame* nr. 24, fq. 17-19. Trajtesë didaktike, nis me një parafrazim të stilit letrar, për të vazhduar me argumente nga Kur’ani, pastaj tregime didaktike nga jeta e pejgamberëve, dhe mendime të dijetarëve të shquar islamë.

EL GAZALI; Ebu Hamid: ***Njohja e kësaj bote;*** E përgatiti: Nexhat Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 13-14, fq. 10-11. Trajtesë nga fusha e Apologjetikës islame-Akaidit, që i kushtohet nevojës së njohës së kësaj bote - dynjasë, sipas parimeve islame.

EL GAZALI; Ebu Hamid: ***Njohja e vetvetes;*** Përktheu dhe përshtati: Nexhat Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 12, fq. 27-29. Trajtesë nga fusha e etikës islame-Ahlakut, ku spikatën tiparet e një besimtari të sinqertë. Shënimi nis me shkoqitjen e hadithit të Pejgamberit: *“Ai që e njeh veten e njeh edhe Perëndinë”*.

EL GAZALI; Muhammed: ***Ejjuhel-Veled (o djalosh);*** Përktheu: Miftar Ajdini; *Dituria Islame* nr. 1, fq. 18-20. Trajtesë nga fusha e etikës-Ahlakut, është prozë e Gazali-ut dhe ka karakter didaktik e moralizues, ku ngjarja është vendosur te një djalosh i vogël.

EL GAZALI; Muhammed: ***Ejjuhel - Veled (2);*** Përktheu nga "Preporod"-i: Miftar Ajdini; *Dituria Islame* nr. 2, fq. 21-25. Trajtesë nga fusha e etikës-Ahlakut, është prozë e Gazali-ut ka karakter didaktik e moralizues, ngjarja është vendosur te një djalosh i vogël.

EL KARDAVI; Jusuf: ***Pijet alkoolike;*** Përktheu e përshtati: Ebu Muamer; *Dituria Islame* nr. 6, fq. 19-21. Trajtesë nga lënda e Jurisprudencës Islame - Fikhut. Është qasje e fikhut për ndalesën e pijeve alkoolike.

EL-AMMARI; Abdulkadir Ibni Muhammed: ***A patën dobi myslimanët nga jeta profetike e Muhammedit a.s.?;*** Përktheu nga arabishtja: Bajrush Ahmeti; *Dituria Islame* nr. 7, fq. 24-25. Vështrim

historik që i kushtohet ndikimit të profetit Muhammed për dije, arsimim e përparim te myslimanët. Këtu autori përmend rezultatet e arritura nga shkencëtarët e njohur myslimanë si Ibni Hathemi, Ibni Nefisi, Biruni, Rraziu, Ibni Sina-i etj.

EL-AMMARI; Abdul-Kadir Ibni Muhammed: ***A patën dobi myslimanët nga jeta profetike e Muhammedit a.s.?*** (2); Përktheu nga arabishtja Bajrush Ahmeti; *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 20-24. Vështrim historik, që i kushtohet ndikimit të profetit Muhammed për dije, arsimim e përparim te myslimanët. Këtu autori ka trajtuar ofrimin e mbrojtjen që i dhanë medinasit Pejgamberit, rëndësinë e hixhretit, marrëdhëniet e myslimanëve me të tjerët etj.

EL-BEHIJJ; Dr. Muhammed: ***Si ta shënojmë ditëlindjen e Pejgamberit a.s.?;*** Përktheu nga boshnjakishta: Muhidin Ahmeti; *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 13. Një shënim i shkurtër se si duhet shënuar datëlindjen e Pejgamberit a.s..

EL-MEWDUDI; Ebu-l-Ala: ***Misioni i pejgamberisë*** (Përktheu: N. Ibrahimi); *Dituria Islame* nr. 6, fq. 12-15. Një vështrim i gjatë kushtuar misionit të pejgamberisë, që është botuar në katër vazhdime. Ky vështrim nga dijetari i njohur Mewdudi vë në pah nevojën e njerëzimit për pejgamber, ku në mënyrë të shkoqitur i bazuar në ajete e hadithe, argumenton misionin e Pejgamberit në transmetimin e Fjalës Hyjnore te njeriu. Në fillim të këtij vështrimi autori shkruan për domosdoshmërinë e misionit të pejgamberëve.

MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Misioni i pejgamberisë (2);*** Përktheu: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 7, fq. 25-29. Trajtesë nga Apologjetika -Akaidi.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Misioni i pejgamberisë (3);*** Përktheu: Nexhatudin Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 15-20. Trajtesë nga Apologjetika - Akaidi.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Misioni i pejgamberisë (4);*** Përktheu: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 12, fq. 18-23. Trajtesë nga Apologjetika -Akaidi.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-Ala: ***Premisat themelore për të kuptuarit e Kur'anit;*** Përktheu nga s.k.: Nexhatudin Rahimi; *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 22-23. Trajtesë nga Apologjetika - Akaidi. Trajtesë nga Apologjetika - Akaidi, në këtë shkrim është jeta vepra dhe mendimi i Ebu-L-A'la El-Mewdudi-së. Shënimi nis me sqarimin dhe jepet për lexuesit se qëllimi i kësaj persiatje është që lexuesve t'u prezantohen njohuri për Mewdudi-un udhëheqësin fetar indo-pakistanez dhe pa mëdyshje (sic) mendimtarin më të begatshëm dhe më autoritativ islam në shekullin XX. Në pesë vazhdime është botuar studimi i Mewdudi-ut që u kushtohet premisave themelore për të kuptuar Kur'anin.



EL-MEWDUDI; Ebu-l-Ala: ***Premisat themelore për të kuptuarit e Kur'anit (2)***; Përktheu nga s.k.: Nexhatudin ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 6, fq. 16-19. Trajtesë nga Apologjetika – Akaidi vazhdimi i dytë.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Premisat themelore për të kuptuarit e Kur'anit (3)*** (Përktheu: N. Ibrahimi); *Dituria Islame* nr. 7, fq. 17-21. Trajtesë nga Apologjetika – Akaidi.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Premisat themelore për të kuptuarit e Kur'anit*** (4); Përktheu: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 13-15. Trajtesë nga Apologjetika – Akaidi.

EL-MEWDUDI; Ebu-l-A'la: ***Premisat themelore për të kuptuarit e Kur'anit*** (5); Përktheu: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 12, fq. 17-18. Trajtesë nga Apologjetika – Akaidi.

ERR-RRUKBAN...; Abdullah El-Alij: ***Dëmet shëndetësore nga duhani***; *Dituria Islame* nr. 25, fq. 34-35. Trajtesë nga lënda e mjekësisë që i kushtohet dëmit që shkakton duhani, ku përpos në aspektin shkencor e mjekësor, pirja e duhanit trajtohet edhe sipas Sheriatit islam.

ESH-SHA'RAVI; M.M: ***El Fetava;*** nga arabishtja përktheu e përshtati: Resul Rexhepi; *Dituria Islame* nr. 3, fq. 11-12. Shënim ku janë botuar disa përgjigje - fetva të dijetarit të njohur egjiptian Sharavi, që janë botuar në shtypin e Egjiptit. Përgjigjet e Sharaviut janë përzgjedhur edhe me aktualitetin te ne, këtu janë botuar fetva që ka dhënë Sharaviu për mëkatet e vogla, për pendimin, dënimin me burgim, Ditën e Ahiretit etj.

ET-TAHAVI; Ebu Xha'fer: ***Akaidi i Tahavisë;*** Përktheu: Ajni Sinani; *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 19-22. Trajtesë nga Apologjetika - Akaidi. Vështrim analitik për akaidin e Tahavi-ut.

ET-TENUBI; Salaha Ahmed: ***Misioni i Muhammedit a.s. - feja e të gjithë pejgamberëve***; përktheu nga arabishtja: Q. Morina; *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 15. Trajtesë kushtuar misionit të Pejgamberit, ku është trajtuar *Njësimi i shpalljes; Të gjithë janë myslimanë; Feja është një.*

HAMIDULLAH; Muhammed: ***Përse e studiojmë Muhammedin (a.s.)?;*** Përktheu: Nexhat Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 1, fq. 12-13. Shënim kushtuar shkaqeve që duhet studiuar Muhammedin a.s.,. për arsyet që duhet studiuar jetën e Pejgamberit, për se autori ndër të tjerat, thotë “*Nuk mund të jetë mysliman ai, i cili nuk e ndjek shembullin e udhëheqësit të tij”*. Autori në vazhdim jep 8 arsye për të njohur e ditur jetën e Pejgamberit.

HAMITI; Mr. Abdullah: ***Pasqyrë e krijimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë;*** *Dituria Islame* nr. 18, fq. 22-24. Studim kushtuar krijimtarisë letrare shqipe të krijuar nga shkrimtarët shqiptarë me alfabet arab në Kosovë. Në këtë studim janë përfshirë kontributet letrare të Tahir Boshnjakut nga Gjakova, Dervish Hasanit nga Krusha e Vogël, mulla Beqirit nga Drenica, Shejh Eminit nga Gjakova, Shejh Junuzit nga Suhadolli etj. Studimi është i pajisur me aparaturë shkencore.

HART; M.: **Muhammedi i dërguari i All-llahut**; Përktheu nga arabishtja: Melaim Shehu; *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 18. Trajtesë kushtuar misionit - pejgamberëllëkut të Muhammedit a.s. sipas studiuesit amerikan M. Hart.

**Intervista (me prof. Ahmed Hajdush-in),** (Intervistuan: Elez Osmani, Qemajl Morina); *Dituria Islame* nr. 17, fq. 22-23. Intervistë me prof Ahmed Hajdushin, profesor i kritikës letrare në Universitetin Tizi-Uzul në Algjeri.

ISMAILI; imam Vehbi: ***Ebu Hamid el Gazali-u (1058-1111);*** E përshtati për botim: N. Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 19, fq. 16-17.



Shënim biografik kushtuar filozofit të njohur islam, Ebu Hamid El-Gazali.

JUNUS; Muhammed: **Shqyrtimi shkencor i ajeteve të Kur'anit mbi ekzistencën**; Përktheu nga arabishtja: Arif Emini; *Dituria Islame* nr. 26, fq. 62. Trajtesë për të dhënat shkencore lidhur me ekzistencën e qenies njerëzore bazuar në ajetet Kur’anore.

LAMALLARI; M. & YMERI; A., SYLA; M.: ***Festa e "Fitër-Bajramit" në mesin e studentëve shqiptarë dhe boshnjakë*** *(Letër nga Kajro)*; *Dituria Islame* nr. 25, fq. 28-29. Reportazh nga Kajro, për manifestimin e festës së Fitër-Bajramit, në mesin e studentëve shqiptarë e boshnjakë.

MAHMUD; Dr. M.: ***All-llahu;*** Përkthimin dhe shënimet: Nexhat Ibrahimi; *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 7-10. Trajtesë doktrinare nga fusha e Apologjetikës - Akaidit.

MAHMUD; Dr. Mustafa: ***Islamizmi nuk njeh ndërmjetësim;*** Përktheu: Rexhep Luma, *Dituria Islame* nr. 1, fq. 9-11. Trajtesë doktrinare nga fusha e Apologjetikës – Akaidit.

MORINA; Mr. Qemajl: ***Disa të dhëna arkivore mbi shqiptarët në arkivin kombëtar të Egjiptit në Kajro;*** *Dituria Islame* nr. 18, fq. 47. Shkrim informativ që zbardh të dhënat për lëndën arkivore, që ka të bëjë me shqiptarët e që ruhet në Arkivin Kombëtar të Egjiptit.

MORINA; Mr. Qemajl: ***Çështja shqiptare në shtypin arab (3);*** *Dituria Islame* nr. 28, fq. 43-44. Shënim kushtuar çështjes shqiptare në shtypin arab, respektivisht Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian. Këtu paraqitet qëndrimi i Turqisë ndaj Lidhjes së Prizrenit.

MORINA; Mr. Qemajl: ***Çështja shqiptare në shtypin arab (4);*** *Dituria Islame* nr. 29, fq. 36-38. Shënim kushtuar çështjes shqiptare në shtypin arab, respektivisht Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian. Këtu paraqitet qëndrimi i Lidhjes së Prizrenit në mbrojtjen e trojeve shqiptare në veriun e Malit të Zi.

MORINA; Mr. Qemajl: ***Çështja shqiptare në shtypin arab (5);*** *Dituria Islame* nr. 30-31, fq. 61-66. Shënim kushtuar çështjes shqiptare

në shtypin arab, respektivisht Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian. Këtu paraqitet mbrojtja e Hotit e Grudës nga shqiptarët.

MORINA; Mr. Qemajl: ***Çështja shqiptare në shtypin arab***; *Dituria Islame* nr. 27, fq. 39-42. Shënim kushtuar çështjes shqiptare në shtypin arab, respektivisht Lidhjes së Prizrenit në shtypin egjiptian, ku paraqitet aktiviteti i Lidhjes së Prizrenit në gazetën “El-Vakie” etj.

MORINA; Qemajl: ***Një fole e shuar e kulturës shqiptare në Egjipt;*** *Dituria Islame* nr. 15-16, fq. 24. Shënim kushtuar teqesë bektashiane shqiptare në Kajro, ku vihet në pah roli i teqesë në ruajtjen e ndjenjave të kolonisë shqiptare në Egjipt.

NAHI; Nexhat H. prof.: ***Kuvajti - vend i "arit të lëngët"***; *Dituria Islame* nr. 20, fq. 36-37. Shkrim nga fusha e gjeografisë, që i kushtohet Kuvajtit.

NAHI; Nexhat H., prof.: ***Arabia Saudite - djepi i islamizmit***; *Dituria Islame* nr. 24, fq. 48-49. Shkrim nga fusha e gjeografisë, që i kushtohet Mbretërisë së Arabisë Saudite, ku jepen të dhëna gjeografike, historike dhe statistika për zhvillimin e ekonomisë e industrisë së Arabisë Saudite.

NAHI; Nexhat H., prof.: ***Iraku shtet arab në trollin e Mesopotamisë së lashtë;*** *Dituria Islame* nr. 21, fq. 36-38. Trajtesë nga gjeografia, kushtuar Irakut, shkrimi fillon me domethënien e emrit të shtetit, pastaj në vazhdim jepen të dhëna të tjera statistikore, ekonomike, demografike, si dhe të dhënat gjeografike për Irakun.

NAHI; Nexhat H., prof.: ***Jordania - shtet i Lindjes së Afërme;*** *Dituria Islame* nr. 26, fq. 44-45. Shkrim nga fusha e gjeografisë, që i kushtohet Mbretërisë së Jordanisë, ku jepen të dhëna gjeografike, historike dhe statistika për zhvillimin e ekonomisë e industrisë së Jordanisë.

NAHI; Nexhat H., prof: ***Siria - shtet mesdhetar në Lindjen e Afërme***; *Dituria Islame* nr. 28, fq. 36-38. Shkrim nga fusha e gjeografisë, që i kushtohet Sirisë.



NEBI**;** Malik Ibn: ***Vlera sociologjike e idesë së Kur'anit;*** Përktheu: I.L.; *Dituria Islame* nr. 3, fq. 25-26. Shënim që vë në pah vlerat dhe qasjen sociologjike të Kur’anit.

OSMANI; Elez: ***Intervistë me Tahir Kukajn;*** *Dituria Islame* nr. 22-23, fq. 47-48. Intervistë me Tahir Kukajn bashkëpunëtor në Radio Kajro, në këtë intervistë Tahir Kukaj flet për punën që bëhet në Radio Kajro në programin në gjuhën shqipe.

OSMANI; Elez: ***Lashtësia e kulturës;*** *Dituria Islame* nr. 18, fq. 35-36. Shënim kushtuar kryeqytetit të Egjiptit Kajros, ku vend të posaçëm zë edhe Universiteti Al-Azhar.

OSMANI; Elez: ***Nili - lumë jete;*** *Dituria Islame* nr. 17, fq. 18-20. Shënim kushtuar lumit Nil.

POLISI; Mehdi: ***Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe;*** *Dituria Islame* nr. 19, fq. 33-35. Studim nga fusha e gjuhësisë, ku autori vë në pah me një qasje serioze për adaptimet fonetike të arabizmave në leksikun e gjuhës shqipe. Autori ka vënë në pah huazimet e arabizmave dhe adaptimet që kanë pësuar në gjuhën shqipe, studimi është i një rëndësie të veçantë.

POLISI; Mr. Mehdi: ***Adaptimet fonteike të arabizmave në gjuhën shqipe (2);*** *Dituria Islame* nr. 20, fq. 39-41. Studim nga fusha e gjuhësisë, ku autori vë në pah me një qasje serioze për adaptimet fonetike të arabizmave në leksikun e gjuhës shqipe. Autori ka vënë në pah huazimet e arabizmave dhe adaptimet që kanë pësuar në gjuhën shqipe, studimi është i një rëndësie të veçantë.

POLISI; Mr. Mehdi: ***Adaptimet fonetike të arabizmave në gjuhën shqipe*** (3); *Dituria Islame* nr. 21, fq. 34-35

SABUNI; Muhammed Ali: ***Njohuri lidhur me Kur'anin (2),*** Përktheu dhe përshtati: Sh. A.; *Dituria Islame* nr. 2, fq. 8-11. Trajtesë kushtuar Kur’anit, punimi është përkthyer nga H. Sherif Ahmeti.

SABUNI; Muhammed Ali: **Njohuri lidhur me Kur'anin;** Përktheu dhe përshtati: Sh. Ahmeti; *Dituria Islame* nr. 1, fq. 4-6. Trajtesë kushtuar Kur’anit, punimi është përkthyer nga H. Sherif Ahmeti.

SAHRIJ; Muhammed: ***Testamenti i dëshmorit (shehidit) sahrij;*** E shqipëroi Sylejman Çerkezi; *Dituria Islame* nr. 18, fq. 11. Shënim

doktrinar që i kushtohet shehidit, ku është vënë në pah roli që ka shehidi në fenë islame.

SHARAVI; Muhammed Muteveli: ***Shpjegim i domethënieve të ajeteve të Kur'anit rreth Isait a.s.;*** Përktheu: Sherif Ahmeti; *Dituria Islame* nr. 15-16, fq. 11-14. Trajtesë nga fusha e Tefsirit, ku shpjegohen e komentohen ajetet për Isain a.s..

SHEHU; Melaim: ***Muhammedi a.s. për diturinë;*** *Dituria Islame* nr. 2, fq. 25. Shënim që vë në pah qëndrimin e Muhammedit a.s. për diturinë. Në këtë punim janë shkoqitur hadithe të Pejgamberit për diturinë.

TAXHEDIN; Abdurrahman: ***Hixhreti;*** Përktheu: Q.M.; *Dituria Islame* nr. 27, fq. 15-17. Trajtesë nga historia islame që i kushtohet ngjarjes së Hixhretit, si ngjarje me të cilin fillon njësimi i epokës së myslimanëve. Trajtesa ka karakter historik dhe fetar.

THAÇI; Mr. Hamdi: ***Gjenialiteti i dijetarit arab Ibni Haldunit (2);*** *Dituria Islame* nr. 6, fq. 23-25. Trajtesë kushtuar dijetarit të njohur arab Ibn Haldunit e shoqëruar me një vështrim për diapazonin e njohurive të tij në fushën e filozofisë po edhe në fushat tjera.

THAÇI; Mr. Hamdi: ***Gjenialiteti i dijetarit arab Ibni Haldunit (3);*** *Dituria Islame* nr. 7, fq. 21-24. Trajtesë kushtuar dijetarit të njohur arab Ibn Haldunit, shoqëruar me një vështrim për diapazonin e njohurive të tij në fushën e filozofisë po edhe në fushat tjera.

THAÇI; Mr. Hamdi: ***Gjenialiteti i dijetarit arab Ibni Haldunit;*** *Dituria Islame* nr. 4-5, fq. 26-29. Trajtesë kushtuar dijetarit të njohur arab Ibn Haldunit, shoqëruar me një vështrim për diapazonin e njohurive të tij në fushën e filozofisë po edhe në fushat tjera.

*** ***Alkooli*** (vjershë - përktheu: Melaim Shehu); *Dituria Islame* nr. 1, fq. 30. Poezi e përkthyer që ka si tematikë dëmin e alkoolit.

*** ***Bisedë e huazuar (me Muhammed El-Gazalin);*** Përktheu nga arabishtja: Q. Morina; *Dituria Islame* nr. 24, fq. 33-36. Në këtë bisedë - intervistë Muhammed el-Gazali flet për rëndësinë që ka feja për njeriun ku ai kërkon kthimin në parimet e fesë.

*** ***I'xhazi i Kur'anit me disa veçanti leksikore dhe stilistikore të tij;*** *Dituria Islame* nr. 2, fq.11-17.



*** ***Kush është prof. Rexha Garodi?;*** Përktheu nga arabishtja: Qemajl Morina; *Dituria Islame* nr. 17, fq. 7-9. Shënim kushtuar Garodit, ku vihen në pah shkaqet që ndikuan te Garodi për të pranuar fenë islame.

*** ***Llojet e të hollave - dijetari që u lind i verbër*** (Përktheu dhe përshtati: Beqir Ismaili); *Dituria Islame* nr. 3, fq. 27. Tregim didaktik

*** ***Në Kajro u mbajt Konferenca e Përgjithshme Islamike;*** *Dituria Islame* nr. 26, fq. 63. Shënim për mbajtjen e Konferencës së Përgjithshme nga Ministria e Çështjeve Fetare të Egjiptit.

*** ***Në Tripoli u mbajt Kongresi i IV i Përgjithshëm i Organizatës Islame Botërore të Daëves;*** *Dituria Islame* nr. 18, fq. 45. Informatë nga Tripoli, kushtuar Kongresit të Daves.

*** ***Si është shënuar historia (arabe) islame sipas hixhretit***; Nga gj. arabe përshtati: Fadil Hasani; *Dituria Islame* nr. 27, fq. 19-20. Trajtesë nga historia kushtuar kronologjisë së njësimit të kohës sipas hixhretit.

*** ***Vera (alkooli) nënë e të këqiave*** (Shqipëroi: Mustafë Bajrami); *Dituria Islame* nr. 10-11, fq. 27-30. Shënim kushtuar dëmeve që sjell alkooli për njeriun.

*** **(Kejt Stivens alias Jusuf Islam): si e pranova islamizmin?** (Përktheu nga arabishtja: Qemajl Morina); *Dituria Islame* nr. 18, fq. 30-31. Rrëfimi i Kejt Stivens për pranimin e fesë islame.

****Lajme nga Bota islame;*** *Dituria Islame* nr. 21; fq. 42. këtu janë dhënë në mënyrë telegrafike lajme nga Bota Islame.

## PËRFUNDIM

Ngase u tha më sipër mund të përfundojmë se Arabistika në revistën *“Dituria Islame”* që botohet në Prishtinë, zë një vend të konsiderueshëm. Nga kjo që prezantuam, nga numri 1 deri 31, bie në sy mungesa e autorëve shqiptarë që kanë shkruar për këtë fushë.

Por, sa u përket temave të përkthyera ato u përkasin fushave të islamologjisë, dhe më pak atyre filologjike.

Gjuhësia është trajtuar disa herë, ndërsa letërsia vetëm një herë. Kontribute më të shpeshta kemi në fushën e historisë.

Sidoqoftë, Arabistika në revistën "Dituria Islame", në numrat që janë marrë në shqyrtim është me interes të studiohet nga këndvështrime të ndryshme .

## SHKURTESAT

| | |
|---|---|
| D.I. | Dituria Islame |
| Q. M. | Qemajl Morina |
| N. I. | Nexhat Ibrahimi |
| Sh. A. | Sherif Ahmeti |
| E. O. | Elez Osmani |
| S.k. | sërbokroate |
| Q. Morina | Qemajl Morina |
| N. Ibrahimi | Nexhat Ibrahimi |
| Sh. Ahmet | Sherif Ahmetii |

*Literatura:*
- Revista "Dituria Islame" nr. 1-30/31.
- Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
- Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë 1975.
- MURTEZIA, Ekrem; Fjalori i feve; Prishtinë 2005.
- ECO, Umberto, Si bëhet një punim diplome, botimet përpjekja, Tiranë 1997.
- SHKODRA, R. & PIREVA, A., Bibliografi e botimeve islame në gjuhën shqipe në Kosovë 1957-1997, Prishtinë 1998.



*Muzafer Shkodra*

# ARABISTIK IN THE "DITURIA ISLAME" MAGAZINE 1-30/31

**(Summary)**

## Introduction

Arabistik is a scientific discipline that studies the Arab language and civilization (literary, cultural and scientific tradition). In other words, it incorporates in itself all that belongs to the Arab world and its history.

The acceptance of Islam by the Albanians some 6 centuries ago contributed to the presence of Arabistik in Albanian literature. This is no surprise when we bear in mind the fact that the Qur'an, the holy book of Islam, was delivered in the Arab language. The Arab language being the language of the Qur'an has contributed to the presence of Arabistik among us, since the middle ages, when along with Islam, other writings from this field spread among us.

*موزافر شكودرا*

# عربيستيكا في مجلة "ديتوريا اسلامة" رقم 1–30\31

## (خلاصة البحث)

**مقدمة**

عربيستيكا هو انضباط علمي و يشمل و نطاقها اللغوى والتقليد الادبي و الثقافي و العلمي وبعبارة أخرى ينطوي على كل ما ينتمي إلى العالم العربي وتاريخ هذا العالم. قبول الإسلام بين الألبان منذ 6 قرون تأثر في حضور عربيستيكا في الأدب الالباني — في قضيتنا في مجلة "ديتوريا اسلامة" و هذا مفهوم لأنه تم نزول القرآن الكريم و هو الكتاب المقدس للمسلمين باللغة العربية. ببساطة اللغة العربية باعتبارها لغة القرآن الكريم تأثرت في وجود عربيستيكا منذ العصور الوسطى عندما بالإضافة إلى الإسلام تسللت الكتابات الأخرى في هذا المجال.

LETËRSI

*Prof. dr. Adem Zejnullahu*

# MITIKJA DHE FETARJA NË TRI KËNGË POPULLORE

Ardhja e Perandorisë Osmane në Ballkan, shënon një kthesë të re në jetën, në historinë dhe në artin tonë poetik popullor. Me osmanët nis një **periudhë e re,** e cila karakterizohet për shumëçka, në radhë të parë **për përhapjen e Islamit** në këto hapësira etnike, por edhe të shtresimit të poezisë popullore me elemente islame.

Feja islame me zhvillimin e saj, në vazhdimësi filloi të zërë vend në botën materiale e shpirtërore të shqiptarëve, por ajo u reflektua gradualisht edhe në fushën e krijimtarisë poetike gojore. Kështu, ritet dhe elementet islame u bënë pjesë e pandarë e jetës dhe krijimtarisë sonë shpirtërore.

Me këtë rast për objekt trajtimi po marrim ***Mitikën dhe fetaren në tri këngë popullore***, të cilat janë të vetmet të këtij lloji në poezinë popullore shqiptare, që karakterizohen për disa veçori, të cilat nuk i hasim në strukturën e krijimeve të tjera poetike gojore. Ato në radhë të parë shquhen për lashtësinë e tyre, e cila daton nga mesjeta e hershme, para ardhjes së osmanëve në Ballkan, por me depërtimin e islamit në trojet tona, ato u veshën me një shtresim të ri mitik të islamizuar.



Në poezinë popullore shqiptare këto tri këngë që këndojnë për Divin njihen edhe me një emërtim tjetër si: **Këngë të moçme të zamanit,** që nënkupton se janë krijime shumë të vjetra.

Krijimet poetike gojore: **Kanga e Divit Marvon, Kënga e divdushmanit dhe Kanga e divit[1],** kanë një strukturë të ngjashme ndërmjet vete. Ato trajtojnë motivin e njëjtë me pak ndryshime në aspektin e realizimit artistik.

Siç dihet nga mitologjia shqiptare **Divi** është një qenie mitologjike shqiptare shumë e hershme e pranuar nga Lindja, e cila shfaqet si përbindësh me trup shumë të madh e me fuqi mbinjerëzore. Këtë lloj qenie të përmasave të mëdha e hasim edhe në krijimet gojore të popujve të ndryshëm të botës, duke filluar nga tradita letrare sumero-babilonase, ku me *Humbabën* lufton *Gilgameshi*, pastaj te grekët e vjetër dhe te popujt tjerë.

Të shumta janë krijimet gojore poetike, por edhe ato në prozë: si përrallat, legjendat, gojëdhënat, të cilat flasin për këto qenie të hershme mitike, të cilat kishin përmasa të jashtëzakonshme trupore gjigante, që ushtronin dhunë ndaj njerëzimit. Këto qenie mitike paraqiten edhe në krijimet gojore shqiptare, ashtu sikurse edhe te popujt tjerë të Ballkanit dhe më gjerë. Kështu, Ciklopët sipas Homerit, ishin viganë nga Sicilia, që kishin vetëm një sy në mes të ballit, viganë, farkëtues ose barinj, por edhe njerëzngrënës. I ngjashëm ishte *Minotauri*, pastaj *Polifemi*, me të cilin u takua Odiseu. I tillë ishte edhe Katallani, me një sy në ballë, që shpesh e hasim në përrallat popullore shqiptare. Po ashtu, edhe Kuçedra sipas mitologjisë shqiptare, ishte një qenie me pamje rrëqethëse, si një gjarpër i madh me 7-12 koka që nxirrte flakë nga goja. Dalja e saj shoqërohej me shtrëngata të mëdha. Në fazën e hershme të zhvillimit njerëzor mendohej se ajo e ndalonte ujin. Ishte edhe njerëzngrënëse, (sidomos vajzat e bukura), kundër së cilës luftojnë dhe mbysin trimat, drangojt.

---

[1] Shih: Prof. dr. Adem Zejnullahu, Këngë popullore me elemente islame, botoi Dituria Islame, Prishtinë, 2011, f. 135 - 161.

Po edhe *Divi Marvon*, në këngët me motiv mitik të islamizuara na paraqitet si një qenie gjysmë-kafshë me brirë e gjysmë-njeri, që shkakton tmerr duke ngrënë mish njeriu. Kjo qenie, në bazë të mitologjisë shqiptare, është shumë më e vjetër sesa ardhja e Islamit në trojet tona, por që më vonë mori ngjyrim fetar.

Këto këngë mund t'i kenë krijuar e islamizuar dervishët apo shehlerët e ndryshëm, ngase ligjërimet poetike bëjnë fjalë për ngjarjen që ndodhi në teqenë e sheh Abdullahut apo të sheh Merdanit.

*Kanga e Divit Marvon*, sikurse edhe dy këngët tjera të këtij lloji në mënyrë të hollësishme pasqyrojnë veprimtarinë keqbërëse të Div Marvonit, të divdushmanit apo të dindushmanit, të cilët donin që ta bëjnë "harab dynjanë", ta shkatërronin njerëzimin. Divi sipas këngëve, kishte brirë të mëdhenj me një fuqi të jashtëzakonshme. Ai, kinse i merrte njerëzit, sidomos vajzat e bukura, i dërgonte në shpellën e vet dhe pastaj i hante. Në vazhdim të këtyre këngëve jepet informacion i mjaftueshëm se ky keqbërës filloi me të madhe ta shkatërrojë njerëzimin dhe një ditë shkon edhe në Teqenë e s*heh Abdullahut*, (në njërën nga këto këngë e hasim te shah Merdani, ndërsa në tjetrën te sheh Kavadaci), ku kryente përkushtimet fetare ndaj Zotit xh.sh. dhe shokëve, (tridhëjetë myridëve) të tij:

*"A ktu je, sheh, hasmi i jem?"*
*"Qetu jom, div, kû kom me konë?*
*Në teqe teme ziqër po bâj;*
*hasmi yt kurrë s'jom konë".*[2]

Divi menjëherë fillon për t'ia ngrërë trupin, atëherë koka e shehut, sipas mitologjisë fluturon në Meke e në Medinë për t'i njoftuar pejgamberët (në *Kangën e Div dushmanit* e hasim në Meqe e Medinë te Resuli - mendohet te Muhammedi a.s. n.v. i A. Z.).

Atëbotë sipas këngëve i vetmi njeri, që mund të luftonte me divin ishte *Ali Dosti*[3] (në këngën e tretë te *Kanga e divit*, e hasim me emrin

[2] Vepra e cituar, f. 135.
[3] Këtu subjekti epik Ali Dosti - nënkupton figurën e hazreti Alis r.a., kushëririt dhe dhëndrit të Muhamedit a.s. Kurse, mbiemëri dost-i m. (pers.), mik, jaran, është shtojcë e rapsodit popullor.



Hali Dosti), i cili dyzet paraardhësit e tij, me babë e nënë, ia kishte vrarë dikur në Anadoll. Sipas tekstit dhe hipërtekstit të këtyre këngëve në shqyrtim, figura e Ali Dostit identifikohet me atë të Alis r.a., kushëririt dhe dhëndrit të Pejgamberit Muhamed a.s., i cili në kohën e vet ishte shumë i fuqishëm dhe njëri ndër luftëtarët më të mëdhenj të përhapjes dhe mbrojtjes së islamit në kohën e tij.

Koka e shehut i njofton pejgamberët për krimin që është duke bërë Divi Mavron, ndaj njerëzimit, por në mënyrë të veçantë ndaj tij. Këtë pamje rrëqethëse, vargjet e këngës popullore e paraqesin kësisoj:

*"Ja vllazni - u paska thonë,*
*na ka dalë ni div Marvon,*
*aj harab dyjên po e bon,*
*mish t'insonit gjith tue ngranë.*
*Në teqe teme ni ditë jam konë,*
*soll ziqër Zotit tuj bô,*
*o ardhë divi e më ka ngranë,*
*e më ka lonë ni gjysë inson,*
*si po m'shihni u ka thonë.*[4]

Në vazhdim të këngës, marrësi njoftohet se hazreti Aliu r.a lufton kundër Divit Marvon, ku sipas tekstit dhe nëntekstit të vargjeve, veprimi i tij, kap dimensione, më të gjera e më të thella sesa që duken në shikim të parë. Ai në këtë këngë, por edhe në të dy këngët tjera, del si simbol i trimërisë dhe urtisë, që lufton të keqen që i kanoset njerëzimit dhe fesë islame. Aliu r.a. para se ta vriste divin keqbërës, sipas parimeve të islamit, më parë, duhej ta ftonte që të bie iman - besim, e vetëm nëse nuk pranon, atëherë kishte lejen e Perëndisë që ta zhdukte.

Ali Dosti sipas porosisë së Pejgamerit (Resulit a.s.) siç përshkruhet në këngë i hip Dyldylit (kalit me krahë që njihet mirë në mitologjinë dhe në folklorin e lindjes), por nuk mund ta ngritte kokën e shehut nga vendi, në mënyrë që të udhëtonin së bashku, dhe t'ia tregonte shpellën e divit. Ali Dosti në ato momente fillon të hezitojë, të bezdiset, duke mos e kuptuar - pse nuk mund ta luajë kokën e shehut prej

[4] Adem Zejnullahu, vepra e cituar, f. 136.

vendit, ndonëse ishte aq i fuqishëm sa mund t'i nxjerrte edhe drunjtë nga toka. Në ato momente dramatike, sipas mitit që paraqitet në këngët në shqyrtim, nis e flet koka e sheh Abdullahut:

*Hiq marak, Ali, mos u bon,*
*se hak sheh jam kon tamon,*
*ditë e natë kom knue Kurân,*
*shum ziqër Zotit i kom bô.*
*Ditë e natë Kurân kom knue,*
*mu prej veni kush s'munet me më lue.*[5]

Ali Dosti me sheh Abdullahun sipas mitologjisë fluturojnë nëpër qiell dhe arrijnë te shpella e divit, ku me anë të litarit, lëshohen në thellësi të madhe, ku gjendej divi me njerëzit e rrëmbyer. Në vazhdim të këngës, rapsodi popullor njofton dëgjuesin se divi flinte në gjumë të thellë. Ali Dosti e takon të shoqen e shehut, e cila me të parë e njeh (ngase e kishte parë në ëndërr) ia tregon dhomën e divit, por edhe sa njerëz kanë mbetur ende të gjallë:

*Gjashtëmijë vetë në ketë shpellë jon konë,*
*veç gjashtëqind divi na ka lonë,*
*natë e ditë tre ja dy tuj ngronë.*
*Edhe me ni çikë qi e ka prû promë,*
*në dynjâ shoqen nuk ia kish lonë;*
*ashtu Zoti mô s'ka me falë,*
*bash si dilli po rrezon.*[6]

Ali Dosti ia nxjerr gjumin divit, dhe sipas porosisë së Perëndisë e fton të vjen në din (në besim), duke i premtuar se për çdo ditë do t'i ketë nga tre desh të pjekur, por me kusht që të mos hajë më mish njeriu. Këtë ballafaqim të Aliut r.a. me divin, vargjet e këngës popullore e paraqesin në këtë mënyrë:

- *Hazreti Alia, o melun, i ka than,*
*hajde n'din, hajde n'iman,*
*ka tre desh, t'pjekun, tajn kam me t'i ba,*

[5] Po aty, f. 141.
[6] Po aty, f. 142.



*për çdo haje, kem me t'i dhanë;*
*sall, mish t'insanit, ma, mos me ngranë.*[7]

Divi, përveç që nuk pranon të vijë në din - iman, por edhe i kërcënohet Aliut r.a. duke i thënë se:

*Edhe ty në mujsha du me të ngronë,*
*pra si në mujsha ty, Ali, me të ngronë,*
*hyjzit në qiell s'due me i lonë;*
*edhe diellin due me nxonë,*
*du me e bô harab dyjên.*[8]

Atëherë Ali Dosti thërret - *ja All-llah!* dhe me një të rame të shpatës e shtrin divin për toke. Sipas të tri këngëve në shqyrtim, rënia me shpatë e Aliut r.a. në kokën e divit ishte aq e fuqishme sa e ndau përgjysmë, por për pak që nuk i preu të gjitha shtresat e tokës. Edhe pas kësaj goditje të fuqishme të Aliut r.a , divi ishte gjallë, i cili e provokon duke i thënë - se kinse s'i ka bërë asgjë, me qëllim të caktuar, që ta godasë edhe njëherë, me ç'rast nga një div do të bëheshin dy dhe krejt botën do ta bënin "harab" (shkatërronin), por në ato momente vjen një urdhër që përshkruhet si urdhër nga Zoti xh.sh., që të mos i japë goditje të tjera.

Ali Dosti pasi e vret divin, sipas këngëve në shqyrtim e kryen një detyrë të shenjtë, fetare e njerëzore, e lut Krijuesin e tij, që t'i japë fuqi që të gjithë ata njerëz të ndodhur në shpellë t'i qetë lart në tokë. Ai bën lutje dhe lutjen e tij ia pranon Perëndia:

*Atëherë duvan Zoti kabull ia bon,*
*kraht e pllumave ia u paska dhonë;*
*ton si pllumat po fluturojnë,*
*përpjetë shpellës ton po shkojnë,*
*në ket dynje dalë kokan konë,*
*u bôn inson apet qysh jon konë.*[9]

[7] Po aty, f. 156.
[8] Po aty, f. 143.
[9] Po aty, f. 146.

Vargjet e fundit të këngëve në shqyrtim njoftojnë dëgjuesin se Ali Dosti i nxjerr të gjithë njerëzit nga shpella, i dërgon nëpër shtëpi të veta, por edhe eshtrat e sheh Abdullahut i tubon në një vend, e lut Zotin xh.sh. që ta ringjallë. Shehu me emër të Krijuesit ringjallet, bëhet sërish sikur ka qenë dhe shkon në teqenë e vet për ta vazhduar misionin, ndërsa hasreti Aliu kthehet në Qerbela.

Në bazë të tekstit, nëntekstit dhe kontekstit të këngëve për të cilat bëmë fjalë më lart, më duket se është me interes për lexuesin që ta tërheqim një paralele ndërmjet Divit Mavron, të këtyre krijimeve poetike gojore dhe të Humbabës në Epin e Gilgameshit.

*Divi Marvon* në epikën gojore shqiptare dhe *Humbaba* në Epin e Gilgameshit, vepër kjo më e vjetër letrare e shkruar dhe e zbuluar deri më sot, mund të hetohen ngjashmëri në veprimet e këtyre keqbërësëve. Të dy këto qenie mitike, si Divi, ashtu edhe Humbaba, janë të dhunshëm të përmasave të mëdha, ata u shkaktojnë shumë të këqija njerëzimit, madje bëjnë mëkate edhe ndaj njerëzve të përkushtuar ndaj Zotit xh. sh., siç ishte sheh Abdullahu, në epikën shqiptare dhe Hyjniu i Diellit - Shamashi në veprën e Gilgameshit. Në këto krijime artistike paraqitet lufta kundër së keqes, me një përjashtim të vogël, Ali Dosti lufton vetëm kundër Divit Marvon, sikurse Muja për t'i nënshtruar zanat, ose Odiseu kundër Polifemit, ndërsa Gilgameshi lufton me shokun e tij, Enkiduji kundër Humbabës:

*Eja, o mik, n' Cedrin hynor të shkojmë,*
*së bashku t'luftojm' kundër Humbanës,*
*t' hyjnive e t' njer'zve armikun ta mbysim!*[10]

Në vazhdim të tërë asaj që u tha më lart, do thënë se këto tri krijime poetike gojore mitike të islamizuara për divin janë të vetmet në poezinë popullore, por edhe më gjerë. Elemente të ngjashme, siç u tha edhe më lart hasim edhe në veprën e "Gilgameshit", në "Iliadën e Odiseun" e Homerit, etj., por jo me një strukturë të tillë.

Këto tri krijime poetike gojore në poezinë popullore shqiptare shquhen për nga struktura dhe kompozicioni i njëjtë, me pak ndryshime në sendërtimin artistik. Ato janë krijime të hershme, që më vonë tërësisht u islamizuan. Në to këndohet veprimtaria e sheh Abdullahut, të përkushtuarit ndaj Zotit xh.sh., por edhe e Aliut r.a., i cili në këto krijime poetike ka rol të dyfishtë. Ai, sipas këtyre këngëve kryen urdhrat e Perëndisë; lufton të keqen që i kanoset njerëzimit, që identifikohet me veprimtarinë keqbërëse të divit në një anë, por edhe në përhapjen dhe mbrojtjen e islamit nga të pafetë në anën tjetër.

Në fund mund të konstatojmë se në strukturën e këtyre tri këngëve popullore mitike të islamizuara gërshetohen në mënyrë të harmonishme elementet përbërëse tradicionale mitike siç janë: fantastikja, legjendarja, përrallorja etj., me ato fetare islame si përbërës kryesor, duke sajuar një tip të veçantë këngësh, që janë krejtësisht të veçanta, jo vetëm në poezinë popullore shqiptare, por edhe më gjerë.

[10] Më gjerësisht, shih: Epi i Gilgameshit, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 46.

*Prof. dr. Adem Zejnullahu*

## THE MYTHICAL AND THE RELIGIOUS IN THREE FOLK SONGS

### (Summary)

The arrival of the Ottoman Empire in the Balkans marked a new chapter in our lives, history and folk poetry. A new period began with the Ottomans, which was characterized, primarily, by the spread of Islam in these territories as well as the incorporation of Islamic elements in folk poetry.

Islam became an ever more important part in the material and spiritual world of the Albanians and it gradually became part of the oral tradition.

Consequently, Islamic rites and elements became an inseparable part of our spiritual tradition.

*آدم زين الله*

## العامل الاسطوري والديني في ثلاث اغاني شعبية

### (خلاصة البحث)

مجيئ الدولة العثمانية في البلقان يسجل اسهاما جديدا في طريق الفن الشعري الشعبي, مع العثمانيين تبدأ مرحلة جديدة في مجالات مختلفة وفي المرتبة الأولى بنشر الاسلام في هذه المناطق وكذلك مع نشر الشعر الشعبي بتأثيرات اسلامية.

الدين الاسلامي بتطوره المستمر بدأ يحل مكانا مهما في العالم المادي والروحي للألبان, و لكن انعنكاسته تطورت في الأدب الشعبي .هكذا نرى أن الكثير من العادات والتقاليد الاسلامية اصبحت جزءا من الابداع الروحي للالبان.

***LETËRSI***

***Mexhid Yvejsi***

# BABAI I POEZISË - MJESHTRI I POETËVE MUHAMMED RUDAKI (858-941)

UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë) e pati shpallur vitin 2008 - Viti Ndërkombëtar i Rudakiut, në nderim e përkujtim të poetit persian, Babait të Poezisë apo Mjeshtrit të Poetëve, siç është cilësuar, Muhammed Rudakiu, me rastin e 1150-vjetorit të lindjes.

*Muhammed Rudaki (858- 941)*

## Kush është Muhammed Rudakiu?

Emri i tij i plotë është: Ebu Abdullah Xhafer ibën Muhammed Rudaki, poet persian, i cili është cilësuar si Adem ul-Shuara (Ademi i Poetëve), Babai i Poezisë apo Mjeshtri i Poetëve, vlerësohet, pranohet si themelues i Letërsisë Klasike Persiane dhe si gjeni dhe prijatar i gjuhës moderne persiane.



Muhammed Rudaki u lind në vitin 858 në Rudak, një qytezë në krahinën Panxhakent, në Taxhikistan.

## Ringjallës i letërsisë dhe lashtësisë së Persisë

Në periudhën e dinastisë Samanite u shfaq Rudakiu, i cili ringjalli madhështinë e letërsisë së lashtësisë perse, dhe për këtë ai u cilësua si babai i poezisë perse. Pas tij në fund të kësaj periudhe shfaqen Ferdusiu dhe Ensariu, dy mësues të mëdhenj të poezisë perse, të cilët e ngritën akoma më lart këtë poezi.

*Përmendorja e poetit Rudakiu në vendlindjen e tij, Panxhakent, Taxhikistan*

## Lindja e tij ngjarje e shënuar në histori

Lindja e Rudakiut përkoi me lindjen e dy figurave të mëdha të historisë së shkencës si Zakaria Razi, mjeku i famshëm iranian, dhe Abu Nasr Farabi filozofi i madh i Iranit.

Nga aspekti historik, lindja e Rudakiut përkoi me zgjerimin e madh të territoreve islame që shtriheshin nga Xhejhuni, në veri të Afrikës dhe perëndim të Evropës në Andaluzi.

## Që në fëmijëri shkruante poezi

Muhamed Oufi është njëri nga historianët më të vjetër që ka patur informacion mbi jetën e Rudakiut. Ai në librin e tij ”Lobab Al Lobab” në lidhje me Rudakiun shkruan se Rudakiu ka qenë një fëmijë tepër i zgjuar dhe inteligjent, ka pasur një memorie të fuqishme dhe në mo-

shën 8-vjeçare ka qenë hafiz i Kur'anit. Ai që në fëmijëri ka shkruar poezi.

## Shkruante poezi dhe këndonte për bukuri

Rudakiu, jo vetëm që ishte hafiz i Kur'anit, që në moshën tetëvjeçare, jo vetëm që shkruante poezi që në fëmijëri, por ai këndonte për bukuri. Këndonte për bukuri, dinte t'i përcjellte poezitë, t'i shndërronte në këngë, këngët i këndonte me melodi, me vegla muzikore që i biente me shumë mjeshtri.

## Mjeshtër muzikor - në oborrin mbretëror

Me këto aftësi, poetit Rudakiu, i doli zëri në katër anë aq sa e ftoi edhe mbreti Al-Saman, i cili mbretëronte në Horosan. Al-Saman, ishte mbreti i tretë i dinastisë Samanite, me Rudakiun pranë, i cili njihte mirë artin, letërsinë, historinë, i dukej se po e qetëson, po ia zhvillon, po ia begaton, po ia lartëson mbretërinë. Kështu vazhdoi deri në vitin 941, në moshën 83-vjeçare, kur ndërroi jetë, kur kaloi në jetën e vërtetë.

## Frymëzimi te burimi...

Poeti persian, Ebu Abdullah Xhafer ibën Muhammed Rudakiu, që kur ishte fëmijë dhe deri në pleqëri, kur ishte verbuar, kishte një burim prej të cilit ishte frymëzuar. Nga ky burim, ku ishte frymëzuar, na dhuroi vargje që, edhe pse mbi 1150 vjet kanë kaluar, ato vargje ende nuk janë harruar... Lum miku im, cili është ky burim? Ky burim nuk shteret, është krijuar për pejgamberët, për këtë burim poeti, Rudakiu, shprehet:

*"Unë shfrytëzoj burimin e pashtershëm të pejgamberëve*
*Si mund të gjej ujë në lumin e tharë grek?"*



## Shkrimet, përkthimet dhe vlerësimet

Duke vështruar poezitë e Rudakiut, kuptohet qartë shkalla e lartë e artit dhe diturisë së tij. Ai kishte një aftësi të veçantë në përdorimin e fjalëve perse. Nuk ekziston asnjë fjalor persisht, ku të mos përmendet emri i Rudakiut, si dëshmues autentik i fjalëve autoktone perse. Duke u bazuar në poezitë e Rudakiut, kuptohet qartë se ai njeh shumë mirë letërsinë arabe, letërsinë dhe historinë e lashtë të Iranit para periudhës islamike, si dhe njihte shumë mirë fetë e ndryshme....

*Muhammed Rudakiu*
*në një pullë postale iraniane*

Gjithë kjo njohuri ndikoi që të miqësohet me intelektualë të mëdhenj të kohës së tij, si Shahid Balkhi, poet dhe filozof i famshëm dhe Abul Hasan Muradi. Shahid Balkhi, Abu Es'hak Xhuibari, Kesai dhe Dakiki, ishin poetë të epokës së Rudakiut, i cili në disa poezi të tij i përmend këta dijetarë të mëdhenj.

Lidhur me poezitë e Rudakiut, është folur shumë dhe studiuesit si Rashid Samargandi, kanë theksuar se poezitë e Rudakiut numërohen në mbi 1 milion e 300 mijë vargje.

*"Nëse dikush duhet të vendoset në kurorën e poetëve*
*Rudakiu ndodhet mbi të gjithë poetët.*
*Numërova poezitë e tij, mbi 13 qindmijëshe".*

(Rashidi Samargandi)

Me shfaqjen e pushtetit të dinastisë Al Saman, u krijua fusha e përshtatshme për letërsinë perse. Paraardhësit Samani, janë ndër paraardhësit iranianë, të cilët kanë bërë përpjekje të shumta për të ringja-

llur dhe lulëzuar poezinë dhe letërsinë persiane. Gjatë kësaj periudhe janë bërë përkthime dhe shkrime të shumta shkencore dhe fetare dhe për këtë arsye mund të thuhet me plot kuptimin e fjalës se kjo periudhë është një ndër periudhat më të rëndësishme të letërsisë persiane.

Një ndër veprat e rëndësishme të përkthimeve shkencore, letrare dhe fetare të periudhës Samani është libri ”Kalile dhe Damane” i përkthyer në persisht. Një tjetër vepër e periudhës Samani, është përkthimi i analizës dhe historisë Tabari, të cilat aktualisht janë dy libra të shtrenjtë të letërsisë perse.

Në periudhën Samani u shfaq Rudakiu, i cili ringjalli madhështinë e letërsisë së kaluar perse dhe për këtë ai u njoh si babai i poezisë perse. Pas tij në fund të kësaj periudhe shfaqen Ferdusi dhe Ensari, dy profesorët e mëdhenj të poezisë perse, të cilët e ngritën akoma më lart këtë poezi. Ferdusi me krijimtarinë e tij, çoi në kulm dhe plotësoi punën dhe rrugën e nisur nga Rudakiu.

Ajo çka ka mbetur sot nga poezitë e Rudakiut, janë vetëm disa poezi dhe tregime dhe disa copëza të librave të tij kushtuar gjuhës dhe poezisë perse. Nga poezitë e Rudakiut kanë mbetur vetëm 960 vargje. Përpjekja e parë shkencore për mbledhjen e poezive të shpërndara të Rudakiut, u bë nga Said Nafisi.

Ai i nxori poezitë e Rudakiut nga librat e vjetër duke i përmbledhur ato dhe duke i botuar në vëllimin e tretë të librit " Jeta dhe poezitë e Rudakiut". Studiuesit janë të mendimit se poezitë e Rudakiut janë të pakrahasueshme për nga forca e përmbajtjes, bukurisë letrare dhe gërshetimit të fuqishëm me natyrën. Për këtë arsye, shumë nga poetët e epokës së tij dhe pas tij, u përpoqën të ndjekin stilin e Rudakiut dhe të frymëzohen nga këto poezi.

Gazeli, gjithnjë ka qenë një kryevepër e poetëve iranianë dhe asnjëherë ky vend nuk ka mbetur pa ndonjë poet të madh që ka krijuar në këtë gjini poetike. Kanë kaluar më shumë se një mijë vjet, kurse Rudekiu akoma llogaritet si njëri ndër kolosët e gazelit. Përshkrimet e tij janë shumë të bukura, ndërsa krahasimet të thjeshta dhe mahnitëse. Gazelet e Rudakiut janë të veçanta, të rrjedhshme dhe tepër tërheqëse për lexuesin.



*”Kur shoh të vdekur, dy buzë janë ngritur lart*
*Ky trup është vdekur nga shpirti i dalë,*
*Ulu këtu pranë meje dhe më fol fjalë të mira*
*Më thuaj se të kam vrarë dhe prapë jam penduar.”*

Në krijimtarinë poetike të Rudakiut vërejmë edhe elegji. Elegji nuk ka krijuar askush tjetër përpara Rudakiut, ose së paku deri më tani nuk është zbuluar një gjë e këtillë. Por, ato vargje që kanë mbetur nga Rudakiut, tregojnë se ai ka qenë mjeshtër edhe ne këtë gjini poetike. Rudakiu në një elegji për mikun e tij poet, Shehid Belhi, dëshmon qartë mjeshtërinë dhe thjeshtësinë e tij në elegji, dhe po ashtu në te vërehet një madhështi shkencore dhe shpirtërore.

*”Pak më parë iku karvani i Shehidit*
*Na mori me vete dhe na shtyri të mendojmë,*
*Për këta dy sy mungon një trup*
*Dhe për nga mençuria, një mijë herë para.”*

Kjo poezi, e cila është krijuar për t’u ngushëlluar nga pleqëria, pas gjithë këtyre shekujve persona të shumtë e këndojnë në vdekjen e të afërmëve të tyre.

Rudakiu këtë botë e përshkruan sikur ëndërr, e ëndrra është ëndërr.

*”Gëzohu në çdo çast të kësaj jete*
*Askush nuk qe i kënaqur, s'paku të jesh ti i kënaqur*
*Pa asnjë arsye kërkohet drejtësi në të*
*Por atë drejtësi nuk e shijoi asnjë mendimtar*
*Kjo botë e pastër është një ëndërr*
*Atë e njeh vetëm njeriu me zemër të zgjuar*
*E mira e saj është në vend të keq*
*Gëzimi i saj është në burg*
*Pse lidhesh aq shumë për këtë botë?*
*Puna e saj është e kotë...*

Babai i poezisë persiane, duke u mbështetur në pavlefshmërinë e kësaj bote, njeriun e thërret që zemrën ta mbajë të gjallë dhe të gëzuar dhe të shfrytëzojë mirësitë e kësaj bote. Kur hedhim një vështrim mbi poezitë e mbetura të Rudakiut, shohim se ai këto këshilla i ka zbatuar gjatë jetës së tij dhe ka jetuar i lumtur dhe në gëzime.

*”Yjet e kësaj botë vdiqën të gjithë*
*Të gjithë do ta përjetojnë vdekjen*
*Ata tani janë nën dhe*
*Çdo gjë që fituan në këtë botë*
*Nuk e morën me vete,*
*Përveç se një qefin të bardhë...*

Rudakiu është njëri ndër poetët që e ka lavdëruar këtë botë dhe ka qenë i mendimit se kjo botë është përplot pasuri dhe kuptimplote. Ai njeriun e mëson që ta vlerësojë çdo çast të kësaj bote dhe jetën që i ka mbetur ta kalojë në gëzime dhe mirësi. Rudakiu nuk është poet enigmatik. Për atë dhe në poezitë e tij, e mira, e keqja, gëzimi dhe hidhërimi janë përshkruar ashtu siç janë në të vërtetë. Ai shumë herë ka theksuar se njeriu duhet të shfrytëzojë të mirat e kësaj bote dhe t'u largohet kërkesave të palakmueshme.

Ai ka lavdëruar zgjimin e zemrës dhe këshillimin e vazhdueshëm në këtë botë dhe neve na ka udhëzuar që të shfrytëzojmë mirësitë e Zotit dhe vazhdimisht të jemi të gëzuar.

*”Bota gjithnjë është sikur syri, e rrumbullakët*
*Pra, derisa të jetë e rrumbullakët ajo sillet e nuk ndalet.”*

## Dashuria tokësore dhe dashuria hyjnore

Në mesin e poezive të Rudakiut vërejmë dy lloje të dashurisë, dashuria e kësaj bote apo tokësore dhe dashuria hyjnore, e cila i përket njeriut të mençur dhe mistik.

Dashuria hyjnore është burim i artit të Rudakiut dhe në të vërtetë është po ai element që ky poet edhe pas kalimit të shumë shekujve, të jetë ende i respektuar dhe i dashur në mesin e lexuesve. Në të vërtetë



po kjo dashuri i afrohet dashurisë së poetëve tjerë, pra dashurisë mistike.

*”Si të flas për takimin me mikun*
*Nga dheu im lulëzon narcisi*
*Ai që mori dije për dashurinë hyjnore*
*U largua nga vetja dhe u zhyt në botëra tjera.”*

Vështrimi i Rudakiut ndaj Zotit, Krijuesit të botëve është shumë i bukur dhe i këndshëm. Ai si një poet besimtar, mysliman, në shumë vargje të tij ka folur për besimin në Një Zoti dhe adhurimin ndaj Tij.

Rudakiu, duke pasur parasysh mrekullitë e krijimit, në krijimtarinë poetike ka sjellë besimin e tij të thellë ndaj sistemit të saktë të krijimit, i cili është njëri nga veprat e Zotit të Madhërishëm. Qëndrimi i Rudakiut ndaj bukurive natyrore dhe manifestimeve të ndryshme të tyre është me sy të zemrës, i saktë dhe i intelektual dhe është bërë shkak i krijimit të figurave të bukura stilistike.

Ky poet, përveç te iranianët, ka pasur një rëndësi të veçantë edhe në mesin e letrarëve, teoricienëve dhe studiuesve të ndryshëm të botës. Rëndësia e tij në mesin e studiuesve të huaj është aq e madhe sa që disa prej tyre një pjesë ose të gjithë studimet e tyre ia kanë kushtuar Rudakiut.

Orientalistët anglezë kanë bërë hulumtime të rëndësishme për jetën dhe veprën e Rudakiut. Iranologu i njohur anglez, Edvard Brown në librin e tij madhështor, shembullor, ”Historia e letërsisë iraniane”, në hyrje të saj ka thënë se gjuha e Rudakiut është e thjeshtë, e ëmbël dhe e rrjedhshme dhe në këtë rrafsh atë e ka krahasuar me Shekspirin.

Kurse, Brown në një pjesë tjetër të librit të tij, Rudakiun e quan edhe bilbil të periudhës së Sasanidëve. Ai sa herë që flet për Rudakiun, atë e quan edhe ‘baba të poezisë persiane’.

Një studiues tjetër i Rudekiut është amerikani William Jackson, autor i librit ”Poezia e lashtë persiane”. Ky studiues amerikan, William Jackson, në librin e tij, Rudakiun dhe Dakikiun i konsideron si yje ndriçuese të poezisë iraniane, ndërsa Rudekiun e cilëson më lart se Dakikiun. William Jackson në këtë vepër thotë se Rudakiu ka lënë

mbi 1 milion e 300 000 vargje dhe shkruan se nga ai kanë mbetur edhe mbi 80 strofa dhe vargje të shpërndara. Ai gjithashtu poezinë e Rudakiut e krahason me poezitë e Lord Bajronit, poet i madh anglez dhe në një krahasim tjetër poetin iranian e konsideron më të mirë se Çaserin (Chaucer) poetin tjetër anglez.

Orientalistët rusë gjithashtu kanë bërë hulumtime të vlefshme për jetën dhe veprën e Rudakiut, siç është edhe Braginskaj...

*Burimet dhe literatura kryesore:*

1. Persian Pageant: A Cultural History of Iran. Calcutta: Arya Press, 1950.
2. Rypka, Jan. History of Iranian Literature. Reidel Publishing Company, 1968.
3. Aryanpur, Manoochehr. A History of Persian Literature. Tehran: K. Press, 1973.
4. Historia e Letërsisë Botërore 1, Rilindja, Prishtinë, 1987.
5. Browne, E.G. Literary History of Persia, 1998.
6. Antologjia e Poezisë Persiane, Dalan Shaplo, Tiranë, 2007.
7. Historia e Letërsisë Perse, Ahmed Tamimdari. (Përktheu Abdullah Rexhepi), Tiranë, 2008.
8. Perla, Revistë Shkencore - Kulturore. Nr.1-55, Tiranë, 1999-2009.
9. Chopra, R.M., "Eminent Poetesses of Persian". Iran Society, Kolkata, 2010.
10. IRIB.



*Mexhid Yvejsi*

# FATHER OF POETRY – MASTER POET – MOHAMMAD ROUDAKI (858-941)

## (Summary)

In 2008, UNESCO (the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization) approved commemoration ceremonies for Mohammad Roudaki, the father of poetry and master poet, on the 1150th anniversary of his birth.

*مجید اویسی*

# أبو الشعر – سيد الشعراء محمد روداكي (858 – 941)

## (خلاصة البحث)

قد أعلن اليونسكو (منظمة الأمم المتحدة للتربية والعلم والثقافة) في عام 2008 – السنة الدولية لروداكي تكريما و ذكرا للشاعر الفارسي أبو الشعرأو سيد الشعراء كما وصفت محمد روداكي بمناسبة ذكرى 1150 من مولده.

**PORTRETE TË SAHABEVE**

*Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha*

# ENES IBN MALIK EL-ENSARI

**"O Zot i im jepi atij pasuri, fëmijë dhe bekoje atë"**
(Nga lutja e Pejgamberit a.s.)

Enes ibn Maliku ishte në moshë të re, kur nëna e tij El-Gumejda ia mësoi dy dëshmitë dhe ia mbushi zemrën e tij të njomë me dashurinë ndaj pejgamberit të Islamit, Muhamedit të birit të Abdullahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të…

Enesi u edukua me dashurinë e Pejgamberit nga lajmet e shumta që kishte dëgjuar për të.

Kjo nuk është për t'u habitur, ashtu siç thotë proverbi arab, sepse edhe veshi dashuron nga një herë para syrit…

Sa kishte dashur djaloshi të shkonte te Pejgamberi a.s. në Mekë, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, të shkonte në Jethrib, që ai të kënaqej me takimin me të.

* * *

Nuk kaloi kohë e gjatë dhe në Jethribin fatlum, u përhap lajmi se i dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, i shoqëruar me shokun e tij Es-Siddik është në rrugë për në Medinë. Gëzimi dhe hareja përfshiu çdo shtëpi dhe kaploi çdo zemër…

Sytë dhe zemrat e njerëzve u lidhën për atë rrugë të bekuar, që bartte hapat e Pejgamberit a.s. dhe shokut të tij për në Jethrib.

* * *

Për çdo mëngjes të rinjtë përhapnin lajmin:

Se Muhamedi ka ardhur…

Enesi nxitonte të vraponte me fëmijët tjerë të vegjël, por ai nuk e gjente. Kthehej në shtëpi i mërzitur e i pikëlluar.

* * *

Një mëngjes, u dëgjuan zërat e disa burrave në Jethrib, të cilët po bisedonin, se Muhamedi dhe shoku i tij i janë afruar Medinës.

Njerëzit nxituan në drejtim të rrugës së bekuar, e cila do t'ua sjellë atyre të dërguarin e udhëzimit dhe të mirësisë….

Njerëzit vraponin në grupe. Aty-këtu shiheshin grupe të fëmijëve, në fytyrat e të cilëve dukeshin shenjat e gëzimit dhe haresë, që kishin mbushur zemrat e tyre të njoma….

Në krye të këtyre fëmijëve ishte Enes ibn Malik El-Ensari.

* * *

Nuk shkoi shumë kohë, dhe u paraqit Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, së bashku me shokun e tij Es-Siddik. Ata kaluan në mes rreshtit të gjatë të burrave dhe të fëmijëve…

Ndërkohë, gratë dhe vajzat e reja po qëndronin në shtëpitë e tyre. Ato kishin hipur në kulmet e shtëpive për ta parë Pejgamberin a.s. dhe thoshin:

Cili është ai?! ….Cili është ai?!.

Ajo ditë, ishte ditë e shënuar.

Enesi vazhdoi ta përmendte atë ditë edhe pasi kishte mbushur më shumë se njëqind vjet të jetës së tij.

* * *

Pejgamberi a.s., ende pa u vendosur mirë në Medinë, tek ai erdhi El-Gumejda bintu Milhan, nëna e Enes ibnu Malikut. Me vete kishte

marrë fëmijën e saj të vogël. Derisa ajo po qëndronte para të dërguari të Allahut, ai po lëvizte në mes duarve të saj me flokët e tij të gjata që ia zinin ballin…

Pasi ajo u përshëndet me Pejgamberin a.s., iu drejtua me këto fjalë:

*“O i Dërguar i Allahut …nuk ka mbetur burrë e as grua prej ensarëve pa të sjellë ndonjë dhuratë, kurse unë nuk kam çka të dhuroj tjetër përveç këtij vogëlushi tim…*

*Merre dhe le të jetë në shërbimin tënd…”*

Pejgamberi a.s., u gëzua për vogëlushin. Filloi t’ia përkëdhel kokën me duart e tij fisnike dhe e bëri pjesë të familjes së tij.

* * *

Enes ibn Maliku, apo siç e quanin "Unejs" në shenjë përkëdhelje, ishte në moshën dhjetë vjeçare, ditën kur pati fatin të hyjë në shërbim të Pejgamberit a.s.

Ai vazhdoi kështu, derisa Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, kaloi në jetën e amshueshme.

Periudha e shoqërimit dhe shërbimit të Pejgamberit a.s. ishte dhjetë vite të plota, gjatë të cilave u udhëzua me këshillimet e tij, mësoi shumë hadithe, u njoh me lajmet, sekretet dhe cilësitë e tij, rast i cili nuk iu dha askujt përveç tij.

* * *

Pejgamberi a.s. ishte sjellë aq mirë dhe aq njerëzishëm ndaj Enes ibn Malikut, sa që është vështirë të sillet prindi ndaj fëmijës së vet…

Ai shijoi butësinë dhe respektin që është vështirë të përshkruhet.

T’ia lëmë vetë Enesit, të na tregojë për disa raste të këtyre sjelljeve sublime të Pejgamberit a.s. ndaj shërbëtorit të tij të vogël.

Enes ibn Maliku thotë:

Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ishte prej njerëzve me moralin më të lartë, zemërhapur dhe njeri i dashur…

Një ditë më dërgoi për t'ia kryer një punë. Unë dola... Në rrugë e sipër takova disa fëmijë duke luajtur në treg. Fillova të luaja me ata



dhe nuk shkova në vendin që më kishte urdhëruar. Kur mbaroi loja, vërejta një njeri që po qëndronte pas meje, më kapi për rroba…

U ktheva dhe pashë se ishte vetë i Dërguari i Allahut. Ai duke buzëqeshur më pyeti:

"O Unejs a ke shkuar atje ku të kam thënë?"

I habitur i thashë: Po…

Po shkoj tash o i Dërguar i Allahut…

Betohem në Allahun se i kam shërbyer dhjetë vjet dhe nuk ka ndodhur të më thotë për një punë që e kam bërë, përse e bëre ?…

Apo për një çështje që e kam lënë, përse e ke lënë?!.

* * *

Pejgamberi a.s. kur e thërriste Enesin e përdorte trajtën e diminutivit, në shenjë dashurie dhe përkëdheljeje. Nga një herë e thërriste o "Unejs" e ndonjë herë tjetër: "Ja bunejje" (djaloshi im).

Vazhdimisht i fliste dhe e këshillonte, derisa ia kishte pajisur zemrën dhe mendjen e tij me këshilla dhe udhëzime..

Prej këtyre këshillave sa për ilustrim po përmendim:

*"O djaloshi im, nëse prej mëngjesit e deri në mbrëmje, ke mundësi që me zemrën tënde të mos urresh askënd, bëje atë..*

*O djaloshi im, kjo është prej sunetit tim, ai që e ngjallë sunetin tim, ai më do mua….*

*Kush më do mua do të jetë me mua në Xhenet…*

*O djaloshi im, kur të hysh në familjen tënde, përshëndeti ata. Kjo është begati për ty dhe anëtarët e familjes tënde".*

* * *

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s., Enes ibn Maliku jetoi mbi tetëdhjetë vjet. Gjatë atyre viteve, ai i pajisi zemrat e njerëzve me dituri prej diturive të Pejgamberit a.s., si dhe pajisi mendjet e njerëzve me fikhun e Pejgamberit a.s….

Ai i ringjalli zemrat, duke përhapur në mes sahabëve dhe tabiinëve udhëzimet e Pejgamberit a.s., si dhe duke përhapur tek njerëzit fjalët fisnike të të Dërguarit të Allahut dhe veprat e tij madhështore.

Për shkak të jetës së tij të gjatë, Enesi u bë burim referimi i myslimanëve, tek i cili ktheheshin për çdo çështje apo vështirësi.

Kështu, kur disa njerëz përçarës në fe, kishin filluar të flisnin për burimin (kroin-havdin) e Pejgamberit a.s., ditën e kiametit, e pyetën për këtë, e ai tha:

Nuk kam menduar, se unë do të jetoj, aq gjatë sa të shoh shembullin tuaj të mos pajtimit për vërtetësinë e burimit. Pas meje kam lënë plaka, që pas çdo namazi i drejtoheshin Allahut të madhërishëm me lutje që t'ua bëjë të mundur të pinë nga burimi i  Muhamedit a..s.

* * *

Enes ibn Maliku vazhdoi të jetojë me kujtimet e të dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, gjatë tërë jetës së tij....

Ishte shumë i gëzuar me ditën e takimit me të, por tejet i pikëlluar me ndarjen  e tij Vazhdimisht përsëriste shumë fjalët të tij....

Lakmonte ta pasojë në veprat dhe fjalët e tij... e donte atë që ai kishte dashur dhe urrente atë që ai kishte urryer. Prej ditëve më të dalluara ai përmendte dy.

Ditën e takimit me të, për herë të parë, dhe ditën e ndarjes me të, për herë të fundit.

Kur përmendte ditën e parë, gëzohej dhe ndihej i lumtur. Kurse kur kujtonte ditën e dytë, pikëllohej dhe qante, dhe i bënte të qanin edhe të tjerët që ishin me të.

Shumë herë thoshte: Kam parë pejgamberin a.s. ditën kur ka hyrë tek ne dhe ditën kur ka vdekur. Ato dy ditë nuk i ngjasojnë njëra-tjetrës.

Ditën kur erdhi në Medinë shndriti çdo send...

Kurse, ditën kur ai vdiq u errësua çdo send.

Shikimin e mbramë që ia hodha, ishte ditën e hënë, kur u hoq perdja nga dhoma dhe e pashë fytyrën e tij, sikur të ishte fletë e mus'hafit... Atëbotë njerëzit po qëndronin në këmbë, mbrapa Ebu Bekrit, duke e shikuar atë. Të gjithë ishin të shqetësuar. Ebu Bekri iu dha shenjë që të qetësoheshin dhe të ishin të durueshëm.



Pas pak, Pejgamberi a.s. ndërroi jetë, në përfundim të asaj dite. Nuk kemi parë pamje më të bukur sesa fytyrën e tij, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, kur e kemi mbuluar me dhe.

* * *

Pejgamberi a.s., më shumë se një herë ishte lutur për Enes ibn Malikun...

Prej lutjeve të tij ishte:

*"O Zot i im, jepi atij pasuri, fëmijë dhe bekoje atë"*…

Allahu u madhërishëm Iu përgjigj lutjes së dërguarit të Tij, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të. Enesi ishte më i pasuri në mesin e ensarve. Kishte më së shumti trashëgimtarë. Ai pati rastin të shohë më shumë se njëqind djem, nipër e mbesa në fund të jetës së vet.

Allahu e bekoi në jetën e tij. Ai jetoi njëqind e tre vjet...

Enes ibn Maliku shpresonte shumë në shefaatin e Pejgamberit a.s., në ditën e kiametit, andaj, shpesh herë thoshte:

Unë shpresoj se do ta takoj të dërguarin e Allahut ditën e kiametit e do t'i them:

O i Dërguari i Allahut. Ky është shërbëtori yt i vogël Unejsi.

* * *

Kur Enes ibnu Maliki u sëmur rëndë, para se të vdiste, u tha familjes së vet:

Ma përsëritni mua: *"La ilahe il-lall-llah, Muham-medun resulull-llah" (nuk Zot tjetër dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij).*

Kështu vazhdoi ta shqiptojë derisa vdiq.

Kishte lënë testament, që një shkop i vogël, të cilin e kishte dhuratë nga Pejgamberi a.s. të varrosej me të. Shkopi ishte vendosur anash në pjesën e sipërme të qefinit.

* * *

I lumi Enes ibnu Malik El-Ensariut për të mirat që Allahu i madhërishëm ia dhuroi.

Jetoi dhjetë vite të plota nën përkujdesjen e Pejgamberit, paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të...

Ishte i treti prej transmetuesve të hadithit. I paraprinin vetëm Ebu Hurejra dhe Abdullah ibnu Umeri...

Shpërblimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi nënën e tij El-Gumejda, për kontributin e tij dhënë Islamit dhe myslimanëve.

**RECENSION**

*Prof. dr. Hysen Matoshi*

# E VËRTETA PËRBALLË EKLIPSIT KOMUNIST

**Mr. Nuridin Ahmeti "Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878-1912)", botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2011, f. 300.**

Togfjalëshat e përfshirë në strukturën titullore të monografisë ***Krerët fetarë* dhe *Lëvizja Kombëtare Shqiptare*,** për një kohë të gjatë, në historiografinë tonë, janë trajtuar në raporte antinomike, madje plotësisht përjashtuese. Edhe pse krerët fetarë kanë qenë forca motorike e proceseve të vetëdijesimit kombëtar shqiptar, edhe pse si elitë intelektuale kanë qenë në krye të zhvillimeve e të proceseve që shënuan kthesa në rrjedhën tonë historike, roli i tyre ose është shpërfillur pjesërisht (e në mjaft raste edhe është mohuar krejtësisht), ose është interpretuar në mënyrë tendencioze si i dëmshëm dhe prapavajtës. Natyrisht argumente të mirëfillta nuk ka pasur në asnjërin rast, ndërsa motivimi për paraqitjen e këtillë të shtrembëruar, a krejtësisht të përmbysur, ka qenë, në rend të parë, i natyrës ideologjike dhe aty-këtu edhe i aversionit fetar që, për gjysmë shekulli ishte model, i cili fatkeqësisht mbizotëroi në strukturën e inteligjencies sonë. Ndonëse ishin në krye të ngjarjeve e të proceseve të shënuara historike, krerët fetarë në historitë tona kombëtare, të shkruara në frymën ateiste-komuniste dhe nën direktivat e historiografisë serbo-ortodokse, censuroheshin rreptë. Edhe sot ndihet njëfarë ngurrimi për ta thënë të vërtetën, edhe sot ajo pohohet me një gjysmë zëri dhe ende si e paplotë. Gjithsesi studiuesi Nuridin Ahmeti është ndër historianët e rrallë që kthen vëmendjen te pjesa e munguar e historisë sonë. Thënë figurativisht, mungesa e secilës pjesë të trupit të njeriut e bën të paplotë atë, ndërsa dihet mirëfilli se mungesa e kokës e gjymton në mënyrë të pariparueshme. Nëse ngjarjet tona historike tregoheshin pa figurat e tyre kryesore, vetëm për faktin se ishin ulema, kjo do të thotë se në këto histori flitet për figura pa koka. Kështu, për dekada me radhë, dy ngjarje të mëdha në historinë e shqiptarëve, sikurse ishin Lidhja e Prizrenit dhe Shpallja e Pavarësisë në Vlorë, paraqiteshin të paplota si rezultat i mënjanimit të kontributit të ulemave të shquar shqiptarë. Qëllimshëm dëmtohej ngjarja vetëm e vetëm që të mos njihej roli i një kategorie të caktuar shoqërore. Komunizmi do të shkonte edhe një hap më tutje: do të ndërhynte edhe në të dhënat faktike dokumentare, madje edhe në fotografitë autentike nga ngjarjet, duke i ribërë ato sipas nevojave ditore. Libri i Nuridin Ahmetit, me qasjen gjithëpërfshirëse e pa paragjykime, synon të ndreqë këto devijime, të demantojë të pavërtetat e mashtrimet e historiografisë komuniste që vërtet krijuan efektin e mosakceptimit të drejtë të figurave dhe të ngjarjeve historike. Natyrisht, nuk duhet menduar se me këtë punë studimore iu dha përgjigje të gjitha mangësive të historiografisë sonë në planin e njohjes së kontributit të krerëve tanë fetarë në historinë kombëtare shqiptare. Përkundrazi, ky është vetëm njëri ndër hapat e parë e të guximshëm, por gjithsesi i bërë në drejtimin e duhur.

Në një përurim është e udhës të thuhen fjalë edhe për strukturën e librit. Ajo përbëhet nga tre kapituj, në të cilët materia studimore shtrohet në perceptim të drejtë metodologjik e kronologjik. Kështu, kapitulli i parë ofron të dhëna të gjithanshme për Vilajetin e Kosovës, gjatë periudhës 1878-1912. Autori ka pasur kujdes që ky kapitull të mos e marrë hapësirën e materies qendrore studimore, por gjithsesi e ka parë të udhës që në të të ofrojë informacionin më elementar mbi Kosovën e asokohshme, duke përfshirë të dhëna për popullsinë, organet e vilajetit, rrethanat politike, kushtet shoqërore-ekonomike dhe arsimimin. Natyrisht, si një referencë autentike, aty ka gjetur vend edhe ndihmesa e Sami Frashërit, për paraqitjen e Vilajetit të Kosovës.

Kapitujt vijues e kanë ndarë materien studimore në dy pjesë, përkatësisht në kapitullin ku përfshihet periudha prej vitit 1878 deri më 1908, ndërsa kapitulli i tretë trajton periudhën e viteve 1908-1912. Kapitulli që nis me Lidhjen e Prizrenit, natyrshëm e trajton si objekt qendror studimor këtë ngjarje madhore të historisë sonë, përkatësisht figurat më emblematike të

ulemave shqiptarë që dhanë kontribut të çmueshëm për realizimin e projektit tonë të parë kombëtar, por pa e lënë anash as Lidhjen Shqiptare të Pejës si vijimësi të së parës. Megjithëse numri i ulemave dhe kontributi i tyre në Lidhjen e Prizrenit ishte i madh, është fakt i padiskutueshëm se Myderriz Ymer Prizreni është figura qendrore e saj, ndaj edhe zë vend parësor në këtë trajtim të autorit. Megjithatë, të dhëna të vyera e konstatime të qëndrueshme gjejmë edhe për Ahmet Korenicën, Sheh Eminin, Dervish Salihun, Hasan efendi Shllakun, Hafiz Ymer Gutën, Sheh Salihun dhe për parinë islame të Plavës e të Gucisë.

Kapitulli i tretë i këtij libri është më vëllimori dhe me një përfshirje edhe më të gjerë të figurave të krerëve fetarë në Lëvizjen tonë Kombëtare. Ndonëse është trajtuar një periudhë prej vetëm katër vjetësh, duhet thënë se këto ishin ndër vitet më dinamike e më përcaktuese për fatin e shqiptarëve. Kufiri nistor ka të bëjë me dy ngjarje me peshë dhe orientuese për zhvillimet e mëpastajme: Revolucionin xhonturk (pritjet e shqiptarëve dhe mashtrimet që iu bënë në planin e përfitimit të të drejtave kombëtare) dhe Kongresin e Manastirit, si kthesën më të rëndësishme për unifikimin e hapësirës kulturore e kombëtare të shqiptarëve. Krerët islamë fetarë nuk i panë me indiferencë këto zhvillime, ndaj për këtë as kryengritjet e shumta të kohës nuk ishin jashtë vëmendjes dhe kontributit të tyre, duke qenë prore në ballë të proceseve që përfundimisht quan në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Autori, përveçse e ka rikthyer vëmendjen e lexuesit te krerët tanë fetarë të asaj kohe, në mjaft raste ka gjurmuar për të dhëna të reja dokumentare, por gjithsesi ndihmesën më të madhe e ka dhënë me faktin se i ka paraqitur të sistemuar në një tërësi unike, e cila, me të drejtë, mund të quhet edhe një tip leksikoni për këtë kategori veprimtarësh fetarë e kombëtarë. Natyrisht, aty lexuesi do të gjejë të dhëna për emrat si: Ymer Lutfi Paqarizi, Mulla Syla i Pozhoranit, Mulla Sinan Maxhera, Halim Ahmeti, Mulla Idrizi, Hafëz Arifi, Azem efendi Olluri, Mulla Ademi i Prapashticës, Rrystem efendi Shporta, Musa Shehzade, Mulla Rasim Zapodi, Hoxhë Mehmeti, Ibrahim Fehmiu, Abdullah Selim Hadri dhe Sheh Mehmet Sezai. Duke mos i parë këto figura fetare e kombëtare jashtë kontekstit të përgjithshëm, autori në monografinë e tij interferon edhe tekste për zhvillimet historike, sikurse janë: Revolucioni xhonturk, Kongresi Manastirit, hapja e shkollës së parë shqipe në Pozhoran të Vitisë më 1909, kryengritjet e këtyre viteve, Kuvendi i Junikut etj.

Interes të veçantë në monografinë ***Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare***



***Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878-1912)*** përbën edhe pjesa dokumentare e saj, ku janë dhënë një numër faksimilesh autentike, fotografish, dëshmish shkrimore, diplomash, vulash që lidhen me krerët e trajtuar fetarë dhe një tekst interesant nga revista fetare “Zani i Naltë”, në të cilin ka të dhëna për personalitete të shquara fetare të Kosovës. Kuptohet ky libër është i pajisur me të gjitha elementet e domosdoshme të një studimi serioz e të bazuar në aparaturën shkencore: ka hyrjen orientuese dhe përfundimin sintetizues, të përkthyer edhe në anglisht, burimet, literaturën dhe treguesin e emrave. Se është konsultuar një numër i madh tekstesh dhe se është punuar me një përkushtim të rrallë për njohjen e literaturës përkatëse, dëshmon edhe fakti se autori ka përdorur në studimin e tij plot 520 referenca.

Në përgjithësi Nuridin Ahmeti ia ka dalë që të identifikojë tri nivele të kontributit madhor të krerëve tanë fetarë të kësaj periudhe: së pari, është përmbushja e detyrës së tyre themelore për drejtimin e jetës fetare në Vilajetin e Kosovës; së dyti, pjesëmarrja aktive në krye të proceseve për çlirimin kombëtar dhe pavarësimin e Shqipërisë; dhe së treti, me të drejtë, e vë theksin edhe te ndihmesa e madhe që krerët fetarë ia dhanë përparimit kulmor e arsimor kombëtar, qoftë me kontribute shkrimore, qoftë me përpjekjet për krijimin e shkollës shqipe dhe njësimin e hapësirës sonë kulturore në rrafshin kombëtar.

Në përmbyllje të kësaj qasjeje mund të thuhet se vlera e kësaj pune të mr. Nuridin Ahmetit, pa dyshim se do të jetë edhe më e madhe nëse pasohet nga studime të tjera dhe nga nivele edhe më të arrira shkencore. Autori, sikundër e dimë, është veçse në fillim të punës shkencore, ndaj mangësi të caktuara edhe mund të vërehen. Besoj se në të ardhmen do të jetë i gatshëm të nxjerrë sa më shumë përfundime, të asimilojë e të përpunojë më tepër nga dijet e pararendësve në procesin e nxjerrjes së rezultatit vetjak. Duke i uruar shëndet dhe mbarësi në realizimin e projekteve vijuese, më mban shpresa se mr. Nuridin Ahmeti do të përmbushë parametrat e kontratës me institucionin në të cilin punon, por, përtej kësaj, besoj se do ta përmbushë, në mënyrë të plotë e si synim të gjithmonshëm, kontratën me të vërtetën shkencore.

***RECENSIONE***

***Akad. Dr. Feti Mehdiu***

# DIMENSIONI ETIK DHE SOCIAL I KRYENGRITJES SË HALIL PATRONËS*

Madhështia e njerëzve të vegjël që nuk kanë pushtet buron nga zemra e tyre e pastër, kurse vogëlsia e njerëzve të mëdhenj me pushtet buron nga mendja e tyre e turbulluar.

Këto dy figura i gjejmë te Halil Patrona dhe sulltan Ahmeti i tretë.

Këtë çështje e kanë trajtuar studiues të ndryshëm dhe kontributet e tyre i gjejmë në gjuhë të ndryshme, duke filluar nga gjuha turke, gjuha gjermane, hungareze, shqipe, angleze etj. Unë do të përqendroj vëmendjen tuaj në disa burime turke dhe shqiptare, të cilat i kam pasë në dorë për këtë rast.

Para se të hyjmë në dimensionin etik e social të kryengritjes së Halil Paronës po sjellim një pasqyrë të shkurtër për figurën e Halil Patronës në disa burime turke:

*Në Kamusu-l-alam, vëllimi i dytë dhe i tretë*

Autori i enciklopedisë, **Kamusu-l-a alam,** Sami Frashëri, në vitin 1889, në vëllimin e dytë Halil Patronën e prezanton si vijon:

*"Është një shqiptar dhe epror i jeniçerëve në kohën e sulltan Ahmetiti të tretë. Pasi që ishte organizator i një kryengritje, bashkë me disa bashkëmendimtarë të tij, u vra nga agai i jeniçerëve Halil Pehlivani dhe grupi i tij."*

Kurse në vëllimin e tretë flet gjërësisht për vendlindjen e Halil Patronës – Hurpishtin, një kasaba e vogël në Vilajetin e Manastirit, 7 km në jug të Kesrijes dhe gjendet afër lumit Belica dhe i takon sanxhakut të Korçës; por këtu nuk e përmend Halilin. Në Hurpishtë flitej gjuha turke, shqipe, greke dhe vllahishtja. Hurpishti ishte qendër nahije, në kazanë e Kesrijes, dhe përfshinte 36 fshatra me 10.000 banorë.

*Në Enciklopedinë Islame: vëllimi, 1, 7, 9.*

***Islam Ansiklopedisi, v.1.(1950)*** autori i tekstit për s. Ahmetin e tretë, Enver Ziya Karal, e përmend Halil Patronën si punëtor i një Hamami në Bejazit, i cili doli në krye të kryengritësve më 28 shtator 1730 dhe si rezultat i kësaj kryengritje, sulltan Ahmeti i tretë, më 1 tetor 1730, pasi mori garancë për jetën e vet dhe familjen e tij, likuidoi disa funksionar të lartë sipas kërkesës së kryengritësve dhe u tërhoq nga posti i sulltanit - dha dorëheqje. Në ***Islam Ansiklopedisi, 7, (1957),*** në artikullin për Sulltan Mahmudin e parë kur flitet gjerësisht për ardhjen e tij në pushtet, pas dorëheqjes së sulltan Ahmetiti të tretë, autori Munir Aktepe, në dy faqet e para Halil Patronën e përmend më shumë se dhjet herë.

*"Mahmudi erdhi në pushtet më 1 tetor 1730 si rezultat i kryengritjes së Halil Patronës, e cila kryengritje e hoqi nga froni sulltan Ahmetin e tretë,"* konstaton autori i këtij artikulli dhe në vazhdim edhe disa herë i referohet këtij kryengritësi duke përmend edhe disa nga bashkëpunëtorët e tij si Musliu, Janaki, Zulali Hasan Efendi, Ibrahim Efendi, Mehmet Murteza, etj. Këtu flitet edhe për pabesinë që i bëri sulltan Mahmudi i parë dhe përfundimin tragjik të Patronës, pikërisht nga bashkemnaku i tij: Halil Pehlivan, të cilin sulltani e thirri të vijë nga Bursa.

Në ***Islam Ansiklopedisi, 9, (1964),*** Halil Patrona prezentohet fare shkurtimisht. Vetëm në katër rreshta, pasi që jepet një spiegim etimologjik i fjalës patrona, thuhet: *"Jeniçeri Halil Patrona, i cili kishte fituar famë gjatë udhëtimit me anije në Lindje, në vitin 1730 ishte në ballë të kryengritjes kundër sulltan Ahmetit të tretë"*.

Në kllapa jepet burimi (Relationes des 2 rebellions, s.8; ingl.tre. Charles Perry, A view of the Levent, London, 1743, s. 64)., dhe ky është burimi më i drejtpërdrejt që përshkruan kryengri-

* Verzion i zgjeruar i referatit të paraqitur në Simpoziumin e pestë ndërkombëtarë të turkologjis, 13-16 prill, 2011 në Prizren.

tjen e Halil Patronës vetëm 13 vjet pas zhvillimit të ngjarjes.

*Në Edebiyatımızda isimler sözlüğü dhe Şairler ve yazarlar sözlüğü*

Në vitin 1970, në veprën e autorit turk, Behxhet Nexhatigil: ***Edebiyatımızda isimler sözlüğü,*** aty ku flitet për shkrimtarin Reshad Ekrem Koçu, mësojmë se në vitin 1962 ështe botuar romani *Forsa Halil*, me një nëntitull: *tarihi uzun hikaye* – rrëfim i gjatë historik (roman historik), kurse në vitin 1968, nga i njëjti autor ishte botuar vepra: *Patrona Halil* (roman).

Edhe në vitin 1973, në veprën: ***Şairler ve yazarlar sözlüğü*** të autorit Shukran Kurdakul, i gjejmë të njejtat informata. Mirëpo këtu, të dyja këto vepra të Reshad E. Koçut janë cilësuar vetëm si romane. Nuk i kemi epitetet si në veprën e Behxhet Nexhatigilit.

Në burimet që i zumë në gojë deri këtu, përveçse te Sami Frashëri, nuk përmendet përkatsia shqiptare e Halil Patronës.

*Në Buyuk Osmanli tarihi, në 10 vëllime, e autorit Josef von Hammer dhe Osmanli devleti tarihi,*

Në veprën e Hammerit e gjejmë në vëllimin e 7 dhe vëllimin e 10.

Në vëllimin e shtatë, kryengritjes së Halil Patronës me jeniçerët e tij i kushton rreth 20 faqe. Përshkruan në hollësi veprimet e Hail Patronës në ballë të kryengritjes së 28 shtatorit të vitit 1730, si rezultat i së cilës ishte heqja e sulltan Ahmetiti të tretë nga froni dhe sjellja në fron e sulltan Mahmudi i parë. Trajtimin e fillon me nëntitullin SULTAN AHMEDIN TATTAN INDIRLILMESI. (rrëzimi i sulltan Ahmedit nga froni)

Menjëherë në fillim Hammeri konstaton se në krye të kësaj proteste ishte shqiptari Halil Patrona, i cili udhëhiqte një grup jeniqerësh prej 17 vetash.

Në këhët e fundit gjejmë një mori tekstesh që flasin për këtë figurë karizmatike të historisë së shekullit XVIII. Prandaj në vazhdim do të sjellim edhe pasqyrën:

## Halil Patrona në faqet elektronike

Ku kemi zgjedhur disa sish që japin përshkrime më të hollësishme për Halil Patronën.

**Shkrimit me titullin:** *Kush është ky Halil i cili dridhi alamet sulltanat me protestën 49 ditshe pikërisht 50 vjet para revolucionit francez?* i përgjigjet teksti vijuese:

*Halil Patrona është shqiptarë nga Hurpishti i Manastirit, i cili me kryengritjen 49 ditshe që organizoi në Stamboll rrëzoi nga froni sulltan Ahmetin*



*e tretë. Ky është ai i cili kur ngriti flamurin e kryengritjes e thirri të gjithë popullatën të bashkohen nën këtë flamur për të realizuar tri kërkesa:*

*Shembjen e shtëpiave publike*

*Dorëheqjen e disa ministrave*

*Heqjen e tatimit të përjetshëm –* ***malikane.***

Halil Patrona është kryengritësi i shekullit 18, i cili nuk i pranoi nga qeveria e s. Ahmetit 100.000 lira ari, e as pozitat e larta që iu afruan. Halil Patrona është unikat në historinë e revolucioneve.

*Teksti tjetër... Kryengritja e Halil Patronës, vazhdon*:

Është një kryengritje që ka filluar me 28 shtator 1730 në Stamboll. Kjo kryengritje e udhëhequr nga Halil Patrona kishte me vete tërë jeniçerët shqiptarë të divizionit të 17. Fakti se sulltan Ahmeti i tretë bënte përgatitje për ekspeditën që do të ndërmerrte për në Iran ishte në favor të kryengritësve. Këta me 30 shtator paraqitën listën, me të cilën kërkonin dorëzimin e 41 funksionarëve shtetëror, duke filluar nga kryeministri Damad Ibrahim Pasha, kajmekami i Stambollit Mustafa Pasha, shejhu-l-islami Abdullah efendi dhe të tjerë.

Kjo kryengritje hoqi nga froni sulltan Ahmetin e tretë dhe solli në fron Mahmutin e parë.

*Teksti i titulluar: Si rrodhi kryengritja*? Afron informcionin vijues:

Më 15 të muajit rebiu-l-evvel të vitit 1143, e enjte, ditë pushimi për Portën e Lartë, në Oxhakun e Jeniçerëve ku merrnin pjesë 17 jeniçer, u arrit marrëveshja dhe te xhamia Sulltan Bejazit, te hyrja Kashëkçëllar, nja tre a katër grupe ngritën bajrakun, ngjeshën shpatat dhe duke thirrur: "*sheriati na thërret, o Ymmeti Muhammed mbyllni dyqanet dhe ejani nën këtë bajrak*" u nisën drejt pazarit mishit (Et mejdani). Në krye të kësaj qëndronte Halil Patrona me jeniçerët tjerë të oxhakut të 17.

*Në një tekst tjetër lexojmë:*

Sulltan Ahmeti i tretë, në kohën kur nisi kryengritja ishte në Uskudar dhe mblodhi bashkpuntorët për të anaizuar kërkesat e kryengritësve. Ata që udhëheqin kryengritjen, Halil Patrona, Musli Beshe, Kuçuk Musli, Kutuxhi haxhi Hysejn, Çinar Ahmed, Ali Usta, Emir Ali, Karayilan, Turshuxhi Ismail, i kanë shqetsuar udhëheqësit e shtetit sidomos kanë vënë në pozitë të shumë të keqe kryeministrin.

Në vazhdim flitet për kërkesat e kryengritsave, gjendjen më të re në Saraj, dënimin e dhëndurëve: Ibrahim Pasha, Mustafa Pasha dhe Mehmet Pasha.

*Në tekstin me titull: Zemërimi i i madh i kryengritësve, lexojmë:*

Kërkesa e sulltanit që të mos digjen por vetëm të rrëzohen e të shkatërrohen shtëpiat publike në Bosfor, me motivacionin se do të na përqeshin e do të tallen me ne armiqtë tonë dhe bota e krishterë, nxiti nervozë të madhe te kryengritësit. Kjo kushtëzoi ultimatumin që i dhanë sulltanit kryengritësit e Halil Patronës. Me telal u dhanë lajmin se brenda tri ditëve të gjithë ata që janë përgjegjës për villat luksoze, t'i rrëzojnë vetë, në të kundërtën do ta pasojnë edhe më keq.

*Teksti i titulluar: Pësimet e Halil Patronës dhe bashkëpunëtorëve të tij*, sjellë informacionet vijuese:

Organizatorët dhe pjesëmarrësit në këto veprime dhe këtë kryengritje shumica ishin shqiptarë. Halil Patrona i realizoi të tria kërkesat e paraqitura dhe i besoi premtimeve të sulltanit se nuk do ta gjente gjë e keqe, por e psoi keq. Sulltani organizoi një solemnitet, kinse për të promovuar përfundimin e këtyre trazirave dhe për të shpërblyer Halil Patronën me gradën e Agait të jeniçerëve, por kjo ishte e kobshme sepse e paguan me kokë Halil Patrona me gjithë shokë. Sipas skenarit të përgatitur ata i merrnin një nga një dhe i futnin në një hapsirë të Divanit të sulltanit dheu hiqej koka. Për këtë likuidim të simpatizuesve të Halil Patronës me gjithë Halil Patronën, Muhsinzade Abdullah Pasha dhe Ibrahim Aga morën grada të larta.

*******

## Dimensioni moral dhe social i kryengritjes së Halil Patronës

Kryengritja e Halil Patronës e vitit 1730, ka qenë një ngjarje e rëndësishme historike jo vetëm për historinë e shtetit Osman por edhe për historinë Botërore.

Në ato studime të autorëve të ndryshëm, që janë shkruar ose janë përkthyer në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe, **dimensioni moral dhe social** si shkaktarë i drejtpërdrejt që nxitën Kryengritjen e njohur të Halil Patronës nuk janë trajtuar, sipas mendimit tim, në nivelin që e meritojnë. Kjo është arsyeja që unë u përcaktova për këtë qasje, më ndryshe.

Kërkesa për ***heqjen e taksës "malikane",*** ishte një kërkesë që mobilizonte shtresat popullore, sepse ata e pësonin më së rëndi me këtë taksë. Kjo u dëshmua me faktin se nga 17 vetë, me të cilët Halil Patrona ditën e enjte të 30 shtatorit 1730, e filloi këtë kryengritje, u ngrit në disa mijëra për-



krahës të këtyre kërkesave të Halil Patronës. Dëshmia tjetër është se kjo kërkesë u miratua pa zhurmë nga Sulltanati Osman.

Kjo çështje meriton trajtim më të gjithanshëm sepse faktori social është me rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e punëve tjera të çdo qeverije. Kur ky faktor destabilizohet me çfarëdo forme qoftë, atëherë aparati shtetërorë kërcënohet me shkatërrim dhe fillon zbatimi i qeverisjes me dhunë.

Kërkesa për *djegien e shtëpive publike*, të cilat ishin ndërtuar në gjashtë- shtat vitet e fundit në të dy anët urës Gallatës për qëllime zbavitje të klanit qeverisës të kategorive të ndryshme, ushtarake e civile, tërhiqte gjithashtu mbas veti një forcë të shëndoshë elitare të sulltanatit. Ajo forcë e shëndoshë e elitës islame, këtë lloj reformimi e kishte emërtuar me emrin e vërtetë - deformim që e shpiente sulltanatin në shkatrrim. Kështu e kishte identifikuar edhe Halil Patrona. Investitorët e huaj dhe përkrahësit vendor të atyre objektve, e kishin kurdisur këtë kurthë djallëzore të maskuar nën plafin e reformave.

Për këtë qëllim Halil Patrona kishte siguruar përkrahjen e elitës islame në hierarkinë e Divanit të Sulltanit. Ata ishin njerëz me pozita të larta, të cilët edhe pozita i ngarkonte me pëpërgjegjësi të kujdesen për moralin shoqëroro të shtetit të tyre. Këta ishin të vetëdijshëm se nën maskën e reformave sulltanatit Osman i përgatitej kurtha shkatërrimtare - shthurja morale, e cila pa dyshim ka si pasojë tëra çrregullimet tjera dhe përfundon me shkatërrimin e sistemit qeverisës.

Kryengritësit kishin vënë në shënjestër, me arsye, personalitete të larta, gjithashtu me poste të larta qeveritare por që ishin përkrahës të veprimeve destruktive në dëm të qeverisë. I pari ishte kryeministri Damad Ibrahim pasha me disa ministra.

Në trajtimet që janë bërë kësaj kryengritje, këta dy faktor përmenden kalimthi, ose injorohen në tërësi.

Si ilustrim po përmendim disa shembuj nga vepra **Osmanli Devleti Tarihi,** ku Halil Patrona përmendet dy herë.

Në **kontekstin e parë** thuhet se si pasojë e kryengritjes së Patronës u ndërpre aktiviteti lidhur me endjen e një lloj pëlhure në Selanik dhe në Edrene.

Shihet shumë qartë se këtu më shumë i jepet rëndësi zhvillimit të tregtisë se sa çështjes sociale të popullatës. Nuk përmendet fare ngarkesa e shtresave të gjera me tatime të papërballueshme. Nuk do koment. Këtu nuk merret në konsideratë dimensioni

social e as moral por vetëm ai material.

Në **rastin e dytë** në kapitullin: *Kryengritja e Patronës*, flet për shfronësimin e s. Ahmetit tretë dhe vendosjen në fron të Mahmuditi të parë, por fare nuk jep arsyetimin që solli sulltanatin deri te këto ndryshime. Mendoj se studiuesit e kësaj periudhe dhe këtyre ngjarjeve doemos të analizojnë kushtet që e sollën në këtë gjendje. Ndërrimi i sulltanit nga pozita nuk ishte punë e thjeshtë dhe nuk mund të ndodhte pa ndonjë arsye të fortë. Ikja e historianëve nga ai realitet e len pezull një ngjarje shumë të rëndësishme historike, nga e cila është dasht të nxjerr mësime aparati shtetëror.

Në vëllimin e parë, kur trajtohet rasti i s. Ahmetit të tretë, nuk përmendet fare Kryengritja e Halil Patronës. Aty thuhet vetëm se: "... në vitin 1730 kryengritjet rezultuan me përmbysjen e të gjitha reformave të zbatuara në Stamboll dhe me rrëzimin e s. Ahmetit të tretë." Në vazhdim shtohet: "Me të ardhur në pushtet Mahmudi i parë (1730-1754) punën e parë që bëri ishte likuidimi i prijësve të kryengritjes."

Kjo sheshazi flet për ambiciet e pushtetarëve. Nuk çanin kokën për gjendjen e popullit por në rend të parë ishte sigurimi i pozitave në pushtet me çdo kusht "likuidimi i prijësve të kryengritjes". Kjo është në kundërshtim të plotë me etikën islame, në të cilën ishte themeluar sulltanati Osman dhe kishte bërë disa shekuj qeverisje mbi ato parime.

Ndërkaq në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, theksohet vetëm dimensioni social i kryengritjes së Halil Patronës, ku lexojmë: "...është figurë historike me origjinë shqiptare, udhëheqës i kryengritjes qytetare të Stambollit me 28-30 shtator 1730, ... Qëllimi i kryengritjes ishte lehtësimi i masave popullore.... Kryengritja pati karakterin e një lëvizjeje të shtresave të varfëra, me qëllim uljen e taksave...."

Marrëveshja e Sulltanit me kryengritësit e Halil Patronës për ”...*vetëm rrënimin e atyre shtëpive*“ nuk do të kishte asgjë të keqe – ashtu u pajtuan edhe kryengritësit, por, arsyetimi i sulltanit se *"popujt e krishterë do ta tallnin Sulltanatin për një akt të tillë"* nuk ishte në frymën e parimeve morale mbi të cilat duhet të qeveriset sulltanati Osman, i cili kishte për bazë Kur anin dhe hadithin e Pejgamberit Muhammed a.s.

Për dimensionin etik të kryengritjes së H. Patronës flet edhe Ahmet Qeriqi në veprën e tij Fenomene Shqiptare, i cili ndër të tjera thotë: "Përveç kërkesave të tij të karakterit shoqëror, Halil Patrona para Sulltanit kishte



parashtruar edhe kërkesa të karakterit moral. Ai rebelohet kundër prishjes së moralit në atë kohë dhe shkaktarin e degradimit moral e identifikon te zotëruesit e shtëpive publike të argëtimit në Stamboll."

Ky dimension moral dhe social e bën këtë kryengritje të veçantë në historinë botërore, me konstatimin se *"Halil Patrona është kryengritësi i shekullit 18, i cili nuk i pranoi nga qeveria e s. Ahmetit 100.000 lira ari, e as pozitat e larta që iu afruan. Halil Patrona është unikat në historinë e revolucioneve.* ***(Patrona Halil isyanın tarihte eşi benzeri yoktur).***

Edhe ajo që prezenton Hammeri në fillim siç thuhet aty: "Ditën e enjte, më 28 shtator, duke lind dielli, përpara xhamis Sulltan Bajazit u dëgjua thirrja e Halil Patronës, drejtuar popullit: *"Kërkesat tona janë në përputhje me sheriatin! Kush është pjestarë i ymmetit Muhammed mbyllni shitoret dhe bashkohuni me ne"!* flet për karakterin etik dhe social të kryengritjes së Halil Patronës. Thirrja e tij për t iu bashkuar në mbrojtje të sheriatit dëshmon se ky e shihte në rrezik moralin shoqëror.

Megjithë këtë, me sa kam arritë të shoh, dimensioni moral dhe social i kryengritjes së Halil Patronës ka gjetë më shumë hapësirë në veprat letrare dhe artistike se sa në veprat historike. Këtu mendoj në veprat e shkrimtari hungarez Jokai Mur (Kanli lale) dhe atij turk Reshad Ekrem Koçu, (Patrona Halil), si edhe në pikturat e artistit Jean Baptiste Vanmour.

Rëndësia që i jepte Halil Patrona çështjes sociale në shoqëri dëshmohet edhe me faktin se ai edhe pasi e pati kuptuar se "... *e pret vdekja*... " e përsëriti kërkesën që **të hiqet taksa *malikane.*** Kërkesë, të cilën edhe sulltani ia konfirmoi si punë të kryer menjëherë.

## Përfundimi

Me sa u përmend më lartë, sipas burimeve turke edhe shqiptare, del se Halil Patrona është një figurë shumë e rëndësishme historike botërore, që ka zënë vend jo vetëm në literaturën historike por edhe në vepra letrare e artistike. Është një personazh, i cili që nga viti 1730 e deri në ditët tona më thellësisht e gjerësisht është studiuar dhe trajtuar nga studiuesit e huaj se sa historianët turq dhe ata shqiptarë.

Halil Patrona është ai i cili në kërkesat e tij u angazhua për dy komponente bazë për mbarëvajtje të punëve të një shteti normal: *komponenta morale dhe ajo sociale*. Është kryengritësi unikat në historinë botërore që filloi një kryengritje me 17 bashkëve-

primtar – jeniçerë, dhe arriti të ndërrojë nga posti një sulltan jo pak të suksesshëm. Ishte një kryengritës, i cili **ia doli që të shkatërrojë bërthamën e amoralitetit që kishte zënë fillë në qendër të sulltanatit Osman** *dhe të lirojë popullin e këtij sulltanati nga një tatim që ndrydhte popullin dhe nuk i sillte asnjë dobi shtetit – por vetëm klaneve të multezimëve të imët.*

Është figura historike që zen vendin qëndror në dy romanet e një shkrimtari turk, dhe në një roman të një shkrimtari hungarez.

Më në fund mund të thuhet edhe kjo: Halil Patrona është një personazh historik, i cili me shpirtbardhësinë e tij i tregoi botës, plot gjysmë shekulli para revolucionit francez, se masat popullore në qendër të sulltanatit osman e përkrahën pikërisht për faktin se ky artikuloi si askush tjetër më parë dy themelet për zhvillim të një shoqërie të shëndoshë ashtu si e do Krijuesi i Gjithësisë, e ata themele janë pastërtia morale dhe barazia sociale. Ndërkaq Historisë shqiptare i mbetet që Halil Patronës – projektues dhe realizues i një projekti moral dhe social në gjysmën e parë të shekullit 18, t'i gjejë vendin e merituar në gjiun e vet.

*Burimet dhe literatura*


- Shemsettin Sami Frasheri: **Kamusu-l-alam,** Istanbul, 1889-1898.
- **Islam Ansiklopedisi**, 7, Istanbul, 1957,
- **Islam Ansiklopedisi,** 9, Istanbul, 1964,
- Hammer (Baron Joseph Von Hammer Purgstall) **Büyük Osmanlı Tarihi**, 1-10, Istanbul, 2005.
- **Tarihi Osmani,** tekst shkollor i fundshekullit XIX.
- Şukran Kurdakul, **Şairler ve yazarlar sözlüğü**, Ankara, 1973.
- Behcet Nacatigil, **Edebiyatımızda isimler sözlüğü**, Ankara, 1970.
- **Osmanli Devleti Tarihi**, 1,2, Istanbul, 1999.
- Joseph von Hammer, **Historija osmanskog (turskog) carstva**, 3, Zagreb, 1979.
- **Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman**, 1, 2, Tiranë, 2009.
- **Fjalori Enciklopedik Shqiptar**, Tiranë, 1985.
- Ahmet Qeriqi, **Fenomene shqiptare,** (Halil Patrona figurë e anashkaluar) Prishtinë, 2005.

## Përmbajtja

Qemajl Morina
**Mehmet Akif Ersoji - poeti i dy popujve........................................ 5**

Nexhat Ibrahimi
**Pejgamberët e dalluar (أُولُو الْعَزْمِ - Ulu'l-azm)................................ 19**

**Ebu Hamid Muhammed ibn Muhammed El-Gazaliu (1058-1111)..................................................................... 49**

M.M.Sharif
**Filozofia.............................................................................. 95**

Ejup Haziri
**Parimet e Legjislacionit Islam - (2).............................................. 113**

Dr. Munir Xhumua
**Dispozitat e sheriatit... mes stabilitetit dhe fleksibilitetit........... 137**

Dr. Mustafa Ceriq
**Influenca e Maturidiut.................................................................. 147**

Dr. sc. Nehat Krasniqi
**Reflekse të traditës kulturore të vendlindjes në personalitetin e Hasan efendi Nahit....................................... 157**

Qemajl Morina
**Kontributi i Mulla Sadri ef. Prestreshit në edukimin e brezave të ri .......................................................... 169**

Ahmed Ebu Zejd
**Biblioteka e Kajrevanit - thesar i kulturës dhe civilizimit islam ....................................................................... 177**

Liridon Kadriu
**Abetarja e Firencës, e vitit 1942, me elemente islame................ 187**

Mr. Rexhep Suma
**Dialogu kulturor, fetar dhe komunikimi medial........................ 195**

Ramadan Shkodra
**Pozita kushtetuese e Kosovës në federatën jugosllave gjatë viteve 1946-1974 (vështrim historik).................................. 215**

Zachary Karabell
**Evropa dhe Perandoria Osmane ................................................. 237**

Muzafer Shkodra
**Arabistika në revistën "Dituria Islame" Nr. 1-30/31 ................. 265**

Prof. dr. Adem Zejnullahu
**Mitikja dhe fetarja në tri këngë popullore ................................. 283**

Mexhid Yvejsi
**Babai i poezisë - mjeshtri i poetëve Muhammed Rudaki (858-941) .................................................... 293**

Dr. Abdurrahman Rafet el-Basha
**Enes ibn Malik el-Ensari ............................................................. 303**

Prof. dr. Hysen Matoshi
**E vërteta përballë eklipsit komunist........................................... 311**

Akad. Dr. Feti Mehdiu
**Dimensioni etik dhe social i kryengritjes së Halil Patronës ...... 315**

Përmbajtja ......................................................................... 325